



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTET I BIZNESIT DHE EKONOMISË

TEZË DOKTORATURE

**KONSOLIDIMI DHE QËNDRUESHMËRIA E SISTEMIT
PENSIONALTË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË:
QASJE ANALITIKE KRAHASIMORE**

Kandidatja:

Msc. Shpresa Alija

Mentor:

Akademik Abdylmenaf Bexheti

Maj, 2019

Drejt përmbushjes së kërkesës për procesimin e mëtutjeshëm të tezës së doktoraturës, e përcaktuar nga rregullorja e ciklit të tretë të studimeve pranë Universitetit të Evropës Juglindore.

Unë, Shpresa Alija, dorëzoj punën e bërë deri tani në temën: ***“Konsolidimi dhe Qëndrueshmëria e Sistemit Pensional të Republikës së Maqedonisë: Qasje Analitike Krahasimore”***, nën udhëheqjen e Akademik Abdylmenaf Bexhetit, që përmbush kriteret e përcaktuara nga rregullorja e këtij cikli.

PËRMBAJTJA:

HYRJE DHE QËLLIMET E STUDIMIT	9
1. Hyrje	9
2. Lënda e hulumtimit	9
3. Hipotezat	10
4. Pyetjet kërkimore	11
5. Objektivat e studimit	11
6. Metodologjia e studimit	12
7. Struktura e punimit	14
8. Rëndësia e studimit	15
KAPITULLI I: QASJA TEORIKE.....	17
I. 1. Koncepti i pensionit.....	17
I.1.1. Pensioni si nevojë për një skemë kontributesh	17
I.1.2. Pensionet kundrejt mbrojtjes sociale	19
I.2. Teoritë klasike dhe neoklasike mbi skemat pensionale	22
I.2.1. Modelet mbi skemat pensionale	24
I. 3. Skemat pensionale	29
I.3.1. Shtylla e parë si formë e mbështetjes së pleqërisë	30
I.3.2. Shtylla e dytë si formë e mbështetjes së pleqërisë	32
I.3.3. Shtylla e tretë si formë e mbështetjes së pleqërisë.....	35
I.4. Metodat e financimit të skemave pensionale	35
I.5. Skemat pensionale me përfitime të përcaktuara kundrejt skemave pensionale me kontribute të përcaktuara: Cilat janë pengesat reale?	36
I.6. Shembuj të sistemeve pensionale	40
KAPITULLI II: ANALIZË KRAHASIMORE.....	43
II.1. Logjikat e ndryshme të reformës pensionale në drejtim të klasifikimit të sistemeve pensionale ..	43
II.2. Reformat pensionale në shtetet e zhvilluara	46
II.2.1. Reformat pensionale në SHBA	46
II.2.2. Reformat pensionale në Japoni	48
II.2.3. Reformat pensionale në Francë.....	51
II.2.4. Reformat pensionale në Gjermani.....	53
II.3. Reformat pensionale në shtetet në zhvillim	55
II.3.1. Reformat pensionale në Estoni.....	55
II.3.2. Reformat pensionale në Sllovaki.....	56

II.3.3. Reformat pensionale në Poloni.....	57
II.3.4. Reformat pensionale në Slloveni	59
II.3.5. Reformat pensionale në Hungari	60
II.4. Reformat pensionale në shtetet në tranzicion	61
II.4.1. Reformat pensionale në Shqipëri	62
II.4.2. Reformat pensionale në Bosnjë dhe Herecegovinë.....	64
II.4.3. Reformat pensionale në Sërbi.....	66
II.4.4. Reformat pensionale në Mal të Zi.....	67
II.4.5. Reformat pensionale në Republikën e Kosovës.....	69
II.5. Analizë krahasimore e moshës së daljes në pension dhe normës së kontributit.....	70
II.6. Shkaqet e nxitjes së reformave pensionale: analizë krahasimore	72
KAPITULLI III: SISTEMI PENSIONAL I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË: MODALITETET PËR SIGURIM PENSIONAL	75
III.1. Sistemi pensional i Republikës së Maqedonisë: reformat dhe struktura e tij	75
III.2. Specifikat dhe kompanitë që menaxhojnë me fondin e detyrueshëm shtetëror	80
III.3. Specifikat dhe kompanitë që menaxhojnë me fondin vullnetar.....	89
III.4. Agjencioni për mbikëqyrjen e sigurimit pensional me financim kapital.....	95
KAPITULLI IV: PËRPUNIMI DHE SISTEMIMI I TË DHËNAVE	98
IV.1. Elementet e bazës së të dhënave si rezultat i modaliteteve të ndryshme të sigurimit pensional ..	98
IV.1.1. Pensionisti.....	98
IV.1.2. I siguruari	99
IV.1.3. Pensionet dhe llojet e tyre.....	101
IV.1.4. Projektionet e popullsisë.....	101
IV.1.5. Të ardhurat e Fondit	102
IV.1.6. Shpenzimet e Fondit	103
IV.1.7. Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i Republikës së Maqedonisë	104
IV.1.8. Ndikimi i fondeve private tek Fondi për sigurim pensional dhe invalidor.....	105
IV. 2. Struktura e bazës së të dhënave për fondet pensionale	105
IV.2.1. Segmenti demografik.....	105
IV.2.2. Segmenti financiar	107
KAPITULLI V: ANALIZË FINANCIARE E FONDIT PËR SIGURIM PENSIONAL DHE INVALIDOR: ANALIZA EMPIRIKE.....	109
V. 1. Aspekti demografik	109
V.1.1. Natalitetidhe fertiliteti.....	109
V.1.2. Mortaliteti.....	114

V.1.3. Jetëgjatësia	115
V. 2. Aspekti ekonomik	121
V.2.1. Rritja reale e pagave	121
V.2.2. Rritja e kostos së jetesës.....	126
V.2.3. Papunësia.....	128
V.2.4. Rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto	132
V. 3. Aspekti Financiar.....	136
V.3.1. Shpenzimet e tranzicionit	137
V.3.2. Ndryshimi i normës së kontributeve (ulja e saj)	138
V.3.3. Kullimi (përfundimi) i kontributeve në shtyllën e dytë.....	140
V.3.4. Pensionistët e rinj	140
V.3.5. Lëvizja e përgjithshme e të ardhurave të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor në Republikëne Maqedonisë	140
V.3.6. Lëvizja e përgjithshme e shpenzimeve të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor në Republikëne Maqedonisë	142
V.4. Ndikimi i ekonomisë informale në Fondin për sigurim pensional dhe invalidor të Republikës së Maqedonisë.....	144
V. 5. Analiza empirike	150
V.5.1. Qëllimi i analizës empirike dhe arsyeshmëria e përcaktimit të variablave varëse.....	150
V.5.2. Përcaktimi i modelit dhe arsyeshmëria e përcaktimit të variablave të pavarura (shpjeguese) .	151
V.5.3. Teknikat e përdorura gjatë analizës empirike	153
V.5.4. Diagnotifikimi i modelit në rastin e testimit të variables së parë varëse (Pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto)	157
V.5.5. Diagnotifikimi i modelit në rastin e testimit të variables së dytë varëse (Pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto, në raport me normën e varësisë së pleqërisë)	159
V.6. Gjetjet nga analiza empirike	161
V.6.1. Gjetjet nga analiza empirike (faza e parë)	161
V.6.2. Gjetjet nga analiza empirike (faza e dytë)	162
V.7. Testimi i hipotezave	167
V.8. Krijimi i skenarëve.....	175
KAPITULLI VI: KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME	182
Bibliografia	201
Appendix	212

LISTA E TABELAVE:

<i>Tabela 1: Sistemi i mbrojtjes sociale në Republikën e Maqedonisë</i>	20
<i>Tabela 2: Ideologjia Bizmarck kundrejt Beveridge</i>	30
<i>Tabela 3: Vlera e përfitimeve të pensionit si përqindje e pagës</i>	33
<i>Tabela 4: Bilanci i fondit të pensioneve.....</i>	35
<i>Tabela 5: Skema pensionale me përfitime të përcaktuara kundrejt skemës pensionale me kontribute të përcaktuara.....</i>	37
<i>Tabela 6: Karakteristikat e investimeve të skemave me përfitime të përcaktuara dhe skemave me kontribute të përcaktuara ...</i>	38
<i>Tabela 7: Pengesat reale gjatë dizajnit optimal të një skeme pensionale</i>	38
<i>Tabela 8: Klasifikimi i sistemeve pensionale në bazë të peshës relative të secilës shtyllë</i>	43
<i>Tabela 9: Karakteristikat e sistemeve pensionale në bazë të grupit të shteteve që mbulojnë</i>	44
<i>Tabela 10: Politika e reformës së pensioneve në SHBA.....</i>	47
<i>Tabela 11: Politika e reformës së pensioneve në Japoni</i>	49
<i>Tabela 12: Politika e reformës së pensioneve në Francë.....</i>	51
<i>Tabela 13: Politika e reformës së pensioneve në Gjermani.....</i>	53
<i>Tabela 14: Karakteristikat e sistemit pensional Sllovak</i>	56
<i>Tabela 15: Parametrat e skemës së pensioneve në Republikën e Shqipërisë</i>	63
<i>Tabela 16: Parametrat kryesorë të sistemit pensional të Malit të Zi</i>	68
<i>Tabela 17: Mosha e daljes në pension dhe norma e kontributit tek disa nga shtetet e zhvilluara.....</i>	71
<i>Tabela 18: Mosha e daljes në pension dhe norma e kontributit tek disa nga shtetet në zhvillim dhe në tranzicion</i>	71
<i>Tabela 19: Mosha e daljes në pension dhe norma e kontributit tek disa nga shtetet në tranzicion</i>	71
<i>Tabela 20: Shkaqet e nxitjes së reformave pensionale në shtetet e zhvilluara, në zhvillim dhe atyre në tranzicion</i>	72
<i>Tabela 21: Të drejtat dhe kushtet për shfrytëzim të pensionit të pleqërisë, invalidor dhe familjar</i>	76
<i>Tabela 22: Numri i shfrytëzuesve të pensionit dhe numri i personave të punësuar 1991-2017.....</i>	77
<i>Tabela 23: Lëvizja e numrit të përfituesve të pensionit 1991-2017.....</i>	78
<i>Tabela 24: Parametra të rëndësishëm rreth gjendjes së sistemit pensional nga viti 1994-2017 (kolona 2 dhe 3 në million denarë)</i>	79
<i>Tabela 25: Shpërndarja e anëtarësisë sipas statusit të tyre në Sava sh. a Shkup për periudhën 2006-2017</i>	82
<i>Tabela 26: Kontributet e paguara, kompensimet, mjetet neto dhe vlera e njësisë kontabile e fondeve pesnionale të detyrueshëm në Sava sh. a Shkup për periudhën 2006-2017 (shumat janë në milion denarë)</i>	82
<i>Tabela 27: Struktura e investimeve të fondeve të detyrueshme pensionale nga Sava sh. a Shkup për periudhën 2006-2011 (në përqindje).....</i>	83
<i>Tabela 28: Struktura e investimeve të fondeve të detyrueshme pensionale nga Sava sh. a Shkup për periudhën 2012-2017 (në përqindje).....</i>	84
<i>Tabela 29: Pensionet e realizuara për anëtarët e shtyllës së dytë nga Sava Sh.a Shkup për periudhën 2008-2017</i>	85
<i>Tabela 30: Shpërndarja e anëtarësisë në fondin pensional të detyrueshëm sipas statusit të tyre në KB Shoqërinë e parë pensionale për periudhën 2006-2017</i>	86
<i>Tabela 31: Kontributet e paguara, kompensimet, mjetet neto dhe vlera e njësisë kontabile e fondeve pensionale të detyrueshëm në KB Shoqërinë e parë pensionale për periudhën 2006-2017 (në milion denarë).....</i>	86
<i>Tabela 32: Struktura e investimeve të fondeve të detyrueshme pensionale nga ana e KB Shoqëria e parë pensionale për periudhën 2006-2011 (në përqindje)</i>	87
<i>Tabela 33: Struktura e investimeve të fondeve të detyrueshme pensionale nga ana e KB Shoqëria e parë pensionale për periudhën 2012-2017 (në përqindje)</i>	88
<i>Tabela 34: Pensionet e realizuara për anëtarët e shtyllës së dytë nga KB Shoqëria e parë pensionale</i>	88
<i>Tabela 35: Shpërndarja e anëtarësisë në fondin pensional vullnetar sipas mënyrës së antarësisë në Shoqërinë Sava Sh.a Shkup për periudhën 2009-2017.....</i>	90
<i>Tabela 36: Kontributet e paguara, kompensimet, vlerat e mjeteve neto dhe vlera e njësisë kontabile e fondeve pensionale vullnetare në Shoqërinë e pensioneve Sh.a Shkup për periudhën 2009-2017 (në milion denarë)</i>	90

<i>Tabela 37: Struktura e investimeve të fondeve vullnetare pensionale në Shoqërinë e pensioneve Sava Sh.a Shkup për periudhën 2009-2013 (në përqindje).....</i>	<i>91</i>
<i>Tabela 38: Struktura e investimeve të fondeve vullnetare pensionale në Shoqërinë e pensioneve Sava Sh.a Shkup për periudhën 2014-2017 (në përqindje).....</i>	<i>91</i>
<i>Tabela 39: Shpërndarja e anëtarësisë në fondin pensional vullnetar sipas mënyrës së anëtarësimit në KB Shoqërinë e parë pensionale për periudhën 2009-2017</i>	<i>93</i>
<i>Tabela 40: Kontributet e paguara, kompensimet, vlera e mjeteve neto dhe vlera e njësisë kontabile e fondeve pensionale vullnetare në KB Shoqërinë e parë pensionale për periudhën 2009-2017 (në milion denarë).....</i>	<i>93</i>
<i>Tabela 41: Struktura e investimeve të fondeve vullnetare pensionale në KB Shoqërinë e parë pensionale për periudhën 2009-2013</i>	<i>94</i>
<i>Tabela 42: Struktura e investimeve të fondeve vullnetare pensionale në KB Shoqërinë e parë pensionale për periudhën 2014-2017 (në përqindje).....</i>	<i>94</i>
<i>Tabela 43: Të dhënat financiare nga Shoqëria e pensioneve Sava Sh.a Shkup rreth menaxhimit me fondet pensionale (shtyllën e dytë dhe tretë), për periudhën 2006-2011 (në milion denarë).....</i>	<i>95</i>
<i>Tabela 44: Të dhënat financiare nga Shoqëria e pensioneve Sava Sh.a Shkup rreth menaxhimit me fondet pensionale (shtyllën e dytë dhe tretë), për periudhën 2012-2017 (në milion denarë).....</i>	<i>96</i>
<i>Tabela 45: Të dhënat financiare nga KB Shoqëria e parë pensionale rreth menaxhimit me fondet pensionale (shtyllën e dytë dhe tretë), për periudhën 2006-2011 (në milion denarë).....</i>	<i>96</i>
<i>Tabela 46: Të dhënat financiare nga KB Shoqëria e parë pensionale rreth menaxhimit me fondet pensionale (shtyllën e dytë dhe tretë), për periudhën 2012-2017 (në milion denarë).....</i>	<i>96</i>
<i>Tabela 47: Lëvizja e numrit të pensionistëve dhe raporti i punësuar-pensioner për periudhën 1990-2017</i>	<i>98</i>
<i>Tabela 48: Lëvizja e numrit të të siguruarëve për periudhën 1990-2017</i>	<i>100</i>
<i>Tabela 49: Numri i përgjithshëm i popullsisë së Republikës së Maqedonisë</i>	<i>106</i>
<i>Tabela 50: Trendi zhvëllimor i natalitetit të Republikës së Maqedonisë për periudhën 1994-2017</i>	<i>110</i>
<i>Tabela 51: Lëvizja e normës së përgjithshme të fertilitetit të Republikës së Maqedonisë për periudhën 1994-2015 dhe parashikimet e saj për të ardhmen deri në vitin 2050.....</i>	<i>111</i>
<i>Tabela 52: Parashikimi i normës së fertilitetit në tre skenarët e mundshëm (optimist, bazik dhe pesimist), për periudhën 2012-2080</i>	<i>112</i>
<i>Tabela 53: Trendi zhvëllimor i mortalitetit të Republikës së Maqedonisë për periudhën 1994-2017</i>	<i>114</i>
<i>Tabela 54: Top 10-shi i shteteve me jetëgjatësi mesatare më të lartë në botë.....</i>	<i>115</i>
<i>Tabela 55: Jetëgjatësia në disa nga shtetet ballkanike për vitin 2017</i>	<i>116</i>
<i>Tabela 56: Jetëgjatësia në Republikën e Maqedonisë për periudhën 1960-2017</i>	<i>117</i>
<i>Tabela 57: Skenari optimist i parashikimit të jetëgjatësisë së Republikës së Maqedonisë për periudhën 2012-2050</i>	<i>118</i>
<i>Tabela 58: Skenari bazik i parashikimit të jetëgjatësisë së Republikës së Maqedonisë për periudhën 2012-2050</i>	<i>118</i>
<i>Tabela 59: Skenari pesimist i parashikimit të jetëgjatësisë së Republikës së Maqedonisë për periudhën 2012-2050</i>	<i>119</i>
<i>Tabela 60: Vështrim i përgjithshëm i lëvizjes së popullsisë për periudhën 1994-2017 (në mijë)</i>	<i>119</i>
<i>Tabela 61: Harmonizimi i kryer i pensioneve prej vitit 2001-2017</i>	<i>121</i>
<i>Tabela 62: Lëvizja e pages mesatare neto, pensionet mesatare sipas llojeve të tyre dhe raporti pension-pagë për periudhën 1991-2017.....</i>	<i>122</i>
<i>Tabela 63: Pjesëmarrja e llojeve të pensioneve në neto pagën mesatare për periudhën 1991-2017</i>	<i>123</i>
<i>Tabela 64: Lëvizja e indeksit për pagën neto reale dhe nominale për periudhën 1995-2017</i>	<i>124</i>
<i>Tabela 65: Parashikimi i rritjes reale të pagave për periudhën 2013-2055.....</i>	<i>125</i>
<i>Tabela 66: Lëvizja e indeksit të kostos së jetesës për periudhën 1995-2017.....</i>	<i>126</i>
<i>Tabela 67: Parashikimi i rritjes së kostos së jetesës për periudhën 2013-2055.....</i>	<i>127</i>
<i>Tabela 68: Lëvizja e punësimit dhe e papunësisë për periudhën 2004-2017</i>	<i>128</i>
<i>Tabela 69: Lëvizja enormë së punësimit krahasuar me prioritetet strategjike të BE-s% dhe strategjinë kombëtare të punësimit të RM-së</i>	<i>129</i>
<i>Tabela 70: Parashikimet për normën e punësimit dhe papunësisë për periudhën 2013-2055</i>	<i>130</i>
<i>Tabela 71: Lëvizja e Prodhimit të Brendshëm Bruto për periudhën 1998-2017</i>	<i>133</i>
<i>Tabela 72: Pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto për periudhën 1990-2017</i>	<i>134</i>
<i>Tabela 73: Parashikimet për lëvizjen e normës reale të Prodhimit të Brendshëm Bruto për periudhën 2013-2055</i>	<i>135</i>

<i>Tabela 74: Parashikimet e shpenzimeve të tranzicionit për periudhën 2013-2015.....</i>	<i>137</i>
<i>Tabela 75: Humbjet financiare si rezultat i ndryshimit të normës së kontributeve për periudhën 2008-2017</i>	<i>139</i>
<i>Tabela 76: Lëvizja e përgjithshme e të ardhurave për periudhën 1994-2017 (në milion denarë)</i>	<i>140</i>
<i>Tabela 77: Lëvizja e përgjithshme e shpenzimeve pensionale për periudhën 1994-2015 (në milion denarë)</i>	<i>142</i>
<i>Tabela 78: Trendi i punësimit informal në Republikën e Maqedonisë për periudhën 2007-2017</i>	<i>146</i>
<i>Tabela 79: Punësimi joformal, paga minimale dhe mesatare në Republikën e Maqedonisë (2007-2017)</i>	<i>147</i>
<i>Tabela 80: Humbjet financiare nga punësimi informal sipas pagës minimale dhe mesatare (2007-2017)</i>	<i>147</i>
<i>Tabela 81: Variablat e pavaruara dhe arsyeshmëria e përfshirjes së tyre në analizën empirike</i>	<i>151</i>
<i>Tabela 82: Shtetet pjesëmarrëse në analizën empirike, periudha dhe burimi i të dhënave</i>	<i>152</i>
<i>Tabela 83: Testimi i variablave shpjeguese dhe ndikimi i tyre në pjesëmarjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto, për periudhën 2000-2015</i>	<i>163</i>
<i>Tabela 84: Testimi i variablave shpjeguese dhe ndikimi i tyre në pjesëmarjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto në raport me normën e varësisë së pleqërisë, për periudhën (2000-2015)</i>	<i>165</i>
<i>Tabela 85: Testimi i hipotezës kryesore</i>	<i>168</i>
<i>Tabela 86: Testimi i hipotezave ndihmëse</i>	<i>169</i>
<i>Tabela 87: Rezultatet e parashikimeve të treguesëve demografik dhe financiar (ARIMA model), për periudhën 2017-2057 (në denarë).....</i>	<i>177</i>
<i>Tabela 88: Rezultatet nga analiza e regresionit (OLS) për sistemin aktual pensional të Republikës së Maqedonisë</i>	<i>180</i>

LISTA E GRAFIKONËVE:

<i>Grafik 1: Trendi i pjesëmarrjes së shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto, për periudhën 2000-2015</i>	<i>161</i>
<i>Grafik 2: Trendi i pjesëmarrjes së shpenzimeve pensionale në Prodhimin e Brendshëm Bruto, në raport me normën e varësisë së pleqërisë, për periudhën 2000-2015</i>	<i>162</i>
<i>Grafik 3: Parashikimet për treguesit demografik të popullsisë së Republikës së Maqedonisë</i>	<i>për periudhën</i>
<i>2017-2057.....</i>	<i>178</i>
<i>Grafik 4: Parashikimet për treguesit financiarë të sistemit pensional të Republikës së Maqedonisë</i>	<i>për periudhën</i>
<i>2017 - 2057</i>	<i>179</i>

HYRJE DHE QËLLIMET E STUDIMIT

1. Hyrje

Sistemi pensional përfaqëson një sfidë të vazhdueshme si për ligjvënësit, rregullatorët, ashtu edhe për shfrytëzuesit e pensioneve. Madje, edhe dilema kyçe e shume shteteve të zhvilluara dhe atyre në tranzicion mbetet pikërisht drejtimi i zhvillimit të sistemit pensional, respektivisht struktura dhe performanca e tij. Sistemi pensional që nga themelimi e deri më sot funksionon në bazë të parimit të solidaritetit mes brezave dhe ka për qëllim krijimin e fondeve për pensionistët dhe ruajtjen e nivelit pothuajse të njëjtë të jetesës. Ky funksionim, fillimisht u konsiderua si i suksesshëm dhe pa vështirësi gjatë implementimit, ngaqë asokohe jetëgjatësia mesatare ishte rreth 55 vjeç dhe raporti i punësuar-pensioner 7 me 1. Mirëpo, si rrjedhojë e ndryshimeve në strukturën demografike u paraqitën vështirësi në drejtim të zbatimit të parimit të solidaritetit mes brezave, që rezultuan nga rritja e jetëgjatësisë mesatare të njeriut dhe uljes së raportit i punësuar-pensioner.

Ndryshimet strukture demografike që drejtpërdrejtë përcaktojnë lëvizjen e të ardhurave pensionale, shkaktuan përkeqësime në sistemet pensionale, krijimin e borxheve në fondet pensionale, gjegjësisht, ndërmarrjen e reformave pensionale në mbarë botën. Deri në vitin 2007 rreth 170 vende adoptuan dhe miratuan disa reforma në sistemet pensionale që synonin: realizimin e të drejtave për sigurimin pensional dhe invalidor për të gjithë gjeneratat; realizimin afatshkurtër dhe afatgjatë të aftësisë paguese; përforcimin e besueshmërisë së publikut dhe stimulimin e zhvillimit të tregjeve të kapitalit, rrjedhimisht inkurajimin e rritjes ekonomike.

2. Lënda e hulumtimit

Reformat pensionale vazhdojnë të paraqesin një kategori dinamike dhe të vazhdueshme që haset jo vetëm në shtetet e zhvilluara (SHBA, Gjermania, Japonia, Britani e Madhe, etj.), por edhe në shtetet në tranzicion (Shqipëria, Serbia, Mali Zi, Kosova, Sllovenia, Sllovakia etj.). Madje, gjatë kësaj periudhe përqendrimi ishte në drejtim të rishikimit të strukturës, mobilizimit të resurseve për tejkalimin e vështirësive demografike dhe financiare, si dhe përgatitjen e një sistemi i cili ofronte zgjidhjen e vështirësive për periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Për rrjedhojë, nevoja për reformimin e sistemeve pensionale në shtetet në tranzicion vijoi si domosdoshmëri për t'ju gjetur zgjidhje vështirësive të shumta pensionale, si dhe për t'i krijuar instrumentet dhe strukturat e nevojshme ekonomike që do t'u siguronin pensione të gjithë atyre që derdhin kontribute mbi pagën e punës së tyre.

Republika e Maqedonisë përgjatë periudhës transitore po ashtu pësoi në reforma pensionale dhe të sistemit pensional, me qëllim të konsolidimit të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor dhe sigurimit të mjeteve për pagesat e pensioneve. Reformat e aprovuara gjegjëse, dolën kryesisht nga lëvizjet demografike dhe përkeqësimi i raportit i punësuar - pensioner. Andaj, duke u mbështetur në hipotezat dhe pyetjet kërkimore, studimi ynë, merr përsipër të analizoj gjendjen aktuale të sistemit pensional dhe ndikimin e reformave pensionale në funksionimin e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor. Kjo e fundit, na bën të qartë rëndësinë dhe së këndejmi na përcakton qëllimet e hulumtimit. Ky studim, ka për qëllim të shkoqit efektet e sistemit pensional dhe implikimet në administrimin e këtij sistemi për t'ju përgjigjur asaj sesa ky sistem ofron siguri në realizimin e të drejtave për sigurim pensional dhe invalidor për të gjithë gjeneratat, sa ndikon në përforcimin e besueshmërisë së qytetarëve, sa ndikon në stimulimin e zhvillimit të tregjeve të kapitalit dhe inkurajimin e rritjes ekonomike.

3. Hipotezat

Hipoteza kryesore:

1. Indikatorët ekonomik dhe trendi i parametrave demografik bëjnë që sistemi pensional i Republikës së Maqedonisë, në afat të gjatë të jetë jo i qëndrueshëm.

Hipotezat ndihmëse:

1. Rritja ekonomike dhe trendi i punësimit bëjnë që sistemi pensional i Republikës së Maqedonisë deri në vitin 2055 të jetë plotësisht i varur nga burimet shtesë të financimit, respektivisht nga buxheti;
2. Rritja reale e pagave, rritja e kostos së jetesës, papunësia dhe rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto, rezonojnë të jenë me rezultate negative në gjendjen aktuale të sistemit pensional të Republikës së Maqedonisë;
3. Faktorët (për dallim nga ato demografik), që ulin pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto janë faktorët që lidhen me tregun e punës dhe me prodhimin vendor;
4. Me rritjen e kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës ulet edhe pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto;
5. Me rritjen e normës së varësisë së pleqërisë dhe jetëgjatësisë rritet edhe pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto;
6. Përqindja më e lartë e personave të edukuar (nga mosha 55-64 vjeç), rrit edhe pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto;

7. Pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto në raport me normën e varësisë së pleqërisë (pensionistët) është negativisht e lidhur me indikatorët demografik dhe tregut të punës;
8. Masat e uljes së informalitetit në ekonomi në përgjithësi kanë ndikim në të ardhurat e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor.

4. Pyetjet kërkimore

Përgjatë hulumtimit në veçanti do të fokusohemi në përgjigjen e pyetjeve kërkimore që dalin nga ky studim, edhe atë:

- Si kanë ndikuar reformat pensionale të ndërmarra në sistemin pensional të Republikës së Maqedonisë?
- A është përkeqësuar gjendja financiare e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor (ekzaminimi i gjendjes financiare momentale të Fondit)?
- Si ndikojnë faktorët demografik dhe ato ekonomik në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet e Fondit?
- Cilët janë faktorët tjerë (përveç demografik), që ndikojnë në rritjen apo uljen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto?
- Cilat masa mund të korrespondojnë me gjendjen aktuale të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor, e njëherit si mund të ndikojnë këto të fundit në përmirësimin e operimit të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor?

5. Objektivat e studimit

Objektivat e këtij studimi janë:

- Të vlerësoj nevojën për ndërmarrjen e vendimeve konzistente, në drejtim të përmirësimit të gjendjes së Fondit për sigurim pensional dhe invalidor, udhëheqjes dhe performancës së shtyllës së parë, duke mos anashkaluar shtyllën e dytë dhe të tretë si pjesë integrale e modelit të Bankës Botërore;
- Të bëj krahasim objektiv të sistemit pensional aktual me modelet e ngjashme të Evropës, të cilët do të vlerësojnë nevojën për rikonstruim të mëtejme të sistemit pensional të Republikës së Maqedonisë, në përputhje me defektet e hasura, mangësitë e detektuara dhe në përpudhje me parametrat demografik dhe ekonomik;

- Të vlerësoj nevojën për sjelljen e vendimeve dhe masave të cilat do të ndikojnë drejtpërsëdrejti në përforcimin e kapacitetit financiar të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor, reduktimin afatmesëm të deficitit dhe kthimin gradual të funksionimit klasik të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor, kundrejt funksionimit pothuajse nga buxheti;
- Në funksion të korrigjimit të strukturës aktuale formale ligjore dhe menaxhimin me shtyllën e parë, të ofroj mundësi për qasje drejt rregullimit normativ - qasje kjo, e cila do të mundësoj pavarësi të thellë, profesionalizëm dhe funksionim të ndarë nga ndikimi i elitave politike (duke marrë në konsideratë pasojat afatgjate nga vendimet e ndërmarra, edhe përtej mandateve politike).

6. Metodologjia e studimit

Duke u mbështetur në qëllimet e formuluar, objektivat e studimit dhe pyetjet kërkimore, kushtëzohet nga nevoja për përcaktimin e një kornize të përshtatshme metodologjike. Në këtë kontekst, fillimisht në mënyrë simetrike analizohen karakteristikat dhe specifikat e sigurimit pensional të detyrueshëm dhe vullnetar. Në këtë drejtim, rëndësi të veçantë i kushtohet metodës së **analizës strukturore - funksionale**, që bazohet në dokumente dhe raporte zyrtare, punime shkencore, artikuj, ligje dhe akte nënligjore në lidhje me ndryshimet esenciale të sistemit pensional dhe krijimin e sistemit të ri të Republikës së Maqedonisë. Për të vijuar më tej, **përdorimi i metodës krahasuese** është dukshëm i pranishëm në këtë studim, që analizon situatën e sistemit pensional para dhe pas reformës, pra skenimi i gjendjes në të kaluarën dhe asaj sot, e shoqëruar më tej me **metodën statistikore** e cila konstaton problemet me të cilat tanimë ballafaqohet Fondi për sigurim pensional dhe invalidor. Gjithashtu, vemë në funksion **një analizë empirike** - një modeli ekonometrik ku identifikohen faktorët tjerë të cilët konsiderohen si mjaft të rëndësishme dhe afektojnë shpenzimet e pensioneve të pleqërisë.

Po ashtu, studimi ynë merr përsipër të analizoj marrëdhënien mes pesë grupeve të faktorëve që pritet të ndikojnë në pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto dhe pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto, në raport me normën e varësisë së pleqërisë. Duke marrë parasysh kredibilitetin e gjetjeve mbi shpenzimet dhe disponueshmërinë e të dhënave statistikore mbi variablat shpjeguese, më tej i klasifikojmë në grupe të veçanta të faktorëve, edhe atë:

- demografikë: raporti i varësisë së pleqërisë dhe jetëgjatësia deri në moshën 65 vjeç;
- të tregut të punës: kohëzgjatja e marrëdhënies së punës, norma e punësimit për grup-moshën mbi 65 vjeç dhe norma e punësimit për grup moshën 15-64 vjeç;
- të produktit kombëtar: Prodhimi i Brendshëm Bruto, Prodhimi i Brendshëm Bruto për

kokë banori, produktiviteti i punës;

- sipas mjaftueshmërisë së të ardhurave të pensioneve: norma e zëvendësimit;
- sipas nivelit arsimor: përqindja e popullsisë së përgjithshme që kanë përfunduar së paku arsimin e mesëm në grup moshën 55-64 vjeç.

Pas grumbullimit të të dhënave rreth variablave që konsistojnë me grupet e faktorëve të lartpërmendura, vemë në përdorim metodën statistikore *Panel Data*. Kjo e fundit, si metodë statistikore gjen përdorim të gjerë në shkencat shoqërore dhe ka për qëllim observimin e të dhënave gjatë dy dimensioneve, sikurse: “Cross Sectional dhe Times Series”. Të dhënat në fjalë, grumbullohen përgjatë 15 viteve dhe mbi të njëjtin individ (në rastin tonë konkret mbi 10 shtete), e më pas drejtohet një regresion mbi këto dy dimensione. E gjithë kjo analizë, konsiston në ndjekjen e dy fazave:

- **Faza e parë:** përfshin vlerësimin e trendit të pjesëmarrjes së shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto dhe pjesëmarrjes së shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto, në raport me normën e varësisë së pleqërisë;
- **Faza e dytë:** përfshin vlerësimin e modeleve të regresionit panel për të dy variablat e varura, duke lënë anash normën e varësisë së pleqërisë nga set-i i variablave shpjeguese gjatë vlerësimit të modelit që i referohet pjesëmarrjes së shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto, në raport me normën e varësisë së pleqërisë.

Për rrjedhojë, modelet në fjalë do të përlllogariten si më poshtë:

$$\frac{SHP}{PBB_{it}} = \alpha_0 + \alpha_1 NVP_{it} + \alpha_2 J_{it} + \alpha_3 KMP_{it} + \alpha_4 NPG_{(>65)it} + \alpha_5 NPG_{(15-64)it} + \alpha_6 PBB_{git} + \alpha_7 PBB_{pcit} + \alpha_8 PP_{git} + \alpha_9 NZ_{it} + \alpha_{10} AM_{(55-64)it} + v_{it} (1)$$

$$\frac{SHP}{PBB} NVP_{it} = \alpha_0 + \alpha_1 J_{it} + \alpha_2 KMP_{it} + \alpha_3 NPG_{(>6)it} + \alpha_4 NPG_{(15-64)it} + \alpha_5 PBB_{git} + \alpha_6 PBB_{pcit} + \alpha_7 PP_{git} + \alpha_8 NZ_{it} + \alpha_9 AM_{(55-64)it} + v_{it} (2)$$

ku v_{it} paraqet një komponent të përgjithshëm të rastit të bazuar në të dhënat e panelit që mbulojnë gabimet e rastit, si dhe efektet fikse dhe efektet e rastit (duke ju referuar me ‘i’ shteteve). Pra, startojmë me **POOLED OLS Regression Model** si model më i thjeshtë, për të vazhduar me **Fixed Effect**, **Random Effect** dhe me **Generalized Method of Moments** (në tekstin në vijim: GMM) si model më i sofistikuar. Për më tutje, për diagnostifikimin nëse POOLED OLS Regression Model është i qëndrueshëm, shërbehemi me testin e homogjenitetit dhe testin Breusch-Pagan, kurse rreth asaj se a duhej të ndiqet Fixed Effect ose Random Effect shërbehemi

me test-in Hausman, për ta përmbyllur me GMM-in. Po ashtu, vendimin në lidhje me atë se a duhej apo nuk duhej të pranohet hipoteza zero, për secilin test në veçanti marrim për bazë signifkancën në nivel $\alpha = 0.05$. E gjithë kjo procedurë e vlerësimit realizohet përmes software-it, STATA 12.

Metodologjia e studimit në fjalë është rrjedhojë e hapave të mëposhtme:

- ✓ studimi i problematikës së sistemit pensional të Republikës së Maqedonisë dhe dinamika e tij;
- ✓ njohja me bazat teorike dhe analizë e gjetjeve të literaturës së huaj dhe studimeve vendasesa i përket fushës së reformave pensionale;
- ✓ analizë e përvojave të shteteve të zhvilluara, në zhvillim dhe atyre në tranzicion sa i përket reformave të ndërmarra në drejtim të përmirësimit të sistemeve pensionale;
- ✓ ndërtimi i pyetjeve kërkimore, formulimi i hipotezave dhe mënyra e zhvillimit të tyre;
- ✓ ndërtimi i modelit empirik, grumbullimi, përpunimi i të dhënave dhe nxjerrja e rezultateve;
- ✓ nxjerrja e konkluzioneve dhe rekomandimet e ardhshme.

Mbi të gjitha, rrugëtimi i studimit shoqërohet me pjesëmarrjen time në forume, diskutime dhe konferenca, si pjesë të rëndësishme të hulumtimit, duke mos neglizhuar kërkesat akademike në Universitetin e Evropës Juglindore

7. Struktura e punimit

Struktura e këtij punimi konsiston në 6 kapituj. Kapitulli i parë i referohet qasjes teorike bashkëkohore të konceptit të pensionit, identifikimin e shkaqeve që impenjuan sendërtimin e teorive (klasike, neoklasike dhe “klasik- Keynesian”) dhe modeleve pensionale (modeli i ciklit jetësor dhe mbivendosjes së gjeneratave Diamond - Samuelson), përfshirë fokusin tonë në studimet empirike rreth testimit të vlefshmërisë së modelit të ciklit jetësor dhe polemikën e krijuar rreth modelit të mbivendosjes së gjeneratave Diamond - Samuelson. Po ashtu, ky kapitull merr përsipër dhe analizon llojet e skemave pensionale, metodat e financimit të tyre, përparësitë dhe mangësitë kundrejt njëra tjetrës, për ta përmbyllur me identifikimin e pengesave reale që paraqiten gjatë dizejnit të një skeme pensionale dhe paraqitjen e shembujve të sistemeve pensionale.

Kapitulli i dytë fillon me trajtimin e formave të ndryshme të reformës pensionale në drejtim të klasifikimit të sistemeve pensionale. Duke u nisur nga kjo, sjellim elaborimin e 14 shteteve, pra, një kombinim të shteteve të zhvilluara (SHBA, Japoni, Francë dhe Gjermani), në zhvillim (Estoni, Sllovaki, Poloni, Slloveni dhe Hungari) dhe atyre në tranzicion (Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Sërbi, Mal të Zi dhe Kosovë). Kapitulli në fjalë specifikon shkaqet të cilat impenjuan ndërmarrjen e reformave pensionale dhe krijimin e sistemeve aktuale pensionale.

Kapitulli i tretë fokusohet tek modalitetet për sigurim pensional, respektivisht një analize të detajuar të sistemit pensional të Republikës së Maqedonisë, para dhe pas reformave pensionale. Për më tepër, kapitulli trajton sfidat e shtyllës së parë dhe sfidat e sigurimit pensional me financim kapital, përfshirë kompanitë që menaxhojnë fondet pensionale si dhe Agjencionin për mbikëqyrjen e sigurimit pensional me financim kapital.

Kapitulli i katërt merret me krijimin e bazës së të dhënave, gjegjësisht me elementet e bazës së të dhënave, si rrjedhojë e modaliteteve të ndryshme të sigurimit pensional dhe invalidor (pensionistin, të siguruarit, pensionet dhe llojet e tyre, projeksionet e popullsisë, të ardhurat dhe shpenzimet e fondit) dhe me strukturën e bazës së të dhënave për fondet pensionale, rrjedhimisht segmentin demografik dhe financiar.

Kapitulli i pestë i dedikohet analizës financiare të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor, që përfshin tre aspekte: aspektin demografik (natalitetin, fertilitetin, mortalitetin dhe jetëgjatësinë), ekonomik (rritjen reale të pagave, koston e jetesës, papunësinë, rritjen e PBB-së), si dhe aspektin financiar (shpenzimet e tranzicionit, ndryshimin e normës së kontributeve, pensionistët e rinj dhe lëvizjen e përgjithshme të të ardhurave dhe shpenzimeve). Po ashtu, ky kapitull nxjerr rezultatet e analizës empirike përmes përdorimit të modelit ekonometrik që ndikon në rritjen e pjesëmarrjes së shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto dhe pjesëmarrjes së shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto, në raport me normën e varësisë së pleqërisë. Kapitulli i fundit i këtij studimi u referohet konkluzave që rrjedhin nga teza e doktoraturës dhe njëkohësisht rekomandimet që ofrohen në këtë drejtim.

8. Rëndësia e studimit

Problemet e sistemit pensional vazhdojnë të tërheqin vëmendjen e ndërmarrjeve publike edhe atyre private, përfshirë organizatat qeveritare apo joqeveritare. E gjithë kjo për faktin se, pensionet nuk janë çështje e zakonshme pasi që i tangojnë punëdhënësit edhe punëmarrësit. Për me tej, përpjekjet për të zhvilluar një sistem gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm nuk mungojnë as edhe nga ana e Bankës Botërore dhe e Republikës së Maqedonisë. Madje, në Republikën e Maqedonisë janë bërë dhe vazhdojnë të bëhen studime në këtë fushë, që

përfshijnë analizë të sistemit aktual pensional (PAYG) dhe matjen e impaktit të krijimit të shtyllës së dytë dhe tretë të sistemit pensional aktual.

Në mes tjerash, rëndësia e çdo studimi konsiston në aftësinë për të pasuruar dhe shtuar dijet ekzistuese, si dhe në ofrimin e zgjidhjeve për tejkalimin e vështirësive qoftë të aspektit demografik apo atij ekonomik (financiar). Parë nga ky këndvështrim, studimi në fjalë ofron një pasqyrë të funksionimit të sistemeve pensionale në vendet e zhvilluara dhe atyre në tranzicion, si dhe u shtohet përpjekjeve të bëra deri më tani sa i përket krijimit të një sistemi të qëndrueshëm pensional për Republikën e Maqedonisë. Përpos kësaj, nëpërmjet këtij hulumtimi gjenerohen edhe njohuri shtesë të nevojshme për qeverinë dhe politikbërësit, duke mos anashkaluar edhe mundësinë për t'u bërë një burim i mirë informacioni për të gjithë punonjësit, qoftë të sektorit publik apo privat mbi atë se, si do jetë cilësia dhe standardi i jetesës së tyre pas periudhës së daljes në pension.

KAPITULLI I: QASJA TEORIKE

I. 1. Koncepti i pensionit

I.1.1. Pensioni si nevojë për një skemë kontributesh

Vështirësitë pensionale vazhdojnë të zënë një vend të veçantë në diskurset ekonomike nga studiuesit që posedojnë një ekspertizë të gjerë në lëmin e pensioneve. Ekspertiza e tyre konsiston në aftësinë për të qenë njohës të mirë të rregulloreve dhe parashikimeve pensionale, menaxher të kualifikuar të investimeve, por, jo edhe parashikues të pensioneve gjatë planifikimit financiar të ciklit jetësor dhe të rreziqeve financiare që hasen në fondet pensionale. Kjo e fundit na bën me dije se, ekspertiza e tyre njëdimensionale shoqërohet nga një mungesë e njohurive të dimensionit social të pensioneve.

Reformat pensionale shkaktuan një mori pyetjesh thelbësore, sikurse: Çka paraqet një pension, për të vijuar me përkufizimin e sistemit pensional dhe arsyet pse duhet të ekzistojë? Cilat janë qëllimet dhe objektivat e sistemit pensional? Pyetje këto, që impenjuan nevojën për një skemë kontributesh dhe krijimin e modeleve pensionale. Sipas autorit (Bodie, 1989), një pension paraqet një rrjedhje të pagesave që fillon nga momenti që një individ pensionohet dhe vazhdon deri në momentin që individ i vdes, që do të thotë se një pension siguron sigurimin e të ardhurave të jetës prej daljes në pension, për aq kohë sa pensionisti jeton.

Për më tej, një pension ka dy qëllime thelbësore edhe pse politika publike shpesh herë numëron edhe dy objektiva tjera për një skemë pensionale. E para ka për qëllim të ndihmojë familjet në shpërndarjen e burimeve duke zbutur konsumin përgjatë jetës (e përcaktuar në postulatit e ciklit jetësor, e që arrihet përmes transferimit të burimeve të grumbulluara gjatë periudhës së punës në momentin e daljes në pension, përkatësisht në momentin kur të ardhurat e individit shterojnë) dhe e dyta ka të bëjë me sigurimin jetësor, posaçërisht sigurimin në lidhje me rrezikun e jetëgjatësisë. Kurse, sa i përket objektivave shtesë që numëron politika publike, objektivi i parë ka të bëjë me lehtësimin e varfërisë dhe i dyti me shpërndarjen e burimeve shtesë mbi nivelin e varfërisë për disa anëtarë të shoqërisë (Schwarz, 2006).

Në rastin e Republikës së Maqedonisë objektivi kryesor i reformës pensionale mbetet konsolidimi dhe ruajtja e qëndrueshmërisë financiare të sistemit pensional, që nënkupton aftësinë e sistemit për të gjeneruar një situatë të tillë financiare që do të krijoj mundësinë për t'i kënaqur nevojat e përfituesve të sotëm (pensionistëve aktual), pa mos kompromentuar mundësinë për të kënaqur edhe nevojat e përfituesve të ardhshëm. Mirëpo, se cila do kishte qenë forma e duhur sa i përket përzgjedhjes së planit pensional, ndajmë bindjen se fillimisht

duhet shqyrtuar arsyet që impenjuan nevojën për një skemë kontributesh në shoqëritë tradicionale dhe moderne, si dhe këndvështrimin korporativ.

Si gjithnjë, ekziston një bollëk goxha i gjerë i literaturës në këtë drejtim, një gamë e gjerë e studimeve empirike të ndërmarrë nga studiuesit e sferës pensionale. Për shembull: në shoqëritë tradicionale familjet ose komunitetet ishin ata që kujdeseshin për individët që e arrinin pleqërinë, që shndërroheshin në persona me aftësi të kufizuara ose vuanin nga vdekja e kryefamiljarit. Mirëpo, si rrjedhojë e zhvillimit të shoqërisë gjegjësisht modernizimit të saj, njerëzit filluan të lëviznin përgjatë komuniteteve, që rezultoi me zbehjen e lidhjeve familjare duke i lënë të moshuarit dhe individët me aftësi të kufizuara pa një rrjet të përshtatshëm sigurie. Edhe pse individët tentonin të kursejnë, por në mungesë të tregjeve financiare të sigurta kursimet e tyre shpesh merrnin formën e pasurive të patundshme duke u vënë nën rrezikun e luhatjes së çmimeve.

Për rrjedhojë, qeveria mori rolin e vënies në dispozicion të një lloji të sistemit pensional, respektivisht qeveritë ose mbështetnin drejtpërsëdrejti pensionet ose mandatonin pjesëmarrjen e tyre në planet pensionale të ofruara nga punëdhënësit ose ofruesit e pensioneve private. Kjo e fundit, rezultonte nga fenomeni i “miopi¹” dhe “hazard moral²”. Andaj, e vetmja mënyrë që qeveritë mund të kufizonin kostot e kujdesit për të moshuarit ishte ofrimi i një plani pensional për individët të cilët mund ta përballonin atë, e pastaj të kufizonin gradualisht edhe pjesëmarrjen e transfertave të drejtpërdrejta të qeverisë për njerëzit që ishin shumë të varfër dhe nuk ishin në gjendje të kursejnë gjatë periudhës së marrëdhënies së tyre në punë.

Kurse, sipas një këndvështrimi të përgjithshëm korporativ skemat pensionale domosdoshmërisht u krijuan si një preventiv nga pasiguria rreth të ardhurave të daljes në pension, nevoja për të krijuar stimuj për rekrutim dhe mbajtje të forcës punëtore, si dhe nga nevoja për të formuluar një mjet apo sistem efikas të kursimit që rezultoi nga tatimimi. Ky këndvështrim, mund të rishqyrtohet më tej edhe përmes një nënvizimi të tre arsyeve imperative që çuan drejt një skeme pensionale shtetërore dhe korporative, sikurse (Blake, 2006):

¹ “Myopia” një gabim refraktiv i syrit që nuk refrakton dritën si duhet në një fokus të vetëm për të parë qartë imazhet. Në rastin tonë konkret “myopia” simbolizon punëtorët që nuk janë aq largpamës, përkatësisht nuk mendojnë për moshën e vjetër kur janë të rinj dhe të shëndetshëm, andaj momenti kur fillojnë të shqetësohen për moshën e tyre mund të jetë tepër vonë për të ndërmarrë ndonjë hap adekuat për të siguruar veten e tyre (Investopedia).

² “Hazard moral” rreziku që njëra palë që është përfshirë në transaksion ka ofruar informacione mashtruese në lidhje me aktivitet, detyrimet, kapacitetin kreditues ose ka tendencë për të marrë rreziqe të pazakonta në një përpjekje të dëshpëruar, për të fituar fitim para se kontrata të zgjidhet. Pra, “hazard morali” mund të jetë i pranishëm sa herë që palët hyjnë në marrëveshje me njëri-tjetrin, kurse në rastin tonë nënkupton mundësinë e konsumimit sa më shumë që është e mundur në moshën e rinisë, me shpresë së shoqëria do të kujdeset për ato kur të jenë të moshuar (Investopedia).

Arsyeja e parë kishte të bëj me rishpërndarjen dhe sigurimin social që u konsideruan si mjaft të vlefshme për sistemet publike, e që njëherit u ekuivalentuan me një detyrim social për të siguruar në radhë të parë që të gjithë të moshuarit të disponojnë me burime të nevojshme për të përmbushur nevojat e tyre primare. Pavarësisht kësaj, arsyeja thelbësore për shtetin që të ofrojë këtë marrëveshje mbetet ideja se shumë qytetarë nuk ishin aq largpamës për të grumbulluar burime adekuate për daljen në pension (miopi). Kjo pikëpamje paternaliste konsistonte në atë se, shumë segmente të shoqërisë nuk ishin gjithë aq të përparuar për të implementuar rregullimet e duhura.

Sidoqoftë, tiparet e rishpërndarjes nuk mund të merren si një parakusht për një skemë pensionale, por mund të shërbejë si një mekanizëm për transferimin e burimeve nga mirëqenia në segmentet më të varfra të shoqërisë, të cilat nuk mund ta përballonin akumulimin e rezervave adekuate. Pra, skemat me rishpërndarje synojnë të sigurojnë ose duhet që të paktën të sigurojnë një pagesë minimale të pensionit.

Arsyeja e dytë kishte të bëj me inkurajimin e kursimeve private ngase shtetet kishin nevojë për formimin e kapitalit, kurse individët për kurse për ta mbështetur veten e tyre në fazën e vështirësive apo mosarritjes së tyre. Andaj, duke përdorur një kombinim të iniciativave dhe rregullave të mandatuara të kontributeve në fuqi, qeveritë inkurajonin qytetarët që të rrisin shkallën e kursimeve, që do të thotë sesa më e madhe nevoja për kurse aq më e lartë ishte edhe norma e kontributit, e me këtë edhe përfitimi.

Arsyeja e tretë kishte të bëj me sjelljen e dëshiruar e cila vazhdimisht duhej nxitur, ngase një skemë pensionale u mundësonte individëve të miratojnë një model të konsumit të ciklit jetësor që mbronte individët jo aq largpamës, e njëherit duke ju siguruar atyre mjete pas daljes në pension.

Së fundmi, pensionet në nivel korporativ paraqesin një pagë të shtyrë e cila është e pagueshme vetëm nëse punonjësit shfaqin karakteristikat e dëshirueshme, respektivisht integritetin dhe ndershmërinë. Andaj, kompanitë duhet të nxisin sjelljen e dëshiruar duke u treguar të gatshëm për të ofruar kontribute të përshtatshme me qëllim që punonjësit të presin pensionimin me dëshirë dhe jo me ankth.

I.1.2. Pensionet kundrejt mbrojtjes sociale

Sistemi i mbrojtjes sociale përkufizohet si një kornizë politike dhe legislative për mbrojtjen sociale, përfshirë kornizën buxhetore, grupin e programeve specifike të mbrojtjes sociale dhe mekanizmat përkatëse të zbatimit të tyre. Mbrojtja sociale trajton sfidat e varfërisë, cënueshmërisë dhe përjashtimeve sociale. Përdorimi gjithnjë e më shumë i masave të mbrojtjes sociale për lehtësimin e varfërisë, kontribuojnë në rruajtjen e dinjitetit, promovimin e të

drejtave individuale, uljen e varfërisë dhe rritjen ekonomike gjithëpërfshirëse. Këto masa përfshijnë një sërë të skemave kontributeve dhe jo-kontributeve, sikurse: transfertat e parave, skemat e sigurimeve, programet që lehtësojnë qasjen në shërbimet sociale dhe masat e ndërlidhura zhvëllimore për të promovuar jetesën dhe përfshirjen financiare. Pra, kur këto shërbime integrohen me iniciativat tjera plotësuese zhvëllimore, japin ndikime mbi varfërinë, cënueshmërinë dhe përjashtimin social (Samson and Taylor, 2015).

Kohët e fundit, ekzistojnë qasje konceptuale të ndryshme për të analizuar objektivat dhe ndikimet e mbrojtjes sociale, ku secila qasje koncepton ndikimet e mundshme në mënyra të ndryshme, sa i përket: transformimit, kapitalit njerëzor, cënueshmërisë dhe të drejtave të njeriut. Sidoqoftë (Devereux and Sabates-Wheeler, 2004), ofrojnë qasjen konceptuale më të përdorur që përshkruan katër funksionet bazë të mbrojtjes sociale, sikurse: mbrojtja³, prandalimi⁴, promovimi⁵ dhe transformimi⁶.

Fillimisht, tre funksionet e para (tre PS në kuadrin e PPP + T) janë konceptuar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës, kurse shtimi i elementit të katërt synon jo vetëm të lehtësoj varfërinë, por edhe të ndryshoj jetën përmes ndjekjes së politikave që ribalancojnë marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit që shkaktojnë cënueshmëri (International Labour Organization, 1919)⁷. Andaj, duke u nisur nga ky përshkrim i shkurtër i mbrojtjes sociale sjellim strukturën e sistemit të mbrojtjes sociale të Republikës së Maqedonisë:

Tabela 1: Sistemi i mbrojtjes sociale në Republikën e Maqedonisë

Mbrojtja sociale	Sigurimet sociale
1. Përfshirja sociale 2. Mbrojtja institucionale 3. Mbrojtja jashtë institucionale 4. E drejta për ndihmë sociale	1. Sigurimi pensionale dhe invalidor në bazë të pagesës aktuale 2. Sigurimi i detyrueshëm pensional më financim të plotë 3. Sigurimi i pleqërisë me kohëzgjatje të shtuar 4. Sigurimi shëndetësor 5. Sigurimi në rast të papunësisë

³ Mbrojtja si objektiv specifik ka sigurimin e lehtësimit nga humbja (p.sh. përfitimet nga të ardhurat, pensionet shtetërore).

⁴ Parandalimi drejtpërsëdrejti dhe duke përdorur mënyra të ndryshme kërkojnë shmangien nga humbja (p.sh. sigurimet shoqërore, fondet e kursimeve).

⁵ Promovimi që synon rritjen e aftësive dhe të ardhurave (p.sh. inputet).

⁶ Transformimi që nënkupton përfshirjen dhe barazinë sociale, të drejtat dhe fuqizimin.

⁷ Sidoqoftë, në praktikë ndërhyrjet për mbrojtjen sociale zakonisht mbulojnë funksione dhe objektiva të shumëfishta ku vetëm sipas draftit preliminar për zhvillim të qëndrueshëm të ndërmarrë nga këshilli për lidhshmëri të Zhvillimit të Qëndrueshëm (Sustainable Development Solutions Network), mund të numërojmë (Indicators for Sustainable Development Goals, 2014): zvogëlimin e varfërisë me të gjitha format e saja; sigurimin e jetës së shëndetshme dhe promovimin e mirëqenies për të gjithë dhe në të gjitha moshat; arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave; nxitjen e rritjes ekonomike të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, punësimin e plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë; uljen e pabarazisë brenda dhe mes vendeve.

Në Republikën e Maqedonisë sistemi i mbrojtjes sociale përfshin mbrojtjen sociale dhe sigurimet sociale me nënkategoritë e tyre (Ministria për punë dhe politikë sociale). Duke u nisur nga kjo konstatojmë se, ekzistojnë dallime thelbësore mes pensionit dhe mbrojtjes sociale, edhe atë në dy aspekte:

- të administrimit
- të financimit

Në aspekt të administrimit ndonëse disa programe të mbrojtjes sociale mund të ngjasojnë me pensionet, prap se prap, asnjë pjesë e mbrojtjes sociale apo e programeve nuk administrohen si skemë pensionale, që do të thotë se mbrojta sociale ofron një gamë të gjerë përfitimesh ku njëra prej tyre është edhe përfitimi për të moshuarit, përderisa pensionet paraqesin përfitime të cilat sigurohen nga individit duke paguar në një skemë pensionale, apo që paguhet nga punëdhënësi. Për këtë arsye, shpesh herë njerëzit ngatërrojnë përfitimet e të moshuarve me përfitimet pensionale. Po ashtu, kur jemi tek aspekti administrativ vlen të theksohet se përgjegjësia kryesore për organizimin e mbrojtjes sociale publike dhe ndihmës i takon Ministrisë së punës dhe politikës sociale. Institucionet përgjegjëse për ndihmë sociale dhe për dorëzimin e ndihmës sociale janë: Qendrat për çështje sociale, Institucionet për mbrojtje sociale, si dhe Kopshtet e fëmijëve që vetëm i rregullon dhe mbikëqyr Ministria për punë dhe politikë sociale, ndërkohë që operativisht vetë funksionojnë. Kurse, të drejtat dhe shërbimet për sigurim social realizohen nëpërmjet Fondit për sigurim pensional dhe invalidor (përfshirë edhe kompanitë private të pensioneve), si dhe nëpërmjet Fondit për sigurim shëndetësor dhe Agjencisë së punësimit.

Në aspekt të financimit mbrojtja sociale paraqet një program qeveritar, e që përgjatë hartimit të buxhetit ndahet vijë buxhetore e posaçme për financimin e programeve të ofruara nga ana e Ministrisë së punës dhe politikës sociale, ndërkohë që pensionet financohen në mënyra të ndryshme, respektivisht përmes kontributit në një skemë pensionale ose hapjes së një llogarie bankare që shërben si formë kursimi, e që luan rolin e pensionit në moshën e pleqërisë. Pra, programet e mbrojtjes sociale financohen nga buxheti, kurse pensionet financohen nga punëdhënësi apo nga qeveria, e në varësi se si është lidhur marrëveshja bëhet edhe shfrytëzimi i këtyre mjeteve - pensionit (kur individit mbush moshën e daljes në pension apo kur i nevojiten individit)

Së fundmi, mund të themi se mbrojta sociale dhe sigurimet sociale administrohen dhe financohen në mënyra të ndryshme, si dhe dizajnohen për kategori njerëzish të ndryshëm.

I.2. Teoritë klasike dhe neoklasike mbi skemat pensionale

Nevoja e transformimit të PAYG sistemit në skemë pensionale plotësisht të financuar, përkatësisht lidhja e kursim - investimeve, luajti rol kyç në ndikimin e skemave pensionale të pafinancuara apo të financuara në raport me rritjen ekonomike. Ky raport, çoi në krijimin e modelit klasik, neoklasik si dhe alternativën e tretë “Klasik - Keynesian”. Modeli klasik i rritjes, favorizoi një reformë të skemës plotësisht të financuar që mori në konsideratë investimin e kursimeve. Neoklasikët, konsideronin pay-as-you-go si të dëmshëm për kapitalin e akumuluar dhe favorizuan skema plotësisht të financuara, kurse pala e tretë “Klasik - Keynesian” u bazuan në kohëzgjatjen e postulave Keynesiane të investimeve të pavaruara nga kursimi, respektivisht përkrahës të sistemit PAYG ose të paktën neutral në lidhje me akumulimin dhe në lidhje me çfarëdo qoftë reforme që synonte nxitjen e kursimit si të dëmshëm për rritjen e kërkesës agregate. Madje, Keynes në “teorinë e përgjithshme” të tij tentoi të dëshmoj se brenda kufijve të shfrytëzimit të plotë të kapacitetit të prodhimit, një nivel më i lartë i investimeve nuk kërkon një reduktim paraprak të konsumit dhe se niveli më i lartë i prodhimit dhe të ardhurat e gjeneruara nga shfrytëzimi më i madh i kapacitetit prodhues, gjenerojnë nivel të kursimeve ekuivalent me vendimet për të investuar (Cesaratto, 2005).

Ekonomitë e reja klasike, prap se prap reflektojnë pikëpamjet para-Keynsiane, gjegjësisht mbrojnë idenë se në periudhë afatgjate investimi është i pavarur nga kursimet dhe se kapaciteti prodhues mund të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme. Parë nga ky këndvështrim, ekonomistët dallojnë dy pozita “Klasike-Keynsiane”, pra, atyre që i atribuohen teorisë kritike të kapitalit të teorisë së Keynes dhe grupit të dytë që merren me identifikimin e mekanizmave që janë prapa rregullimit të kursimeve për investime afatgjate.

Të parët, sa i përket kërkesave efektive i atribuohen teorisë kritike të kapitalit të teorisë së Keynes, rrjedhimisht kufizojnë rolin e kërkesës efektive në rastet e periudhës afatshkurtër në të cilën ngurtësia e normës së interesit ose reagimi i ngadaltë i investimeve në rast të një rënie të normave të interesit parandalon rënien e pagave nominale ose zgjerimin e ofertës së parasë, duke dërguar ekonominë përsëri në punësim të plotë. Pra, Keynes hapi rrugën për sintezat neoklasike duke theksuar mundësinë se një normë më e lartë e kursimit mund të rezultojë në më shumë metoda intensive të prodhimit “indirekt” ose kapitale, kurse kundër kësaj mundësie argumentoi se ekuilibri i ri mund të kërkojë një metodë prodhimi të “tërthortë”, respektivisht iu referua ngurtësisë së normës nominale të interesit në prani të një rënie në normën natyrore, e që vazhdon me rritje të mëtejshme të kursimit.

Rreth kësaj të fundit (Garegnani, 1970), sugjeroi se rezultatet e polemikave mbi teorinë e kapitalit të frymëzuar nga (Sraffa, 1960) mund të vërtetojnë parimin Keynes'ian të pavarësisë së investimit nga kursimi, ngase teoria e kapitalit kritik në mënyrë rigoroze dhe të përgjithshme dëmton shumë mundësi të rrjedhjes së kërkesës për faktorët e prodhimit. Ky derivim mbështet në dy mekanizma alternativ, sikurse: (a) zëvendësim i drejtpërdrejt i faktorëve në prodhim dhe/ose në rast kur koeficientët e prodhimit janë fiks dhe (b) zëvendësim indirekt i faktorëve që operojnë nëpërmjet rregullimeve në përbërjen optimale të shportave konsumatore të konsumit, si përgjigje ndaj ndryshimit të çmimeve relative (Solow, 1970).

Për rrjedhojë, mekanizmi i parë i zëvendësimit parashikon se kur norma e interesit ulet, metoda e prodhimit të kapitalit intensiv bëhet më shumë fitimprurës, rrjedhimisht kërkesa e kapitalit rritet. Po ashtu, polemika ka treguar se kur ka një shumëllojshmëri të teknikave dhe më shumë se një lloj të kapitalit të mirë, mundësitë e teknikave të reja kalojnë dëmin e këtij parashikimi neoklasik (Sraffa, 1960; Garegnani, 1970). Mirëpo, sipas teorisë margjinale rënia e çmimit të çdo faktori shpie në një rënie të çmimit relativ dhe në një rritje të kërkesës për mallrat, ku faktori i prodhimit është përdorur në mënyrë relative. Por, ashtu siç paga reale ndryshon nga zero në maksimum, çmimi i çdo malli të prodhuar X duke përdorur një teknikë të caktuar mund të rritet dhe të ulet në lidhje me çmimin e një malli të prodhuar Y që përdorën një teknikë tjetër të caktuar, që do të thotë se nuk ka një pritje “a priori” për drejtimin e ndryshimit bazuar në “intensitetin e faktorit” gjatë prodhimit të dy mallrave (Sraffa, 1960). Pra, polemika e Piero Sraffa plotëson hipotezat Keynes'iane se kursimet derivohen nga investimet, e jo anasjelltas siç parashikon teoria tradicionale.

Të dytët nisen nga identifikimi i mekanizmave që janë prapa rregullimit të kursimeve për investime afatgjate. Sipas teorisë së kërkesës efektive afatgjate motori i rritjes përfaqësohet nga komponenti autonom ose final i kërkesës agregate. Këto të fundit nuk varen nga niveli aktual ose i pritjes së të ardhurave reale të krijuara nga vendimet e firmave për të prodhuar, e që e përbëjnë: konsumi autonom, shpenzimet qeveritare dhe eksportet. Shpenzimet autonome përfshijnë transferet sociale nga shteti - pagesat e pensioneve PAYG. Pra, në aspektin klasik-Keynes'ian, shpenzimet sociale përfaqësojnë një motor të rritjes dhe se nuk ka asnjë kontradiktë midis barazisë së madhe sociale dhe rritjes (Cesaratto, 2003).

Së fundmi, zgjerimi i “Shtetit të Mirëqenies” mund t'i parandalojë pengesat politike të pranimit të ndryshimeve në aspekt të shpërndarjes, rrjedhimisht tatim më i lartë mbi fitimet nga klasat e pasura. Ekonomitë perëndimore zgjerimin e “Shtetit të Mirëqenies” e vendosën në kushtet historike të pas Luftës së Dytë Botërore, ndonëse në fund të viteve 1970-ta roli i shtetit në shpërndarjen sociale ishte nën sulm permanent. Për më tej, në teorinë margjinale kontradikta mes “barazisë” dhe “efikasitetit” është më mekanike dhe në përputhje me teorinë

në fjalë, transfertat e pensioneve zvogëlojnë të ardhurat, përkatësisht reduktojnë vendimet e kursimeve dhe te akumulimit.

I.2.1. Modelet mbi skemat pensionale

Strukturat pensionale dizajnohen për të siguruar të ardhura për individët që vuajnë një humbje në kapacitetin e të ardhurave si pasojë e moshës së avancuar, përvojës së aftësisë së kufizuar ose vdekjes së personit që siguron të ardhurat në familje. Për rrjedhojë, ekonomia e pensioneve merret me alokimin e këtyre burimeve të pakta gjatë ciklit jetësor, pra, gjatë periudhës kur një individ punon dhe del në pension. Kjo e fundit, shkakton implikime mikroekonomike dhe makroekonomike, që më së miri mund të elaborohen përmes modelit të ciklit jetësor dhe modelit të mbivendosjes së gjeneartave.

Modeli i ciklit jetësor (lifecycle model - LCM)

Marrja e vendimeve individuale për pension llogaritet si komponenti i parë i mikroekonomisë së pensioneve. Modeli tradicional për shqyrtimin e vendimmarrjes individuale për pension është modeli i ciklit jetësor nga Ando dhe Modigliani (1957, 1963), i zgjeruar më vonë nga Merton (1969, 1971). Ky model mbështetet në idenë e një individi (racional dhe mirë i informuar) që planifikonte konsumin e tij gjatë gjithë ciklit jetësor bazuar kryesisht në parashikimet e tij për të ardhurat jetësore. Pra, si motiv kryesor për të kursyer paraqitej grumbullimi i mjeteve për të rruahtur konsumin aktual edhe në pension.

Po ashtu, modeli i ciklit jetësor bazohet në vëzhgimin empirik se konsumi agregat për kokë banori ishte më pak i qëndrueshëm në krahasim me të ardhurat agregate për kokë banori - të ardhurat e përfaqësuesit individual (Blake, 2006). Në një kontekst të ciklit jetësor sugjeron se, individët me kalimin e kohës do të tentojnë të zbusin konsumin e tyre. Si rast më tipik kemi ndarjen e jetës së një individi në dy periudha: periudha e rinisë dhe punës dhe periudha e pleqërisë dhe daljes në pension. Mirëpo, përmes huamarrjes dhe kreditimit ky i fundit u zgjerua më tej duke e ndarë ciklin jetësor në tre periudha, edhe atë: periudha e të rinjve, periudha mes moshës së mesme dhe ajo e pleqërisë.

Në periudhën e parë kur individi fillon punën menjëherë pasi përfundon arsimin e rregullt, shpenzimet e individit si rezultat i dëshirës për të blerë pasuri fizike dhe të krijoj familje i kalojnë të ardhurat, përkatësisht individi merr hua. Në periudhën e dytë individi fillon të kursejë për dalje në pension duke akumuluar një fond të aseteve financiare dhe fizike, ngase nivelet e larta të shpenzimeve zvogëlohen, rrjedhimisht të ardhurat tejkalojnë konsumin (individi arrin t'i paguaje huamarrjet e periudhës së parë). Në periudhën e daljes në pension individi shpenzon më shumë se të ardhurat e tij, më shumë se çka fituar në një periudhë kohe të caktuar, mbase tërheq mjetet financiare të grumbulluara gjatë periudhës nga mosha e mesme - deri në vdekje.

Në fakt, shpenzimet e konsumit mund të jenë më të ulta se në fazën e para pensionimit, mirëpo të ardhurat e individit janë dukshëm më të ulëta se në fazën e para pensionimit.

Andaj, në rast mungese të një sistemi pensional individ përfundon në një nivel më të ndjeshëm në standardin jetësor, nëse nuk ka kursyer në mënyrë adekuate për daljen në pension. Madje, për individin do ishte mjaft e vështirë të merr hua, nëse nuk ka perspektivë të të ardhurave të ardhshme me të cilat do të paguaje huanë. E sigurisht, duke e kuptuar në kohë individ do të planifikojë të reduktojë shpenzimet e konsumit në nivelin e të ardhurave dhe të gëzojë konsum më të lartë se të ardhurat kur të ardhurat janë relativisht të ulta. Kjo e fundit, njihet si kursim për pension, e si rrjedhojë e këtij kursimi konsumi bëhet më i qëndrueshëm se të ardhurat. Po ashtu, kursimet për daljen në pension shpiejnë në akumulimin e mjeteve financiare që tërhiqen pasi individ del në pension.

Pra, modeli i ciklit jetësor parashikon se konsumi është i qëndrueshëm gjatë gjithë ciklit jetësor, kursimet parashikohen të jenë pozitive për individët që punojnë dhe negative për individët në pension (Modigliani, 1986).

Studime empirike rreth testimit të vlefshmërisë së modelit të ciklit jetësor

Pavarësisht atraksioneve të shumta teorike që qarkullonin asokohe rreth modelit të ciklit jetësor, studimet e hershme empirike nuk është se ofruan një mbështetje të madhe për modelin e ciklit jetësor. Madje, një pjesë e studimeve empirike gjetën edhe dëshmi që binin në kundërshtim me parashikimet e modelit të ciklit jetësor se, pasuria e krijuar gjatë jetës është e orientuar gjatë daljes në pension. Për shembull: (Darby, 1977), (Kotlikoff and Summers, 1981) dhe (Laitner and Juster, 1996), përgjatë hulumtimeve të tyre erdhën në përfundim se, në SHBA “pasuritë e ciklit jetësor” që rrjedhnin nga kursimet e grumbulluara përbënin më së shumti 30% të aseteve të përgjithshme amerikane, pra, pjesa tjetër ishte e trashëguar. Po ashtu (Danziger et al., 1982), (Poterba, 1994) dhe (Horioka et al., 1996), zbuluan se të moshuarit në SHBA dhe në Japoni nuk është se zotërojnë pasurinë mjaftueshëm shpejt për të qenë në përputhje me modelin e ciklit jetësor, ndonëse realisht morën pjesë në grumbullimin e pasurisë në SHBA.

Për më tej, mospërputhje të ngjashme me modelin e ciklit jetësor u dëshmuan edhe përmes fakteve tjera të shfaqura, e që një pjesë e tyre konstatuan se rritja e pasurisë së sigurimeve shoqërore tenton të ulë kursimet, ndërkohë që rritja e pasurisë së pensionit privat tenton të rrisë kursimet. Rreth kësaj të fundit kemi edhe gjetjet: (Kotlikoff, 1979) dhe (Leimer and Richardson, 1992) duke u mbështetur në të dhënat e SHBA-së konstatuan se, pasuria e sigurimeve shoqërore zëvendësoi pasurinë private prej 0.6 - 0.67 në vend të 1, edhe pse modeli i jetëgjatësisë u konsiderua si i vlefshëm. Kurse (Takayama, 1990), erdhi në konstatim se një rritje e pasurisë së sigurimeve shoqërore uli raportin japonez të kursimeve.

Ndonëse gjetjet empirike paraprake e argumentuan se ekzistojnë mospërputhje rreth modelit të ciklit jetësor, një raport i zhdrejtë mes pasurisë së sigurimeve sociale dhe kursimeve, një lidhje e fortë mes këtyre dy treguesëve, prap se prap, studiuesit e asokohe hasën edhe në fakte të cilët kundërshtonin lidhjen mes pasurisë së sigurimeve sociale dhe kursimeve, e se kjo e fundit nuk ishte gjithaq e rëndësishme. Për shembull: (Blinder et al., 1983), (David and Menchik, 1987) dhe (Green, 1981) duke u mbështetur në të dhënat e Mbretërisë së Bashkuar arritën në përfundim se, rritja e kursimeve të pensioneve profesionale rriti kursimet diskrecionare jo - pensionale, me koeficient në rangun 0.48 - 1.19 në vend se 1, ndonëse zëvendësimi është konsideruar si i përsosur.

Sidoqoftë, autorët (Jappelli and Modigliani, 2003) përgjatë hulumtimit të tyre hasën në kundërshtim me gjetjet paraprake duke treguar se, në pension kursimet në vend që të rriten ato ulen dhe nuk është se përcaktohen në mënyrë të përshtatshme kursimet. Andaj, duhej përcaktuar standardi i kursimeve ku sipas një përkufizimi të përshtatur nga studimet në fjalë, standard i kursimeve tregoi diferencën mes të ardhurave të disponueshme, respektivisht pasasë së gatshme dhe konsumit. Sidoqoftë, ky përkufizim i kursimeve në njërën anë injoroi kontributet e derdhura në skemat e pensioneve gjatë marrëdhënies në punë, kurse nga ana tjetër përfshiu pensionin e parave të gatshme të marra në pension⁸.

Pra, studimet e hershme empirike nuk arritën të ofrojnë një mbështetje të fortë sa i përket modelit të ciklit jetësor, duke arritur në një përkufizim të pasaktë të kursimeve. Mirëpo, dëshmitë empirike erdhën në përfundim se: pensionet shtetërore pakësojnë nevojën për të kursyer privatisht për dalje në pension, ndonëse efekti i tyre në nxitjen e daljes në pension të parakohshëm është i dobët; pensionet private profesionale rrisin kursimet dhe inkurajojnë pensionimin e parakohshëm; si dhe pensionet private personale gjithashtu rritin kursimet, por inkurajojnë pensionimin e mëvonshëm.

Modeli i mbivendosjes së gjeneratave (Overlapping Generations Model -OLG)

Modeli i mbivendosjes së gjeneratave Diamond - Samuelson (Overlapping Generations Model-OLG) u konsiderua si gurë themeli i makroekonomisë moderne, një model dinamik ekonomik që përgjithësoi modelin e ciklit jetësor. Filloi me një individ përfaqësues nga secili brez dhe grumbullohej tek të gjithë individët që njëkohësisht jetonin. Po ashtu, sjellja e

⁸Autorët që u morën me modelin e ciklit jetësor argumentuan se, përkufizimi përkatës i të ardhurave është fitimi i të ardhurave nga puna dhe prona, e për këtë arsye përkufizimi përkatës i kursimeve është diferenca mes të ardhurave të fituara neto dhe konsumit. Për rrjedhojë, nevojitet përkufizim përkatës i kursimeve gjatë gjithë periudhës së marrëdhënies në punë, përfshirë kontributet e derdhura në skemat e pensioneve (qoftë publike apo private, të detyrueshme ose vullnetare), që do t'ju shtohen më tej të ardhurave të arkëtuara, për t'u nxjerrë të ardhurat e fituara (pasi që këto kontribute paguhën nga të ardhurat e fituara dhe prandaj duhet të shtohen përsëri në të ardhurat në para të gatshme). Gjithashtu, gjatë daljes në pension pensioni duhej të zbritej nga të ardhurat në para, ngase pensionet nuk janë pjesë e të ardhurave të fituara.

individëve, kompanive dhe qeverive në modelin OLG-ë supozohej me kalimin e kohës të ndikoj në sjelljen dinamike të ekonomisë (Blake, 2006).

Modeli i mbivendosjes së gjeneratave Diamond - Samuelson për herë të parë u zhvillua në vitin 1958 nga Samuelson, e më tej nga Diamond në vitin 1965, ku sipas tyre individët janë përcaktuar gjeneratave që kanë jetuar një periudhë të caktuar (me kohëzgjatje të caktuar), sipas datës së lindjes, e në çdo kohë më shumë se një gjeneratë do të jenë gjallë. Secila gjeneratë do të tregtoje me gjeneratën para dhe pas në faza të ndryshme të jetës së tyre. Po ashtu, OLG-ë modeli mund të përdorej për të studiuar pasojat agregate të individëve nga kursimet e ciklit jetësor. Modeli më i thjeshtë i mbivendosjes së gjeneratave ishte modeli i dy periudhave, respektivisht në çdo moment ekzistonin dy breza: brezi i ri dhe i vjeçër. Në vijim, shkurtimisht do të paraqesim gjendjen e gjeneratës së tranzicionit gjatë transformimit të PAYG skemës drejt skemës pensionale të financuar, përkatësisht se çka ndodhi me pensionet në modelin e mbivendosjes së gjeneratave në rastin kur oferta e punës dhe dalja në pension ishin ekzogjene, si dhe në rastin kur oferta e punës dhe dalja në pension ishin endogjene.

1. Nga skema PAYG drejt skemës pensionale të financuar në rastin kur oferta e punës dhe dalja në pension ishin ekzogjene mbështeti idenë se, ekziston një sistem PAYG në një ekonomi dinamike efikase. Po ashtu, gjenerata e parë që merrte këtë pension ishin në gjendje më të mirë krahasuar me gjeneratat tjera që u përkeqësuan. Mirëpo, a thua sa ishte e mundur në një ekonomi dinamike të bëhej kalimi në një sistem pensional të financuar duke e përmirësuar eficiencën Pareto?

Gjenerata e tranzicionit që i përkiste gjeneratës së re në kohën e transferimit humbej. Kjo e fundit, duhej të paguante dy herë për pensionin e saj. Së pari, derdhnin kontribute për të paguar pensionet e gjeneratës së vjeçër që i përkisnin sistemit PAYG, e njëkohësisht ishin në pritje të marrjes së pensionit PAYG kur të plakeshin - pension ky, që nuk do të paguhej më. Së dyti, të kontribuojë në skemën e pensioneve plotësisht të financuara. E nëse asgjë tjetër nuk ndodhte, gjenerata e përkohshme pa dyshim ndodhej në një situatë të palakmueshme nga futja e sistemit plotësisht të financuar, andaj ishte e pamundur zhvendosja e një skemë të pa financuar në një skemë pensionale të financuar pa mos e përkeqësuar gjeneratën e tranzicionit - gjeneratë kjo, që duhej të paguante si për pensionin e vet të financuar plotësisht, ashtu edhe për pensionin PAYG të gjeneratës së mëparshme.

2. Nga skema PAYG drejt skemës pensionale të financuar në rastin kur oferta e punës dhe dalja në pension ishin endogjene nuk shkaktoi përmirësimin Pareto, ngase në kohën e reformës nuk mund të gjendeshin burimet për të kompensuar gjeneratën e vjeçër pa e përkeqësuar gjeneratat e ardhshme.

Mirëpo, sipas (Homburg, 1990) dhe (Fredrich and Martin, 1991), kur oferta e punës ishte endogjene dhe kontributet në sistemin PAYG ishin proporcionale me të ardhurat, sistemi PAYG ishte shtrembërues. Në këtë rast një zhvendosje graduale në një sistem plotësisht të financuar mund të arrihej duke shkaktuar një përmirësim të mirëqenies (eficienca Pareto), për aq kohë sa, taksat e pashtrembëruara mund të përdorëshin gjatë fazës së tranzicionit. Burimet lëshoheshin duke lëvizur nga një sistem shtrembërues në një sistem joshtrëmberues, e që njëkohësisht u përdorën për të kompensuar gjeneratën e humbur. Pra, kur oferta e punës dhe dalja në pension ishin endogjene dhe u përgjigjeshin taksave, atëherë kalimi gradual nga një skemë e pa financuar në një skemë plotësisht të financuar ishte e mundur (duke e përmirësuar mirëqenien - eficienca Pareto), për aq kohë sa taksat e pashtrembëruara përdorëshin në fazën e tranzicionit.

Polemika rreth modeli të mbivendosjes së gjeneratave Diamond - Samuelson

Ashtu sikurse në modelin e ciklit jetësor, mospërputhje të ngjashme u hasën edhe në modelin e mbivendosjes së gjeneratave të Diamond - Samuelson, respektivisht polemika e njohur e Samuelson - Lerner'it që kishte të bëjë me kritikën e Abba Lerner (1959) mbi atë se, sistemi PAYG shërben vetëm si një “zinxhir letrash” ku çdo gjeneratë i premttohej se transferet në të ardhmen do ju kthehen në një normë pozitive. Po ashtu, Lerner duke u mbështetur në praktikën kombëtare të kontabilitetit, pohoi se skema PAYG shërben si një pajisje përmes së cilës penzionerët aktual mbrohen nga produktet sociale aktuale që prodhohen nga punëtorët aktual. Lerner, në mes tjerash nënvizoi se fiksioni i sigurimit nuk pati të bëjë aq shumë me analizat ekonomike, sesa me pranueshmërinë politike të PAYG-ut (Cesaratto, 2005).

Kjo e fundit, nxiti më tej debatin e njohur “post Samuelson-Lerner” ku me ç'rast, Meeropol duke shfrytëzuar linjat e Lernerit theksoi se “fiksioni”, ku siguria sociale nuk konsiderohej si program për rishpërndarjen e të ardhurave, por, si ndihmesë në rruajtjen e mbështetjes së gjerë politike hapi një rrugë të mundshëm për “sulm” ndaj atyre që nuk ju pëlqente kjo ide. Ky deklaram i Meeropol'it, ishte konstatuar më herët edhe nga Milton Friedman që akuzonte përkrahësit e Samuelsonit për shitje, kur realisht skema PAYG shërbente si një pajisje për përfitime tatimore (në fund ata realisht shitnin një letër zinxhir). Po ashtu, shënimet e Cohen-it luajtën rol të rëndësishëm që nga momenti i prezantimit të elementit politik në shpejgimin e sistemit PAYG si një institucion social.

Pechman për dallim nga Milton Friedman u prononcua me një reagim shumë më ndryshe mbi sistemin PAYG, gjegjësisht se mënyra më e mirë për ta mbrojtur sistemin në fjalë ishte njohja dhe pranimi i natyrës së sistemit si një sistem transferimi i taksave (siç bëri Friedman) dhe si një marrëveshje e institucionalizuar mes gjeneratave të punës dhe jo të punës (punëtorëve dhe pensionistëve). Kjo e fundit, u trajtua më tej nga Cambell që theksoi se,

tatimpaguesi realisht konceptohet si pagues i taksave dhe jo si përfitues pensional (Cesaratto, 2005).

Pra, modeli i mbivendosjes së gjeneratave para se gjithash konsiderohet si një mjet i fuqishëm për analizimin e sistemeve pensional, ku secili brez trajton dy breza: brezin e mëparshëm dhe bresin pas tij. Po ashtu, treguesi kryesor i shtetit në modelin e mbivendosjes së gjeneratave të Diamond - Samuelson është kapitali fizik që paraqet rrugën dinamike në tërësi. Për rrjedhojë, kur oferta e punës dhe dalja në pension në modelin Diamond-Samuelson janë ekzogjene dhe kur futet një sistem pensional shtetëror i financuar plotësisht, nuk paraqitet ndryshim në rrugën dinamike të ekonomisë, përderisa fondi investon në stokun e kapitalit dhe gjeneron të njëjtin ritëm të kthimit si në kursimet private. Në të kundërtën, nëse futet një sistem PAYG pa financim rezultati është jo - neutral. Pra, skema e pa financuar është më e lartë se skema e financuar vetëm nëse plotësohet kushti i Araonit, gjegjësisht shkalla e rritjes në popullsi (e cila është e barabartë me shkallën e kthimit në skemën e pafinancuar), e tejkalon shkallën e kthimit në stokun e kapitalit (që është i barabartë me normën e kthimit në një skemë të financuar).

Përfundimisht, me një ofertë pune ekzogjene është e pamundur të zhvendosesh nga një skemë e pa financuar në një skemë pensionale të financuar, pa mos e përkeqësuar gjeneratën e tranzicionit që duhet të paguajë si për pensionin e vet të financuar plotësisht, ashtu edhe për pensionin PAYG të gjeneratës së mëparshme. Kurse, kur oferta e punës dhe dalja në pension janë endogjene dhe u përgjigjen taksave, atëherë kalimi gradual nga një skemë e pa financuar në një skemë të financuar është e mundur dhe duke e përmirësuar mirëqenien (eficienca Pareto), për aq kohë sataksat e pashtrembëruara mund të përdoren gjatë fazës së tranzicionit.

I. 3. Skemat pensionale

Pensionet apo dalja në pension mund të konsiderohet si sajim i ekonomive të zhvilluara që ngadhnjeu mes fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX. Andaj, për njerëzit që jetojnë në vendet e zhvilluara është konvencionale të flitet për sistem pensional shumë shtyllësh i projektuar nga Banka Botërore dhe për sistem pensional i strukturuar në plane pensionale, fonde pensionale dhe ente pensioni⁹.

⁹ Modeli i strukturuar nga ana e Bankës Botërore përbëhet nga tre shtylla: shtylla e parë që paraqet formën e detyrueshme me përfitime të përcaktuara dhe e menaxhuar nga sektori publik; shtylla e dytë paraqet formën e detyrueshme me kontribute të përcaktuara dhe që menaxhohet nga sektori privat (kompanitë dhe fondet pensionale); si dhe shtylla e tretë si formë vullnetare dhe që menaxhohet nga sektori privat (kompanitë dhe fondet pensionale).

1.3.1. Shtylla e parë si formë e mbështetjes së pleqërisë

Shtylla e parë si pjesë e sistemit të sigurimeve sociale sigurohet nga shteti. Ekzistojnë dy lloje të sistemeve të sigurimeve sociale: Beveridge dhe Bizmarck. Në vitin 1942, William Henry Beveridge prezantoi përpara parlamentit britanik sistemin Beveridge që ofronte një mbështetje të mjaftueshme (kujdes bazik), e për njerëzit që dëshironin të gëzonin një standard më të lartë jetësor pritej që të bënin një zgjedhje alternative (Britania e Madhe dhe SHBA kanë sistemin e sigurimit social Beveridge). Kurse, sistemi Bizmarck i krijuar në vitin 1983 nga Otto Von Bizmarck ofroi mbështetje shumë më bujare, në një nivel që nuk kërkonte individët të bënin marrëveshje shtesë (Gjermania, Italia dhe Franca posedojnë sistemin e sigurimit social Bismarck-ian).

Tabela 2: Ideologjia Bizmarck kundrejt Beveridge

Funksionet	Bizmarck	Beveridge
Baza ligjore	Kontributet	Nënshtetësia/qëndrimi
Baza për financim	Paga	Të gjitha të ardhurat publike
I siguruari	Profesional	Shteti
Paketa e fitimit	E qartë	E nënkuptuar
Menaxhment	I pavarur	Qeveria
Burimet ose ofruesi	Nëpërmjet kontratës private	Paga dhe kontratat publike
<i>Burimi: OECD, 1st annual meeting of SBO network on health expenditure, 2011</i>		

Pra, sistemi Bizmarck synoi të sigurojë një standard jetësor të balancuar përgjatë gjithë jetës së të siguruarit, ndërkohë që sistemi Beveridge fokusohej në ofrimin e nivelit ekzistencial për të siguruarit. Mirëpo, edhe përkundër dallimeve në funksionim, prap se prap sistemet në fjalë nuk mund të përjashtonin njëri tjetrin, ngase të dy sistemet kishin për qëllim reduktimin e varfërisë dhe pabarazisë e të ardhurave, rrjedhimisht nxitjen e kohezionit social dhe përmirësimin e efikasitetit të ekonomisë, si dhe përmirësimin e sigurisë individuale dhe lehtësimin e rreziqeve sociale.

Shumica e skemave pensionale të shtyllës së parë janë jofinanciare, të definuara për nga natyra apo skema me kontribute të përcaktuara imagjinare (të njohura ndryshe si pay-as-you-go). Këto të fundit paraqesin skema të pafinancuara ku anëtarët kanë llogari individuale të kontributeve të përcaktuara. Për dallim nga skemat me kontribute të përcaktuara - të financuara (Financial Defined Contribution - FDC), kontributet e anëtarëve të vendosura në llogaritë individuale nuk janë të “financuara”, që do të thotë se mjetet e akumuluar në llogaritë individuale të anëtarëve nuk investohen në instrumentet e tregjeve financiare, por, janë të lidhura me një variabël jofinanciare (me normën e rritjes së Bruto Prodhimit të Brendshëm ose me normën e rritjes së të ardhurave mesatare kombëtare). Kurse, mjetet në skemat me kontribute të përcaktuara të financuara investohen në asetet e tregut financiar. Pra, skema pay-as-you-go me llogari individuale të përcaktuara paraqet një skemë imagjinare me kontribute të

përcaktuara (si shembull kemi Suedinë dhe Poloninë të cilët eksperimentuan me skemat jofinanciare imagjinare me kontribute të përcaktuara - Notional Defined Contribution)¹⁰.

Për më tej, është e rëndësishme të potencohen dy dallimet esenciale mes skemës me kontribute të përcaktuara imagjinare dhe asaj me kontribute të përcaktuara të financuara, edhe atë (Holzmann and Palmer, 2006):

- Së pari, ndryshojnë në lidhje në kontributin e tyre potencial në kursimet kombëtare. Një skemë me kontribute të përcaktuara imagjinare (pay-as-you-go) ofron kontribut të drejtpërdrejt në kursim, përderisa skema me kontribute të përcaktuara të financuara kontribuon në kursimet kombëtare nga faza e ndërtimit deri në maturim, e se efekti i mundshëm në kursimin kombëtar do të varet nga demografia e pjesëmarrësve;
- Së dyti, ndryshojnë në raport me normën e sistemit të kthimit. Pjesëmarrësit në skemën e parë fitojnë një normë të brendshme të kthimit që përcaktohet nga faktorët që qëndrojnë pas zhvillimit të ekonomisë, ndërkohë që pjesëmarrësit në skemën e dytë fitojnë një normë të kthimit të përcaktuar nga tregu financiar.

Pra, në një skemë me kontribute të përcaktuara imagjinare pjesëmarrësit ose punëdhënësit në emër të tyre paguajnë kontribute për të ardhurat gjatë gjithë karrierës së tyre. Kontributet e secilës periudhë vendosen në një llogari të veçantë individuale, e që rriten me kontribute të reja dhe njëherit kreditohen me një normë kthimi, përkatësisht norma e brendshme e kthimit. Po ashtu, përfitimi nga kjo skemë është pensioni jetësor që mund të kërkohet në çdo kohë nga minimumi i moshës së daljes në pension. Kjo e fundit na bën me dije se, ky përfitim nuk mund të sigurojë për të gjithë mbulim të mjaftueshëm në moshën e pleqërisë, ngase për një ose më shumë arsye jo të gjithë individët kanë akumuluar të ardhura të mjaftueshme para daljes në pension.

Megjithkëtë, kjo është një karakteristikë me të cilën identifikohet çdo përfitim i varur nga të ardhurat pa mos anashkaluar faktin se formula e pensioneve në këtë skemë nuk përmban rishpërndarje të brendshme të të ardhurave të sistemit, që do të thotë se kjo skemë duhet të plotësohet me një formë të skemës së mbështetjes me të ardhura të ulëta. Gjenerimi i skemës me kontribute të përcaktuara imagjinare (pay-as-you-go) përfshin kapitalin imagjinar - joreal, anuitetin, normën e brendshme të kthimit dhe ekuilibrin financiar¹¹. Sidoqoftë, ajo që është më thelbësore është fakti se pjesëmarrësit në skemën me kontribute të përcaktuara imagjinare

¹⁰ Skemat me kontribute të përcaktuara imagjinare (pay-as-you-go) ndryshojnë nga skemat financiare në aspektin e efikasitetit ekonomik.

¹¹ Gjenerimi i skemës me kontribute të përcaktuara imagjinare (pay-as-you-go) përfshin këto elemente: kapitalin imagjinar (joreal), anuitetin, normën e brendshme të kthimit dhe ekuilibrin financiar (Blake, 2006).

financohen me të hyra ekzogjene, rrjedhimisht nga të ardhurat e përgjithshme tatimore (Holzmann and Palmer, 2006)¹².

I.3.2. Shtylla e dytë si formë e mbështetjes së pleqërisë

Shtylla e dytë sigurohet nga kompanitë në formën e skemave ose planeve pensionale profesionale. Fondet e pensioneve profesionale financohen nga fondi i mjeteve pensionale të grumbulluara nga kontributet ose shpërblimet e paguara nga punëdhënësi dhe punonjësi, si dhe nga kthimi i investimeve nga kontributet e investuara. Pensioni paguhet nga fondi i përlllogaritur sapo anëtari pensionohet, edhe pse ndonjëherë fondi i akumuluar i jepet ndonjë shoqërie të sigurimit jetësor që obligohet t'i siguroj pensionistit një pension jetësor. Për më tej, ekzistojnë tre kategori të anëtarëve të skemës, edhe atë: anëtari aktiv që punon për kompaninë dhe kontribuon në të; anëtari në pension që ka dalë nga kompania dhe tërheq një pension; dhe anëtari i shtyrë, gjegjësisht punëtor i cili nuk punon më për kompaninë dhe nuk ka dalë në pension, por, ka fituar të drejtën e pensionit në bazë të shërbimit të tij të mëparshëm për kompaninë dhe anëtarësinë e tij në skemë, e që kjo e fundit bëhet e pagueshëm kur anëtari i shtyrë tërhiqet nga puna e tij e fundit.

Ndonëse shumica e skemave pensionale profesionale janë të financuara, prap se prap, llogaritja e përfitimeve të pensionit mund të ndryshojë shumë mes llojeve të ndryshme të skemave. Duke u nisur nga kjo, ekzistojnë tre lloje kryesore të skemës pensionale profesionale, edhe atë: skema pensionale me përfitime të përcaktuara, me kontribute të përcaktuara dhe hibrid apo me origjinë të përzier (Blake, 2006).

1. Skemat pensionale me përfitime të përcaktuara

Skema pensionale me përfitime të përcaktuara siguron një "përfitim të përcaktuar", një pension të paracaktuar qoftë në monedhë absolute ose si një pjesë e një mase të pagës (përqindje e përcaktuar e pagës përfundimtare ose një mesatare e pagës së viteve të fundit). Po ashtu, përfitimi i përcaktuar dhe njëkohësisht i garantuar mund të shprehet në terma real dhe nominal, ndërkohë që pjesëmarrësit dhe sponsorët (ose të dyja), me kalimin e kohës kontribuojnë në mënyra të ndryshme. Raporti i pensionit ose përfitimi për një masë të pagës njihet si "shkalla e zëvendësimit".

¹² Vetitë e skemës me kontribute të përcaktuara imagjinare (pay-as-you-go) janë: vlera aktuale e përfitimit jetësor e një individi në çdo kohë është e barabartë me bilancin e llogarisë së individit; për të ruajtur normën e kontributeve fikse asetet e skemës duhet të jenë të barabarta ose të jenë më të mëdha se detyrimet e përgjithshme; ekuilibri financiar kërkon që llogaritë të vlerësohen në normën $g + \rho$, etj (Holzmann and Palmer, 2006).

Skema më e thjeshtë me përfitime të përcaktuara ofron një pension fiks që varet nga fitimet ose inflacioni pasues. Sidoqoftë, lloji më i zakonshëm i skemës me përfitime të përcaktuara është skema e pagave përfundimtare ku pensionet e paguara lidhen drejtpërsëdrejti me pagën e fituar në vitin e fundit të punësimit, ose mesatarja e tre ose pesë viteve të punës të anëtarit të skemës. Për rrjedhojë, pensioni aktual paraqet një pjesë të pagës përfundimtare ku fraksioni llogaritet si një produkt i normës akruale (p.sh. 1%) dhe numrit të viteve të shërbimit (Blake, 2006).

Tabela 3: Vlera e përfitimeve të pensionit si përqindje e pagës

Viti i punësimit	Vlera aktuale e përfitimeve të reja të fituara (%)	Vlera e përfitimeve të përlogaritura (%)
1	0.32	0.32
10	0.98	6.88
20	3.10	32.58
30	9.18	115.68
40	26.08	365.14

Burimi: Pension Economics, David Blake, fq.24

Tabela e mësipërme tregon se përfitimet janë të ngarkuara dhe se vlera aktuale e përfitimeve të fituara në çdo vit është më e madhe në vitet e mëvonshme, se sa në vitet e mëparshme. Mbingarkimi i përfitimeve shkaktohet nga vlera kohore e parasë dhe inflacioni. Pra, një punëtor i moshuar është më afër daljes në pension se një punëtor i ri, andaj vlera aktuale e një njësie shtesë të përfitimit të pensionit është më e lartë për punëtorin e moshuar. Kurse, inflacioni rrit mbingarkimin duke rritur normën nominale të interesit dhe pagat nominale. Pra, me çdo vit shtesë punësimi fitohet një vit shtesë shërbimi dhe rrjedhimisht paga nominale bëhet më e lartë.

Si lloj tjetër i skemës me përfitime të përcaktuara kemi skemën e bilancit të daljes në pension ku përfitimi përcaktohet në terma të një shume fikse dhe jo si pension, e që zakonisht matet si shumëfish i shumës akruale, si përqindje specifike e pagës mesatare të viteve të punës dhe viteve të shërbimit. Skemat me përfitime të përcaktuara gjithnjë e më shumë zëvendësohen me skemat me kontribute të përcaktuara. Andaj, se çka ofron kjo skemë dhe si funksionon do e shqyrtojmë në vijim.

2. Skemat pensionale me kontribute të përcaktuara

Në skemat pensionale me kontribute të përcaktuara kontributet mund të jenë shuma fikse vjetore ose përqindje fikse e pagës dhe se pensioni varet nga vlera e fondit të akumuluar deri në kohën e daljes në pension. Nëse vlera e fondit të akumuluar është e ulët (si rrjedhojë e kontributeve të ulta ose performancës së dobët të investimeve) pensioni do të jetë i ulët, e nëse vlera e fondit është e lartë atëherë pensionet do të jenë në nivel të lartë. Pra, skemat me

kontribute të përcaktuara për dallim nga skemat paraprake nuk tregojnë as suficit dhe as deficit.

Po ashtu, kontributet mund të paguhen nga anëtari, punëdhënësi ose nga një kombinim i të dyjave. Nëse punëdhënësi pajtohet të paguajë një pjesë të kontributeve të anëtarit dhe pasi këto të jenë paguar, punëdhënësi nuk ka asnjë detyrim tjetër ndaj anëtarit në lidhje me pensionin. Kjo e fundit na bën me dije se, skemat me kontribute të përcaktuara karakterizohen me mundësi transferi të mirë duke i bërë ata lehtësisht të transferueshme mes vendeve të punës (Blake, 2006). Ndonëse karakterizohen me mundësi të mirë transferimi, prap se prap pensioni përfundimtar është i pasigurt, ngase varet tërësisht nga performanca e aktiveve të kontributeve të grumbulluara. Prandaj, dy individë me kontribute identike, por portofole të ndryshme të investimeve mund të marrin pensione gjerësisht të ndryshme, ashtu sikurse dy individë me histori kontribute identike mund të marrin pensione gjerësisht të ndryshme, përgjatë periudhave të ndryshme kohore.

Mirëpo, si rrjedhojë e ndryshimeve në ligjet tatimore ose si rezultat i kontributeve ekzistuese të cilat sigurojnë një shkallë zëvendësimi të pamjaftueshëm apo të tepërt është e mundur që kontributet me kalimin e kohës të ndryshojnë. Kjo e fundit, çon më tej në një dallim thelbësor mes dy skemave, respektivisht skemës me përfitime të përcaktuara dhe me kontribute të përcaktuara, sikurse: ***“Në skemën me përfitime të përcaktuara rezultati përfundimtar është i definuar (përqindja e zëvendësimit të synuar që duhet t'u paguhet pjesëmarrësve është artikuluar nga ofruesi - Fondi për sigurim pensional dhe invalidor), përderisa tek skema me kontribute të përcaktuara rezultati përfundimtar është i ndryshueshëm”*** (Modigliani and Muralidhar, 2005).

3. Skemat pensionale hibride (me origjinë të përzier)

Skemat hibride kanë përmbajtjen e përbërësve të skemës pensionale me përfitime të përcaktuara dhe me kontribute të përcaktuara. Si shembuj kryesor të skemave pensionale me origjinë të përzier mund të numërojmë: skemën sekuenciale hibride, hibride të kombinuara, marrëveshjet mbështetëse, skemën e bilancit të parasë, skemën me përfitime të synuar, etj (Wesbroom and Reay, 2005)¹³.

¹³ Skema sekuenciale hibride përfshinë një element të skemës me kontribute të përcaktuara dhe një element të skemës me përfitime të përcaktuara. Skema hibride e kombinuara ofron një pension me përfitime të përcaktuara deri në një kufi dhe një pension me kontribute të përcaktuara në lidhje me pagën mbi këtë kufi. Marrëveshjet mbështetëse ku marrëveshja e parë ka të bëjë me një skemë me kontribute të përcaktuara dhe me një mbështetje me përfitime të përcaktuara, kurse marrëveshja e dytë ka të bëjë me një skemë me përfitime të përcaktuara dhe me një mbështetje me kontribute të përcaktuara. Skema e bilancit të parasë (cash-it) paraqet një skemë me përfitime të përcaktuara në të cilën përfitimi është përcaktuar si një llogari individuale brenda skemës. Skema specifikon normën e kontributit dhe normën e kthimit të investimeve që do të kreditohet në llogarinë e anëtarit. Skema e përfitimit të synuar paraqet një skemë me kontribute të përcaktuara që ka për qëllim të ofrojë një pension të synuar, dhe se kontributet duhet të përshtaten me kalimin e kohës nëse fondi nuk e arrin ose e tejkalon objektivin.

I.3.3. Shtylla e tretë si formë e mbështetjes së pleqërisë

Shtylla e tretë njihet ndryshe si një kursim shtesë për daljen në pension që individi zgjedh përpos atyre që ofrohen nga shteti ose kompania për të cilën individi punon. Këto të fundit, zakonisht mbahen në llogaritë e depozitave ose në fondete përbashkëta të investuara në aksione ose në obligacione. Nëse një individ vendosën të kursej nëpërmjet një skeme formale pensionale, mënyra e kursimit do të jetë pothuajse e njëjtë sikurse tek skema me kontribute të përcaktuara, të njohura ndryshe si skema personale pensionale ose si llogari individuale për dalje në pension (Blake, 2006).

I.4. Metodat e financimit të skemave pensionale

Sistemet pensionale mund të kategorizohen në bazë të përfitimeve që ata premtojnë dhe në bazë të mënyrës se si i financojnë këto premtime. Duke u nisur nga kjo, ekziston një zgjedhje mes dy llojeve të skemave pensionale, edhe atë: me përfitime të përcaktuara dhe kontribute të përcaktuara. Kurse, sa i përket mënyrës së financimit dallojmë skema pensionale të bazuara në skema PAYG dhe skema pensionale plotësisht të financuara.

Shumica e sistemeve të sigurimeve sociale janë PAYG apo skema me përfitime të përcaktuara ku pjesëmarrësit e tanishëm janë të obliguar të derdhin kontribute për të paguar përfitimet e pensionistëve të tanishëm. Në një skemë PAYG të pastër nuk ka akumulim fondesh pasi që të gjitha kontributet e derdhura nga ana e forcës punëtore disbursohen në shërbim të pensionistëve. Kurse, skemat korporative ose profesionale me përfitime të përcaktuara dhe kontribute të përcaktuara kanë tendencë të financohen pjesërisht dhe plotësisht. Për rrjedhojë, financimi kërkon një akumulim të fondeve para daljes në pension për t'u shërbyer detyrimeve të ardhshme. Fondet e akumuluar në shtyllën e dytë investohen më tej në asete të tregtueshme ose jo të tregtueshme.

Tabela 4: Bilanci i fondit të pensioneve

Asetet aktuale		Përfitimi nga pensioni
Kontributet e ardhshme		
Kthimet e ardhshme		
Raporti financiar = Asetet / përfitimi nga pensioni		
Burimi: Muralidhar 2001. E përshtatur nga Innovations in Pension Fund Management nga Arun S. Muralidhar, 2001 nga Board of Trustees of the Leland Stanford Jr. University, me lejen e botuesit.		

Siç mund të shihet nga tabela mësipër disa kombinime të kontributeve dhe kthimeve të pasurive përdoren për të shërbyer pensionet, ndonëse ekzistojnë këndvështrime të ndryshme rreth skemës me kontribute të përcaktuara se a janë plotësisht të financuara apo jo?!

Sipas (Logue and Rader, 1997), skemat me kontribute të përcaktuara janë gjithmonë të financuara plotësisht. Kjo e fundit konsiderohet si e vërtetë në kuptimin që pensionet paguhen tërësisht nga cilido kapital që është akumuluar, por mund të keq interpretohet në drejtim të asaj se sponsori është indiferent ndaj madhësisë së pensionit (shumë hulumtues gabimisht supozojnë se edhe sponsorët dhe pensionistët janë indiferentë ndaj pensionit të paguar në skemat me kontribute të përcaktuara).

Madje, edhe në një skemë me kontribute të përcaktuara është kritike që pjesëmarrësit të kenë një shkallë zëvendësimi të synuar (e pa garantuar), të zgjedhin kontributin e tyre, politikën e investimeve ose të gjitha bashkë për të arritur targetin e tyre - pensionin. Duke u bazuar në këtë të fundit (Muralidhar et al., 1998b), sugjerojnë se planet me kontribute të përcaktuara janë të pafinancuara nëse asetet në plan nuk janë të mjaftueshme për të ofruar një nivel zëvendësimi të synuar.

Së fundmi, pavarësisht metodës së financimit një bilanc i fondit të pensioneve mund të distilohet, përkatësisht metodat e ndryshme të financimit u kushtojnë më shumë rëndësi kontributeve ose aseteve të akumuluar dhe kthimeve të aseteve për të paguar përfitimet e premtuara. Ngjashëm reformat pensionale mund të fokusohen në përfitimet, politikën e kontributit dhe politikën e investimeve që shoqërohen më tej me ndryshime dhe rregullim institucionale të sistemit të sigurimit social të një vendi (Muralidhar, 2001).

I.5. Skemat pensionale me përfitime të përcaktuara kundrejt skemave pensionale me kontribute të përcaktuara: Cilat janë pengesat reale?

Programet pensionale të punëdhënësve ndonëse ndryshojnë për nga mënyra e hartimit dhe për nga legjislacioni i tyre (Akti për Sigurim të të Ardhurave të Pensionit të Punonjësve - ERISA), prap se prap, klasifikimi i tyre konsiston në dy lloje kryesore: skema pensionale me përfitime të përcaktuara dhe skema pensionale me kontribute të përcaktuara. Mirëpo, cilët janë përparësitë kundrejt njëra tjetrës, çka ofron secila skemë në veçanti sjellim tabelën vijuese (Modigliani and Muralidhar, 2005):

Tabela 5: Skema pensionale me përfitime të përcaktuara kundrejt skemës pensionale me kontribute të përcaktuara

Skema pensionale me përfitime të përcaktuara	Skema pensionale me kontribute të përcaktuara
1. Skemat me përfitime të përcaktuara sigurojnë të ardhura të qëndrueshme të pensionit bazuar në paga. Të drejtat e përfitimit të pensionit të punonjësit përcaktohen nga formula që merr parasysh vitet e shërbimit për punëdhënësin dhe në shumicën e rasteve pagat.	1. Skemat me kontribute të përcaktuara ofrojnë më pak të ardhura të parashikueshme për dalje në pension, varësisht nga performanca e investimeve. Punonjësi ka llogari individuale dhe të drejtë zgjedhje në lidhje me llojin e aseteve në të cilën akumulimi është investuar.
2. Skemat me përfitime të përcaktuara shpërndajnë rrezikun e investimeve në një numër të madh individësh të moshave të ndryshme dhe gjatë horizonteve të ndryshme kohore ¹⁴ .	2. Tek skemat me kontribute të përcaktuara horizonti kohor është jeta e një individi (Orszag and Stiglitz, 1999).
3. Skemat me përfitime të përcaktuara kanë kosto më të ulëta për menaxhimin e aseteve.	3. Skemat me kontribute të përcaktuara u mundësojnë individëve që të përshtatin portofolion e tyre ndaj rrezikut që ata dëshirojnë të bartin. Individët marrin pjesë në të gjitha fitimet dhe humbjet e tyre që shoqërohet me një kosto më të lartë përgjatë menaxhimit të pasurive të tyre.
4. Skemat me përfitime të përcaktuara ofrojnë sigurim për një periudhë të gjatë (longevity), dhe mundësia që paratë të mbarojnë para se individi të vdejë është kryesisht jo ekzistuese, përveç në rast të moskujdesit të sponsoruesit që rezulton më tej me mungesë të mbulimit të sigurimit.	4. Skemat me kontribute të përcaktuara nuk ofrojnë sigurime dhe pensionet mund të jenë të shtrenjta për t'u blerë. Mirëpo, transferimi i parave trashëgimtarëve në rast vdekjeje të parakohshme është e mundur vetëm në skemat me kontribute të përcaktuara, ndonëse skemat me përfitime të përcaktuara ofrojnë përfitime për të mbijetuarit.

Pas shqyrtimit të skemës pensionale me përfitime të përcaktuara kundrejt skemës me kontribute të përcaktuara, në vijim duke marrë për bazë karakteristikat e investimit që këto skema veçmas ofrojnë, sjellim një krahasim mes skemës me përfitime të përcaktuara dhe asaj me kontribute të përcaktuara.

¹⁴ Sponsori i skemës mbart rrezikun e investimit të planit, ka një kornizë shumë më të gjatë dhe një kapacitet shumë më të lartë të rrezikut për dallim nga individët tjerë në skemë.

Tabela 6: Karakteristikat e investimeve të skemave me përfitime të përcaktuara dhe skemave me kontribute të përcaktuara

Përfitimet e përcaktuara	Kontributet e përcaktuara
Siguron përfitime të qëndrueshme	Lejon përputhjen e flukseve të parasë së gatshme me nevojat eventuale
Sponsoruesi i skemës bartën rrezikun	Individët bartin rrezikun
Shpërndanë rresikun e investimit	Individi ka të drejtë zgjedhje në investime
Ofron sigurim kundrejt jetëgjatësisë	Lejon që pasuria të trashëgohet
Një kombinim i skemave mund të jetë më i favorshëm	
<i>Burimi: Muralidhar, 2001.</i>	

Tabela e mësipërme përmbledh krahasimin e planeve me përfitime të përcaktuara dhe me kontribute të përcaktuara, prandaj është e qartë se një përzjerje e karakteristikave të investimit të planeve me përfitime të përcaktuara dhe atyre me kontribute të përcaktuara do të kënaqte një grup më të madh individësh, sesa çdo lloj plani në veçanti¹⁵.

Duke shqyrtuar përparësitë e skemave përkatse dhe karakteristikat e investimeve që secila nga këto skema ofrojnë, ndajmë bindjen se gjatë dizajnit optimal të një skeme pensionale paraqiten edhe një mori pengesash reale. Për rrjedhojë, dizajni optimal i një skeme pensionale ka të ngjarë të jetë një specifik e fortë e cila zakonisht ballafaqohet me pengesa reale (Bodie et al., 1988). Në këtë pikë, ajo që mund të bëhet është detektimi i tyre me kujdes, listimi i pengesave reale dhe përshkrimi i rrethanave në të cilat një skemë pensionale mund të dominojë (tabela në vijim).

Tabela 7: Pengesat reale gjatë dizajnit optimal të një skeme pensionale

Pengesat reale	Shkaqet e paraqitjes së pengesave
1. Zgjedhja dhe performanca e investimit	Skemat me kontribute të përcaktuara ofrojnë fleksibilitet të mjaftueshëm për të zgjedhur një strategji të kthimit të rrezikut, të përshtatshme për preferencat dhe rrethanat individuale të punonjësit. Ndërkohë që skema me përfitime të përcaktuara i detyron individët të grumbullojnë pjesën e pensionit nga kursimi për pension në formë të pensionit të shtyrë, duke kufizuar në këtë formë dhe zgjedhjen e rrezikut të kthimit.
2. Modelet përkatëse	Skemat me përfitime të përcaktuara janë të ngarkuar në thelb. Po ashtu, edhe skemat me kontribute të përcaktuara mund të mbingarkohen duke

¹⁵ Tek skemat me përfitime të përcaktuara dhe me kontribute të përcaktuara vlen të theksohet se, njëra nga variantet e skemës me kontribute të përcaktuara është skema e Fondit Provident. Pra, kontributet individuale grumbullohen për investime dhe pjesëmarrësit kreditohen me një dividendë vjetore e cila zakonisht është norma e kthimit të aktiveve. Ky variant bart me vete edhe dy disavantazhe kryesore që kanë të bëjnë me atë se individët që mbajnë rrezikun e investimit janë zakonisht të shpërndarë nga vendimarrësit dhe pjesëmarrësit nuk janë në gjendje të zgjedhin politikën e tyre të investimit, e që rrjedhimisht nuk kanë edhe kontroll mbi nivelin e rrezikut të marrë (Muralidhar, 2001).

	zgjedhur një normë kontributesh që rritet me moshën dhe zotërimin e punëtorit. Dallimi i dukshëm dhe i pandarë në modelet e aktualitetit mes dy skemave është fakti se, zvarritja (mbingarkimi) i skemës me përfitime të përcaktuara është stokastike, në kuptimin që vlefshmëria e përfitimit të vërtetë varet mbi normën e inflacionit të pagave.
3. Përfundimi dhe lehtësia në bartje (transferimi)	Çështja e lehtësisë së transferimit lidhet ngushtë me modelin aktual. Për skemat me kontribute të përcaktuara me normat e kontributeve të lidhura me qëndrimin e punonjësit dhe moshën, ndëshkimi për ndërprerjen e hershme mund të jetë po aq i madh sa në planin me përfitime të përcaktuara. Si rrjedhojë e lehtësisë së transferimit, aktualisht më së shumti favorizohen skemat me kontribute të përcaktuara sesa skemat me përfitime të përcaktuara.
4. Stimujt (nxitjet)	Përfitimet pensionale në skemat me kontribute të përcaktuara varen nga trajektorja e pagave gjatë gjithë karrierës së punëtorit, ndërkohë që përfitimet në shumicën e skemave me përfitime të përcaktuara varen nga paga mesatare përfundimtare. Për këtë arsye, punëtorët në skemat me përfitime të përcaktuara, duhet të kenë një nxitje më të madhe për të mbështetur një nivel të lartë të përpjekjeve gjatë gjithë karrierës në mënyrë që të arrijnë një pagë të lartë në fund të karrierës.
5. Ekonomitë informative në hartimin dhe zbatimin e skemës pensionale	Planifikimi i të ardhurave nga pensionet paraqitet si një nga fushat më komplekse të financave personale. Shumë punonjës e konsiderojnë si një shërbim që punëdhënësi i tyre të përcaktojë dhe të sigurojë një nivel të përshtatshëm të kursimeve për ta. Meqenëse të ardhurat e daljes në pension zakonisht përcaktohen si përqindje e zëvendësimit të pagës, përfitimet nga skemat me përfitime të përcaktuara të cilat janë të përcaktuara pikërisht në ato kushte janë më të lehta për t'u interpretuar.
6. Rreziku nga vijueshmëria e pagave	Nëse vijueshmëria e pagës për individin është e paparashikueshme në fillim të një karriere, atëherë kjo paparashikueshmëri konsiderohet si shumë e rrezikshme, ngase përfitimet nga pensioni varen kryesisht nga paga përfundimtare.
	Një burim i madh i pasigurisë në skemat me

7. Rreziku i normës së interesit	kontribute të përcaktuara ka të bëj me kushtet nën të cilat mund të shndërrohet fondi i pensionit në një rrjedhë të të ardhurave të daljes së pensionit. Duke ofruar pensione skemat me përfitime të përcaktuara në mënyrë efektive garantojnë normën e interesit në pension. Megjithatë, nënvizojmë se pa indeksimin e përfitimeve kjo është një garancion i normës nominale dhe jo i normës reale të interesit në pension.
--	---

Së fundmi, është me rëndësi të theksohet fakti se zgjedhja mes skemave me përfitime të përcaktuara apo me kontribute të përcaktuara ka gjithashtu implikime të mosinvestimit. Kjo ndodh ngase skemat me kontribute të përcaktuara kërkojnë një grup të arsimuar, financiarisht të shkolluar për të përdorur lirinë e zgjedhjes dhe për të siguruar normat e përshtatshme të zëvendësimit në pension. Kurse, skemat me përfitime të përcaktuara kërkojnë të mbështeten nga struktura të fuqishme të qeverisjes, për t'u siguruar se fonde të mjaftueshme janë investuar për të përmbushur detyrimet e ardhshme. Andaj, kombinimi apo përzierja relative e skemave ka të ngjarë të jetë më shumë rrjedhojë e vendimarrjes së shtetit apo thjeshtë rrjedhojë e një vendimi individual.

I.6. Shembuj të sistemeve pensionale

Implementimi i sistemeve pensionale nga ana e shteteve dhe kompanive siguron një sfond të karakteristikave të ndryshme që këta sisteme krijojnë duke i klasifikuar në: model kilian, sistem i sigurimeve sociale, fonde të detyrueshme providente, etj.

Modeli Kilian

Modeli Kilian filloi të implementohet në vitin 1981 dhe përfshiu shkrirjen graduale të skemës PAYG, duke u zëvendësuar me një skemë të detyrueshme me kontribute të përcaktuara. Punëtorët e rinj përfshiheshin në skemën me kontribute të përcaktuara, kurse pjesëmarrësit që veç më i përkisnin skemës PAYG kishin të drejtën e zgjedhjes mes këtyre dy skemave, respektivisht mes skemës së vjeçër dhe asaj të re. Për më tej, asetet e grumbulluara u menaxhuan nga një kompani private e quajtur Administradora de Fondos de Pensiones ose AFP, e zgjedhur nga pjesëmarrësit sipas listës së miratuar nga qeveria duke i lënë individët në masë të madhe të bartin rrezikun nga performanca e investimeve (Ruiz-Tagle and Castro, 1998).

Sidoqoftë, sistemi Kilian ofronte disa garancione sikurse: asistencë sociale të ulët për ata që nuk mbuloreshin nga plani i detyrueshëm; pension minimal të garantuar me rreth 25% të pagës mesatare, nëse kontributet janë derdhur për të pakten 20 vjeç; një normë minimale të përfitimeve të garantuar për secilin fond të pensioneve; si dhe garancion në pagesat e

anuiteteve (pensioneve) nga ana e shtetit nëse kompania e sigurimeve deshton (World Bank, 1994).

Sistemi i sigurimeve sociale në SHBA

Sistemi i sigurimeve sociale i themeluar në vitet 1930-ta, u dizajnuar sipas linjave të një sistemi PAYG dhe paraqet një sistem publik të mandatuar më një pjesëmarrje shumë të gjerë dhe të detyrueshme. Përfitimi mesatar pensional përfaqëson një shkallë zëvendësimi diku prej 50%, të 35 viteve më të mira nga historia e pagave. Po ashtu, u bënë edhe disa rregullime në drejtim të rishpërndarjes së pensioneve tek pjesëmarrësit e varfër, duke ndikuar në ndryshimin nga mesatarja e normës së zëvendësimit individual. Për këtë arsye norma e zëvendësimit është më e lartë tek individët që kanë një histori të të ardhurave të ulëta, sesa tek ata që kanë të ardhura të larta. Sidoqoftë, përfitimet paguhen deri në vdekje përfshirë nga viti 1972 edhe indeksimin substancial të inflacionit, si dhe shtrihen tek të mbijetuarit (Modigliani and Muralidhar, 2005).

Aktualisht, sistemi i sigurimeve sociale nuk konsiderohet si një sistem i pastër PAYG, që do të thotë se shmangia drejt dështimit të sistemit të sigurimit social ishte e pamundur. Duke u nisur nga kjo, gjatë viteve 1982 - 1983 Komisioni Greenspan rekomandoi një kontribut të mprehtë në rritje që mundësoi krijimin e një rezerve të ashtëquajtur Fondi i Mirëbesimit për mbulimin e mungesave të ardhshme (edhe pse kjo reformë ishte e pamjfatueshme dhe nevojiteshin reforma të reja për të shmangur dështimin në shekullin XX).

Skemat 401 (K) dhe llogaritë individuale të daljes në pension në SHBA

Skemat 401 (K) dhe llogaritë Individuale të daljes në pension konsiderohen si më të përhapurat në Shtetet e Bashkuara dhe si më të referuarat kur bëhet fjale për skemat me kontribute të përcaktuara. Nën skemat 401 (K), kontribuojnë edhe punëdhënësit edhe punonjësit, njëkohësisht pjesëmarrësit janë të lire të zgjedhin strategjitë e investimit nga ofruesit që menaxhojnë astetet e pjesëmarrësve. Po ashtu, pjesëmarrësve u lejohet të huazojnë nga llogaritë e tyre brenda kufijve të përcaktuar dhe në mënyrë të veçantë. Kurse, sa i përket strukturës pjesëmarrësve u ofrohen zgjedhje të mjaftueshme në drejtim të: zgjedhjes së alokimit të aseteve (një përzierje e obligacioneve dhe aksioneve apo aseteve ndërkombëtare dhe vendore) dhe zgjedhjes së menaxherëve të preferuar nga lista e menaxherëve dhe fondeve të përbashkëta (Munnell and Chen, 2017).

Megjithatë, në të dy sistemet pjesëmarrësit posedojnë një diskrecion mbi nivelin e kontributeve, ndonëse ka kufizime për kontributet maksimale. Këto kufizime të kontributeve ekzistojnë pasi që kursimet e tilla paraqesin tatim të shtyrë (Orszag and Stiglitz, 1999).

Fondet e detyrueshme providente

Fondet e detyrueshme providente paraqesin skema pensionale ku individët kontribuojnë në skemë, kurse shuma totale grumbullohet në një fond të përbashkët qendror. Skemat e tilla zakonisht u ofrohen punëtorëve të sektorit privat dhe më së shumti janë të përhapura në Indi dhe Malajzi (Asher, 2000)

Për më tej, fondi i përbashkët qendror investohet në pasuri të ndryshme, ku pjesëmarrësit fitojnë dividendë në kontributet e tyre - dividendë kjo, e cila është e barabartë me kthimet e strategjisë së investimit, ndonëse në disa vende dividendët janë më të sheshta përgjatë disa viteve të kthimit (për të reduktuar luhatshmërinë). E gjithë kjo, vetëm e vetëm të lejohet e hapur mundësia që sistemi të jetë "i pafinancuar", nëse eventualisht ndodhin një seri kthimesh negative (edhe pse ende nuk është e qartë se si do të mbulohen këto defiçite). Për shembull: në Malajzi një garancion minimal prej 2.5% u ofrohet pjesëmarrësve të cilët edhe pse kanë llogari individuale nuk është se kanë zgjidhje (Thillainathan, 2003).

KAPITULLI II: ANALIZË KRAHASIMORE

II.1. Logjikat e ndryshme të reformës pensionale në drejtim të klasifikimit të sistemeve pensionale

Studiuesit e pensioneve në bazë të përvojës dhe vëzhgimit të sistemeve pensionale të Evropës Perëndimore zhvilluan një klasifikim të dyfishtë të pensioneve, gjegjësisht sigurimet sociale dhe sistemet me shumë shtylla. Si dimension kryesor i këtij dallimi u konsiderua pesha relative e të dy shtyllave kryesore të politikës së pensioneve, edhe atë: shtylla e parë e njohur përgjithësisht si një skemë publike universale e pensioneve dhe shtylla e dytë profesionale ose si një alternativë individuale ndaj saj.

Tabela 8: Klasifikimi i sistemeve pensionale në bazë të peshës relative të secilës shtyllë

Shtylla e parë	Shtylla e dytë	
	Vullnetare dhe e kufizuar (mbulim rreth 40% - 60% të forcës punëtore)	E detyrueshme dhe / ose e përhapur (mbulim rreth 80% - 90% të forcës punëtore)
Inekzistente Siguron përfitime në nivelin e jetesës Ofron zëvendësim të plotë të të ardhurave (të paktën 60% e të ardhurave)	I paplotë (i mangët) Tajvani Bismarckian Lite Kanada SHBA (Japonia) Sigurim social Franca Gjermania Italia Suedia (para viteve 1990) (Korea)	Sistemet me shumë shtylla Zvicra Anglia Suedia (pas viteve 1990)

Burimi: Ageing and Pension Reform Around the World, fq.6.

Infrastrukturat e ndryshme të sistemeve pensionale gjeneruan stimuj të ndryshëm për politik-bërësit dhe politikat e ndryshme pensionale - stimuj këto, që i klasifikuan më tej shtetet në: shtete të sigurimeve sociale, Bismarckian Lite, shtete me sistem pensional me shumë shtylla dhe shtete me sisteme pensionale jo të plota. Mirëpo, se cilët janë karakteristikat kryesore, gjegjësisht përmes çka dallohen shtetet që posedojnë njërin nga sistemet pensionale gjegjëse, shërbehuni me tabelën vijuese:

Tabela 9: Karakteristikat e sistemeve pensionale në bazë të grupit të shteteve që mbulojnë

Grupet e shteteve sipas karakteristikave pensionale
Shtetet e sigurimeve sociale
▪ Sistemet pensionale të sigurimeve sociale u krijuan pas luftës së dytë botërore; ▪ Sistemet pensionale konsiderohen si një kontratë sociale mes shtetit dhe qytetarëve; ▪ Menaxhimi i pensioneve u delegohet partnerëve social (punëdhënësve dhe organizatave të punonjësve); ▪ Qeveritë konsiderohen përgjegjës për atë që ndodh në fushën e pensioneve; ▪ Plakja e popullsisë gjeneron llojin më të vështirë dhe të diskutueshëm të pensionit - gjenerim ky, që rezulton nga kombinimi i presioneve të forta për kursim (shkurtim) dhe rezistencës së fortë kundrejt një hapi (lëvizje) të tillë; ▪ Politika e reformës pensionale karakterizohet nga zbatimi i politikave të politikbërësve dhe shmangia e fajit¹⁶;
Shtetet “Bismarckian Lite”
▪ Më pak të ekspozuara ndaj problemeve të qëndrueshmërisë së pensioneve (Bonoli and Shinkawa, 2005); ▪ Madhësia e vogël e pensionit shtetëror siguron qëndrueshmëri financiare të skemave gjatë gjithë tranzicionit demografik (si rrjedhojë e kombinimit të financave shtesë dhe masave të moderuara të kursimit); ▪ Kufizimet (shkurtime) e pensioneve dhe rritjes së fondeve konsiderohen para se gjithash rezultat i vendimeve politike; ▪ Kufizimet e pensioneve bëhen lehtë pasi që shteti nuk mban përgjegjësi; ▪ Sigurimi vullnetar profesional ndikohet nga plakja e popullsisë; ▪ Skemat e pensioneve profesionale shumë shpejt konvertohen nga skema me përfitime të përcaktuara në skema me kontribute të përcaktuara (vetëm që barra e rrezikut që lidhet me plakjen e popullsisë dhe kthimet e investimeve të transferohen nga punëdhënësi tek punonjësi); ▪ Ekspozim më i lartë ndaj rrezikut të mbulimit të pamjaftueshëm.
Shtetet me sistem pensional me shumë shtylla
▪ Transferimi mes brezave kryhet nga një kombinim i skemave PAYG dhe instrumenteve të financuara (Bonoli, 2003) ▪ Pensioni bazë financohet nga PAYG (shtylla e parë) që ekspozohet ndaj të njëjtave probleme të lidhura me plakjen e popullsisë, njëjtë si në rastin e skemave të sigurimit social; ▪ Pensionet e shtyllës së dytë rezultojnë nga instrumente të financuara plotësisht, shpesh nga punëdhënësi ose prej një pjese të shtyllës së parë që janë më pak të ndjeshëm ndaj ndryshimeve demografike; ▪ Këto skema nuk kryejnë transferta mes brezave, andaj ndryshimet në madhësinë relative të gjeneratave janë të parëndësishme për qëndrueshmërinë financiare të këtyre skemave; ▪ Madhësia e problemit është dukshëm më e vogël në sistemet me shumë shtylla, sesa në ato të sigurimeve sociale¹⁷;

¹⁶ Politika e reformës pensionale në vendet e sigurimeve sociale karakterizohet nga zbatimi i politikave të politikbërësve dhe shmangia e fajit. Pra, nën kufizimet e rrepta ekonomike kombëtare dhe ndërkombëtare dhe me një kosto minimale politike, duhet të gjenin mënyra për të mbuluar shpenzimet e ardhshme të pensioneve.

¹⁷ Madhësia e problemit ishte dukshëm më e vogël në sistemet me shumë shtylla krahasuar me sistemet e sigurimeve sociale. Për rrjedhojë, pensionet bazë të Zvicrës ose Britanisë përbënin më pak se 7% të Prodhimit të Brendshëm Bruto, përderisa pensionet e sigurimeve sociale që ekzistonin në Francë, Gjermani apo Itali u kushtonin këtyre vende më shumë se 10% të Prodhimit të Brendshëm Bruto.

- Pensionet e financuara nga sistemet me shumë shtylla mund të vijnë nën presion (si rezultat i faktorëve demografik), por shkalla në të cilën ky presion shndërrohet në një rrezik politik, varet posaçërisht nga shkalla e përfshirjes së shtetit në rregullimin e pensioneve profesionale;
- Qeveritë nuk janë drejtpërdrejt përgjegjëse për përcaktimin e nivelit të përfitimeve të pensionit;
- Niveli i përfitimeve pensionale varet nga rregullat që zbatojnë (që janë në fuqi), performanca e tregut të aksioneve, aftësitë menaxheriale të menaxherit të fondeve dhe nga fati (krijohet një tjetër lloj politike) (Myles and Pierson, 2001);
- Edhe pse karakterizohen nga një shkallë shumë e madhe e mbulimit të pensioneve private, prap se prap nuk e arrijnë 100%-shin¹⁸;
- Me qëllim të zvogëlimit të numrit të atyre që janë përjashtuar nga mbulimi i pensioneve private, bënë pensionet e shtyllave të dyta si të detyrueshme (edhe pse ka mjaft hapësirë për përmirësim).

Shtetet me sisteme pensionale jo të plota

- Tajvani bën pjesë në grupin e shteteve që nuk posedon një sistem universal, gjithëpërfshirës sa i përket pensioneve të plota (tabela paraprake);
- Mungesa e sigurimit të pensioneve në fillim të tranzicionit demografik gjeneroi një lloj tjetër të politikës së pensioneve;
- Shqetësimet për qëndrueshmërinë financiare nuk morën ndonjë vëmendje domethënëse në domenin publik për faktin se, sistemi ekzistues i pensioneve ishte fillestar;
- Ndonëse popullsia e Tajvanit ishte relativisht e re, prap se prap po rezikohej nga plakja e popullsisë;
- Grupet që po i afroreshin moshës së daljes në pension po rriteshin gjithnjë e më shumë - rritje kjo, që krijoi një terren shumë pjellor për zhvillimin e politikave ekspansioniste të pensioneve, edhe pse kostoja financiare për skemën e ardhshme ishte e kufizuar - së paku në periudhën fillestare të veprimit, ndërkohë që shpërblimet politike ishin mjaft të rëndësishme;
- Shpërblimet politike nxitën një konkurrencë mjaft të madhe mes partive politike dhe politikanëve individualë në hartimin e propozimeve për zgjerimin e sigurimit pensional.

Pra, përmes identifikimit të karakteristikave kryesore që e veçojnë secilin grup shtetesh nga shtetet tjera, arrijmë të nxjerrim në pah përparësitë dhe mangësitë e shtetit të sistemit pensional kundrejt llojit tjetër. Po ashtu, kur jeme tek shtetet e sigurimeve sociale dhe atyre “Bismarckian Lite”, është e rrugës të nënvizojmë arsyet që çuan drejt presionit për kursim - arsye këto, që dolën para se gjithash si rrjedhojë e një numri tiparësh institucionale të sistemeve të sigurimeve sociale, ngase (Pierson, 1997):

- pjesa më e madhe e transferimit mes brezave kryhej nga skemat PAYG, ku me ç’rast pensionet në këto vende ishin jashtëzakonisht të ndjeshme ndaj ndryshimeve në proporcione relative të forcës punëtore dhe pensionistëve;

¹⁸ Shtetet me sistem pensional me shumë shtylla ndonëse karakterizohen nga një shkallë shumë e madhe e mbulimit të pensioneve private, prap se prap nuk e arrijnë 100%-shin. Kjo e fundit ndodh për shkak të pranisë së një pjese të punonjësve me paga të paqëndrueshme në tregjet bashkëkohore (me pagë shumë të ulët) dhe të cilët teknikisht janë vështirë për t’u siguruar. Duke u nisur nga kjo, viteve të fundit shtetet me sistem pensional me shumë shtylla me qëllim të zvogëlimit të numrit të atyre që janë përjashtuar nga mbulimi i pensioneve private, i bënë pensionet e shtyllave të dyta si të detyrueshme (edhe pse ka mjaft hapësirë për përmirësim).

- presioni për kursim përforcohej edhe më tej për faktin se parashikimi i evolucionit të financave të skemave PAYG ishte relativisht i lehtë;
- presioni për kursim vijoi edhe si rezultat i lidhjes ndërmjet politikës së pensioneve dhe punësimit, ngase skemat e pensioneve të sigurimeve sociale financohen nga kontributet e punëdhënësve dhe punonjësve duke ndikuar kështu drejtpërsëdrejti edhe në koston e punës¹⁹.

Andaj, për të elaboruar më hollësisht politikën e reformës pensionale dhe peshën relative të çdo shtylle, në vijim, përmes një kombinimi të shteteve që u përkasin grupit të “sigurimeve sociale”, “Bismarckian Lite”, si dhe atyre me shumë shtylla, do të trajtojmë evolucionin e reformave pensionale, rrjedhimisht impaktin e tyre në krijimin e sistemeve pensionale aktuale.

II.2. Reformat pensionale në shtetet e zhvilluara

II.2.1. Reformat pensionale në SHBA

Programet e pensioneve publike në SHBA sikurse në shumë shtete tjera të zhvilluara (Japonia, Franca, Gjermania, Austria) kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë nën ndikimin e presioneve të ndryshme, sikurse: plakja e popullsisë, rritja e ulët e të ardhurave dhe nga presionet konkurruese për të limituar pagesën e taksave. Për rrjedhojë, politik-bërësit në të gjithë botën e industrializuar, dizajnuan një repertor të përbashkët të alternativave të mundshme për t’iu përgjigjur presioneve në fjalë. Alternativa e parë kishte të bëj me reduktimin e përfitimeve të veçanta dhe/ose të përshtatshmërisë së programeve të pensioneve të tyre, e dyta kishte të bëj me gjetjen e mënyrave të reja të rifinancimit të programeve të pensioneve, si dhe alternativa e tretë kishte të bëj me përpjekjen apo angazhimin e qeverisë në ristrukturimin themelor të programeve të pensioneve (Bonoli and Shinkawa, 2005).

Po ashtu, Shtetet e Bashkuara u identifikuan edhe për modelet e ndryshimit të politikave, respektivisht në vend të heqjes së sistemit të vjeçer pensional, e rimodeluan atë me një program të ri për punëtorët e rinj, që do të thotë se SHBA-të praktikisht nuk miratuan asnjë ndryshim thelbësor në programin e sigurimeve sociale përveç kalimit të një pakete të reformës së sigurisë sociale në vitin 1983 (Hinrichs, 2000). Mirëpo, se si u zhvillua politika e reformës pensionale deri në krijimin e sistemit pensional aktual të SHBA-së, sjellim tabelën vijuese (Orszag and Stiglitz, 1999):

¹⁹ Sa i përket koston së punës vlen të përmendet se, investitorët ndërkombëtarë nuk i pëlqejnë deficitet e mëdha buxhetore që lidhen me shpenzimet e larta të pensioneve, ngase normat e larta të kontributeve pensionale dekurajojnë hyrjet e investimeve të huaja direkte.

Tabela 10: Politika e reformës së pensioneve në SHBA

Periudha	Zhvillimi i reformave pensionale
1930	Depresioni i madh i viteve 1930 - shtysë për zgjerimin e politikës sociale (Weaver, 2005).
1935	Akti i Presidenti Franklin Roosevelt - përfshiu dy programe për të moshuarit: sigurim për të moshuarit (Old Age Insurance) dhe ndihmë për të moshuarit (Assistance Old Age).
1970	Presionet për kursim - impenjuan ndërmarrjen e iniciativës inkurajuese për kursim dhe për rifinancimin e të njëjtave, për të mos anashkaluar më tej edhe mundësinë për zbatimin e reformave më thelbësore (rezultat i krizave të vazhdueshme të Fondit të sigurimeve sociale dhe presioneve buxhetore).
1972	Lufta mes administratës së Nixon dhe Kongresit demokratik - rezultoi me një rritje të përfitimeve prej 20% dhe indeksimin e përfitimeve kundrejt inflacionit. Kongresi zëvendësoi programin e ndihmës për të moshuarit me të Ardhurat e sigurimit suplementar (Supplementar Security Income - SSI).
1977	Ndryshimet gjatë periudhës së Jimmy Carter dhe Ronald Reagan - fillimi i kursimeve (shkurtimeve) të pensioneve, si rezultat i kombinimi të stagflacionit që uli hyrjen e të ardhurave në fond dhe mekanizmit të gabuar të indeksimit që u dha punëtorëve të sapo dalë në pension fitime të papritura.
1981 - 1989	Kufizimet (shkurtime) e sigurimeve sociale: 1. Shkurtimeve e sigurimeve sociale gjatë administrimit të Ronald Reagan; 2. Shtypja e paketës së reformave në vitin 1981 nga David Stockman (drejtor i zyrës së menaxhimit dhe buxhetit të shtëpisë së bardhë). Kjo paketë reforme përfshinte: a) një vonesë tre mujore për rregullimin e kostos së jetesës; b) një ndryshim në llogaritjen e përfitimeve fillestare për pensionistët e ardhshëm, si dhe c) një prerje të rëndë dhe të menjëhershme në drejtim të përfitimeve për pensionistët e ardhshëm; 3. Iniciativat e shkurtimeve (kufizimit) në vitet e Clinton'it.
1993	Presidenti Clinton caktoi një komision për të studiuar dhe ofruar rekomandime rreth sigurimit social dhe çështjeve të së drejtës në lidhje me sigurimin social. Debatet rreth ristrukturimit fundamental të sigurimeve sociale u përqendruan kryesisht në: zgjerimin e gamës së opsioneve të investimeve (aksione) dhe në shkallët e ndryshme të "privatizimit" të sigurimeve sociale përmes kontributeve të detyrueshme ose vullnetare për pensionet individuale (1994-96 Advisory Council Report, 1997).
1997	Raporti nga këshilli këshillëdhënës i sigurimit social - kishte të bëjë me përkrahjen e mënyrës së investimit të fondeve të sigurimit social në kapital dhe krijimin e llogarive individuale mbi të cilat punëtorët do të kishin një kontroll rreth investimeve (1994-96 Advisory Council Report, 1997).
1999	Bill Clinton propozoi të rezervonte 62% të suficitit të sigurimeve sociale të parashikuara gjatë 15 viteve vijuese për të forcuar Fondin e sigurimit social.
2000	Ristrukturimi i sigurisë sociale - kandidati Republikan Xhorxh W. Bush, sugjeroi që punëtorëve t'u lejohej të shmangin taksat e pagave të tyre të sigurimeve sociale në llogaritë individuale, përderisa kundërshtari i tij demokratik Al Gore, argumentoi se një veprim i tillë do të dobësonte më tej qëndrueshmërinë e sistemit të sigurimeve sociale (Sack, 2000).

Pra, zhvillimi i politikës pensionale të SHBA-së nga viti 1930 e këndeje mundësoi sendërtimin aktual të sistemi amerikan **pensional shtetërore** (emri zyrtar: OASDI - Programi i sigurimit të moshuarve, mbijetuarve dhe sigurimit të personave me aftësisë të kufizuar), që operon në bazë të sistemit PAYG dhe financohet përmes taksave të sigurimeve sociale të paguara nga punëdhënësit dhe punonjësit (që zënë 84%), nga të ardhurat tatimore të paguara nga përfituesit e sigurimeve sociale me të ardhura të larta (që zënë 2%) dhe nga interesi i gjeneruar nga rezervat e fondeve të akumuluar (14%).

Kontributet janë të përjashtuara nga taksat, edhe pse përfitimet tatimohen nëse të ardhurat totale në pension tejkalojnë një shumë të caktuar. Moshë e pensionit ligjor varet nga viti i lindjes së pensionistit dhe qëndron në mes të 65 dhe 67. Sa i përket **pensioneve profesionale** është konstatuar se në industrinë e sektorit privat 60% e fuqisë punëtore kanë qasje në planet pensionale, ku skemat me kontribute të përcaktuara dominojnë në pensionet profesionale dhe mbulojnë 43% të fuqisë punëtore, përderisa vetëm 20% e fuqisë punëtore të sektorit privat merr pjesë në skemat me përfitime të përcaktuara. Gjithsej 51% e totalit të fuqisë punëtore është e integruar në çfarëdo lloji të planit pensional.

II.2.2. Reformat pensionale në Japoni

Japonia mund të klasifikohet si një anëtar i kategorisë “Bismarckian Lite” i sistemeve pensionale, që u përballua me një sfidë mjaft serioze sa i përket qëndrueshmërisë së pensioneve. Popullsia në Japoni po plakej shumë më shpejt dhe vazhdon të konsiderohet si një nga shoqëritë më të moshuara në botë. Po ashtu, vlen të theksohet se kufizimi i pensioneve në Japoni filloi që në vitet 1980 (si rrjedhojë e neglizhencës institucionale të ngulitur në sistemin pensional) kur raporti i plakjes së popullsisë ishte relativisht i ulët (9.1 % në 1980 dhe 12 % në 1990). Sidoqoftë, procesi i kufizimit të pensioneve në Japoni u analizua shumë mirë duke iu referuar konceptit të “shmangies së fajit”, ku u dalluan 5 strategji për shmangien e fajit, sikurse (Weaver, 1986) dhe (Pierson, 1996):

- Strategjia I - kufizimi i agjendës ose përjashtimi i çështjeve që krijojnë fajin nga rendi i ditës;
- Strategjia II - riorganizimi i çështjeve. Vendimmarrësit tentonin të parandalonin keqpërdorimin, duke zhvilluar opsione të reja të politikave që shpërndanin ose dëmtonin humbjet;
- Strategjia III - ulja e dukshmërisë;
- Strategjia IV - shmangia e fajit duke gjetur “kurban” ose duke luajtur një grup kundër tjetrit.
- Strategjia V - formimi i konsensusit.

Ndonëse kufizimi i pensioneve në Japoni ishte i kuptueshëm në aspektin e kufizimeve institucionale dhe në drejtim të politikës së shmangies së fajit, prap se prap ajo që e dallonte Japoninë ishte njëanshmëria mbi atë se, vetë institucionet duke punuar në një mënyrë jo të zakonshme ndikuan në zvogëlimin e pensioneve (të paktën në vitet e 80'ta). Pra, fragmentimi institucional shkaktoi ngushtësi fiskale në skemat e pensioneve, gjegjësisht në vend që të parandaloj procesin e kufizimit të pensioneve, e lehtësoi atë si proces. Andaj, për më shumë rreth politikës së reformës së pensioneve dhe krijimit të sistemit pensional aktual në Japoni, shërbehuni me tabelën vijuese:

Tabela 11: Politika e reformës së pensioneve në Japoni

Periudha	Zhvillimi i reformave pensionale
1875 - 1894	Futja e planeve fillestare të pensioneve detare, ushtarake dhe të shërbimit civil (Shinkawa, 2005).
1907	Prezantimi i planit kombëtar të pensioneve të ndërsjella hekurudhore (të ngjashme u prezantuan edhe në biznese të tjera kombëtare, përfshirë: duhanin, telegramin, etj).
1920	Në vend të sigurimit të një pensioni publik, pagesat e pensioneve specifike të kompanive u përhapën mes firmave të mëdha. Qëllimi: fillimisht si një mjet për të siguruar punë të kualifikuar, e më pas si zëvendësim për sigurimin publik të papunësisë.
1939	Paraqitja e planit pensional të marinarëve për të siguruar fuqinë punëtore të nevojshme për transportin detar.
1942	Nxjerrja e një pensioni (për punëtorët), që vlente për të gjithë punonjësit përveç atyre në bizneset e vogla (me më pak se dhjetë punonjës).
1980	Pensionimi në moshën 60 vjeçare (praktikë e zakonshme në sektorin privat).
1985	Krijimi i planit pensional bazik. Pensioni publik përbëhej nga tre nivele: 1. Niveli i parë ishin pensionet bazë që i mbulonin të gjithë qytetarët e moshës 20 vjeç e sipër. Një kontribut minimal prej 25 vjeçësh ishte i nevojshëm për të fituar të drejtën për pension bazik, kurse 40 vite kontribute të paguara, garantonin një përfitim të plotë. Pensionet bazë (PB), përfshinin tre lloje të ndryshme të sigurve: a) anëtarët e sigurimeve kombëtare të pensioneve; b) punonjësit e sektorit publik dhe sektorit privat; c) bashkëshortet e sigurve të llojit të dytë (të ardhurat vjetore të të cilave ishin më të ulëta se 1.3 milionë jen). 2. Niveli i dytë bazohej mbi PAYG sistemin dhe përbëhej nga planet e pensionit të punonjësve. Ky nivel siguronte punonjësit me pensione të lidhura me të ardhura të moderuara dhe përbëhej nga: a) siguri i pensioneve të punonjësve (të parashikuara për punonjësit e sektorit privat) dhe b) planet reciproke të pensioneve (për shërbyesit publik dhe atyre pothuajse publik). Qeveria qendrore dhe qeveritë lokale kishin skemat e tyre të pavarura. 3. Niveli i tretë përfshiu pensionet e korporatave. Ky nivel përbëhej nga skema vullnetare private e pensioneve (shumica e të cilave ishin plane pensionale të korporatave të sponsorizuara nga punëdhënësit). Pensionet e korporatave ishin dy lloje: a) fondet e pensioneve të punonjësve dhe b) planet pensionale tatimore të kualifikuara. Të parët zëvendësonin një funksion publik kurse të dytët ishin thjesht skema pensionale të korporatave.
1994	Rritja e moshës së të drejtës në planin bazik (PB)

1989	Futja e një instrumenti të ri në formën e Fondeve kombëtare të pensione. Qëllimi: sigurimi i anëtarëve të cilët nuk janë të mbuluara nga pensionet e nivelit të dytë të pensioneve publike.
2001	Futja e legjislacionit të ri mbi pensionet e korporatave. Pra, qeveria paraqiti dy ligje të reja: ligjin për pension korporativ me përfitime të përcaktuara dhe ligjin për pension korporativ me kontribute të përcaktuara . Ligji i parë mundësoi krijimin e dy llojeve të planeve të pensione: a) planin e "llojit të kontratës" dhe b) planin e "llojit të fondit". Ligji i kontributeve të përcaktuara lejoi futjen e planit me kontribute të përcaktuara, të modeluar pas planit amerikan 401 (k). Ekzistonin dy lloje të planeve me kontribute të përcaktuara: a) plani korporativ dhe b) plani individual.
2002	Ministria e shëndetësisë, punës dhe mirëqenies në dhjetor të vitit 2002, publikoi një draft paraprak të reformës së vitit 2004. Argumentet: shkalla e kontributit të të punësuarëve të rritet gradualisht nga 13.58 % e të ardhurave vjetore deri në 20 % edhe atë deri në vitin 2025 (me gjasë të mbahet ky nivel edhe më tej); nivelet e përfitimeve të ndryshonin sipas ndryshimeve të faktorëve demografik dhe ekonomik (përfshirë jetëgjatësinë, shkallën e fertilitetit, normat e interesit, çmimet) dhe jo në bazë të vendimeve politike.
2004	Kalimi nga skema me përfitime të përcaktuara në skemën me kontribute të përcaktuara.
2001 - 2013	Rritja graduale e moshës së daljes në pension deri në 65 vjeç.
2006 - 2018	Zbatimi i procedurës së njëjtë edhe për punonjëset femra (vonesë në rastin e femrës ishte për shkak të faktit që mosha e daljes në pension për femrat ishte rritur në atë kohë nga 55 - 60, edhe atë deri në vitin 1999).

Pra, duke u bazuar në politikën e reformës së pensione që përfshiu periudhën nga viti 1875 e kënde, konstatojmë se sistemipensional aktual i Japonisë përbëhet nga: **sistemi kombëtar i pensioneve të sheshta** dhe nga **pensionet e lidhura me punësimin për punonjësit e sektorit publik dhe privat**. Këto dy elemente janë të kombinuara nga shtylla e pensioneve publike. Punëdhënësit mund të krijojnë Fonde pensioni për punonjësit që operojnë, por që zëvendësojnë përfitimet nga pjesa e të ardhurave të pensioneve publike dhe mund të ofrojnë përfitime shtesë. Për më tepër, punonjësit dhe të vetë punësuarit mund të krijojnë llogari të kontributeve të përcaktuara në Shoqatën kombëtare të pensioneve kombëtare, kurse sa i përket planeve japoneze të pensioneve vullnetare mund themi se këto plane marrin formë të ndryshme (planet pensionale tatimore të kualifikuara, fondet e pensioneve të punonjësve, etj) ("Wilmington plc", 1978).

II.2.3. Reformat pensionale në Francë

Franca shfaqet si shembulli më ekstrem i një vendi ku reformat e mirëqenies, posaçërisht reformat e pensioneve ishin pothuajse të pamundura, ndonëse tendencat demografike ishin të njohura që nga mesi i viteve 1980 (duhej të kalonin 13 për t'u ndërmarrë një reformë e pjesshme). Sipas (Andersen, 1990) sistemi francez i pensioneve paraqiste sistemin më tipik të mirëqenies i cilësuar si konservator dhe korporatist. Ky sistem financohej kryesisht nga kontributet sociale të paguara nga punëdhënësit dhe punonjësit dhe menaxhohej nga bordet administrative të përbëra nga përfaqësuesit e tyre.

Për më tej, si rrjedhojë e tendencave të vazhdueshme që po ndërmerreshin në politikën e pensioneve, Franca dëshmoi se shumë shpejt po adaptohej ndaj ndryshimeve (në të njëjtën mënyrë si vendet tjera Evropiane), ku vetëm brenda 10 viteve u miratuan dy reforma mjaft të rëndësishme: reforma e vitit 1993 dhe reforma e vitit 2003, të ekzaminuara më hollësisht në tabelën vijuese:

Tabela 12: Politika e reformës së pensioneve në Francë

Periudha	Zhvillimi i reformave pensionale
1945	Plani francez i sigurimeve sociale i vitit 1945, bazë për krijimin e skemës <i>lerégime général</i> që mbuloi kryesisht sektorin privat. Qëllimi: zgjerimi i mbulimit të popullsisë në të ardhmen dhe zbatimi i parimeve të sistemit Beveridge (uniteti dhe gjithëpërfshirja).
1980	Copernic Foundation Report - kritikoi idenë se goditja demografike po kërcënonte sistemin e pensioneve (Mandin and Palier, 2005).
1993	Edouard Balladur Reform (kryeministër i Francës 1993 - 1995) Qëllimi: Ndryshimi i formulës së llogaritjes dhe indeksimit të pensioneve (niveli i pensionit u llogarit duke iu referuar pagave të 25 viteve më të mira. Për një pension të plotë duhej të derdeshin kontribute për 40 vjeç, e jo për 37.5, siç ishte para reformës). Fokusi skemat e pensioneve të sektorit privat.
1995	The Juppe Plan (Alain Marie Juppe - kryeministër i Francës 1995-1997). Qëllimi: Zgjerimi i rregullave të pensionit nga sektori privat tek publik. Rritja e derdhjes së kontributeve nga 37.5 - 40 vjeç për një pension të plotë. Sidoqoftë, formula për pensionet publike mbeti e pandryshuar: 37.5 vjeç për një pension të plotë dhe shuma të llogaritej duke u bazuar në 6 muajt e fundit të karrierës.
1997	Politika pensionale e Lionel Jospin (kryeministër i Francës 1997-2002). Qëllimi: përgatitja e reformës për pensionet e financuara dhe rruajtja e të ardhmes së sistemit PAYG.
1999	1. Prezantimi i raportit të Charpin-it Konstatimet e tij: rritja dramatike e të moshuarve pas vitit 2006; nëse vazhdohej me trendet e fertilitetit dhe emigracionit të ulët dhe rritjes së jetëgjatësisë, në vitin 2040 çdo i treti francez do të ishte mbi 60 vjeç; raporti i varësisë do të rritej (fillimisht 10 punëtorë financonin 4 pensionist, kurse më vonë 10 punëtorë financonin 7 pensionist). Pra, sistemi PAYG do rrezikohej deri në vitin 2010.

	Rekomandimet e tij: të reformohet skema e pensioneve të sektorit privat; për një pension të plotë, periudha e derdhjes së kontributeve të rritet deri në 42.5 vjeç; harmonizim mes punonjësve të sektorit privat dhe atij publik. 2. Raporti i René Teulade për Conseil Économique et Social Propozimet: ngritjen e nivelit të pensioneve (duke ndryshuar mënyrën e indeksimit për pensionet e punonjësve privat dhe duke mbajtur më shumë llogari për periudhat jashtë punësimit formal gjatë llogaritjes së të drejtave të pensionit); kthimin nga 40 në 37.5 vjeç për një pension të plotë; rritjen e fondit rezervë (fonds de réserve); rritjen e rolit të shtetit në financimin e të drejtave të pensioneve jo-kontributore. 3. Sondazhi për Notre Temps - 952 të intervistuar ku 72% e tyre konstatonin se sistemi PAYG nuk do të ishte në gjendje të garantoj pensione në të ardhmen, andaj urgjentisht të ndërmerret ndonjë reformë. 4. Krijimi i fondit rezerve loi de financement de la sécurité sociale, fillimisht me një donacion prej 304 milion Euro. Objektivi i fondit: arritja e 150 miliard euro ne vitin 2020. Sidoqoftë, objektivi nuk u realizua, ngase rezerva nga 7.1 miliardë euro ne vitin 2001 arriti në 13 miliardë euro në vitin 2002 dhe 17 miliardë euro në vitin 2003.
2001	Krijimi i Komitetit drejtues të pensionit (Conseil d’Orientation des Retraites, COR) Qëllimi: rritjen e gjatësisë së periudhës së derdhjes së kontributit dhe rritjen e shkallës së përgjithshme të punësimit.
2003	The Fillon Reform François Fillon (ministër i Punës dhe politikës sociale) dhe Jean-Paul Delevoye (ministër i Shërbimeve civile), filluan bisedimet për sjelljen e sektorit publik në të njëjtën linjë me sektorin privat (objektivi kryesor i reformës). Më 18 prill 2003 qeveria paraqiti planin e saj edhe atë: 1) sektori publik do të duhet të punojë 40 vite për një pension të plotë, njëjtë si në sektorin privat; 2) periudha e kontributit do të rritej deri në 41 vjeç në vitin 2008 dhe pothuajse deri në 42 vjeç në vitin 2020; 3) për të gjithë pensionistët indeksimi i pensioneve do të bazohet në çmimet; 4) krijimi i një sistemi të ri dhe i bazuar: në bonuse (surcote), e që do t’u atribuohet personave që dalin në pension pas moshës ligjore dhe në sanksion (décote), në rast të daljes në pension para moshës së paraparë, ose në rast të mungesës së pagesës së kontributeve për vite të caktuara; Mungesë e masave të qarta për mënyrën se si do të financohet i gjithë deficit i projektuar për sistemin pensional.

Pra, pas ekzaminimit të hollësishëm të sistemit pensional francez dhe ndërmarrjes së vazhdueshme të reformave pensionale mund të themi se, sistemi pensional francez aktualisht është i përbërë nga: një shtyllë publike e financuar nga PAYG skema, një sistem profesional i detyrueshëm dhe nga aranzhimet vullnetare profesionale dhe ato personale. Fondi rezervë i pensioneve publike financohet kryesisht nga: tatimi social mbi të ardhurat, pasuritë dhe investimet, teprica e Fondit kombëtar francez të vjeçërsisë dhe përmes të ardhurave nga shitja e disa pasurive shtetërore.

Sa i përket pensioneve profesionale, përveç sistemit social bazik të gjithë punonjësit janë anëtarë të planeve plotësuese të detyrueshme, përderisa skemat e pensionit profesional vullnetar zënë akoma vetëm një pjesë të vogël të tregut. Skemat e detyrueshme të pensioneve profesionale njihen si AGIRC (për drejtuesit) dhe ARRCO (për jo-drejtuesit), bazohen në marrëveshjet kolektive duke ofruar përfitime të përcaktuara, kurse në skemat vullnetare profesionale kemi planet për sigurim pensional dhe planet afatgjata të kursimit (PERCO).

II.2.4. Reformat pensionale në Gjermani

Qeveria Red - Gren e Gjermanisë krahas ndryshimeve të shumta të ndërmarra gjatë periudhës 1989 - 2001, në fund të vitit 2003 ndërmori një reformë pensionale që kishte për qëllim mbylljen e deficitit afatshkurtër të skemës së pensioneve publike. Si arsytim tjetër për nismën e reformës së fundit ishin përsëri faktorët demografik, gjegjësisht ulja e fertilitetit, jetëgjatësia dhe shfrytëzimi jo-proporcional i programeve të mirëqenies nga ana e të moshuarve (programet në fjalë përfshinin shërbimet shëndetësore, të kujdesit afatgjatë dhe skemat e pensioneve të pleqërisë) (Lynch, 2001; Andersen and Sarasa, 2002). Pra, edhe Gjermania sikurse shtetet tjera të zhvilluara shumë herët filloi të ballafaqohet me sfidën e një popullsie të plakur, e që ndikoi që në Gjermani nga vitit 1957 e këndeje, të ndërmerren një sërë reformash përmes akteve të miratuara, sikurse në tabelën vijuese:

Tabela 13: Politika e reformës së pensioneve në Gjermani

Periudha	Zhvillimi i reformave pensionale
1957	Regullimi i formulës së përfitimit (Hinrichs, 2005)
1992	Akti i Reformës së Pensionit 1992 (PRA92) - i miratuar nga organet legjislative në vitin 1989 dhe i cili hyri në fuqi në mënyrë efektive në vitin 1992 + më pas ▪ Regullimi i përfitimeve sipas zhvillimit të pagës neto të vitit të mëparshëm; ▪ Subvencionet shtetërore u rritën në 20% të shpenzimeve vjetore të skemës (në mënyrë të përhershme); ▪ Të gjitha dispozitat për të dalë në pension para moshës 65 vjeç pa uljen e përfitimeve u shfuqizuan në vitin 2012 (përfshijmë: punëtorë me aftësi të kufizuara serioze); zbritje të përhershme edhe atë: 0.3% në muaj; ▪ Huadhëniet për periudhat e shkollimit dhe të arsimit terciar të reduktohen edhe atë: nga 13 deri në 7 vjeç, maksimum në 75% të pagës mesatare; ▪ Huadhëniet për kujdesin e fëmijëve të posalindur pas vitit 1991 u rritën nga 1 në 3 vjeç, në 75% të pagës mesatare.
1999	Akti i Reformës së Pensionit 1999 (PRA99) - i miratuar nga organet legjislative në vitin 1997 dhe i cili në mënyrë të planifikuar dhe në mënyrë efektive hyri në fuqi në vitin 1999 + më pas ▪ Moshë e daljes në pension për personat me aftësi të kufizuara u shty nga 60 në 63 vjeç (përfitime të zbritura nëse kërkohet dalje në pension mes moshës 60 dhe 63); ▪ Përlllogaritja e përfitimeve të pensioneve me aftësi të kufizuara ndryshoi në disfavor të kërkuesit, ndërkohë kërkesat për pretendim të pensioneve me aftësi të kufizuara rriteshin; ▪ Rritja e jetëgjatësisë deri në moshën 65 vjeçare u morr parasysh gjatë llogaritjes së

	përfitimit fillestar dhe përshtatjes së pensioneve aktuale; ▪ Huadhëniet që mbulohehin nga punësimi njëkohësisht mund t'ju shtoheshin kredive për kujdesin e fëmijëve vlera e të cilëve u rrit nga 75 në 100% të pagës mesatare;
2001	Akti i Reformës së Pensionit 2001 (PRA2001) - i miratuar nga organet legjislative në vitin 2001 dhe i cili hyri në fuqi në mënyrë efektive në vitin 2002 + më pas ▪ Formula e rregullimit të përfitimeve përfshiu ndryshimet e normës së kontributeve në skemën e pensioneve publike dhe në pensionet e çertifikuara private (efekti: ulja e raportit të zëvendësimit); ▪ Pensione për të mbijetuarit; ▪ Rivlerësimi i të ardhurave të ulëta për prindërit kur fëmija e tyre ishte mes 3 dhe 10 vjeç, ose huadhënie (kredi) shtesë nëse prindërit nuk ishin të punësuar, e të cilët ishin duke rritur dy ose më shumë fëmijë nën moshën 10 vjeçe; ▪ Kontributi i subvencionuar nga taksat në dispozitat plotësuese të çertifikuara (duke filluar nga viti 2002 dhe duke u rritur gradualisht në 4% të fitimeve të mbuluara maksimalisht në vitin 2008): Riester - Rente; Veprimi politik shkaktohej nëse parashikohej që shkalla e kontributit do të kalonte 20% përpara vitit 2020 ose 22% përpara vitit 2030 ose raporti i zëvendësimit i synuar do binte nën 67%.

Pra, si rrjedhojë e miratimit të akteve për reformimin e sistemit pensional gjerman, aktualisht sistemi gjerman i pensioneve është i bazuar në një shtyllë të fortë pensionesh publike. Pensioni i shtyllës së parë gjermane (statutore) paraqet një sistem të detyrueshëm (PAYG) i financuar nga punonjësit, punëdhënësit dhe subvencionet qeveritare. Shkalla e kontributit është e ndarë në mënyrë të barabartë ndërmjet punonjësit dhe punëdhënësit, me një maksimum vjetor të vlerësimit të kontributeve vjetore prej 74,400 € (në Gjermaninë Perëndimore) dhe 64,800 € (në Gjermaninë Lindore). Mosha e pensionit ligjor është 65 vjeç për burrat dhe gratë, por është planifikuar të rritet në 67 vjeç gjatë një periudhe tranzicioni nga 2012 në 2029, kurse e drejta e pensionit bazohet në numrin e viteve të kontributit, nivelin mesatar të të ardhurave dhe në moshën e pensionit.

Për më tej, duke u mbështetur në pensionet statutore dhe profesionale individët mund të zgjedhin të përmirësojnë përfitimet e tyre pensionale duke investuar në një pension privat. Edhe pse ekzistojnë mënyra të ndryshme për të investuar në një pension privat, ne mund të nënvizojmë dy prej tyre si më të spikatur: Riester Pension Plan që paraqet një plan pensional jetësor dhe që subvencionohet nga qeveria deri në një shumë prej 2.100 € në vit dhe Rürup Pension Plan që paraqet një plan pensioni jetësor dhe shumë më fleksibël në krahasim me planin pensional Riester. Ky plan vjen në tri lloje të investimeve: pensione klasike të lidhura me njësi dhe në formë të menjëhershme.

II.3. Reformat pensionale në shtetet në zhvillim

Shtetet në zhvillim (Polonia, Çekia, Sllovenia, Sllovakia, Estonia), gjatë hartimi të reformës pensionale në radhë të parë duhet të merrnin në konsideratë nivelin ekzistues të zhvillimit institucional dhe strukturën e industrisë dhe tregjeve të shërbimeve financiare. Madje, si parakushte më të rëndësishme për zbatimin e suksesshëm të reformës së detyrueshme pensionale, veçonin: kornizën gjithëpërfshirëse rregullative, strukturat e afta mbikëqyrëse dhe infrastrukturën funksionale të tregut, përfshirë edhe nivelin e përvojës dhe edukimit financiar të anëtarëve të skemës së detyrueshme pensionale.

Në vijim, përmes paraqitjes së arsyeve që impenjuan rimodelimet e sistemeve pensionale, sjellim reformat pensionale të ndërmarra në disa nga shtetet në zhvillim, për të ardhur deri tek mënyra e funksionimit aktual të sistemit pensional në Estoni, Sllovaki, Poloni, Slloveni dhe Hungari.

II.3.1. Reformat pensionale në Estoni

Në qershor të vitit 1997 qeveria e Estonisë miratoi një koncept të reformës pensionale duke zgjeruar bazën e sistemit pensional. Kjo e fundit përbëhej nga 3 shtylla: pensionet publike, skema e detyrueshme pensionale e financuar nga vetë individët dhe skema vullnetare (Lillelaide et al., 2009).

Pensionet publike (shtylla e parë) të financuara nga skema PAYG u riformua në vitin 1998, duke sjellur ndryshime thelbësore në drejtim të llogaridhënies për kontributet personale, përfshirjes së një formule për llogaritjen e përfitimeve të bazuara pjesërisht në kontribute dhe ndryshime në drejtim të rritjes graduale të moshës së daljes në pension (deri në 63 vjeç, si për burrat ashtu edhe për gratë).

Skema e detyrueshme pensionale e financuar nga vetë individët (shtylla e dytë) u miratua në vitin 2001, kurse hyri në fuqi në vitin 2002. Kjo shtyllë paraqet një skemë individuale e financuar me kontribute të detyrueshme dhe që karakterizohet nga një kontribut i mesëm prej 6% e të ardhurave bruto. Gjatë fazës së akumulimit kontributet grumbullohen në fondet e veçanta pensionale të shtyllës së dytë të përzgjedhur nga vetë individët. Kurse, në momentin e daljes në pension kompanitë e sigurimit paguajnë pensionet në formë të anuiteteve dhe në mënyrë të rregullt, ndonëse ekziston mundësia për pagesë nga fondet e pensioneve në rast se pensioni është shumë i vogël ose e tejkalon një kufi të caktuar.

Skema vullnetare (shtylla e tretë) u miratua në vitin 1998 dhe lejoi investime në kontrata të veçanta sigurimi ose në fonde pensionale vullnetare. Kjo shtyllë u inkurajua mjaft mirë nga trajtimi i favorshëm i taksave, si ndaj kontributeve ashtu dhe ndaj përfitimeve. Sidoqoftë, arsyet për ndërmarrjen e reformave pensionale, respektivisht rikonstruimin e sistemit pensional përmes shtyllës së dytë dhe tretë rezultuan kryesisht nga nevoja për:

- rritjen e interesit individual dhe rritjen e përgjegjësisë ndaj sistemit pensional;
- sigurimin e mbrojtjes adekuate të të ardhurave të pleqërisë dhe shmangien e zvogëlimit të shkallës mesatare të zëvendësimit (si rezultat i zhvillimeve demografike të pafavorshme);
- rruajtjen e qëndrueshmërisë politike dhe financiare të sistemit pensional përmes shpërndarjes së rreziqeve;

Pra, tre shtyllat e sistemit pensional të sinkronizuara së bashku synojnë t'u sigurojnë njerëzve të ardhurat e pleqërisë, ngase vetëm të kombinuara me njëra tjetrën mund të neutralizojnë më së miri rreziqet demografike, investimet, rreziqet politike dhe rreziqet tjera që kërcënojnë shtyllat individuale.

II.3.2. Reformat pensionale në Sllovaki

Si një nga reformat më të rëndësishme pensionale të ndërmarra në Sllovaki konsiderohet reforma pensionale e vitit 2005, gjegjësisht inkorporimi i shtyllës së dytë si rezultat i efektivitetit të ulët të pensioneve vullnetare private të krijuara në vitin 1997. Po ashtu, për shkak të deficitit të sistemit publik (PAYG) u ndërmorrën reforma dytësore, sikurse: rritja graduale e moshës së daljes në pension dhe vendosja e një lidhje mes kontributeve dhe pagesave të përfitimeve ("Wilmington plc", 1978). Për rrjedhojë, në mënyrë tabelare sjellim karakteristikat e secilës shtyllë të sistemit pensional Sllovak.

Tabela 14: Karakteristikat e sistemit pensional Sllovak

Shtylla e parë	Shtylla e dytë	Shtylla e tretë
Që nga viti 1907	Që nga viti 2005	Që nga viti 1996
Mbulon: 100%	Mbulon: 62%	Mbulon: 35%
PAYG publike	Llogari individuale private	Llogari individuale private
I detyrueshëm	Vullnetare	Vullnetare
Me përfitime të përcaktuara	Me kontribute të përcaktuara	Me kontribute të përcaktuara
Agjencioni i Sigurimeve Sociale	Menaxherët privat	Menaxherët privat
Mbikëqyrja: Ministria e Punëve	Mbikëqyrja: Banka Kombëtare	Mbikëqyrja: Banka Kombëtare
Norma e zëvendësimit: 45% e pagës mesatare		
<i>Burimi: World Bank International Insurance Symposium, Peter Penzes, fq: 3</i>		

Përfshirja e shtyllës së dytë rezultoi me pasoja natyrore në sistemin e pensioneve publike. Masat thelbësore të ndërmarra në drejtim të reformave pensionale pritej që të ndikojnë në reduktimin e presionit financiar në periudhë afatgjate, përderisa në periudhë afatshkurtër transformimi radikal i sistemit pensional shkaktoi një kosto të konsiderueshme, e njohur si kosto e tranzicionit. Me rikonstruimin e sistemit pensional, shtylla e parë pësoi reduktim të kontributeve me qëllim që transferimet shtesë nga buxheti i shtetit ose nga fondi rezervë të jenë të mundshme dhe të arsyeshme.

Po ashtu, qeveria sllovaqe planifikoi t'i përdor të ardhurat shtesë nga privatizimi për të mbuluar deficitin e ardhshëm (Penzes, 2012). Sidoqoftë, pjesëmarrësit në shtyllën e detyrueshme, aktualisht mund të transferojnë një pjesë të taksës së tyre të pagave në llogaritë e tyre individuale. Kjo përqindje është e lartë dhe përbën 9% të pagës bruto. Norma e përgjithshme e kontributit është 28.75% e pagës bruto, për të cilën punëdhënësit paguajnë 21.75% dhe punonjësit 7%. Shkalla e kontributit ndahet mes programit të pensioneve publike (19.75%) dhe shtyllës së re të detyrueshme (9%) (Ivan, 2006).

Shtylla e dytë paraqet skemën e detyrueshëm të llojit të kontributeve të përcaktuara, pra 9% nga bruto pagat të drejtuara në llogaritë individuale të anëtarëve, kurse mjetet e grumbulluara menaxhohen nga kompanitë për menaxhimin e aseteve pensionale. Shtylla e fundit paraqet skemën vullnetare të llojit të kontributeve të përcaktuara që daton nga viti 1996. Po ashtu, edhe në shtyllën e tretë mjetet e grumbulluara menaxhohen nga menaxherët privat dhe mbikëqyren nga Banka Kombëtare.

Pra, reformat pensionale të ndërmarra në Sllovaki kishin për qëllim rivendosjen e qëndrueshmërisë afatgjate të pensioneve publike, forcimin e parimit të meritës dhe promovimin e kursimeve private pensionale, përkatësisht promovimin e shtyllës së tretë.

II.3.3. Reformat pensionale në Poloni

Shfrytëzimi i privilegjeve të pensioneve të hershme nga ana e popullsisë polake konsiderohej si një nga arsytet për zbatimin e reformës pensionale në Poloni. Moshë e largimit nga tregu i punës llogaritej si njëra nga më të ulëtat e vendeve të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD). Kjo e fundit, rezultoi nga trashëgimia e sistemit pensional paraprak që ofroi një gamë të gjerë të privilegjeve të daljes në pension të parakohshëm, drejtuar grupeve të ndryshme profesionale. Duke u nisur nga kjo, autorët e reformës pensionale gjatë dizajnit të sistemit të ri pensional kërkuan zgjidhje që do t'i stimulonin punëtorët që të zgjasin përvojën e tyre në punë (Agnieszka, 2009).

Sistemi pensional i Polonisë aktualisht përbëhet nga shtylla e parë dhe e dytë, e që plotësohen më tej nga kursimet pensionale vullnetar (shtylla e tretë). Po ashtu, përveç planeve pensionale vullnetare profesionale të prezantuara në vitin 1999, ekzistojnë edhe skemat personale vullnetare që ndonjëherë u referohen si shtylla e katërt dhe kanë për qëllim nxitjen e kursimeve shtesë private. Për më tej, Polonia në vitin 2002 krijoi një fond rezervë demografik për të mbuluar deficitet e ardhshme. Sidoqoftë, sistemi i ri pensional mbuloi vetëm personat e lindur pas vitit 1948, që do të thotë se deri në vitin 2008 individët për dy arsye udhëhiqeshin sipas rregullave të sistemit të vjeçër, edhe atë: ose nuk ishin të mbuluar nga sistemi i ri pensional, ose sepse aplikonin për ndonjë aranzhim kalimtar (OECD Private Pensions Outlook, 2009).

Pensionet publike (shtylla e parë) paraqesin një skemë të detyrueshme PAYG të bazuar në llogaritë e kontributeve të përcaktuara imagjinare, të drejtuara nga institucioni shtetëror i sigurimeve shoqërore (ZUS), i cili zëvendësoi sistemin PAYG të mëparshëm me përfitime të përcaktuara. Llogaritë e kontributeve të përcaktuara imagjinare imitojnë parimet e pensioneve të financuara në sistemin publik, që do të thotë se përfitimet varen në mënyrë rigorozë nga kontributet e derdhura. Po ashtu, në një skemë me kontribute të përcaktuara imagjinare, ekziston një llogari hipotetike ose virtuale për çdo pjesëmarrës që përmban të gjitha kontributet e derdhura përgjatë periudhës kontribuese. Përfitimet pensionale llogariten duke marrë parasysh jetëgjatësinë mesatare në momentin e daljes në pension. Shkalla totale e kontributit është 19.5% e të ardhurave të tatueshme të punonjësit, e ndarë në mënyrë të barabartë ndërmjet punëdhënësve dhe punonjësve. Nga norma totale e kontributit shumica hyn në skemën publike, kurse 2.3% derdhet në skemën e llogarisë individuale që paguhet tërësisht nga punonjësi.

Llogaritë individuale të detyrueshme (shtylla e dytë) marrin formën e Fondeve pensionale të hapura dhe janë të llojit me kontribute të përcaktuara. Institucioni i sigurimeve shoqërore, kalon normën 2.3% të sistemit të detyrueshëm në Fondet e pensioneve të hapura. Për të vijuar më tej, Fondet pensionale të hapura paraqesin subjekte juridike të pavarura të krijuara dhe të menaxhuara nga një shoqëri aksionare, e ashtuquajtur Shoqëri e përgjithshme e fondit pensional. Përpos që ekziston një rregullore mbi atë se ku duhet të investohen mjetet e grumbulluara, Shoqëria në fjalë nga burimet e veta duhet të krijojë një llogari rezervë për Fondin e hapur. Kjo llogari shërben për të kompensuar deficitet që vijnë nga kthimet e investimeve (nën kthimin minimal të detyrueshëm).

Pensionet vullnetare profesionale (shtylla e tretë) kishin një fillim të ngadaltë në Poloni, duke u konsideruar si jo shumë të suksesshme (që nga prezantimi i tyre në vitin 1999) ("Wilmington plc", 1978). Skemat e pensioneve vullnetare profesionale janë skema me kontribute të përcaktuara dhe me stimulime të kufizuara tatimore. Pra, nëse punëdhënësi krijon një skemë pensionale vullnetare profesionale është i detyruar të paguajë kontribute për personelin e tij, por të mos e tejkalojë 7%-shin e pagës së punonjësit.

II.3.4. Reformat pensionale në Slloveni

Përkeqësimi financiar i fondeve pensionale në Slloveni dukshëm nënvizoi nevojën e sigurimit të burimeve financiare shtesë dhe përmirësimin e praktikave të menaxhimit të rrezikut, duke shkaktuar një sërë përpjekjesh për reforma në sistemin pensional (Groome et al., 2006). Reformat pensionale synonin kryesisht (Sinfo, 2010):

- sigurimin e pagesës së rregullt të pensioneve për pensionistët dhe për punëtorët që do dalin në pension në dekadat e ardhshme;
- sigurimin e një pensioni të denjë për gjeneratat aktuale dhe të ardhshme;
- rritjen e drejtësisë së sistemit pensional me theks të veçantë në kontributet individuale (arkën e pensioneve);
- ngarkimin e barabartë të gjeneratave (moshës së re, mesme dhe të moshuar);
- zbatimin gradual të ndryshimeve, respektivisht rikonstruimin e sistemit pensional.

Sistemi i Sigurimit pensional dhe invalidor i Republikën së Sllovenisë mbulon (Ministria e punës, familjes, çështjeve sociale dhe mundësive të barabarta):

1. sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor bazuar në solidaritetin mes brezave;
2. sigurimin e detyrueshëm pensional në bazë të kontributeve të paguara në llogaritë e kursimeve personale pensionale;
3. sigurimin pensional vullnetar në bazë të kontributeve të paguara në llogaritë e kursimeve personale pensionale.

1. Sigurimi i detyrueshëm pensional dhe invalidor garanton: të drejtat për pension (pension të pleqërisë, pension të parakohshëm, invalidor, të pjesshëm, familjar); të drejtat për sigurim invalidor (të drejtat për rehabilitim profesional, përfitim rehabilitues profesional, përfitim invalidor, të drejtën për të punuar me orar të pjesshëm, por jo më pak se katër orë në ditë ose njëzet orë në javë, etj) dhe të drejta të tjera (të drejtën për ndihmë dhe kompensim, për plotësim vjetor).

2. Sigurimi i detyrueshëm pensional (profesional) mbulon kërkesat e detyrueshme të sigurimit pensional profesional dhe të drejtat që rrjedhin nga sigurimi në rast të pleqërisë dhe vdekjes, të përcaktuara në bazë të kontributeve të paguara. Shuma e pensionit profesional varet nga shuma e fondeve të depozituara në llogarinë personale të personit dhe nga kohëzgjatja e periudhës së marrjes së pensionit profesional (shuma nuk mund të bjerë nën shumën që personi i siguruar do të kishte marrë në sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor).

3. Sigurimi pensional vullnetar (plotësues) përfaqëson depozitimin e fondeve në llogarinë personale të një anëtar, me qëllim të sigurimit të të ardhurave shtesë për personin kur ai /ajo fiton të drejtat nga sigurimi i detyrueshëm pensional dhe invalidor. Ky fond mund të krijohet dhe menaxhohet nga: një shoqëri pensionale; një shoqëri sigurimi që posedon autorizim për të kryer transaksione brenda grupit të sigurimit jetësor dhe nga një bankë që posedon autorizim për të kryer transaksione në lidhje me menaxhimin e fondeve pensionale.

Pra, si arsye kryesore për rikonstruimin e sistemit pensional sllloven konsiderohen ndryshimi i strukturës së popullsisë dhe tregut të punës, reduktimi aktiv i forcës punëtore, inkuadrimi i vonshëm i të rinjve në tregun e punës, dalja e parakohshme në pension, etj.

II.3.5. Reformat pensionale në Hungari

Reforma pensionale gjithëpërfshirëse që u zhvillua në Hungari kishte për qëllim transformimin e sistemit pensional në dy shtylla (njëjtë sikur në vendet anëtare të BE-së). Po ashtu, si reforma pensionale të rëndësishme vlen të theksohen dy modifikimet në sistemin pensional hungarez, sikurse (Ministry for National Economy, 2010):

- zbatimi i anëtarësimit të detyrueshëm në Fondit pensional hungarez (nga 1 janari i vitit 1998) dhe krijimi i Fondeve private pensionale vullnetare, si dhe;
- rritja e moshës së daljes në pension (në vitin 2009).

Gjatë rikonstruimit të sistemit pensional hungarez u paraqitën vështirësi të cilët fillimisht e vurën në diskutim financimin e shtyllës së parë. Po ashtu, si një vështirësi strukturore e sistemit pensional hungarez ishte edhe fakti i detyrimeve të solidaritetit dhe llojit të kujdesit social nga shtylla e parë. Llojet e solidaritetit ndërlidhen me detyrimet pensionale të pleqërisë dhe llojet sociale për kompensimet e individëve me aftësi të kufizuara dhe me përfitimet e hershme të pensionit. Andaj, si rrjedhojë e këtij dualiteti të solidaritetit dhe llojeve të kujdesit social brenda shtyllës së parë sistemi hungarez pensional nuk u tregua transparent.

Për të vijuar më tej, sistemi pensional hungarez u ballafaqua edhe me problemin e stimulimit, respektivisht nuk dha stimuj të mjaftueshëm për kursimet pensionale vullnetare që rezultuan në një akumulim nën-optimal të kursimeve afatgjate në fondet vullnetare pensionale private. Së fundmi, sistemi pensional u ballafaqua edhe me mungesën e 1 milion punonjësve të punësuar ligjërisht që paguanin kontribute në afat të shkurtër dhe të mesëm, si dhe me mungesën e 1 milion fëmijëve që rrjedhimisht ndikojnë në qëndrueshmërinë afatgjate të sistemit pensional.

Ndonëse sistemi pensional hungarez hasi në vështirësi dhe kundërshtime gjatë ridizajnit të tij, prap se prap arriti të modifikohet dhe të sjellë një sistemi të ri pensional të bazuara në tre shtylla, edhe atë:

- Shtylla e parë (sistemi publik PAYG);
- Shtylla e dytë (sistemi i detyrueshëm i fondit të pensioneve private);
- Shtylla e tretë (sistemi i fondit të pensioneve private vullnetare).

Gjatë shqyrtimit të reformave pensionale dhe arsytet e nxitjes së reformave në fjalë, konstatojmë se modifikimet më të rëndësishme pensionale në shtetet në zhvillim (Estoni, Poloni, Hungari, Slloveni, Sllovaki) ndodhën gjatë viteve 90 - ta e këndeje, e që kishin të bëjnë kryesisht me inkorporimin e shtyllës së dytë dhe të tretë. Përpos kësaj, rimodelimi i sistemeve pensionale në shtetet në zhvillim kishte për qëllim edhe rritjen e interesit individual dhe rritjen e përgjegjësisë ndaj sistemit pensional, sigurimin e mbrojtjes adekuatë të të ardhurave të pleqërisë, sigurimin e një pensioni të denjë për gjeneratat e ardhshme, rritjen e transparencës, rruajtjen e qëndrueshmërisë politike dhe financiare të sistemit pensional përmes shpërndarjes së rreziqeve, etj.

II.4. Reformat pensionale në shtetet në tranzicion

Konteksti ekonomik dhe politik luajti një rol vendimtar në dizajnimin e reformës pensionale. Ndonëse kaluan dy dekada nga transformimi politik dhe ekonomik, reforma pensionale akoma mbetet një detyrë e papërfunduar në pjesën më të madhe të vendeve post-socialiste. Për rrjedhojë, reformatorët e skemës pensionale duhej të gjenin përgjigje përtej lëvizjes së gjerë nga shteti në treg, përkatësisht nga sistemi PAYG në parafinancim. Andaj, nëse të moshuarit në të ardhmen do të jenë në gjendje më të mirë se tani nuk do të varet vetëm nga dizajni i reformës pensionale, por edhe nga kapacitetet shtetërore, posaçërisht kapacitetet administrative që dallojnë qartë nga rajoni në rajon. Siç potencon (Barr, 2001) “nëse qeveria është joefektive çdo skemë pensionale do të rrezikohet”, qoftë e formës private apo publike ose kontribuese apo jokontribuese.

II.4.1. Reformat pensionale në Shqipëri

Transformimi i ekonomisë së centralizuar në ekonomi të tregut krijoi domosdoshmërinë për zgjerimin e rrjetit të mbrojtjes sociale dhe ndërmarrjen e një reforme rrënjësore në sistemin e Sigurimit social të Shqipërisë, respektivisht krijimin e një sistemi të ri që synonte²⁰: krijimin e një sistemi të ri që do t'ju përshtatej ndryshimeve radikale të ndodhura në rendin politik, ekonomik e social; ruajtjen e të drejtave sociale dhe ekonomike në fushën e sigurimeve sociale; unifikimin gradual të moshës së pensionit dhe të periudhës së kontribuimit në skemë gjatë një periudhe të caktuar kohore; garantimin e fondeve për të siguruar pagesat e pensioneve (që përfshinin rreth 1/6 e popullsisë së përgjithshme); reduktimin e pjesëmarrjes së buxhetit në drejtim të financimit të sigurimeve sociale dhe ofrimin e mundësive për zbatimin e skemave të reja të sigurimeve sociale të bazuara në kushtet e tregut (Gjini, 2013).

Mirëpo, si rrjedhojë e vështirësive përgjatë zbatimit të legjislacionit në periudhën 1994 - 1998, nevoja për konsolidimin e mëtejme të sistemit pensional, përvoja e grumbulluar diktuan më tej nevojën për ndërmarrjen e disa reformave parametrike në sistemin e pensioneve. Reformat më të rëndësishme parametrike u realizuan përgjatë vitit 2002 dhe kishin për qëllim fuqizimin e mëtejshëm të qëndrueshmërisë financiare të sistemit të Sigurimeve sociale. Sidoqoftë, në vitin 2004 - 2005 në sistemin e Sigurimeve sociale të Shqipërisë u konstatuan disa vështirësi tjera të cilat kerkonin zgjidhje të menjëhershme, sikurse: unifikimi i legjislacionit në fushën e sigurimeve me normat dhe standardet ndërkombëtare, rregullimi i legjislacionit sa i përket bazës së vlerësuar dhe indeksimit të saj dhe reduktimi i mëtejshëm i normës së kontributeve që vazhdon të mbetet akoma e lartë.

Pra, reformat e shumta parametrike të ndërmarra gjatë periudhës 1993-2005 sollën krijimin e sistemit aktual të Sigurimeve sociale në Shqipëri, që përbëhet nga:

1. **sigurimi i detyrueshëm** që mbështetet në parimin paguaj sot që të përfitosh nesër dhe mbulon të punësuarit, punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit;
2. **sigurimi vullnetar** që mbron një kategori të personave që janë jashtë kushteve të skemës së detyrueshme, gjegjësisht përfshinë personat që për shkaqe të arsyeshme nuk mund të sigurohen në skemën e detyrueshme;
3. **sigurimi suplementar** që përfshin pensionet shtesë për zyrtarët shtetëror;
4. **pensionet e posaçme shtetërore** që ndahen për kategori të caktuara sociale gjatë rasteve të veçanta dhe për arsye të veçanta të paraparë me ligj.

²⁰ Më 11 maj të vitit 1993 Parlamenti i Shqipërisë aprovoi Ligjin Nr. 7703, "Për Sigurimet Sociale në Republikën e Shqipërisë", që hyri në fuqi më 1 tetor 1993.

Po ashtu, vlen të theksohet se me Sigurimet sociale në Republikën e Shqipërisë merret Instituti i sigurimeve sociale (ISSH) që është i pavarur dhe operon në përputhje me Ligjin për sigurim social. Andaj, përmes klasifikimit të parametrave pensionale paraqesim karakteristikat kryesore të secilit parametër të sistemit pensional të Republikës së Shqipërisë.

Tabela 15: Parametrat e skemës së pensioneve në Republikën e Shqipërisë

Përqindja e kontributit	21.6 % për pensionet
Mosha e daljes në pension	Aktualisht për burrat (Instituti i sigurimeve shoqërore): Kategoria I - 62 vjeç me 36 vite kontribute të derdhura; Kategoria II - 65 vjeç me 36 vite kontribute të derdhura; Kategoria III - njëjtë si kategoria e dytë. Aktualisht për gratë: Kategoria I - 57 vjeç me 35 vite kontribute të derdhura; Kategoria II - 60v6m me 36 vite kontribute të derdhura; Kategoria III - njëjtë si kategoria e dytë.
Përqindja e përfitimit	Pensioni bazë + 1 % në vit të mesatares jetike të rivlerësuar sipas rritjes së kontributeve mesatare; 0.5% shtesë në muaj për shtyrjen e moshës së daljes në pension përtej moshës së caktuar për dalje në pension (Nr.7703, ndryshuar me nenin 1, të Ligjit nr. 104/2014, datë 31.07.2014); 0.6 % reduktim në muaj për dalje të parakohshme në pension deri 3 vjeç përpara afatit.
Indeksi i pensioneve pas daljes në pension	Indeksohen sipas legjislacionit në përputhje me ndryshimet e çmimeve.
Pensioni për personat me aftësi të kufizuara	Përfitohet vetëm në rast se ka pasur kontribute për gjysmën e periudhës, gjegjësisht nga mosha 20 vjeçare deri në moshën e paaftësisë; Pensioni i barabartë me shumën bazë + 1 % për çdo vit të mesatares jetike të rivlerësuar sipas rritjes së kontributeve mesatare; Pensioni maksimal është ose dyfishi i shumës bazë ose 80 % i pagës së fundit.
Pension për personat të mbetur të ve	E ve në moshën 55 vjeçare, mbajtëse e një fëmije që ishte në ngarkim të të vdekurit deri në moshën 8 vjeç dhe e paaftë për punë; I ve në moshën 60 vjeçare, mbajtës i një fëmije që ishte në ngarkim të të vdekurit deri në 8 vjeç dhe i paaftë për punë.
Burimi : Legjislacioni shqiptar dhe informacione të marra nga faqja zyrtare ISSH (www.ish.gov.al)	

Përgjatë shqyrtimit të skemave pensionale të Republikës së Shqipërisë konkludojmë se, arsyeja kryesore e reformimit të herë pas hershëm të sistemit të Sigurimeve sociale mbetet qëndrueshmëria financiare. Megjithatë, ekzistojnë edhe faktorë tjerë të cilët ndërlidhen me qëndrueshmërinë financiare, sikurse: prirja e padëshiruar e plakjes së popullsisë, vendosja e kufijve minimal dhe maksimal për madhësinë e pensionit dhe transformimi nga ekonomia e centralizuar në atë të tregut që u shoqërua me papunësi masive, rritje të ekonomisë informale dhe dalje masive në pension të parakohshëm të punonjësve si rezultat i rikonstrumit apo mbylljes së ndërmarrjeve publike (veprim që ndikoi edhe në përkeqësimin e raportit i punësuar-pensioner).

II.4.2. Reformat pensionale në Bosnjë dhe Hercegovinë

Pas shpërbërjes së Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë dhe krijimit të shteteve të reja u krijuan edhe sisteme të reja pensionale në secilin prej këtyre shteteve, përfshirë edhe Bosnjën dhe Hercegovinën (me të gjitha elementet e tyre të bazuara në sistemin e Sigurimeve pensionale dhe invalide të Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë).

Sigurimi pensional dhe invalidor në Bosnjë dhe Hercegovinë u rregullua me Aktin për sigurim pensional që hyri në fuqi më 30 korrik 1998 dhe bazohej në parimet e reciprocitetit, solidaritetit të gjeneratave dhe në natyrën e detyrueshme të sigurimit pensional dhe invalidor (sistemit PAYG)²¹. Për më tej, ky i fundit nënkuptonte edhe ndërmarrjen e disa reformave parametrike, sikurse (Omanovic, 2009):

- zvogëlimin e të drejtave dhe përfitimeve që ofronte sistemi pensional paraprak;
- uljen e vështirësive në kërkesat për të drejtën e pensionit të pleqërisë (kufijtë e moshës për gratë 55 vjeç dhe për meshkujt 60 vjeç u rritën në 65 vjeç për të dy gjinitë dhe jo më pak se 20 vjeç shërbim për të drejtën e përfitimit të pensionit, ose 40 vjeç shërbim pa marrë parasysh moshën);
- ndryshim në përcaktimin e bazës së pensionit (që nga viti 2005 rritje graduale e bazës së pensionit për çdo vit), si dhe
- ndryshim në përqindjen e bazës së pensionit për përcaktimin e shumës së pensionit (nga 85% - 75%).

²¹ Para miratimit të aktit për krijimin e Sistemit Pensional dhe Invalidor në Bosnjë dhe Hercegovinë (periudha 1992 - 1995), ekzistonin dy institucione sociale që në thelb ishin të bazuara në Sistemin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë - Gazeta Zyrtare e Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës 29/98, 49/00, 32/01, 73/05 dhe 59/06.

Mirëpo, me qëllim të arritjes së qëndrueshmërisë financiare dhe stabilitetit të sistemit të Sigurimit pensional dhe invalidor u bënë ndryshime në harmonizimin e pensioneve, pra pensionet u harmonizuan në bazë të fondeve të mbledhura për pagesën e pensioneve. Ndonëse u ndërmorrën një sërë reformash parametrike, qeveria e asokohe vlerësonte së për të siguruar një qëndrueshmëri afatgjate të sistemit pensional është e nevojshme një reformë sistemore që do siguronte stabilitet, mbulim më të gjerë dhe mundësi të reja për inkorporimin e formave të reja të sigurimit pensional. Për rrjedhojë, qeveria e Bosnjës dhe Hercegovinës themeloi një grup ekspertësh që ishin drejtpërdrejtë të kyçur në sistemin pensional. Ekspertët e angazhuar përdorën njohuritë dhe përvojën e tyre për të kontribuar në gjetjen e zgjidhjeve më adekuate për Sigurimin pensional dhe invalidor. Andaj, më 30 janar 2008 qeveria e Bosnjës dhe Hercegovinës miratoi draft strategjinë e reformës së sistemit pensional, ku përpos kësaj u shtrua një debat publik pas së cilës u themeluan bazat për reformën e ardhshme të sistemit pensional të Bosnjës dhe Hercegovinës.

Aktualisht, sistemi pensional i Bosnjës dhe Hercegovinës përbëhet nga dy skema në të dy njësitë - Federata e Bosnjë dhe Hercegovinës (FBH) dhe Republika Sërbe (RS) (Internatioal Labour Office, 2009). Të dy njësitë posedojnë fonde të veçanta pensionesh ndërkohë që skemat e pensioneve rregullohen me legjislacion të veçantë. Sa i përket financimit të ardhurat kryesore të burimeve për sistemin pensional janë të ardhurat nga kontributet, pothuajse 100% e të ardhurave në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe 65% të të ardhurave në Republikën Sërbe.

Shpenzimet kryesore të sistemit pensional përfshijnë: përfitimet pensionale prej 94%, shpenzimet për administrimin e sistemit pensional deri në 3%, për sigurim shëndetësor pensional 2% dhe shpenzimet tjera 1%. Sistemi pensional i Bosnjës dhe Hercegovinës siguron: pensionet e pleqërisë, pensionet për individët me aftësi të kufizuar dhe për të mbijetuarit. Të parët përbëjnë 44% të numrit të përgjithshëm të përfitimeve pensionale të ofruara, të dytët zënë 21% dhe 35% zënë pensionet për të mbijetuarit. Për më tej, raporti mes numrit të punëtorëve dhe numrit të pensionistëve është relativisht i pafavorshëm, 1.29 punëtorë për 1 pensionist, që rezulton me nivel të ulët të përfitimeve të pensioneve (European Commission et. al, 2008).

Së fundmi, ajo që mund të thuhet rreth reformës pensionale në Bosnjë dhe Hercegovinë është fakti se, reformat në fjalë u nxitën kryesisht nga: nevoja për të luftuar varfërinë, rruajtja e stabilitetit të sistemit pensional dhe siguri i qëndrueshmërisë financiare afatgjate, nevoja për të përmirësuar dhe përforcuar sistemin e financimit publik, lehtësimin e aderimit të Bosnjës dhe Hercegovinës në Bashkimin Evropian, rikthimin e besimit tek individët dhe përfituesit e siguruar në sistemin pensional dhe krijimin e një fondi të fortë pensional që do të plotësojë

nevojat e klientëve. Andaj, sfidat kryesore të sistemit pensional në fjalë mbeten kryesisht përshtatshmëria, qëndrueshmëria dhe transparenca.

II.4.3. Reformat pensionale në Sërbë

Sërbia si shumë shtete tjera në tranzicion u parapriu reformave parametrike në drejtim të rikonstruimit të sistemit pensional, respektivisht inkorporimit të shtyllës së tretë. Madje, vetëm në dekadën e fundit ndërmoi një set reformash pensionale, në drejtim të: legjislacionit pensional, rritjes së moshës së daljes në pension, riformulimit të formulës së indeksimit, ripërcaktimit të pensionit minimal dhe maksimal, ndryshimit dhe ripërcaktimit të pensionit për personal me aftësi të kufizuar, etj.

Aktualisht, sistemi pensional në Sërbë është një sistem publik PAYG që rregullohet sipas ligjit për sigurim pensional dhe invalidor. Po ashtu, përveç kontributeve nga të punësuarit sigurimi i mjeteve pensionale realizohet edhe nga buxheti i shtetit, shitja e kapitalit social gjatë procesit të privatizimit, fitimi neto i akumuluar nga portofoli i letrave me vlerë që transferohen në Fond dhe nga burime tjera të parapara me ligjin për Sigurimin pensional dhe invalidor. Pra, sistemi pensional i Sërbisë përbëhet nga (Jovanović et al., 2015):

- **shtylla e parë** - sigurimi i detyrueshëm pensional dhe invalidor i rregulluar sipas ligjit për sigurim pensional dhe invalidor;
- **shtylla e tretë** - sigurimi pensional vullnetar që përfshin fondet e pensioneve vullnetare dhe planet ligjore.

Shtylla e parë funksionon sipas parimit të solidaritetit mes brezave (PAYG), të punësuarit e tanishëm financojnë pensionistët e tanishëm me një normë kontributi prej 22%, duke ofruar pensione për të moshuarit, individët me aftësi të kufizuar, të mbijetuarit dhe kompensim në para për dëmtim trupor, ndihmë dhe përkujdesje ndaj personit të tretë dhe për mbulim të shpenzimeve të varimit. Moshë e daljes në pension është 60 vjeç për gra dhe 65 për burat me një periudhë sigurimi minimum prej 15 vitesh. Po ashtu, sigurimi i detyrueshëm pensional dhe i aftësisë së kufizuar sigurohet dhe administrohet nga Fondi për sigurimin pensional dhe invalidor, ku konsolidimi administrativ u arrit më 1 janar 2008 nga tre fonde të veçanta që administruan më parë sigurimin pensional dhe invalidor për punonjësit, të vetëpunësuarit dhe fermerët, ndërsa konsolidimi financiar u arrit më 1 janar 2011 (Nikač, 2015).

Fondet pensionale vullnetare dhe planet ligjore u themeluan në vitin 2006, kurse në fund të vitit 2008 u krijuan gjithsej 10 fonde që siguronin 155.871.00 individë (6.2% e personave të siguruar në shtyllën e parë). Si parime bazë u konsideruan anëtarësimi vullnetar, shpërndarja e rrezikut të investimeve, barazia e anëtarësimit dhe transparenca (Pension and Disability Insurance Fund of Serbia).

Mirëpo, pavarësisht reformave parametrike të ndërmara nga vitit 2001 e kënde, Sërbia është në proces të vazhdueshëm të përmirësimit të funksionimit të sistemit pensional në drejtim të administrimit të pensioneve, rrjedhimisht efikasitet të lartë dhe kosto të ulët, përmirësim të mbledhjes së kontributeve, përforcim të shtyllës së tretë, përfshirje të fondit ushtarak në pensionin publik, etj.

II.4.4. Reformat pensionale në Mal të Zi

Zbatimi i reformave pensionale u bë pothuajse një domosdoshmëri në dekadat e fundit si për shtetet në zhvillim ashtu edhe për shtetet në tranzicion, ndonëse reformat pensionale në shtetet në zhvillim ishin vështirë për t'u zbatuar si rezultat i tregjeve financiare të pazhvilluara dhe tregjeve të pafavorshme të punës - dimensione këto, që përcaktojnë prioritetet e zbatimit të reformës pensionale. Duke u nisur nga kjo, Mali i zi për të mënjeluar dobësitë e shumta me të cilët ballafaqohej sistemi pensional i asokohe, për të arritur stabilitet financiar të qëndrueshëm në bashkëpunim dhe konsultim të vazhdueshëm me Bankën Botërore vendosi të përdorë konceptin e sistemit pensional me shumë shtylla, edhe atë: riformulimin e sistemit ekzistues (PAYG) bazuar në solidaritetin e gjeneratave (shtylla I); përfshirjen e kursimeve të detyrueshme individuale të financuara plotësisht (shtylla II) dhe përfshirjen e kursimeve vullnetare (shtylla III) (Todorovic, 2009).

Si rrjedhojë e miratimit të Ligjit të ri për sigurim pensional dhe invalidor dhe zbatimin e tij prej 1 janar të vitit 2004 u vendos ristrukturimi i sigurimit ekzistues të detyrueshëm dhe prezantimi i një kornize normative për përfshirjen e shtyllës së dytë dhe tretë. Shtylla e parë e sistemit pensional operonte në përputhje me ligjin për sigurimin pensional dhe invalidor, përderisa dy shtyllat tjera të sistemit pensional operonin si subjekte me legjislacione të ndara.

Mirëpo, çdo veprim bart me vete edhe pasoja, përkatësisht pasojat nga aplikimi i ligjit të ri që kishin të bëjnë me: shpenzimet e pensioneve të shtyllës së parë të cilat ranë nga rreth 13 % e Prodhimit të Brendshëm Bruto para reformës në 9.4 % në vitin 2006; bazën e kontributeve që u rrit nga 51.5 % e të ardhurave të përgjithshme në vitin 2003 në 67.7 % në 2006 (si pasojë e një shkalle më të lartë të punësimit dhe të një rënie në aktivitetin e ekonomisë "gri"); dhe me trendin negativ në numrin vjetor të përfituesve të rinj të pensioneve, veçanërisht pensionistët e rinj me aftësi të kufizuara²² (Fabris, 2009). Në vijim, si rrjedhojë e ndryshimit të ligjit sjellim parametrat kryesorë të sistemit pensional të Malit të Zi.

²² Duke u bazuar në pasojat nga miratimi i aktit për rikonstruim të Sistemit Pensional dhe Invalidor, më 22 dhjetor 2010 Parlamenti i Malit të Zi miratoi ligjin për ndryshimet në Ligjin për sigurimin pensional dhe invalidor që hyri në fuqi më 6 janar 2011. Me miratimin e këtij ligji Mali i Zi vazhdoi reformën e Sistemit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor që filloi në vitin 2004.

Tabela 16: Parametrat kryesorë të sistemit pensional të Malit të Zi

Parametrat	Dispozitat
Shtylla I - Pensioni publik	
Përfshirja	Të gjithë punëtorët e sektorit privat dhe publik, të vetëpunësuarit dhe punëtorët bujqësorë (Hutsebaut, 2011).
Llojet e pensioneve	45% pensionet e pleqërisë (nga numri total i pensioneve të paguara nga Fondi). 27.5% pensionet për individët me aftësi të kufizuar dhe për të mbijetuarit.
Raporti i mbështetjes ekonomike	1.7 kontribues për një pensionist.
Kushtet për pension të pleqërisë	67 vjeç dhe të paktën 15 vjeç kontribute pensionale (rritja graduale e moshës për burrat deri në vitin 2025 dhe për gratë deri në vitin 2041) ("Official Gazette of the Republic of Montenegro" No. 54/03). 40 vjeç sigurim pensional pa marrë parasysh moshën. 30 vjeç sigurim pensional nga të cilët më së paku 20 vjeç janë përvojë pune efektive në miniera ku kontributi pensional llogaritet me përfitime në rritje.
Kushtet për pension të hershëm	Nga mosha 62 vjeç me 15 vjeç kontribute pensionale (si për burrat ashtu edhe për gratë), kurse në rast të daljes në pension të parakohshëm pensioni ulet me 0.35% në muaj.
Norma e zëvendësimit	Gjatë gjysmës së vitit 2010 ishte 66.41%. Shkalla e zëvendësimit neto të pensionit mesatar ishte 56% në vitin 2010.
Baza e llogaritjes	Në vitin 2004 koeficienti personal është llogaritur në bazë të 12 viteve më të mira të njëpasnjëshme. Që nga vitit 2004 numri i viteve që merren parasysh për llogaritjen e koeficientit personal u rrit për 2 në vit. Deri në vitin 2019 koeficienti personal (dhe kështu pensioni i pleqërisë) do të bazohet në të ardhurat e fituara gjatë tërë karrierës.
Shtylla e II - Sigurimi i detyrueshëm pensional i bazuar në kursimet personale të kapitalizuara	
Përfshirja	Çdo person i siguruar posedon llogarinë e tij personale të kursimit me një fond privat të pensionit, ku paguhen kontributet. Këto fonde investohen dhe fitimi u shtohet mjeteve në llogarinë personale të të siguarit.
Funksionimi	Shtylla e dytë bazohet në kursimet individuale që kapitalizohen më tej dhe funksionon si një sistem me kontribute të përcaktuara.
Operuesit me shtyllën e II	Shtylla e dytë është e natyrës juridike private me personat juridik privat si operatorë.
Transparent	Çdo person i siguruar ka qasje të shikojë në çdo moment shumën në llogarinë e tij/saj personale.
Shtylla e III - Sigurimi pensional vullnetar i bazuar në kursimet personale të kapitalizuara	
Parimet e shtyllës së dytë vlejné edhe për shtyllën e tretë.	

Pra, rikonstruimi i sistemit pensional në Malin e Zi kishte për qëllim reduktimin e përgjegjësisë së shtetit ndaj sigurimit të detyrueshëm publik. Përpos kësaj, arsyet për nxitjen e reformave pensionale në Mal të Zi ishin të shumta, duke filluar nga nevoja për:

- barazimin e kushteve të daljes në pension si për burrat ashtu dhe për gratë;
- rritjen graduale të moshës së daljes në pension (67 vjeç për meshkujt deri në vitin 2025 dhe për gratë deri në vitin 2041);
- miratimin e dispozitës që një person me 40 vjeç kontribute të derdhura të fitoj të drejtën për pension pavarësisht moshës së saj/tij;
- futjen e mundësisë së daljes në pension të parakohshëm në moshën 62 vjeçare me 15 vjeç kontribute pensionale të derdhura;
- reduktimin e moshës së daljes në pension nën 55 vjeç për llojet e veprimtarisë për të cilat kontributet pensionale llogariten me përfitime në rritje;
- ndryshimin e sistemit të indeksimit të pensioneve, etj.

Së fundmi, nënvizojmë se për të pasur një sinkronizim adekuat të reformave pensionale është e nevojshme krijimi i grupeve punuese të përshtatshme të përbëra nga përfaqësuesit e Ministrisë së financave, Ministrisë së punës dhe çështjeve sociale, përfshirë edhe përfaqësuesit e tregut të kapitalit dhe përfaqësuesit e Bankës Qëndrore.

II.4.5. Reformat pensionale në Republikën e Kosovës

Sistemi pensional i Republikës së Kosovës si pjesë integrale e sistemit pensional të Republikës Federale të Jugosllavisë (RFS), bazohej në parimin paguaj sot që të përfitosh nesër (pay as you go). Ky i fundit në vitin 1987 prodhoi një numër të lartë të pensionistëve në krasim më numrin e kontribuesve, duke operuar me një deficit financiar që fillimisht u mbulua nga buxheti dhe që më vonë u konsiderua si një nga shkaqet kryesore për shfaqjen e krizës ekonomike në Republikën Federale të Jugosllavisë.

Për më tej, parlamenti i Sërbisë solli vendimin e përjashtimit të shqiptarëve nga puna duke e detyruar integrimin me forcë të Fondit pensional të Kosovës në Fondin pensional të Sërbisë. Prandaj, gjatë viteve 1998-2002 popullata e moshuar e Kosovës nuk morrën pensione, punonjësit e ndryshëm nuk kontribuan në ndonjë sistem pensional, ngase funksionimi i sistemit pensional i Jugosllavisë u bllokua nga Serbia. Ky bllokim, në njërin anë ndërpreu mundësinë e pensionimit të individëve që plotësonin kushtet për dalje në pension, kurse nga ana tjetër krijoi nevojën për krijimin e një sistemi të ri pensional në Kosovë (Bexheti and Mjaku, 2017).

Sistemi i ri pensional i Kosovës filloi të zbatohet në vitin 2002 dhe kishte për qëllim: mbulimin e të gjithë banorëve të Kosovës, rritjen e moshës së daljes në pension, llogaritjen e pensioneve bazuar në pagë (përvojën totale), indeksimin e pensioneve, zvogëlimin e shkallës së zëvendësimit, përkatësisht krijimin e një sistemi pensional me tre shtylla. Mirëpo, ajo që e dallonte Kosovën nga shtetet tjera në transicion ishte mungesa e shtyllës së parë që krijoi nevojën për themelimin e një Fondi pensional që do të mbulote zbrazëtirën e shtyllës së parë. Kjo e fundit, u zëvendësua me themelimin e Trustit të kursimeve pensionale të Kosovës (TKPK), dhe funksionon në bazë të skemës obligative. Po ashtu, për plotësimin e reformës pensionale Rregullorja 2005/20 e Kosovës parashikoi themelimin e Fondit suplementar të punëdhënësve dhe themelimin e Fondit suplementar individual. Këto fonde suplementare formojnë shtyllën e tretë që përkrahet nga shteti përmes lehtësirave tatimore për punëdhënësin dhe të punësuarit që kursejnë në këtë skemë.

Aktualisht, sistemi pensional i Kosovës përbëhet nga (Fondi Pensional i Kosovës, 2006):

1. **shtylla e parë** që përfshin pensionin bazë ku qeveria e Kosovës nga buxheti i saj, çdo qytetarit mbi 65 vjeç i paguan pension mujor në vlerë prej 40€;
2. **shtylla e dytë** që përfshin kursimet individuale si rezultat i kontributit të detyrueshëm në TRSUT (5% punëdhënësi dhe 5 % punonjësi);
3. **shtylla e tretë** që përfshin pensionet suplementare të stimuluar nga lehtësimet tatimore, pra dallojmë dy lloje të fondeve suplementare: Fondi suplementar i punëdhënësve dhe Fondi suplementar individual (FONDI).

Pra, duke u bazuar në arsyet e nxitjes së reformave pensionale në shtetet tjera në tranzicion mund të themi se, edhe në Republikën e Kosovës reformat pensionale të ndërmarra kishin për qëllim racionalizimin e sistemit ekzistues financiar dhe përgatitjen e sistemit pensional me komponentën e financimit kapital, respektivisht krijimin e sistemit pensional me tre shtylla. Kjo e fundit, në mënyrë indirekte pati për qëllim edhe transferimin e përgjegjësisë mbi punëdhënësit dhe të punësuarit.

II.5. Analizë krahasimore e moshës së daljes në pension dhe normës së kontributit

Pas shyrimit të politikës pensionale dhe reformave pensionale të ndërmarra në gjithsej 14 shtete, duke marrë për bazë moshën e daljes në pension dhe normën e kontributit sjellim një aspekt krahasimor përmes një kombinimi të shteteve të zhvilluara dhe ato në zhvillim, kur kihet parasysh mosha e daljes në pension dhe norma e kontributit:

Tabela 17: Moshë e daljes në pension dhe norma e kontributit tek disa nga shtetet e zhvilluara

Moshë e daljes në pension			Norma e kontributit në %		
Shtetet	Gra	Bura	Punëdhënësi	Punonjësi	Total
SHBA	66	66	6.20	9.35	12.4
Japonia	62	62	Pjesërisht	Pjesërisht	14.64
Franca	65	65	10.45	7.30	17.75
Gjermania	65	65	9.35	9.35	18.7
Spanja	65	65	23.6	4.7	28.3
Italia	65	65	26.54 (drejtuesi dhe 28.98 për drejtuesit & punonjësit)	9.19	35.73
Kanada	65	65	4.95	4.95	9.9
Zvicra	64	65	4.2	4.2	8.4

Pra, shtetet e zhvilluara zbatojnë një moshë të daljes në pension nga 65 vjeç, kurse norma e kontributit është disi më e ulët në krahasim me grupin e shteteve të zhvilluara dhe në tranzicion (shtetet e zhvilluara synojnë në promovimin e skemave pensionale vullnetare).

Tabela 18: Moshë e daljes në pension dhe norma e kontributit tek disa nga shtetet në zhvillim dhe në tranzicion

Moshë e daljes në pension			Norma e kontributit në %		
Shtetet	Gra	Bura	Shtylla I	Shtylla II	Total
Estonia	62	63	20	2	22
Sllovakia	62	62	21.75	7	28.75
Polonia	60	65	17.2	2.3	19.5
Sllovenia	63	65	15.5	8.85	24.35
Hungaria	62	62	10	-	10
Maqedonia	62	64	11.7	6.3	18
Kosova	65	65	Pension prej 40 Euro	5 punëdhënësi & 5 punëtori	10

Tek shtetet në zhvillim dhe në tranzicion tendencat e moshës së daljes në pension janë rritëse, kurse në aspekt të normës së kontributit këta shtete janë me një normë kontributi më të lartë. Republika e Maqedonisë në krahasim me shtetet tjera që përsuan një zhvillim të mëvonshëm konsiderohet si një nga vendet me normë kontributi më të ulët, andaj për të arritur një konsolidim financiar njëri nga rekomandimet do të ishte pikërisht rritja e normës së kontributit në 21.2% dhe rritja e moshës së daljes në pension në përputhje me rritjen e jetëgjatësisë.

Tabela 19: Moshë e daljes në pension dhe norma e kontributit tek disa nga shtetet në tranzicion

Moshë e daljes në pension			Norma e kontributit në %			
Shtetet	Gra	Bura	Shtylla I	Shtylla III	Total	
Shqipëria	60	65	16.9	4.7 - sigurimi vullnetar që përfshin një kategori të personave që janë jashtë kushteve të skemës së detyrueshme që për shkak të arsyeshme nuk mund të sigurohen në skemën e detyrueshme. Nga totali 21.6 punëdhënësi paguan 12.79 dhe 8.81 punëtori.	21.6	
B & H	65	65	Nga totali prej 23 punëdhënësi paguan 6 dhe 17 punëtori			23
Sërbia	61	65	26	Sistemi pensional i Sërbisë përbëhet nga shtylla e I dhe III. Nga totali prej 26 punëdhënësi paguan 12 dhe 14 punëtori.	26	

Tabela 19-të paraqet llojin e sistemit pensional më specifik. Për shembull: Shqipëria përfshin sigurimin e detyrueshëm, sigurimin vullnetar që mbron kategorinë që për arsye të ndryshme nuk mund të sigurohen në skemën e detyrueshme, sigurimin suplementar dhe pensionet e posaçme vullnetare. Kosova dallohet nga shtetet tjera për mungesën e shtyllës së parë që e zëvendëson Trusti i kursimeve pensionale të Kososvës. Po ashtu, Serbia dallohet për sistem pensional që posedon shtyllën e parë dhe të tretë, respektivisht sistemin e detyrueshëm pensional dhe invalidor dhe sigurimin pensional vullnetar që përfshin fondet e pensioneve vullnetare dhe planet ligjore.

Së fundmi, ajo që mund të themi rreth shteteve që shërbyen si mostër për analizë krahasimore është fakti se, nevoja për reformimin e sistemeve pensionale (rritjen e moshës së daljes në pension dhe normën e kontributit) vijoi si domosdoshmëri për t'ju gjetur zgjidhje problemeve të shumta pensionale dhe për t'i krijuar instrumentet dhe strukturat e nevojshme ekonomike që do mundnin t'u sigurojnë pensione të gjithë atyre që derdhin kontribute mbi pagën e punës së tyre.

II.6. Shkaqet e nxitjes së reformave pensionale: analizë krahasimore

Kompleksiteti i çështjeve pensionale, shumëllojshmëria e qasjeve dhe rezultatet nga zbatimi i reformave pensionale kërkojnë një diskutim të vazhdueshëm për t'iu përgjigjur dilemave të shumëta sikurse: a jemi duke shkuar në drejtimin e duhur? A kemi përzgjedhur qasjen adekuate dhe çka më tej? Mundësia e shkëmbimit të pikëpamjeve dhe përvojave të ndryshme, diskutet e hapura në kërkim të përgjigjeve më të mira, përkeqësimi i vazhdueshëm i parametrave demografik dhe financiar, nxitën nevojën për ndërmarrjen e reformave të ndryshme pensionale. Mirëpo, sa dallonin shkaqet e nxitjes së reformave pensionale ndërmjet shteteve të zhvilluara, në zhvillim dhe atyre në tranzicion pasqyron më së miri tabela në vijim:

Tabela 20: Shkaqet e nxitjes së reformave pensionale në shtetet e zhvilluara, në zhvillim dhe atyre në tranzicion

Grup shtetet
Shkaqet e nxitjes së reformave pensionale në shtetet e zhvilluara rezultuan nga nevoja për: ▪ reduktimin e përfitimeve pensionale; ▪ përshtatshmërinë e programeve pensionale; ▪ gjetjen e mënyrave të reja për rifinancimin e programeve pensionale; ▪ krijimin e fondeve të reja pensionale; ▪ ristrukturimin themelor të programeve pensionale; ▪ transformimin e skemave pensionale nga skemat me përfitime të përcaktuara në kontribute të përcaktuara; ▪ riformulimin e formulës së llogaritjes së pensioneve; ▪ ndryshimin e mënyrës së indeksimit të pensioneve; ▪ rritjen e moshës së daljes në pension;

- dhe shumë më tepër.

Shkaqet e nxitjes së reformave pensionale në shtetet në zhvillim rezultuan nga nevoja për:

- përfshirjen e shtyllës së dytë dhe tretë (pensionet profesionale dhe kursimet vullnetare);
- uljen e deficitit të sistemit publik (PAYG);
- rritjen e interesit individual dhe rritjen e përgjegjësisë ndaj sistemit pensional;
- sigurimin e mbrojtjes adekuate të të ardhurave të pleqërisë;
- sigurimin e një pensioni të denjë për gjeneratat e ardhshme;
- rritjen e transparencës;
- forcimin e parimit të meritës;
- ngarkimin në mënyrë të barabartë përfshirë gjeneratën e moshës së re, të mesme dhe të moshuar;
- rruajtjen e qëndrueshmërisë politike dhe financiare të sistemit pensional përmes shpërndarjes së rreziqeve;
- rivendosjen e qëndrueshmërisë afatgjate të pensioneve publike;
- dhe shumë të tjera.

Shkaqet e nxitjes së reformave pensionale në shtetet në tranzicion rezultuan nga nevoja për:

- krijimin e një sistemi pensional që do t'ju përshtatej ndryshimeve radikale të ndodhura në rendin politik, ekonomik e social;
- ruajtjen e të drejtave sociale dhe ekonomike në fushën e sigurimeve sociale;
- unifikimin gradual të moshës së pensionit dhe të periudhës së kontribuimit në skemë gjatë një periudhe të caktuar kohore;
- garantimin e fondeve për të siguruar pagesat e pensioneve;
- reduktimin e pjesëmarrjes së buxhetit në drejtim të financimit të sigurimeve sociale,
- luftë kundër varfërisë;
- përmirësimin dhe përforcimin e sistemit të financimit publik;
- rikthimin e besimit tek individët dhe përfituesit e siguruar në sistemin pensional;
- krijimin e një Fondi të fortë pensional që do të plotësojë nevojat e klientëve;
- barazimin e kushteve të daljes në pension si për burrat ashtu dhe për gratë;
- ndryshimin e sistemit të indeksimit të pensioneve;
- krijimin e grupeve të përshtatshme punuese (përfaqësues nga organet kompetente);
- ofrimin e mundësive për zbatimin e skemave të reja të sigurimeve sociale bazuara në kushtet e tregut;
- dhe shumë të tjera.

Pra, gjatë trajtimit të hollësishëm të mostrës së shteteve të zgjedhura për analizë të procesit të reformave pensionale konstatojmë se, reformat në fjalë ishin kryesisht të nxitura nga ndikimi i presioneve të ndryshme sikurse: plakja e popullsisë, rritja e ulët e të ardhurave, jetëgjatësia, fertiliteti, shfrytëzimi i programeve të mirëqenies në mënyrë joproporcionale nga ana e të moshuarve, për të mos anashkaluar edhe presionet e faktorëve ekonomik.

Reformat më të rëndësishme pensionale në shtetet e zhvilluara (SHBA, Japoni, Francë dhe Gjermani) u zhvilluan kryesisht nga viti 1980-2003 dhe kishin të bëjnë me transformimin e skemave pensionale nga skemat me përfitime të përcaktuara në kontribute të përcaktuara, respektivisht krijimin e sistemeve me shumë shtylla. E gjithë kjo, për faktin se transferimi mes brezave në sistemet me shumë shtylla kryhet nga një kombinim i skemave PAYG dhe instrumenteve të financuara, andaj edhe ndikimi i plakjes së popullsisë në shtete që zbatojnë sisteme më shumë shtylla është i ndryshëm (varësisht të instrumentit ose shtyllës që shteti zbaton). Po ashtu, qeveritë nuk janë drejtpërdrejt përgjegjëse për përcaktimin e nivelit të përfitimeve të pensionit, që do të thotë se niveli i përfitimeve varet nga rregullat që zbatohen, performanca e tregut të aksioneve, aftësitë menaxheriale të menaxherit të fondeve, lloji i politikës së krijuar, etj.

Sa i përket zhvillimit të reformave pensionale në shtetet në zhvillim (Estonia, Polonia, Hungaria, Sllovenia, Sllovakia) mund të themi se modifikimet më të rëndësishme pensionale ndodhën gjate viteve 90 - ta e këndej dhe synonin rimodelimin e sistemit pensional, që rrjedhimisht do rezultonte me uljen e deficitit të sistemit publik (PAYG). Presionet ishin nga më të ndryshme, sikurse: plakja e popullsisë, reduktimi aktiv i forcës punëtore, inkuadrimi i vonshëm i të rinjve në tregun e punës, efektiviteti i ulët i pensioneve vullnetare private, rritja graduale e moshës së daljes në pension, vendosja e një lidhje mes kontributeve dhe pagesave të përfitimeve, shfrytëzimi i privilegjeve të pensioneve të hershme, respektivisht dalja e parakohshme në pension, etj.

Së fundmi, shtetet në tranzicion ndonëse nuk filluan nga zero, prap se prap pësuan në reforma pensionale dhe sistemit pensional duke trajtuar një detyrë akoma më të vështirë, rindërtimin e kuadrit ekzistues institucional. Reforma sistemike shpesh herë shoqërohej ose u parapri nga reforma parametrike, ku disa nga shtetet në tranzicion u përcaktuan për skemën me kontribute të përcaktuara me parafinancim të detyrueshëm. Të gjitha reformat e ndërmarra - parametrike, synonin racionalizimin e sistemeve ekzistuese pensionale dhe diversifikimin e reziqeve demografike dhe atyre ekonomike. Ndonëse reformat pensionale dallonin nga shteti në shtet sa i përket formës dhe periudhës së zbatimit, prap se prap arsyet ishin të njëjta dhe vijuan kryesisht si rrjedhojë e transformimit të ekonomisë nga një ekonomi e centralizuar në atë të tregut, nga prirja e padëshiruar e plakjes së popullsisë dhe përkeqësimi i parametrave demografik dhe atyre financiar.

Natyrisht që vështirësitë e fushës pensionale (si rrjedhojë e kompleksitetit dhe aktualitetit të tyre) nxisin nevojën për rishikimin e tyre të mëtejshëm ose rishikimin e më hollësishëm të disa aspekteve të tyre - hulumtime permanente.

KAPITULLI III: SISTEMI PENSIONAL I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË: MODALITETET PËR SIGURIM PENSIONAL

III.1. Sistemi pensional i Republikës së Maqedonisë: reformat dhe struktura e tij

Republika e Maqedonisë përgjatë periudhës transitore pësoi në reforma pensionale dhe të sistemit pensional me qëllim të konsolidimit të fondit pensional dhe sigurimit të mjeteve për pagesat e pensioneve. Sistemi pensional si pjesë e sistemit financiar vazhdon të mbetet përgjegjës për sigurimin e mjeteve financiare dhe për sigurimin social për pensionerët ekzistues dhe ato të ardhshëm, rrjedhimisht mobilizimin e mjeteve dhe sigurimin e pensioneve për personat që plotësojnë kushtet ligjore për dalje në pension (Mrksic, 2003).

Sipas një këndvështrimi historik sistemi pensional i Republikës së Maqedonisë ekziston më shumë se 60 vjeç, e që gjatë gjithë kohës përmirësohet dhe zhvillohet duke tentuar të sigurojë një qëndrueshmëri financiare afatgjate. Ndryshimet më të rëndësishme të këtij subjekti janë bërë në vitin 1995 deri 1997, 2000 dhe 2006, ku njëherit me ndryshimin e fundit të ligjit për sigurim pensional dhe invalidor u vendosun bazat e financimit kapital të sigurimit pensional dhe invalidor. Megjithkëtë, duke ndjekur simetrikisht praktikat ndërkombëtare dhe njëkohësisht në bashkëpunim me Fondin Monetar Ndërkombëtarë dhe Bankën Botërore, në vitin 2006 në Republikën e Maqedonisë u ndërmorrën disa reforma të rëndësishme në drejtim të përmirësimit të sistemit pensional (Бар и Дажмонд, 2003).

Pra, nga 1 janar i vitit 2006 filloi implementimi i sistemit të reformuar pensional ku rolin kryesor vazhdon të luaj Fondi për sigurim pensional dhe invalidor. Ky i fundit, duke ndjekur formën procedurale bën thirrjen, kontrollin dhe kryerjen e transferit të kontributeve për sigurimin pensional dhe invalidor në llogaritë personale të siguruesve (e që janë të siguruar në fondet private pensionale), realizimin e së drejtës për sigurim pensional dhe invalidor dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare për sigurim social (Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i Republikës së Maqedonisë).

Të gjitha reformat e ndërmarra parametrike kishin për qëllim racionalizimin e sistemit financiar ekzistues dhe njëkohësisht përgatitjen e sistemit me financim shtesë, përkatësisht me komponentin e financimit kapital. Reformat në fjalë përfshinë: rritjen e moshës së daljes në pension, llogaritjen e pensioneve të bazuar në pagat (nga gjithsej përvoja), indeksimin e pensioneve, uljen e normës së zëvendësimit dhe krijimin e një sistemi pensional me më shumë shtylla që do të ofrojë mënyrë të kombinuar të financimit dhe diversifikimit të reziqeve ekonomike dhe demografike. Mbi të gjitha, reformat e ndërmarra duhej të mundësonin

funkcionimin e sistemit pensional në tre shtylla, edhe atë: shtylla e parë që përfshinë sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor në bazë të solidaritetit të gjeneratave, shtylla e dytë sigurimin pensional të detyrueshëm me financim kapital dhe shtylla e tretë sigurimin pensional vullnetar në bazë të kursimit të kapitalizuar individual.

Për rrjedhojë, në shtyllën e parë dhe të dytë nga sistemi i detyrueshëm pensional përfshihen të gjithë të punësuarit në bazë të marrëdhënies së punës dhe kryerjes së veprimtarisë, e në shtyllën e tretë përfshihen të gjithë personat që ndajnë mjete aq sa dëshirojnë - vullnetarët. Sa i përket menaxhimit të mjeteve që grumbullohen nga pagesat e kontributeve, ligjërisht me mjetet që grumbullohen në shtyllën e parë qeverisën Fondi për sigurim pensional dhe invalidor, kurse me mjetet që grumbullohen në dy shtyllat tjera menaxhojnë kompanitë private pensionale (KB Shoqëria e parë pensionale dhe NLB Fondi i ri pensional që në mars të vitit 2018 mori emrin e ri Shoqëria e pensioneve Sava sh. a Shkup²³).

Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i Republikës së Maqedonisë mundëson realizimin e sigurimit pensional dhe invalidor konform ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, e në mënyrë të veçantë rregullon të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor për të gjithë siguruesit e Republikës së Maqedonisë. Po ashtu, në Fondin për sigurim pensional dhe invalidor zbatohet politika e zhvillimit të sigurimit pensional dhe invalidor, ndërmerren masat për përmirësimin e të njëjtit, përcaktohen të drejtat për shfrytëzimin e pensionit minimal dhe maksimal, realizimin e pensionit të pleqërisë, invalidor dhe familjar, kompensimin me të holla në rastet e dëmtimeve fizike dhe të drejtat tjera që dalin nga sigurimi pensional dhe invalidor (Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i Republikës së Maqedonisë).

Përgjatë realizimit të së drejtës për shfrytëzim të pensionit të pleqërisë, invalidor dhe atij familjar i siguruari paraprakisht duhet t'i plotësoj kushtet sikurse më poshtë:

Tabela 21: Të drejtat dhe kushtet për shfrytëzim të pensionit të pleqërisë, invalidor dhe familjar

Pension pleqërie
Të drejtat dhe kushtet për shfrytëzim të pensionit të pleqërisë: ▪ 64 vjeç për meshkuj dhe 62 për femra dhe më së paku 15 vjeç përvojë pune; ▪ përcaktimi i pensionit të pleqërisë: mesatarja mujore e pagave gjatë periudhës së sigurimit; ▪ në bazën pensional nuk përfshihen pagat që i siguruari do t'i realizojë gjatë vitit të realizimit të drejtës për pension; ▪ pensioni i pleqërisë përcaktohet nga baza e pensionit në përqindje, varësisht nga lartësia e përvojës (stazhit).
Pension invalidor
Në rast se konstatohet se tek i siguruari ekziston invaliditet, edhe atë:

²³ Investimi i mjeteve në kompanitë private pensionale kryhet në përputhje me rregullat strikte të ligjit dhe rregulloreve të tjera për financim kapital, si dhe në përputhje me strategjinë dhe taktikat e Fondit. Mjetet e investuara në kompanitë private janë nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të Agjencionit për mbikëqyrje të sigurimit pensional me financim kapital.

- në rastin kur ndryshimet në gjendjen shëndetësore nuk mund të mënjahen me shërim, rrjedhimisht zvogëlim të përhershëm të punës (më tepër se gjysma) krahasuar me të siguarin që posedon arsim të njëjtë dhe që është fizikisht apo psikikisht shëndoshë e mire (në rast se i siguari është mbi moshën 50 vjeç);
- në rastin kur ndryshimet shëndetësore nuk menjanohen me shërim, për rrjedhojë i siguari humb përjetësisht të drejtën për punë pa marrë parasysh moshën për punë.

Pension familjar

Pensioni familjar fitohet në rast të plotësimit të kushteve të veçanta dhe të përgjithshme.

Kushtet e përgjithshme:

- nëse i siguari nga i cili merret pensioni familjar në ditë e vdekjes ka mbushur më së paku 5 vite shtazh sigurimi ose 10 vite stazh pensional;
- nëse i siguari përmbush kushtet për pension të pleqërise dhe invaliditetit ose ka qene shfrytëzues i tyre;
- nëse vdekja e të siguarit vjen si rrjedhojë e lëndimeve në punë ose sëmundjeve profesionale, atëherë anëtarët e familjes fitojnë pension familjar varësisht nga stazhi i pensionimit të të siguarit;

Kushtet e veçanta:

- mundësi për shfrytëzim të pensionit familjar nga e veja (nëse ajo ka mbushur 50 vjeç, ka qenë e pa aftë për punë ose paaftësia është shkaktuar brenda 1 vit pas vdekjes së tij dhe në rast të ketë mbetur me një ose me shumë fëmijë ku me ç'rast e veja i kryen obligimet prindërore);
- e veja fiton pension familjar edhe në rast se: fëmija e të siguarit lind pas vdekjes së tij; ka ekzistuar shtatëzania në ditën e vdejes së tij; si dhe nëse fëmija lind i vdekur ose vdes para 45 ditëve, të vesë i takon pension familjar për skadimin e 45 ditëve pas lindjes;
- mundësi për shfrytëzim të pensionit familjar nga vejani (të ketë mbushur 55 vite me rastin e vdekjes së bashkëshortes; deri në vdekjen e saj të ketë qenë i paaftë për punë ose pa aftësi të jetë shkaktuar në afat prej 1 viti deri në ditën e vdekjes së saj; si dhe të ketë mbetur me një ose më shumë fëmijë ku me ç'rast duhet t'i kryen obligimet prindërore);
- mundësi për shfrytëzim të pensionit familjar nga fëmija deri në moshën 15 vjeç dhe deri në moshën 26 vjeç nëse shkollohet. Mirëpo, nëse fëmija gjatë periudhës së shfrytëzimit të pensionit mbetet i paaftë për punë atëherë ai përgjithëmonë e bartën të drejtën e shfrytëzimit të pensionit familjar;
- Mundësi për shfrytëzim të pensionit familjar nga ana e prindit (deri në vdekjen e shfrytëzuesit të pensionit e ëma ka mbushur 45 vjeç dhe i ati 55 vjeç).

Burimi: Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i Republikës së Maqedonisë

Në momentin e plotësimit të kushteve të parapra me ligjin për sigurim pensional dhe invalidor, të siguarit fitojnë të drejtën e daljes në pension. Se si ka lëvizur numri i të punësuarëve dhe pensionistëve, si dhe numri i të punësuarëve për një pensioner gjatë periudhës 1991-2017, sjellim tabelën vijuese:

Tabela 22: Numri i shfrytëzuesve të pensionit dhe numri i personave të punësuar 1991-2017²⁴

Vitet	Numri i të punësuarëve	Numri që shfrytëzojnë pensione	Numri që shfrytëzojnë pensione deri në 1000 të punësuar	Numri i të punësuarëve për 1 pensioner
1991	534.887	180.749	338	3.0
1992	531.083	193.294	364	2.7
1993	503.010	210.537	418	2.4
1994	468.632	216.834	463	2.2
1995	427.658	219.307	513	2.0

²⁴ Pranë këtyre shfrytëzuesve të pensionit Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor paguan edhe pension ushtarak dhe të bujqëve. Bashkë me këto pensione të shpërndara numri i përgjithshëm i shfrytëzuesve të pensionit arrin 310.744 shfrytëzues të pensionit.

1996	403.820	222.727	552	1.8
1997	381.723	227.099	596	1.7
1998	370.869	232.216	626	1.6
1999	374.025	235.839	631	1.6
2000	367.162	241.221	657	1.5
2001	351.009	247.200	704	1.4
2002	332.728	249.421	750	1.3
2003	321.105	254.262	775	1.3
2004	348.212	260.075	747	1.3
2005	348.500	265.152	761	1.3
2006	394.882	269.681	714	1.46
2007	424.338	272.386	693	1.55
2008	451.491	273.281	654	1.65
2009	475.780	273.977	576	1.74
2010	466.280	273.751	587	1.70
2011	489.608	280.891	567	1.74
2012	507.061	285.411	557	1.8
2013	526.909	291.821	549	1.8
2014	536.191	296.215	548	1.8
2015	558.821	299.640	536	1.9
2016	570.168	305.766	536	1.9
2017	575.574	310.744	540	1.9
Burimi: nga raportet vjetore për vitet përkatëse nga Fondi për sigurim pensional dhe invalidor				

Pra, nga viti 1991-2006 kemi një rënie graduale në numrin e të punësuarëve dhe që rrjedhimisht ndikon tek raporti i punësuar - pensioner. Pas vitit 2006 ky numër filloi gradualisht të rritet duke arritur deri në 575.574 të punësuar (duke e rritur edhe raportin i punësuar - pensioner deri në 1.9).

Tabela 23: Lëvizja e numrit të përfituesve të pensionit 1991-2017

Vitet	Pensioni i pleqërisë	Pensioni invalidor	Pensioni familjar	Gjithsej
1991	94.676	38.206	47.867	180.749
1992	102.021	41.030	50.243	193.294
1993	113.799	43.867	52.871	210.537
1994	116.617	45.472	54.745	216.834
1995	116.241	46.509	56.557	219.307
1996	116.560	47.431	58.254	222.245
1997	118.148	48.909	60.042	227.099
1998	119.194	51.208	61.814	232.216
1999	120.574	52.060	63.205	235.839
2000	124.210	52.549	64.462	241.221
2001	128.322	52.619	66.259	247.200
2002	129.648	52.514	67.259	249.421
2003	133.008	52.237	69.022	254.267
2004	137.840	51.589	70.646	260.075
2005	142.827	50.180	72.145	265.152
2006	164.852	49.364	73.465	269.681
2007	150.075	48.364	74.257	272.696
2008	149.682	48.562	75.037	273.281
2009	150.092	47.947	75.937	273.976
2010	151.894	46.118	75.739	273.751

2011	156.016	44.895	76.530	277.441
2012	162.086	43.648	76.600	282.334
2013	169.362	42.741	77.011	289.114
2014	176.157	41.245	76.458	293.860
2015	182.954	39.814	76.872	299.640
2016	190.633	38.343	76.790	305.766
2017	197.383	36.970	36.391	310.744

Burimi: nga raportet vjetore për vitet përkatëse nga Fondi për sigurim pensional dhe invalidor

Sipas tabelës së prezantuar më lartë vërejmë se numri i përfituesve është në rritje, pra më shumë se gjysma e shfrytëzuesve të pensioneve janë përfitues të pensionit të pleqërisë, kurse pjesa tjetër i dedikohet përfituesve të pensionit familjar dhe invalidor.

Tabela 24: Parametra të rëndësishëm rreth gjendjes së sistemit pensional nga viti 1994-2017 (kolona 2 dhe 3 në million denarë)

Vitet	Të ardhurat	Shpenzimet	Numri i pensionistëve	Numri i të punësuarëve	R. i punësuar pensioner	Lëvizja e të punësuarëve në shërbimin profesional
1994	17.494	18.444	216.834	468.632	2.2	-
1995	18.010	18.295	219.307	427.658	2.0	630
1996	18.326	18.925	222.727	403.820	1.8	635
1997	18.879	19.504	227.099	381.723	1.7	621
1998	20.520	20.533	232.216	370.869	1.6	611
1999	21.031	20.681	235.839	374.025	1.6	620
2000	22.896	22.941	241.221	367.162	1.5	625
2001	24.289	24.696	247.200	351.009	1.4	624
2002	25.809	25.880	249.421	332.728	1.3	635
2003	27.728	27.764	254.262	321.105	1.3	623
2004	29.028	29.117	260.075	348.212	1.3	607
2005	28.911	29.028	265.152	348.500	1.3	656
2006	32.409	31.206	269.681	394.882	1.46	704
2007	34.053	32.770	272.386	424.338	1.55	684
2008	37.622	38.733	273.281	451.491	1.65	716
2009	41.589	41.393	273.977	475.780	1.74	678
2010	41.470	42.507	273.751	466.280	1.70	737
2011	43.937	44.305	280.891	489.608	1.74	709
2012	46.371	46.227	285.411	507.061	1.8	677
2013	51.070	50.855	291.821	526.909	1.8	654
2014	53.781	54.017	296.215	536.191	1.8	636
2015	57.254	56.789	299.640	558.821	1.9	645
2016	61.684	61.488	305.766	570.168	1.9	637
2017	65.319	65.148	310.744	575.574	1.9	608

Burimi: nga raportet vjetore për vitet përkatëse nga Fondi për sigurim pensional dhe invalidor

Pra, tek të gjitha parametrat vërejmë oscilime relative dhe që deri diku janë edhe të arsyeshme, ngase këto oscilime janë kryesisht rezultat i ndryshimit të faktorëve demografik, ekonomik dhe i transformimit të sistemit pensional të Republikës së Maqedonisë.

Megjithkëtë, ajo që është për t'u nënvizuar është fakti se çdo ndryshim në cilin do qoftë parametër shkakton ndryshime në parametrat tjerë të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor. Kjo varshmëri e krijuar nga parametrat bazë thekson edhe një herë arsyet që impenjuan konsolidimin e sistemit pensional të Republikës së Maqedonisë, edhe atë: nga nevoja për përmirësimin e performancës financiare, uljen e presionit të mplakjes së popullsisë, ndryshimin e sistemit të bazuar në parimin e solidaritetit të brezave dhe nga nevoja për futjen e një sistemi të kombinuar nga fondet shtetërore dhe ato private.

III.2. Specifikat dhe kompanitë që menaxhojnë me fondin e detyrueshëm shtetëror

Shtylla e dytë po ashtu është e detyrueshme, por për dallim nga shtylla e parë të cilën e kontrollon shteti me shtyllën e dytë udhëheqin shoqëritë pensionale sipas ligjit për sigurim pensional të detyrueshëm me financim kapital. Çdo shkujdesje përgjatë menaxhimit të mjeteve të grumbulluara krijon pasiguri dhe mosbesim tek shfrytëzuesit e pensioneve në lidhje me të ardhmen e tyre. Duke u nisur nga kjo fondet e detyrueshme pensionale ligjërisht orientohen në atë se, si dhe ku duhet investuar mjetet e grumbulluara dhe janë përgjegjës për shumëfishimin e mjeteve të mobilizuara, rrjedhimisht krijimin e profitit për pensionerët e ardhshëm.

Në Republikën e Maqedonisë shoqëritë pensionale që menaxhojnë me shtyllën e dytë janë: NLB Fondi i ri pensional që në mars të vitit 2018 mori me emrin e ri Shoqëria e pensioneve Sava sh.a Shkup dhe KB Shoqëria e parë pensionale. Riemërtimi i NLB Fondit të ri pensional vijoi si rrjedhojë e shitjes së 100% të aksioneve kompanisë slovene Sava Re DD., Ljubljana, që konsiderohet si një grup i fuqishëm (shtatë kompani sigurimi dhe dy kompani pensionesh), me një reputacion të gjerë ndërkombëtar. Ky grup i qëndrueshëm operon më shumë se 40 vite në industrinë e sigurimit dhe risigurimit, e që në përputhje me kriteret e përcaktuara në legjislacion ka arritur rezultate të shkëlqyera. Po ashtu, i gjithë procesi i blerjes është realizuar nën mbikëqyrjen e Agjencionit për mbikëqyrjen e sigurimeve pensionale me financim kapital.

Çdo anëtar i fondit të detyrueshëm pensional e fiton të drejtën e pensionit nga shtylla e dytë, në momentin që e fiton të drejtën për pension pleqërie konform ligjit për sigurim pensional dhe invalidor (mosha e daljes për pension për burra 64 vjeç dhe për gra 62 vjeç, me përvojë pune minimum 15 vjeç), pra anëtarët e shtyllës së dytë marrin një pension nga Fondi për sigurim pensional dhe invalidor dhe një nga institucioni i autorizuar për pagesën e pensionit

nga shtylla e dytë. E kur kjo arrihet, anëtari i Shoqërisë së pensioneve Sava sipas zgjedhjes individuale shfrytëzon shumën e plotë të mjeteve të akumuluar në tre mënyra, përmes²⁵:

- tërheqjeve të programuara në bazë të kontratës së lidhur mes anëtarit dhe shoqërisë e cila menaxhon me fondin e detyrueshëm pensional;
- tërheqjeve të përkohshme të programuara si rrjedhojë e kombinimit me pension (anuitet) përjetësisht të vonuar;
- blerjes së menjëhershme të pensionit (anuitetit), nga shoqëria për sigurim jetësor e autorizuar për realizimin e së njëjtës.

Format e mësipërme konsistojnë me procedurën e ushtrimit të së drejtës për pension si nga shtylla e parë ashtu edhe nga shtylla e dytë²⁶, megjithëse Shoqëria e pensioneve SAVA ofron edhe mundësi për realizimin e së drejtës për pension vetëm nga shtylla e dytë, pra në shërbim të anëtarëve të cilët nuk kanë ushtruar të drejtën e pensionit të pleqërisë nga FSPI-ja, si rrjedhojë e mospërmbljes së kërkesave ligjore. Duke u nisur nga kjo, anëtarët paraqesin kërkesat e tyre për ushtrimin e së drejtës për pension vetëm nga shtylla e dytë tek shoqëritë që menaxhojnë me fondet pensionale ku ata janë anëtarë, edhe pse kërkesat duhet të dorëzohen pas përfundimit të moshës 65 vjeç, të shoqëruar me deklaratë të vërtetuar nga noteri publik për heqje dorë nga e drejta e pensionit të shtyllës së parë dhe nga e drejta për shumën më të ulët të pensionit.

Kurse, sa i përket trashëgimit të mjeteve (në përputhje me Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital), mjetet e akumuluar në llogarinë individuale të anëtarit të vdekur, mund të trashëgohen vetëm nëse anëtari i vdekur nuk ka anëtarë në familjen e tij që do e shfrytëzonin të drejtën për pension familjar konform Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor. Në vijim prezantojmë shpërndarjen e anëtarëve në fondet e detyrueshme pensionale sipas statusit të tyre, kontributet e paguara në shtyllën e dytë, kompensimet, vlerën e mjeteve neto, vlerën e njësisë kontabile dhe strukturën e investimeve të fondeve të detyrueshme pensionale nga ana e shoqërive pensionale për periudhën 2006 - 2017.

²⁵ Kur jemi tek tërheqja e përkohshme e programuar dhe blerja si modalitete që ofrohen nga shoqëria e sigurimit theksojmë se, këto modalitete implementohen menjëherë pasi që të lëshohet licenca e parë për kryejn e punës së sigurimit në klasën e anuitetit dhe pagimit të pensioneve për shfrytëzuesit e pensioneve.

²⁶ Kjo procedurë fillon me paraqitjen e kërkesës për realizimin e të drejtës të pensionit të pleqërisë në Fondin për sigurim pensional dhe invalidor. Pas kryerjes së procedurës, ky i fundit paraqet kopje nga vendimi i miratuar sa i përket njohjes ose mos njohjes së të drejtës për pension pleqërie në Shoqërinë pensionale që menaxhon me fondin pensional të parashtruesit të kërkesës.

Tabela 25: Shpërndarja e anëtarësisë sipas statusit të tyre në Sava sh. a Shkup për periudhën 2006-2017

Vitet	Vullnetarisht	Të detyrueshëm				Gjithsej
		Me kontratë	Të shpërndarrë	Përkohësisht të shpërndarë ²⁷	Gjithsej	
31.12.2006	27.638	22.205	8.437	3.127	33.769	61.407
31.12.2007	28.998	28.682	14.756	4.471	47.909	76.907
31.12.2008	30.240	40.147	20.110	3.169	63.426	93.666
31.12.2009	30.784	47.988	27.395	5.230	80.613	111.397
31.12.2010	31.350	57.945	32.627	4.161	94.733	126.083
31.12.2011	31.801	67.901	36.478	4.039	108.418	140.219
31.12.2012	32.080	76.570	39.705	4.903	121.178	153.258
31.12.2013	32.050	81.369	45.213	7.697	134.279	166.329
31.12.2014	32.009	81.469	56.181	8.134	145.784	177.793
31.12.2015	31.987	82.423	69.527	9.752	161.702	193.689
31.12.2016	31.829	81.986	79.699	10.753	172.438	204.267
31.12.2017	31.682	81.915	93.777	11.677	187.369	219.051

Burimi: nga raportet vjetore të statistikave për vitet përkatëse (Agjencioni për mbikëqyrjen e sigurimeve pensionale me financim kapital)

Pra, sa i përket shpërndarjes së anëtarësisë vërehet një oscilim relativ në kolonën vullnetarisht që përfaqëson anëtarët të cilët në mënyrë automatike me hyrjen në fuqi të shtyllës së dytë kanë kaluar në njërën nga fondet private. Kurse, sa i përket anëtarësimit të detyrueshëm po ashtu vërehet një trend rritës. Gjithsej numri i anëtarëve në vitin 2017 arrin deri në 219.051 anëtarë.

Tabela 26: Kontributet e paguara, kompensimet, mjetet neto dhe vlera e njësisë kontabile e fondeve pensionale të detyrueshëm në Sava sh. a Shkup për periudhën 2006-2017 (shumat janë në milion denarë)

Vitet	Kontribute ²⁸	Kompensime	Mjetet neto	Vlera e njësisë kontabile ²⁹
31.12.2006	596,54	52,07	557,12	105,929336
31.12.2007	859,06	76,00	1.419,46	115,511364
31.12.2008	1.154,04	91,42	2.232,91	100,155213
31.12.2009	1.363,41	109,78	4.001,80	116,874672
31.12.2010	1.458,51	109,10	5.700,89	125,009646
31.12.2011	1.612,14	112,33	7.435,29	129,003093
31.12.2012	1.778,77	125,06	9.774,67	139,225567
31.12.2013	1.915,72	136,09	12.447,83	151,117506
31.12.2014	2.109,46	148,04	15.322,08	160,733889
31.12.2015	2.417,75	160,78	18.578,00	170,193521
31.12.2016	2.733,08	178,49	22.358,80	179,771032

²⁷ Të siguruarit në mënyrë të detyrueshme antarësohen në shtyllën e dytë me qëllim që të sigurohet shumëfishimi i mjeteve. Sipas një zgjedhje të rastësishme anëtarët shpërndahen përkohësisht nga ana e Agjencionit për mbikëqyrjen e sigurimeve pensionale me financim kapital, me qëllim që të sigurohet shumëfishimi i mjeteve. Të siguruarit në fjalë, kanë afat kohorë 3 muaj për të zgjedhë në cilin Fond të detyrueshëm do të antarësohen. Mirëpo, nëse gjatë afatit kohorë nuk vendosin në cilin Fond do të antarësohen, atëherë mbesin anëtarë në Fondin pensional të detyrueshëm në të cilin ishin alokuar përkohësisht.

²⁸ Kontributet dhe kompensimet janë dhënë në bazë mujore dhe mjetet neto në vlerë kumulative.

²⁹ Njësia kontabile përdoret për mbajtjen e shënimeve rreth mjeteve në fondet pensionale. Një njësi kontabile, paraqet pjesëmarrjen proporcionale në mjetet e përgjithshme neto të fondit pensional. Pra, vlera e njësisë kontabile është e barabartë me vlerën e mjeteve neto, pjesëtuar me numrin e përgjithshëm të njësive kontabile të të gjithë llogarive dhe nënlogarive individuale.

31.12.2017	2.995,35	185,27	26.519,03	189,686331
<i>Burimi: nga raportet vjetore të statistikave për vitet përkatëse (Agjencioni për mbikëqyrjen e sigurimeve pensionale me financim kapital)</i>				

Me hyrjen në fuqi të shtyllës së dytë vërehet një trend rritës në pjesën e kontributeve dhe që rezulton në rritjen e kompensimeve dhe mjeteve neto. Vlera e njësishë kontabile gjithashtu shënon rritje duke arritur në vitin 2017 deri në 189,686331 njësi.

Kurse, sa i përket investimeve të fondeve pensionale nëpër aksione, depozita, obligacione apo nëpër letra me vlerë të tjera, rrjedhimisht kompanitë që dëshirojnë të përfshihen në portofolet e fondeve pensionale duhet të përmbushin një sërë kriteresh të përcaktuara paraprakisht në aktet ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me sigurimin pensional me financim kapital. Po ashtu, gjatë përzgjedhjes së kompanive që do përfshihen në portofolion e fondeve pensionale merren në konsideratë perspektivat afatgjate të këtyre kompanive konform afatgjatësisë së detyrimeve në bazë të presioneve të fondit, ndërkohë që në tregjet e huaja investohet edhe në obligacione të emetuara nga qeveritë dhe bankat qendrore të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, që parasegjithash plotësojnë kriteret për vlerësim të kreditit dhe ofrojnë një kthim të duhur kundrejt rrezikut.

Tabela 27: Struktura e investimeve të fondeve të detyrueshme pensionale nga Sava sh. a Shkup për periudhën 2006-2011 (në përqindje)

Lloji i pasurisë / investimit	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Aksionet nga emetuesit e huaj	0,00	0,79	1,06	2,49	4,67	5,58
Obligacionet nga emetuesit e huaj	0,00	0,00	0,00	0,00	3,80	0,00
Fondet e investimeve nga emetuesit e huaj	0,00	0,00	0,11	0,37	4,39	5,79
Letrat me v. afatshkurte - emetuesit e huaj	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
Aksionet nga emetuesit e brendshëm	4,98	22,38	7,79	5,44	3,27	3,06
Obligacionet nga emetuesit e brendshëm	67,34	54,77	48,52	59,94	50,76	63,44
F. Investimeve nga emetuesit e brendshëm	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
L. V. afatshkurte - emetuesit e brendshëm	13,19	0,00	2,39	0,00	0,52	0,00
Gjithsej investimi në letrat me vlerë	85,50	77,95	59,87	68,24	67,42	77,87
Depozitat	14,48	22,05	38,62	31,38	32,20	21,85
Mjetet në para	0,00	0,00	0,46	0,03	0,34	0,25
Kërkesat	0,01	0,00	1,06	0,35	0,04	0,04
Gjithsej mjetet	100,00	100,00	100,00	100,00	100,00	100,00
Gjithsej kërkesat	0,39	0,05	1,33	0,07	0,07	0,06
Mjetet neto	99,61	99,95	98,67	99,93	99,93	99,94
<i>Burimi: nga raportet vjetore të statistikave për vitet përkatëse (Agjencioni për mbikëqyrjen e sigurimeve pensionale me financim kapital)</i>						

Tabela 28: Struktura e investimeve të fondeve të detyrueshme pensionale nga Sava sh. a Shkup për periudhën 2012-2017 (në përqindje)

Lloji i pasurisë / investimit	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Aksionet nga emetuesit e huaj	6,40	10,42	10,47	11,64	11,76	11,72
Obligacionet nga emetuesit e huaj	0,00	0,00	0,00	0,45	1,00	1,33
Fondet e investimeve nga emetuesit e huaj	7,98	11,09	14,07	13,87	13,30	13,50
Letrat me v. afatshkurte - emetuesit e huaj	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
Aksionet nga emetuesit e brendshëm	3,93	4,33	4,44	4,46	3,96	4,25
Obligacionet nga emetuesit e brendshëm	63,98	61,33	55,85	56,27	56,49	57,61
F. Investimeve nga emetuesit e brendshëm	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
L. V. afatshkurte - emetuesit e brendshëm	1,02	0,00	0,00	1,57	1,43	0,00
Gjithsej investimi në letrat me vlerë	83,31	87,17	84,83	88,25	87,93	88,42
Depozitat	15,40	12,60	14,01	9,55	11,87	11,41
Mjetet në para	0,29	0,07	0,02	0,18	0,00	0,00
Kërkesat	0,99	0,16	1,14	2,02	0,20	0,16
Gjithsej mjetet	100,00	100,00	100,00	100,00	100,00	100,00
Gjithsej kërkesat	0,09	0,09	0,09	0,25	0,06	0,05
Mjetet neto	99,91	99,91	99,91	99,75	99,94	99,95
Burimi: nga raportet vjetore të statistikave për vitet përkatëse (Agjencioni për mbikëqyrjen e sigurimeve pensionale me financim kapital)						

Siç vërehet kemi një përzjerje të investimeve në llojet e letrave me vlerë ku pjesëmarrje më të madhe shënojnë obligacionet nga emetuesit e brendshëm - nën margjinat e 60%-shit (niveli më i ulët shënohet në vitin 2008 me 48.52%, kurse niveli më i lartë në vitin 2006 me 67.34%). Me tej, pasojnë investimet në aksionet nga emetuesit e brendshëm deri në 22.38%, për të vijuar me një rrënie të theksuar deri në 4.25% në vitin 2017. Në strukturën e investimeve rëndësi të veçantë shënojnë fondet e investimeve nga emetuesit e huaj (0.11% në vitin 2008, duke u rritur deri në 13.50% në vitin 2017) dhe aksionet nga emetuesit e huaj (niveli më i lartë prej 11.72% arrihet në vitin 2017). Përpos letrave me vlerë, struktura e investimeve mbështetet edhe në depozitat që në vitin 2008 shënojnë pjesëmarrje më të lartë prej 38.62%, për të vijuar më pas me një rrënie të dukshme deri në 11.41% në vitin 2017.

Sa i përket pagesës së pensione nga sigurimi i detyrueshëm pensional me financim kapital kushtet për fitimin e së drejtës për pension nuk ndryshojnë. Nga shtylla e parë paguhet pjesërisht pensioni i pleqërisë, familjar dhe pensioni invalidor sipas formulës së përcaktuar e cila përfshinë përqindjen e përcaktuar në varësi të viteve të shërbimit (përvoja), shumëzuar me bazën e pensionit e përcaktuar nga pagat e valorizuara gjatë gjithë kohës që i siguruari ka qenë në marrëdhënie pune. Kurse, pjesa tjetër e pensionit (mbetja) nga pensioni i pleqërisë, gjithmonë sipas një zgjedhje të anëtarit realizohet nga shtylla e dytë në njërën nga format e ofruara, edhe atë: përmes anuitetit pensional, tërheqjes së programuar apo përmes një kombinimi mes anuitetit pensional dhe tërheqjes së programuar.

Tabela 29: Pensionet e realizuara për anëtarët e shtyllës së dytë nga Sava Sh.a Shkup për periudhën 2008-2017

Vitet	Pension invalidor	Pension Familjar	Pension pleqërie			Gjithsej
2008	6	15	12			33
2009	10	11	0			21
2010	11	21	0			32
2011	17	5	0			22
2012	20	39	0			59
2013	31	28	0			59
2014	14	31	5			50
2015	12	36	Tërheqjet e programuar 1	Pagesë e menjëhershme 6	Trashëgimia 34	89
2016	28	74	6	16	49	173
2017	23	57	9	24	34	147

Burimi: nga raportet vjetore të statistikave për vitet përkatëse (Agjencioni për mbikëqyrjen e sigurimeve pensionale me financim kapital)

Pra, nga tabela e mësipërm vërejmë një rritje permanente në numrin e pensioneve pjesërisht të realizuara nga shtylla e dytë ku pjesa më e madhe e pensioneve të realizuara u përkasin pensioneve invalide dhe atyre familjare. Nga vitit 2015 filloi edhe realizimi i pagesës së pensioneve të pleqërisë në varësi të preferencës së anëtarëve të Shoqërisë Sava Sh.a Shkup.

Përpos Shoqërisë së pensioneve Sava sh.a Shkup me shtyllën e dytë menaxhon edhe KB Shoqëria e parë pensionale. KB Fondi i parë i hapur dhe i detyrueshëm pensional Shkup, i themeluar dhe menaxhuar nga ana e KB Shoqërisë së parë pensionale SHA Shkup, përbëhet nga mjetet e paguara nga kontributet e anëtarëve të kësaj shoqërie. Pronarët e fondit të parë pensional të detyrueshëm janë anëtarët aktual dhe anëtarët e pensionuar, ku të drejtat e tyre pronësore vijnë në varësi të shumës së mjeteve të akumuluar në llogaritë e tyre në fond. Për rrjedhojë, mjetet e fondit të parë të detyrueshëm pensional janë të ndara nga mjetet e KB Shoqërisë së parë pensionale SHA Shkup, duke u lënë nën rruajtjen e Bankës kujdestar me qëllim që të arrihet një nivel i lartë i sigurisë së këtyre mjeteve. Po ashtu, këto mjete nuk mund të jenë subjekt i të kërkuarit dhe as subjekt i ekzekutimit të kreditorëve në emër të KB Shoqërisë së parë pensionale.

Sikurse në Shoqërinë e pensioneve Sava sh.a Shkup edhe në KB Shoqërinë e parë pensionale investimi i mjeteve të grumbulluara nga anëtarët e saj, realizohet konform rregullave të repta ligjore për sigurim pensional të detyrueshëm me financim kapital dhe në harmoni me strategjinë dhe taktikën investuese të fondit të parë pensional. E gjithë kjo, vetëm e vetëm të minimizohet rreziku nga humbjet eventuale dhe të arrihet fitim sa më i lartë për të siguruarit (anëtarët) e saj. Kurse, për mbikëqyrjen e mjeteve të investuara kujdeset Agjencioni për mbikëqyrjen e sigurimit pensional me financim kapital (KB Shoqëria e parë pensionale SHA Shkup).

Pagimi i pensioneve dhe i kontributeve pensionale nga shtylla e parë dhe e dytë arrihet atëherë kur një anëtar i fondit pensional të detyrueshëm fiton të drejtën për pension të pleqërisë konform ligjit për sigurim pensional dhe invalidor. Mjetet e akumuluar në llogarinë e tij mund të shfrytëzohen në varësi të zgjedhjes individuale, qoftë përmes tërheqjeve të programuara, blerjes së një anuiteti pensional që paguhet deri në fund të jetës nga Shoqëria për sigurim jetësor e autorizuar për këtë qëllim ose përmes kombinimit të opsionit të parë dhe të dytë. Kurse, sa i përket trashëgimisë dhe mundësisë për realizimin e pensionit vetëm nga shtylla e dytë vlen procedura e njëjtë si në rastin e Shoqërisë së pensioneve Sava Sh.a Shkup.

Tabela 30: Shpërndarrja e anëtarësisë në fondin pensional të detyrueshëm sipas statusit të tyre në KB Shoqërinë e parë pensionale për periudhën 2006-2017

Vitet	Me vetëdëshirë	Të detyrueshëm				Gjithsej
		Me kontratë	Të shpërndarrë	Përkohësisht të shpërndarë	Gjithsej	
31.12.2006	32.835	21.292	8.770	3.727	33.789	66.624
31.12.2007	34.716	30.174	15.596	5.260	51.030	85.746
31.12.2008	36.060	39.770	21.842	3.802	65.414	101.474
31.12.2009	36.785	51.680	31.701	5.461	88.842	125.627
31.12.2010	37.259	61.386	37.339	4.903	103.628	140.887
31.12.2011	37.500	72.804	41.573	4.535	118.912	156.412
31.12.2012	37.566	82.275	44.992	5.389	132.656	170.222
31.12.2013	37.522	87.862	50.595	7.732	146.189	183.711
31.12.2014	37.473	87.947	61.326	8.612	157.885	195.358
31.12.2015	37.424	89.132	74.838	10.205	174.175	211.599
31.12.2016	37.279	89.161	85.233	11.085	185.479	222.758
31.12.2017	37.166	89.931	99.007	12.111	201.049	238.215

Burimi: nga raportet vjetore të statistikave për vitet përkatëse (Agjencioni për mbikëqyrjen e sigurimeve pensionale me financim kapital)

Sa i përket shpërndarjes së anëtarësisë edhe në rastin e KB Shoqërisë së parë pensionale vërehet një oscilim relativ në kolonën vullnetarisht dhe një trend rritës në pjesën e anëtarësimit të detyrueshëm që në vitin 2017 arriti deri në 238.215 anëtarë.

Tabela 31: Kontributet e paguara, kompensimet, mjetet neto dhe vlera e njësisë kontabile e fondeve pensionale të detyrueshëm në KB Shoqërinë e parë pensionale për periudhën 2006-2017 (në milion denarë)

Vitet	Kontribute	Kompensime	Mjetet neto	Vlera e njësisë kontabël
31.12.2006	728,76	63,64	684,42	106,265900
31.12.2007	1.023,95	90,69	1.704,51	115,303221
31.12.2008	1.336,51	105,45	2.771,57	107,116421
31.12.2009	1.595,93	131,13	4.737,26	120,667142 ³⁰
31.12.2010	1.684,74	126,75	6.740,75	129,590887
31.12.2011	1.879,56	131,33	8.583,89	130,697013
31.12.2012	2.015,43	143,20	11.349,43	142,372582

³⁰ Rritja e shpejtë e vlerës së njësisë kontabël në fund të muajt shtator në Shoqërinë Sava Sh.a. Shkup dhe në fund të muajt dhjetor në KB Shoqëria e parë pensionale, i detyrohet ndryshimit të mënyrës së vlerësimit të instrumenteve financiare. Kjo e fundit, ishte rrjedhojë e riklasifikimit të kategorisë instrumente financiare që deri në maturim mbahen në kategorinë instrumente financiare të disponueshme për shitje.

31.12.2013	2.174,01	155,97	14.351,87	153,757419
31.12.2014	2.376,00	168,95	17.706,97	164,578077
31.12.2015	2.695,46	182,76	21.374,23	174,392410
31.12.2016	3.025,03	201,58	25.691,42	184,786292
31.12.2017	3.311,50	209,02	30.392,74	195,037486
Burimi: nga raportet vjetore të statistikave për vitet përkatëse (Agjencioni për mbikëqyrjen e sigurimeve pensionale me financim kapital)				

Edhe në KB Shoqërinë e parë pensionale me hyrjen në fuqi të shtyllës së dytë vërehet një trend rritës në pjesën e kontributeve, rrjedhimisht edhe në rritjen e kompensimeve dhe mjeteve neto. Vlera e njësisë kontabile po ashtu shoqërohet me një rritje permanente sa që në vitin 2017 kjo vlerë arrin deri në 195,037486 njësi.

Sa i përket politikës së investimit KB Shoqëria e parë pensionale ndjek rreptësisht rregullat dhe parimet e vendosura nga ana e saj, nën mbikëqyrjen e Agjencionit për mbikëqyrje të sigurimit pensional me financim kapital. E gjithë kjo, vetëm e vetëm të sigurohet siguria e mjeteve të akumuluar, diversifikimi i rrezeve nga investimi i të njëjtave dhe rruajtja e nivelit adekuat të likuiditetit. Përpos kësaj, KB Shoqëria e parë pensionale përqëndrohet në arritjen e normës afatgjate nominale të interest, të paktën për 2 pikë përqindjeje mbi normën e inflacionit për të njëjtën periudhë (30 vjeç), përkatësisht arritjen e normës reale të interest të paktën për 2%.

Tabela 32: Struktura e investimeve të fondeve të detyrueshme pensionale nga ana e KB Shoqëria e parë pensionale për periudhën 2006-2011 (në përqindje)

Lloji i pasurisë / investimit	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Aksionet nga emetuesit e huaj	0,00	4,34	2,21	0,00	0,00	0,00
Obligacionet nga emetuesit e huaj ³¹	0,00	0,00	0,00	0,00	2,29	0,00
Fondet e investimeve nga emetuesit e huaj	0,00	0,29	0,68	0,30	7,21	19,68
Letrat me v. afatshkurte - emetuesit e huaj	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
Aksionet nga emetuesit e brendshëm ³²	2,83	15,91	6,45	4,24	3,13	3,88
Obligacionet nga emetuesit e brendshëm ³³	76,46	63,95	40,62	55,35	56,14	60,12
F. Investimeve nga emetuesit e brendshëm	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
L. V. afatshkurt - emetuesit e brendshëm ³⁴	1,73	0,00	4,88	0,00	0,00	0,00
Gjithsej investimi në letrat me vlerë	81,02	84,50	54,85	59,89	68,77	83,68
Depozitat	18,95	15,47	44,57	38,20	31,04	15,87
Mjetet në para	0,00	0,02	0,57	1,40	0,18	0,30
Kërkesat	0,03	0,02	0,01	0,51	0,01	0,15
Gjithsej mjetet	100,00	100,00	100,00	100,00	100,00	100,00
Gjithsej kërkesat	0,38	0,05	0,09	0,08	0,06	0,07

³¹ Obligacionet nga emetuesit e huaj përfshijnë obligacionet shtetërore.

³² Sipas KB Shoqërisë së parë pensionale qëllimi i investimeve në aksione bëhet kryesisht për të maksimizuar rritjen reale afatgjatë të mjeteve, kurse sa i përket investimeve në instrumentet me të ardhura fikse pritet që të gjenerohen të ardhura të qëndrueshme dhe të sigurohet mbrojtje e portfolios.

³³ Obligacionet nga emetuesit e brendshëm përfshijnë: obligacionet shtetërore të vazhdueshme, obligacionet shtetërore për denacionalizim, obligacionet shtetërore për kursime të vjeçra - në valutë të huaj, euro obligacionet maqedone, obligacionet korporative, etj.

³⁴ Letrat afatshkurtër nga emetuesit e brendshëm përfshijnë bonot e thesarit tre mujor.

Mjetet neto	99,62	99,95	99,91	99,92	99,94	99,93
Burimi: nga raportet vjetore të statistikave për vitet përkatëse (Agjencioni për mbikëqyrjen e sigurimeve pensionale me financim kapital)						

Tabela 33: Struktura e investimeve të fondeve të detyrueshme pensionale nga ana e KB Shoqëria e parë pensionale për periudhën 2012-2017 (në përqindje)

Lloji i pasurisë / investimit	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Aksionet nga emetuesit e huaj	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
Obligacionet nga emetuesit e huaj	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
Fondet e investimeve nga emetuesit e huaj	16,71	22,69	27,91	29,31	30,11	29,18
Letrat me v. afatshkurte - emetuesit e huaj	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
Aksionet nga emetuesit e brendshëm	3,47	2,95	2,52	2,15	1,89	2,13
Obligacionet nga emetuesit e brendshëm	66,32	61,99	59,83	61,62	63,53	63,35
F. Investimeve nga emetuesit e brendshëm	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
L. V. afatshkurt - emetuesit e brendshëm	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
Gjithsej investimi në letrat me vlerë	86,50	87,63	90,26	93,08	95,52	94,66
Depozitat	12,44	12,19	8,35	5,00	4,12	5,02
Mjetet në para	0,06	0,02	0,33	0,22	0,20	0,19
Kërkesat	1,00	0,15	1,06	1,70	0,15	0,14
Gjithsej mjetet	100,00	100,00	100,00	100,00	100,00	100,00
Gjithsej kërkesat	0,10	0,06	0,18	0,31	0,05	0,04
Mjetet neto	99,90	99,94	99,82	99,69	99,95	99,96
Burimi: nga raportet vjetore të statistikave për vitet përkatëse (Agjencioni për mbikëqyrjen e sigurimeve pensionale me financim kapital)						

Siç vërehet edhe në KB Shoqërinë e parë pensionale kemi një përzjerje të investimeve në llojet e letrave me vlerë ku pjesëmarrje më të madhe shënojnë obligacionet nga emetuesit e brendshëm (niveli më i ulët shënohet në vitin 2008 me 40.62%, kurse niveli më i lartë në vitin 2006 me 76.46%). Përgjithësisht, investimet në obligacionet nga emetuesit e brendshëm përgjatë periudhës së analizuar kanë lëvizur kryesisht nën margjinat e 60% - shit. Me tej, pasojnë investimet në aksionet nga emetuesit e brendshëm me një pjesëmarrje prej 2.13 % në vitin 2017, për të mos anashkaluar fondet e investimeve nga emetuesit e huaj (0.29% në vitin 2007 duke u rritur deri në 29.19% në vitin 2017) dhe depozitat që në vitin 2008 shënojnë pjesëmarrje më të lartë prej 44.57%, për të vijuar më një rrënie deri në 5.02% në vitin 2017.

Tabela 34: Pensionet e realizuara për anëtarët e shtyllës së dytë nga KB Shoqëria e parë pensionale

Vitet Lloji i pensionit	Pension Invalidor	Pension Familjar	Pension pleqërie			Gjithsej
2008	8	19	0			27
2009	9	19	0			28
2010	13	18	0			31
2011	20	8	0			28
2012	18	33	0			51
2013	50	36	0			86
2014	9	32	0			41
2015	35	63	Tërheqjet e programuar 0	Pagesë e menjëhershme 2	Trashëgimia 40	140
2016	34	67	8	4	52	165
2017	35	68	6	11	41	161

Sa i përket pensioneve të realizuara nga shtylla e dytë prej tabelës së mësipërm vërejmë një rritje të vazhdueshme në numrin e pensioneve pjesërisht të realizuara nga shtylla e dytë, ku pjesa më e madhe e pensioneve të realizuara u përkasin pensioneve invalidore dhe atyre familjare. Nga vitit 2015 edhe në KB Shoqërinë e parë pensionale filloi realizimi i pagesës së pensioneve të pleqërisë në varësi të preferencës së anëtarëve të anëtarësuar në këtë Shoqëri.

Megjithkëtë, karakteristika kryesore e shtyllës së dytë me financim kapital mbetet menaxhimi privat dhe konkurrues që ju mundëson shoqërive pensionale menaxhimin e fondeve pensionale dhe investimin e kontributeve të paguara (duke marrë për bazë rrjedhjen dhe menaxhimin e fondeve nga shoqëritë pensionale, përcaktohet strategjia për investime si mundësi për rritje maksimale të kontributeve të përgjithshme në interes të anëtarëve). Diversifikim i rreziqeve nga investimet e bëra (përfshirë edhe diversifikimin ndërkombëtar), po ashtu mbetet karakteristikë e rëndësishme për sistemin pensional, përfshirë të drejtën për zgjedhje individuale dhe iniciativë individuale.

III.3. Specifikat dhe kompanitë që menaxhojnë me fondin vullnetar

Shtylla e tretë paraqet mënyrën e re të sigurimit pensional me financim kapital në bazë të kontributeve të përcaktuara vullnetarisht. Ajo që e dallon shtyllën e tretë është përfshirja e të gjithë personave të cilët dëshirojnë të sigurojnë një volum të lartë të sigurisë materiale, kurse me mjetet e grumbulluara menaxhojnë kompanitë pensionale, sikurse: NLB Fondi i ri pensional i riemërtuar më tej Shoqëria e pensioneve Sava Sh.a Shkup dhe KB Shoqëria e parë pensionale.

Një anëtar i fondit pensional vullnetar i Shoqërisë së pensioneve Sava Sh.a Shkup fiton të drejtën e përfitimit pensional nga shtylla e tretë, të paktën 10 vite para moshës së fitimit të së drejtës për pension pleqërie konform Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor. Po ashtu, anëtari i fondit pensional vullnetar i Shoqërisë së pensioneve Sava Sh.a Shkup ka të drejtën e zgjedhjes individuale për njërin nga llojet e pensioneve, edhe atë: anuitete, tërheqje të programuara, pagesë të njëhershme, të shumëhershme ose një kombinim nga opsionet në fjalë. Kurse, sa i përket trashëgimisë së mjeteve po citojmë nenin 145 nga ligji për sigurim vullnetar pensional me financim kapital: *“Në rast të vdekjes të një anëtari të fondit pensional, mjetet e llogarisë të anëtarit ose të anëtarit në pension bëhen pjesë e trashëgimisë të trashëgimlënësit dhe me ato mjete vepron në përputhje me Ligjin për trashëgimi”* (Shoqëria e pensioneve Sava Sh.a Shkup).

Sa i përket shpërndarjes së anëtarësisë sipas statusit të tyre në Shoqërinë e pensioneëve Sava Sh.a Shkup, për të vijuar me kontributet e paguara në shtyllën e tretë, kompensimet, vlerën e mjeteve neto, vlerën e njësisë kontabile dhe strukturën e investimeve të fondeve vullnetare pensionale nga ana e Shoqërisë së pensioneëve Sava Sh.a Shkup për periudhën 2009-2017, sjellim tabelat në vijim:

Tabela 35: Shpërndarja e anëtarësisë në fondin pensional vullnetar sipas mënyrës së antarësisë në Shoqërinë Sava Sh.a Shkup për periudhën 2009-2017

Vitet	Vullnetarisht në llogari individuale	Në skemën e pensioneëve me llogari profesionale	Gjithsej
2009	1.036	551	1.587
2010	1.988	882	2.870
2011	2.499	1.325	3.824
2012	3.366	1.986	5.352
2013	3.866	2.487	6.353
2014	4.822	2.885	7.707
2015	5.443	3.148	8.591
2016	5.781	3.389	9.170
2017	6.141	3.502	9.643

Burimi: nga raportet vjetore të statistikave për vitet përkatëse (Agjencioni për mbikëqyrjen e sigurimeve pensionale me financim kapital)

Sa i përket shpërndarjes së anëtarësisë vërehet një trend rritës si në anëtarësimin me llogari individuale ashtu edhe në pjesën e anëtarësimin sipas skemës së pensioneëve me llogari profesionale. Gjithsej numri i anëtarëve në vitin 2017 arrin deri në 9.643 anëtarë.

Tabela 36: Kontributet e paguara, kompensimet, vlerat e mjeteve neto dhe vlera e njësisë kontabile e fondeve pensionale vullnetare në Shoqërinë e pensioneëve Sh.a Shkup për periudhën 2009-2017 (në milion denarë)

Vitet	Kontributet	Kompenzimet	Mjetet neto	Vlera e njësisë kontabël
31.12.2009 ³⁵	5,78	0,25	5,55	103,061825
31.12.2010	26,34	1,47	31,42	107,592926
31.12.2011	39,96	1,84	71,54	111,854726
31.12.2012	37,60	2,35	110,38	118,742851
31.12.2013	45,36	3,08	164,08	130,511147
31.12.2014	68,03	4,17	234,47	140,946772
31.12.2015	89,00	5,74	338,15	147,535595
31.12.2016	109,60	7,45	459,08	154,578083
31.12.2017	129,82	9,42	602,23	164,155073

Burimi: nga raportet vjetore të statistikave për vitet përkatëse (Agjencioni për mbikëqyrjen e sigurimeve pensionale me financim kapital)

Pra, me hyrjen në fuqi të shtyllës së tretë vërehet një trend rritës në kolonën kontributet e paguara që rrjedhimisht rezulton edhe me rritjen e kompenzimeve dhe mjeteve neto. Vlera e njësisë kontabile gjithashtu shënon rritje, përkatësisht deri në 164,155073 njësi në vitin 2017.

³⁵ Anëtarësimi dhe pagesa e kontributeve në Shoqërinë e pensioneëve Sava sh.a Shkup ka filluar më 15 korrik të vitit 2009.

Tabela 37: Struktura e investimeve të fondeve vullnetare pensionale në Shoqërinë e pensioneve Sava Sh.a Shkup për periudhën 2009-2013 (në përqindje)

Lloji i pasurisë / investimit	2009	2010	2011	2012	2013
Aksionet nga emetuesit e huaj	0,00	0,88	2,95	4,50	8,62
Obligacionet nga emetuesit e huaj	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
Fondet e investimeve nga emetuesit e huaj	0,00	5,46	9,13	8,61	12,00
Letrat me v. afatshkurte - emetuesit e huaj	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
Aksionet nga emetuesit e brendshëm	6,07	9,69	14,49	14,05	14,14
Obligacionet nga emetuesit e brendshëm	20,25	33,35	27,00	42,50	41,01
F. Investimeve nga emetuesit e brendshëm	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
L. V. afatshkurte - emetuesit e brendshëm	0,00	0,00	0,00	1,35	0,00
Gjithsej investimi në letrat me vlerë	26,32	49,38	53,57	71,00	75,79
Depozitat	54,15	47,54	44,46	27,84	22,55
Mjetet në para	19,53	2,99	1,92	1,14	1,66
Kërkesat	0,00	0,08	0,05	0,02	0,01
Gjithsej mjetet	100,00	100,00	100,00	100,00	100,00
Gjithsej kërkesat	0,93	1,10	0,16	0,12	0,14
Mjetet neto	99,07	98,90	99,84	99,88	99,86

Burimi: nga raportet vjetore të statistikave për vitet përkatëse (Agjencioni për mbikëqyrjen e sigurimeve pensionale me financim kapital)

Tabela 38: Struktura e investimeve të fondeve vullnetare pensionale në Shoqërinë e pensioneve Sava Sh.a Shkup për periudhën 2014-2017 (në përqindje)

Lloji i pasurisë / investimit	2014	2015	2016	2017
Aksionet nga emetuesit e huaj	10,03	11,53	12,88	13,08
Obligacionet nga emetuesit e huaj	0,00	0,00	1,38	1,36
Fondet e investimeve nga emetuesit e huaj	16,38	15,35	13,70	13,57
Letrat me v. afatshkurte - emetuesit e huaj	0,00	0,00	0,00	0,00
Aksionet nga emetuesit e brendshëm	14,86	14,41	13,18	13,17
Obligacionet nga emetuesit e brendshëm	40,96	45,24	45,11	43,04
F. Investimeve nga emetuesit e brendshëm	0,00	0,00	0,00	0,00
L. V. afatshkurte - emetuesit e brendshëm	0,00	0,00	0,00	0,00
Gjithsej investimi në letrat me vlerë	82,23	86,53	86,25	84,22
Depozitat	14,98	12,93	12,69	14,72
Mjetet në para	2,73	0,54	1,02	0,96
Kërkesat	0,06	0,00	0,04	0,10
Gjithsej mjetet	100,00	100,00	100,00	100,00
Gjithsej kërkesat	0,16	0,11	0,43	0,23
Mjetet neto	99,84	99,89	99,57	99,77

Burimi: nga raportet vjetore të statistikave për vitet përkatëse (Agjencioni për mbikëqyrjen e sigurimeve pensionale me financim kapital)

Siç mund të vërejmë nga struktura e investimeve pjesëmarrja më e madhe e investimeve në shtyllën e tretë u përket obligacioneve nga emetuesit e brendshëm (niveli më i ulët shënohet në vitin 2009 me 20.25%, kurse niveli më i lartë shënohet në vitin 2015 me 45.24%), investimeve në aksionet nga emetuesit e brendshëm (prej 6.07% në vitin 2009, për të arritur deri në 13.17% në vitin 2017), pa mos anashkaluar fondet e investimeve nga emetuesit e huaj (fillojnë me 5.46% dhe përfundojnë me 13.57%), aksionet nga emetuesit e huaj (niveli më i lartë arrihet në vitin 2017 me 13.08%) dhe depozitat (niveli më i lartë arrihet në vitin 2009 me 54.15%, për të vijuar më një rrënie deri në 14.72% në vitin 2017).

Përpos Shoqërisë së pensioneve Sava Sh.a Shkup me shtyllën e tretë menaxhon edhe KB Fondi i parë i hapur vullnetar pensional. Ky fond mundëson sigurimin e të ardhurave më të larta pensionale pas daljes në pension për personat e punësuar, kategorinë e personave që janë të papunë për një periudhë afatgjatë, të involvuarit në projekte apo misione të huaja, palën e tretë (bashkëshort, anëtarë të familjes) dhe të ardhura pensionale për personat nga mosha 15 deri 70 të cilët nuk realizojnë të drejtën për pension konform Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor dhe nuk derdhin kontribute pensionale konform Ligjit për sigurim pensional vullnetar me financim kapital.

Po ashtu, shtylla e tretë mundëson sigurim pensional vullnetar kolektiv apo thënë ndryshe skemat pensionale profesionale, ku punëdhënësit paguajnë mjete shtesë për sigurim pensional për një grup të caktuar ose për të gjithë të punësuarit e tyre. Andaj, në bazë të shumës dhe perudhës së pagimit të mjeteve, kontributeve të paguara dhe kthimit nga investimi, përcaktohet edhe shuma e mjeteve të akumuluar që përdoret më tej për pagimin e kontributeve pensionale nga ana e KB fondit të parë të hapur vullnetar pensional. Një anëtar i KB fondit pensional vullnetar e fiton të drejtën e kontributeve pensionale 10 vite përpara moshës së daljes në pension konform ligjit për sigurim pensional dhe invalidor. Ky i fundit, është i obliguar të bëj zgjedhjen e tij jo më vonë se mosha 70 vjeç, e nëse ndodh e kundërta Shoqëria e informon anëtarin për obligimin e zgjedhjes.

Për më tej, kur një anëtar i fondit pensional vullnetar që i përket KB Shoqërisë së parë pensionale e fiton të drejtën për kontribute pensionale shuma e plotë e mjeteve të akumuluar sipas zgjedhjes individuale të tij përdoret për: pagesën e shumës totale të faturës së tij (e vetme apo e shumfishtë), blerjen e anuitetit pensional, tërheqje të programuara ose kombinim i opsioneve në fjalë. Mirëpo, në rastin e vdekjes së anëtarit apo anëtarit i cili veçse më ka dalur në pension, mjetet e akumuluar në llogarinë individuale të tij mbeten pjesë e trashëgimisë së lënësit duke vepruar konform ligjith për trashëgimi. Kurse, në rastet kur nga komisioni për vlerësimin e aftësisë për punë nga ana e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor konstatohet se një anëtar i fondit pensional vullnetar është i paaftë për punë të përheshme, atëherë anëtari në fjalë pavarësisht moshës ka të drejtë për mundësitë për kontribute pensionale konform Ligjit për sigurim pensional vullnetar me financim kapital.

Në vijim prezantojmë shpërndarjen e anëtarëve sipas statusit të tyre, kontributet e paguara në shtyllën e tretë, kompensimet, vlerën e mjeteve neto, vlerën e njësisë kontabile, si dhe strukturën e investimeve të fondeve vullnetare pensionale për periudhën 2009-2017, në KB Shoqërinë e parë pensionale.

Tabela 39: Shpërndarja e anëtarësisë në fondin pensional vullnetar sipas mënyrës së anëtarësimit në KB Shoqërinë e parë pensionale për periudhën 2009-2017

Vitet	Vullnetarisht në llogari individuale	Në skemën e pensioneve me llogari profesionale	Gjithsej
2009 ³⁶	1	23	24
2010	495	3.543	4.038
2011	622	7.749	8.371
2012	940	10.463	11.403
2013	1.199	10.973	12.172
2014	1.463	11.263	12.726
2015	1.573	11.580	13.153
2016	2.198	11.621	13.819
2017	2.838	11.319	14.157

Burimi: nga raportet vjetore të statistikave për vitet përkatëse (Agjencioni për mbikëqyrjen e sigurimeve pensionale me financim kapital)

Sa i përket shpërndarjes së anëtarësisë edhe në KB Shoqërinë e parë pensionale vërehet një trend rritës, si në anëtarësimin me llogari individuale ashtu edhe në antarësimin sipas skemës së pensioneve me llogari profesionale. Gjithsej numri i anëtarëve në vitin 2017 arrin deri në 14.157 anëtarë.

Tabela 40: Kontributet e paguara, kompensimet, vlera e mjeteve neto dhe vlera e njësisë kontabile e fondeve pensionale vullnetare në KB Shoqërinë e parë pensionale për periudhën 2009-2017³⁷ (në milion denarë)

Vitet	Kontributet	Kompenzime	Mjetet neto	Vlera e njësisë kontabël
31.12.2009	0,18	0,07	0,18	100,204385
31.12.2010	12,45	0,53	12,41	106,891617
31.12.2011	28,00	1,16	40,05	112,639593
31.12.2012	42,07	1,94	81,02	119,129537
31.12.2013	67,66	2,95	154,22	129,015451
31.12.2014	95,70	4,28	262,30	139,908803
31.12.2015	128,03	6,21	397,85	146,709341
31.12.2016	133,21	7,52	538,68	154,465341
31.12.2017	139,67	9,12	694,24	162,989756

Burimi: nga raportet vjetore të statistikave për vitet përkatëse (Agjencioni për mbikëqyrjen e sigurimeve pensionale me financim kapital)

Me hyrjen në fuqi të shtyllës së tretë edhe në KB Shoqërinë e parë pensionale vërehet një trend rritës në kolonën e kontributeve dhe që rrjedhimisht rezulton tek kompenzimet dhe mjetet neto. Vlera e njësisë kontabile po ashtu shënon rritje deri në 162,989756 në vitin 2017.

³⁶ Anëtarësimi dhe pagesa e kontributeve në KB Shoqërinë e parë pensionale, ka filluar me 21 dhjetor të vitit 2009.

³⁷ Kontributet dhe kompensimet janë dhënë në baza mujore, kurse mjetet neto në vlerë kumulative.

Tabela 41: Struktura e investimeve të fondeve vullnetare pensionale në KB Shoqërinë e parë pensionale për periudhën 2009-2013

Lloji i pasurisë / investimit	2009	2010	2011	2012	2013
Aksionet nga emetuesit e huaj	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
Obligacionet nga emetuesit e huaj	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
Fondet e investimeve nga emetuesit e huaj	0,00	0,00	0,00	17,03	23,99
Letrat me v. afatshkurte - emetuesit e huaj	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
Aksionet nga emetuesit e brendshëm	0,00	21,58	13,71	12,92	9,09
Obligacionet nga emetuesit e brendshëm	0,00	38,08	33,39	34,70	42,54
F. Investimeve nga emetuesit e brendshëm	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
L. V. afatshkurte - emetuesit e brendshëm	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
Gjithsej investimi në letrat me vlerë	0,00	59,65	47,11	64,65	75,62
Depozitat	98,89	36,51	41,37	31,92	22,49
Mjetet në para	1,11	3,84	11,49	3,41	1,87
Kërkesat	0,00	0,00	0,04	0,03	0,02
Gjithsej mjetet	100,00	100,00	100,00	100,00	100,00
Gjithsej kërkesat	0,09	0,24	0,47	0,22	0,14
Mjetet neto	99,91	99,76	99,53	99,78	99,86

Burimi: nga raportet vjetore të statistikave për vitet përkatëse (Agjencioni për mbikëqyrjen e sigurimeve pensionale me financim kapital)

Tabela 42: Struktura e investimeve të fondeve vullnetare pensionale në KB Shoqërinë e parë pensionale për periudhën 2014-2017 (në përqindje)

Lloji i pasurisë / investimit	2014	2015	2016	2017
Aksionet nga emetuesit e huaj	0,00	0,00	0,00	0,00
Obligacionet nga emetuesit e huaj	0,00	0,00	0,00	0,00
Fondet e investimeve nga emetuesit e huaj	26,79	28,74	28,64	28,02
Letrat me v. afatshkurte - emetuesit e huaj	0,00	0,00	0,00	0,00
Aksionet nga emetuesit e brendshëm	8,54	5,69	4,37	4,46
Obligacionet nga emetuesit e brendshëm	46,78	51,46	51,63	53,53
F. Investimeve nga emetuesit e brendshëm	0,00	0,00	0,00	0,00
L. V. afatshkurte - emetuesit e brendshëm	0,00	0,00	0,00	0,00
Gjithsej investimi në letrat me vlerë	82,11	85,88	84,64	86,01
Depozitat	14,71	12,10	13,26	11,71
Mjetet në para	3,14	2,00	2,04	2,25
Kërkesat	0,03	0,02	0,05	0,03
Gjithsej mjetet	100,00	100,00	100,00	100,00
Gjithsej kërkesat	0,67	0,14	0,60	0,42
Mjetet neto	99,33	99,86	99,40	99,58

Burimi: nga raportet vjetore të statistikave për vitet përkatëse - MAPAS

Sa i përket strukturës së investimeve edhe në KB Shoqërinë e parë pensionale obligacionet nga emetuesit e brendshëm shënojnë pjesëmarrjen më të madhe (niveli më i ulët shënohet në vitin 2011 me 33.39%, kurse më i larti në vitin 2017 me 53.53%), për të vijuar me fondet e investimeve nga emetuesit e huaj (fillojnë me 17.03% në vitin 2012 dhe arrijnë deri në 28.02% në vitin 2017). Po ashtu, struktura e investimeve mbështetet edhe nga depozitat që në vitin 2009 shënojnë pjesëmarrjen më të lartë me 98.89%, për të vijuar më një rrënie deri në 11.71% në vitin 2017.

Pra, me formimin e shtyllës së tretë apo krijimin e fondeve pensionale vullnetare kompletohet sistemi pensional i Republikës së Maqedonisë. Po ashtu, krijimi i shtyllës së tretë synoi minimizimin e problemeve aftagjate të sistemit pensional aktual, sikurse: uljen e pasigurisë financiare, mplakjen e popullsisë dhe problemet demografike të shprehura përmes zvogëlimit të numrit të punësuarëve dhe rritjes së numrit të pensionerëve (aspekte këto, që do të trajtohen në mënyrë më të detajuar në pjesët vijuese të këtij hulumtimi).

III.4. Agjencioni për mbikëqyrjen e sigurimit pensional me financim kapital

Agjencioni për mbikëqyrjen e sigurimit pensional me financim kapital u themelua në korrik të viti 2002 dhe ka për qëllim mbikëqyrjen e veprimtarisë së fondeve pensionale, të kontrolloj punën e Shoqërisë së pensioneve Sava Sh.a Shkup dhe KB Shoqërisë së parë pensionale, për t'i mbrojtur interesat e anëtarëve të fondeve pensionale. Agjencioni në fjalë është person juridik dhe për punën e bërë përgjigjet përpara Parlamentit të Republikës së Maqedonisë. Po ashtu, Agjencioni për mbikëqyrjen e sigurimit pensional me financim kapital është përgjegjëse për lëshimin, revokimin dhe heqjen e licencave për themelimin e shoqërive pensionale, kryerjen e veprimtarive, menaxhimin me fondet pensionale dhe nxjerrjen, revokimin dhe anulimin e lejeve për menaxhimin me fonde pensionale të detyrueshme dhe vullnetare. Për më tej, ky i fundit bashkëpunon me Ministrinë e financave, Bankën popullore të Republikës së Maqedonisë, Komisionin për letra me vlerë dhe me institucione tjera për të siguruar mbikëqyrjen efektive rreth sigurimit pensional me financim kapital.

Tabela 43: Të dhënat financiare nga Shoqëria e pensioneve Sava Sh.a Shkup rreth menaxhimit me fondet pensionale (shtyllën e dytë dhe tretë), për periudhën 2006-2011 (në milion denarë)

Vitet	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Të ardhurat ³⁸	58,113	84,598	103,652	120,866	123,674	128,925
Shpenzimet ³⁹	58,674	79,175	79,114	99,115	94,779	99,290
Humbja/fitimi	561,606	5,074	24,537	21,751	28,906	29,634
Hum/fitim i akumuluar	-39,464	-34,389	-22,852	11,685	35,062	30,797
Burimi: nga raportet vjetore të statistikave për vitet përkatëse (Agjencioni për mbikëqyrjen e sigurimeve pensionale me financim kapital)						

³⁸ Të ardhurat përfshijnë: të ardhurat nga menaxhimi i fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, të ardhurat financiare dhe të ardhurat tjera të kompanive private pensionale.

³⁹ Shpenzimet përfshijnë: shpenzimet për menaxhimin e fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, shpenzimet e agentëve, të marketingut, të transaksioneve, shpenzimet për Agjencionin për mbikëqyrjen e sigurimeve pensionale me financim kapital, shpenzimet për rrualtjen e pasurisë, për lëndët e para dhe materialet, për kryerjen e shërbimeve, shpenzimet për amortizim, për pagat dhe kompenzimet e të punësuarve, etj.

Tabela 44: Të dhënat financiare nga Shoqëria e pensioneve Sava Sh.a Shkup rreth menaxhimit me fondet pensionale (shtyllën e dytë dhe tretë), për periudhën 2012-2017 (në milion denarë)

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Të ardhurat	142,444	159,913	171,414	183,741	201,795	214,178
Shpenzimet	101,154	101,904	113,038	121,119	129,442	126,989
Humbja/fitimi	37,798	58,009	58,376	62,622	72,353	87,189
Hum/fitim i akumuluar	55,666	91,032	148,648	154,985	160,619	223,202
Burimi: nga raportet vjetore të statistikave për vitet përkatëse (Agjencioni për mbikëqyrjen e sigurimeve pensionale me financim kapital)						

Sipas të dhënave të prezantuara mësipër konstatohet se Shoqëria Sava Sh.a Shkup tre vitet fillestare të funksionimit i përmbylli me një humbje të akumuluar prej 39.464 milion denarë në vitin 2006, me 34.389 milion denarë në vitin 2007 dhe 22.852 milion denarë në vitin 2008. Mirëpo, në vitin 2009 për herë të parë Shoqëria Sava Sh.a Shkup realizoi të ardhura të mjaftueshme, për t'i mbuluar humbjet e akumuluar nga vitet paraprake, përderisa KB Shoqëria e parë pensionale këtë e realizoi në vitin 2008.

Në vitin 2010 Shoqëria Sava Sh.a Shkup po ashtu realizoi fitim të akumuluar, kurse ndryshimi i të ardhurave në mes shoqërive përkatëse i dedikohet kryesisht KB Shoqërisë së parë pensionale që realizoi të ardhura më të larta (për 17.038 milion denarë më shumë), përderisa shpenzimet nga ana e shoqërive në fjalë ishin pothuajse të barabarta. Për rrjedhojë, në vitin 2011 Shoqëria Sava Sh.a Shkup shënon një rënie në fitimin e akumuluar për 4.265 milion denarë. Megjithatë, nga viti 2012 e këndej Shoqëria Sava Sh.a Shkup i përmbyll vitet vijuese me një fitim të akumuluar sa që në vitin që lam pas ky fitim arriti deri në 223.202 milion denarë.

Tabela 45: Të dhënat financiare nga KB Shoqëria e parë pensionale rreth menaxhimit me fondet pensionale (shtyllën e dytë dhe tretë), për periudhën 2006-2011 (në milion denarë)

Vitet	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Të ardhurat	66,319	94,953	111,631	137,454	140,712	144,420
Shpenzimet	69,090	87,565	91,996	95,917	93,734	95,444
Humbja/fitimi	2,773	7,388	29,634	41,536	46,977	48,975
Hum/fitim i akumuluar	27,018	19,630	28,926	0,00	81,946	44,805
Burimi: nga raportet vjetore të statistikave për vitet përkatëse (Agjencioni për mbikëqyrjen e sigurimeve pensionale me financim kapital)						

Tabela 46: Të dhënat financiare nga KB Shoqëria e parë pensionale rreth menaxhimit me fondet pensionale (shtyllën e dytë dhe tretë), për periudhën 2012-2017 (në milion denarë)

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Të ardhurat	154,092	36,614	188,624	204,442	225,751	245,171
Shpenzimet	99,063	101,222	105,422	115,544	126,047	119,874
Humbja/fitimi	55,029	73,597	83,201	88,897	99,703	125,296
Hum/fitim i akumuluar	58,362	102,102	107,737	167,049	200,572	228,103
Burimi: nga raportet vjetore të statistikave për vitet përkatëse (Agjencioni për mbikëqyrjen e sigurimeve pensionale me financim kapital)						

Sa i përket KB Shoqërisë së parë pensionale konstatojmë se, kjo Shoqëri vetëm dy vitet fillestare të funksionimit i përmbylli me një humbje të akumuluar prej 27.018 milion denarë në vitin 2006 dhe 19.630 milion denarë në vitin 2008. Mirëpo, për dallim nga NLB Fondi i ri pensional i riemërtuar më vonë Shoqëria Sava Sh.a Shkup, KB Shoqëria e parë pensionale për herë të parë në vitin 2008 realizoi të ardhura të mjaftueshme për t'i mbuluar humbjet e akumuluar nga vitet paraprake. Kurse, në vitin 2009 fitimi i akumuluar arriti në zero, gjegjësisht arriti pikën kritike (as humbje as fitim).

Për më tej, në vitin 2010 KB Shoqëria e parë pensionale (ashtu sikurse Shoqëria Sava Sh.a Shkup) realizoi fitim të akumuluar për 17,038 milion denarë më shumë, ndonëse shpenzimet nga ana e tyre ishin pothuajse të barabarta. Mirëpo, edhe KB Shoqëria e parë pensionale në vitin 2011 shënoi rënie në fitimin e akumuluar për 37.141 milion denarë, kurse nga viti 2012 e këndej përmbyll vitet me një fitim të akumuluar - të theksuar, sa që në vitin 2017 ky fitim arriti deri në 228.103 milion denarë.

Pra, Agjencioni për mbikëqyrjen e sigurimit pensional me financim kapital (përpos angazhimit në drejtim të përmbushjes së misionit dhe vizionit) vazhdon të promovoj, organizoj dhe të nxisë zhvillimin e sigurimit pensional me financim kapital. Po ashtu, në bashkëpunim me Ministrinë e punës dhe politikës sociale kontribuon në ngritjen e vetëdijes së publikut të gjerë, përfshirë qëllimet dhe parimet e shoqërive pensionale, përfitimet nga anëtarësimi në njërin nga fondet pensionale, të drejtat e anëtarëve të fondeve pensionale të detyrueshme dhe atyre vullnetare dhe për çështje tjera lidhur me sigurimin pensional me financim kapital.

KAPITULLI IV: PËRPUNIMI DHE SISTEMIMI I TË DHËNAVE

IV.1. Elementet e bazës së të dhënave si rezultat i modaliteteve të ndryshme të sigurimit pensional

Projektimi i qëndrueshmërisë së sistemit pensional të Republikës së Maqedonisë, e në veçanti të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor arrihet përmes përpunimit dhe sistemimit të një baze të dhënash të përshtatshme dhe të besueshme, gjeneruar nga burimet përkatëse (ligjore) që mundësojnë marrjen e informacioneve kualitative dhe pasqyrimin e gjendjes reale të sistemit pensional aktual. Kjo bazë të dhënash përbëhet nga disa elemente, sikurse: pensionisti dhe i siguruari, pensionet dhe llojet e tyre, projeksionet e popullsisë, të ardhurat dhe shpenzimet e Fondit, si dhe Fondi për sigurim pensional dhe invalidor ndikimi i fondeve private tek ai shtetëror (shpenzimet e tranzicionit).

IV.1.1. Pensionisti

Pensionisti si objektiv kryesor i Fondit për sigurim pensional dhe invalidor luan rolin e njëjtë me të siguarin pasi që nga numri i përgjithshëm i pensionistëve varet gjendja financiare e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor (sa më i lartë numri i pensionistëve, aq më shumë mjete financiare janë të nevojshme për pagesën e pensioneve). Po ashtu, pensionistët si pjesë përbërëse e bazës së të dhënave mund të analizohet nga perspektiva e numrit të pensionistëve dhe nga tendenca e lëvizjes së tyre. Sa i përket numrit të pensionistëve vlen të theksohet fakti se, numri i pensionistëve vazhdimisht shënon rritje përderisa raporti i punësuar - pensioner ulet. Andj, se si ka lëvizur ky numër dhe si qëndron raporti i punësuar - pensioner sjellim tabelën vijuese:

Tabela 47: Lëvizja e numrit të pensionistëve dhe raporti i punësuar-pensioner për periudhën 1990-2017

Vitet	Numri pensionistëve	Raporti i punësuar-pensioner
1990	166.224	3.6
1991	180.749	3.0
1992	193.294	2.7
1993	210.537	2.4
1994	216.834	2.2
1995	219.307	2.0
1996	222.727	1.8
1997	227.099	1.7
1998	232.216	1.6
1999	235.839	1.6
2000	241.221	1.5
2001	247.200	1.4

2002	249.421	1.3
2003	254.262	1.3
2004	260.075	1.3
2005	265.152	1.3
2006	269.681	1.46
2007	272.386	1.55
2008	273.281	1.65
2009	273.977	1.74
2010	273.751	1.70
2011	280.891	1.74
2012	285.411	1.8
2013	291.821	1.8
2014	296.215	1.8
2015	299.640	1.9
2016	305.766	1.9
2017	310.744	1.9
<i>Burimi: nga raportet vjetore për vitet përkatëse nga Fondi për sigurim pensional dhe invalidor</i>		

Pra, në vitin 1990 numri i pensionistëve arrin në 166.224 kurse raporti i punësuar - pensioner 3.6 (3 të punësuar financonin një pensionist). Mirëpo, ky numër vazhdimisht shënoi rritje sa që në vitin 1995 arriti në 219.307 dhe raporti i punësuar - pensioner shënoi rrënie deri në 2.0, kurse në vitin 2000 numri i përgjithshëm i pensionistëve arriti deri në 241.221 dhe raporti i punësuar - pensioner vazhdoi të ulej deri në 1.5. Rrënia më e madhe e raportit i punësuar - pensioner shënohet në vitin 2002 në 1.3, ndërkohë që numri i pensionistëve arriti në 265.122. Nga viti 2006 e këndej fillon një rritje graduale e raportit i punësuar - pensioner duke arritur deri në 1.9 në vitin 2017 dhe numri i pensionistëve deri në 310.744 pensioner.

Andaj, duke marrë për bazë trendin e këtyre dy parametrave konstatojmë se, numri i përgjithshëm i pensionistëve gjithmonë do të paraqes problem për Fondin për sigurim pensional dhe invalidor, për aq kohë sa raporti i punësuar - pensioner shënon rrënie, që do të thotë se numri i pensionistëve si element i bazës së të dhënave vazhdon të luaj një rol të rëndësishëm në projeksionet financiare të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor.

IV.1.2. I siguruari

I siguruari përfaqëson elementin më të rëndësishëm nga baza e të dhënave ngase nga numri i përgjithshëm i të siguarëve varet trendi i elementeve tjerë dhe korrelacioni mes tyre. Rëndësia e të siguarit para se gjithash konsiston në shumën e fondeve që ndahen nga subjektet afariste, e që njëherit përfaqësojnë burimin kryesor të të ardhurave, rrjedhimisht zënë pjesën më të madhe në bilancin e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor (me rritjen e këtyre mjeteve automatikisht rriten edhe të ardhurat e Fondit dhe anasjelltas). Ashtu sikurse pensionistët edhe të siguarit mund të analizohen nga perspektiva e lëvizjes së numrit të tyre, andaj se si ka lëvizur numri i të siguarëve nga periudha 1990 - 2017 sjellim tabelën në vijim:

Tabela 48: Lëvizja e numrit të të sigurve për periudhën 1990-2017

Vitet	Numri i të sigurve (punësuarëve)
1990	601.950
1991	534.887
1992	531.083
1993	503.010
1994	468.632
1995	427.658
1996	403.820
1997	381.723
1998	370.869
1999	374.025
2000	367.162
2001	351.009
2002	332.728
2003	321.105
2004	348.212
2005	348.500
2006	394.882
2007	424.338
2008	451.491
2009	475.780
2010	466.280
2011	489.608
2012	507.061
2013	526.909
2014	536.191
2015	558.821
2016	570.168
2017	575.574

Burimi: nga raportet vjetore për vitet përkatëse nga Fondi për sigurim pensional dhe invalidor

Pra, si rezultat i periudhës së tranzicionit numri i të sigurve shënoi ulje konstante duke arritur deri në 427.658 në vitin 1995, kurse në vitin 2003 shënoi nivelin më të ulët deri në 321.105 të sigurve. Trendi rrënës në uljen e numrit të të sigurve ndikon negativisht edhe në parametrat tjerë të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor të Republikës së Maqedonisë. Mirëpo, nga viti 2004 e këndej fillon një trend i vogël rritës në numrin e të sigurve në raport me nivelin rrënës mes viteve 1990 - 2003. Ky trend rritës në numrin e të sigurve sigurisht se është mjaft pozitiv për sistemin pensional, megjithëse varet shumë edhe nga korrelacioni me numrin e pensionistëve. Ky ndikim pozitiv ka të bëjë së pari me kontributet që gjenerohen nga të sigurve (vetëm në vitin 2017 pjesëmarrja e tyre në të ardhurat e përgjithshme të Fondit arrin deri në 79.5%) dhe për shkak të rëndësisë së nivelit të tyre në raport me nivelin e pensionistëve.

IV.1.3. Pensionet dhe llojet e tyre

Pjesëmarrja e pensionit si përqindje e pagës së paguar konsiderohet si indikatorë mjaft i rëndësishëm për funksionimin e sistemit pensional dhe zhvillimin e tij, si dhe për vijueshmërinë e rritjes së pensioneve në raport me rritjen e pagave. Të dhënat e gjeneruara deri më tani në lidhje me nivelin e pagave dhe realizimin e pensioneve na informojnë rreth gjendjes aktuale të bilancit të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor, dhe vështirësive në realizimin e pagesave të pensioneve dhe plotësimin e nevojave të tyre. Sipas nenit 37 të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor të Republikës së Maqedonisë, rregullimi i pensioneve bëhet duke marrë për bazë dy parametra, edhe atë: lëvizjen e indeksit të kostos së jetesës deri në 50% dhe rritjen e pagës mesatare në lartësi prej 50% për të gjithë të punësuarit në Republikën e Maqedonisë (Ligji për sigurim pensional dhe invalidor i Republikës së Maqedonisë).

Po ashtu, sipas nenit 34 të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor rregullimi i pensionit bëhet më 1 janar dhe 1 qershor sipas përqindjes që fitohet si shumë e rritjes së indeksit të kostos së jetesës në gjashtë mujorin e parë dhe përqindjes së rritjes së pagës bruto mesatare për të gjithë të punësuarit e Republikës së Maqedonisë, në gjashtë mujorin e parë në raport me gjysmën tjetër të vitit që i paraprinë. Rritja më e madhe e pensioneve prej 5% deri në 8% shënohet në vitin 2008, si rezultat i rregullimit shtesë me vendimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë që kontribuoi në rritjen e vlerës reale të pensioneve dhe në përmirësimin e sigurisë materiale dhe financiare të shfrytëzuesve të pensioneve (Утрински весник, 2008). Ky veprim u përsërit edhe një herë në vitin 2013, rrjedhimisht u bë rritja shtesë e pensioneve që në njërën anë ndikoi në përmirësimin e jetesës së pensionistëve, kurse në anën tjetër ngarkoi financiarisht akoma më shumë Fondin për sigurim pensional dhe invalidor të Republikës së Maqedonisë (А1оН, 2013).

Sa i përket llojeve të pensioneve numri i përfituesve të pensioneve është vazhdimisht në rritje. Pjesëmarrje më të madhe në gjithsej pensionet e ndara shënojnë pensionet e pleqërisë (nga 94.676 përfitues në vitin 1991 deri në 197.383 në vitin 2017), kurse pjesa tjetër u përket pensioneve familjare dhe atyre invalidor. Nëse flasim për gjithsej pensionet e ndara për periudhën 1991-2017 konkludojmë se, numri i shfrytëzuesve të pensioneve është pothuajse duke u dyfishuar.

IV.1.4. Projeksionet e popullsisë

Me plakjen e popullsisë dhe rritjen e jetëgjatësisë rritet gjithnjë e më shumë numri i individëve që shfrytëzojnë pensione dhe zvogëlohet numri i individëve që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të vendit. Sistemi pensional i Republikës së Maqedonisë ka arritur në gjendjen e aplikimit të masave jo të pëlqyeshme, pra rritjen e moshës së daljes në pension duke ndikuar paralelisht në rritjen e fuqisë punëtore dhe uljen e shfrytëzuesve të pensioneve.

Megjithkëtë, kjo e fundit nuk mund të aplikohet vazhdimisht dhe të eliminoj vështirësitë demografike, andaj rekomandohet ndikimi në fertilitet përmes mënyrave dhe politikave të rritjes së shkallës së fertilitetit. Ky fenomen i njohur gjithandej shkaktoi shqetësim edhe në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, që më së miri shprehet përmes fjalimit të deputetit Laszlo Andor përpara parlamentit Evropian në vitin 2012, duke këmbëgullur kategorikisht në ndërmarrjen e reformave pensionale në tre drejtime (Laszlo, 2012):

- rritjen e moshës së daljes në pension (67 deri në 70 vjeç) në përputhje me jetëgjatësinë;
- rritjen e mundësive për punësimin e të moshuarve duke ndikuar në mos braktisjen e tregut të punës;
- stimulimin e pensionistëve të ardhshëm në investimin më të madh tek fondet pensionale vullnetare;

Pra, shqetësimet e deputetëve evropian edhe njëherë nënvizojnë nevojën dhe reagimin e shpejtë në lëvizjet demografike, rrjedhimisht kontroll mbi treguesit demografik të cilët merren si parakusht kryesor për projektimin e ardhshëm të sistemit pensional të Republikës së Maqedonisë.

IV.1.5. Të ardhurat e Fondit

Të ardhurat e Fondit janë treguesi më i rëndësishëm i bazës së të dhënave prej ku varet qëndrueshmëria dhe funksionimi i Fondit për sigurim pensional dhe invalidor i Republikës së Maqedonisë. Korrelacioni mes treguesëve demografik, numrit të të siguruarve dhe të ardhurave të Fondit është aq i lartë saqë reflektohet jo vetëm në të ardhurat e Fondit pensional shtetëror, por edhe në të ardhurat e sigurimit pensional të detyrueshëm me financim kapital dhe vullnetar. Duke u nisur nga kjo, të ardhurat e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor mund të rriten përmes disa mënyrave sikurse:

- rritjes së numrit të të siguruarve (të punësuarëve);
- rritjes së kontributeve për sigurim pensional;
- rritjes së pagave.

Pra, që të arrihet rritja e numrit të të punësuarëve së pari duhet të rritet zhvillimi ekonomik i Republikës së Maqedonisë dhe përmirësimi i performancës ekonomike, përkatësisht krijimi i kushteve për rritjen e kompanive që paralelisht do të ndikojnë në rritjen e pagave të të punësuarëve. Mirëpo, edhe nëse përqindja e kontributeve për sigurim pensional mbetet e njëjtë, prap se prap do të ndaheshin nga baza më e lartë e pagës, e që në terma absolut kjo shumë e mjeteve të ndara do ishte më e lartë. Kurse, sa i përket mënyrës më pak të pëlqyeshme dhe më të shpejtë të gjenerimit të të ardhurave, e që njëherit do të zgjidhte problemin kryesor të qëndrueshmërisë financiare mbetet rritja e normës së kontributeve për

sigurim pensional dhe invalidor. Kjo e fundit, dukshëm do të ndikonte në rritjen e të ardhurave dhe uljen e pjesëmarrjes së buxhetit për mbulimin e deficitit fiskal.

Sidoqoftë, se si kanë levizur të ardhurat e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor për periudhën 1991 - 2017, sa humbje i shkaktoi Fondit ulja e normës së kontributit nga 21.2% në 18%, më detajisht i sjellim në pjesën e pestë të këtij studimi, përkatësisht në analizën financiare të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor të Republikës së Maqedonisë - aspekti financiar.

IV.1.6. Shpenzimet e Fondit

Ristrukturimi i sistemit pensional dhe rritja e vazhdueshme e numrit të pensionistëve, drejtpërsëdrejti ndikoi në rritjen e shpenzimeve të tranzicionit dhe shpenzimeve për pagesën e pensioneve (e theksuar më së shumti në dekadën e fundit). Sipas të dhënave të fundit të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor shpenzimet për pagesën e pensioneve arrijnë në 51.9 miliardë denarë (ose 97% më shumë se në vitin 2007), ndërkohë që shpenzimet për pagat e të punësuarëve janë rritur për 0.64%. Sa i përket shpenzimeve tjera vërehet një ulje, por nëse ju referohemi shpenzimeve në total krahasuar me vitin 2007, vërejmë se këto të fundit janë rritur për 98.81% (Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i Republikës së Maqedonisë).

Për rrjedhojë, nga viti 2006 e këndej konform Ligjit për sigurim pensional të detyrueshëm me financim kapital në Fond filloi realizimi i shpenzimeve mbi bazë të transferimit të mjeteve në fondet pensionale private, për kontributin për sigurim pensional dhe invalidor për anëtarët që kishin qasje në fondet pensionale private. Këto shpenzime nga 1.8 miliardë denarë në vitin 2007 arritën në 6.2 miliardë denarë në vitin 2017, pra një rritje për 333.14% si rezultat i rritjes së numrit të anëtarëve dhe pagesës së detyrimeve nga viti paraprak (Mitkov, 2018). Andaj, duke marrë për bazë trendin rritës të shpenzimeve pensionale vetëm në dekadën e fundit konstatojmë se, kjo rritje rezultoi nga ndërrmarja e reformave pensionale në drejtim të:

- rrjedhjes apo kullimit të kontributeve në shtyllën e dytë;
- deficitit strukturor si rezultat i mos ekuilibrit të të ardhurave dhe shpenzimeve;
- zvogëlimit të kontributeve dhe bazës më të ulët për llogaritjen dhe pagesën e kontributeve.

Deficiti strukturor paraqet një vështirësi me të cilën ballafaqohet sistemi pensional i Republikës së Maqedonisë që nga vitet e nëntëdhjeta të shekullit XX. Me restrukturimin e sistemit pensional ky deficit u rrit edhe më shumë për shkak të rrjedhjes së një pjese të kontributeve në shtyllën e dytë (të njohura ndryshe si shpenzime të tranzicionit) dhe uljes së normës së kontributeve për sigurim pensional dhe invalidor deri në 18%. Pra, deklarata paraprake e deputetit europian Laszlo Andor ishte vetëm një lloj paralajmërimi për zbatuesit e reformave pensionale në drejtim të kujdesit maksimal gjatë zbatimit të tyre, ngaqë për çdo

reform pensionale të ndërmarrë ngarkohet edhe më shumë Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i Republikës së Maqedonisë. Andaj, se si kanë lëvizur shpenzimet e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor për periudhën 1991 - 2017, më detajisht i prezantojmë në analizën financiare të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor të Republikës së Maqedonisë (kapitulli vijues).

IV.1.7. Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i Republikës së Maqedonisë

Lëvizjet e pashmangshme demografike gjithandej dëshmuar se reforma pensionale ishte një domosdoshmëri ku secili shtet duhej përshtatur, edhe pse ekonomitë e tranzicionit të brishtë vështirë se e tejkalojnë barrën e trashëguar nga sistemi pensional socialist. Në Republikën e Maqedonisë ndërmarrja e reformës pensionale fillimisht synoi uljen e barës së Fondit pensional shtetëror, e më vonë edhe optimizimin e saj që do të arrihej në momentin e fillimit të pagesës së pensioneve nga shtylla e dytë.

Mirëpo, si pasojë e reformës pensionale dhe uljes së përqindjes së kontributeve për shtyllën e parë, rrjedhimisht të ndara për shtyllën e dytë barra e Fondit pensional shtetëror u rrit edhe më shumë. Në vitin 2006 kontributet arrinin në 21.2% (me reformën e ndërmarrë pensionale 7.42% ndaheshin për shtyllën e dytë) për t'u zvogëluar deri më 18% në vitin 2011 (parimisht 6.3% për shtyllën e dytë). Kjo e fundit na bën me dije për humbjen financiare që ju shkaktua Fondit pensional shtetëror dhe rritjen e pjesëmarrjes së buxhetit shtetëror për financimin e deficitit fiskal i shkaktuar nga ulja e kontributeve për sigurim pensional dhe invalidor (Атанасовска, 2011).

Mbi të gjitha, reforma pensionale parashikonte që pas akumulimit të mjeteve të nevojshme në shtyllën e dytë të fillohet forma e kombinuar e pagesës së pensioneve, gjegjësisht Fondi pensional shtetëror do të ngarkohej me një të tretën, kurse shtylla e dytë me dy të tretën e mjeteve të nevojshme për pagesën e pensioneve (me këtë do të kompensohej kostoja aktuale për transferimin e mjeteve në shtyllën e dytë). Kurse, sa i përket bazës së të dhënave Fondi për sigurim pensional dhe invalidor është në korrelacion me të gjitha parametrat e sistemit pensional, sikurse: të siguruarit, pensionistët, të ardhurat dhe shpenzimet në lidhje me pensionet, etj.

Pra, baza e të dhënave të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor është një sublimim i treguesëve numerikë të elaboruar më parë për numrin e përgjithshëm të të siguruarëve dhe pensionistëve dhe konstatimin se, gjendja financiare e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor varet kryesisht nga lëvizja e raportit të këtyre dy parametrave, respektivisht të punësuarëve dhe pensionistëve.

IV.1.8. Ndikimi i fondeve private tek Fondi për sigurim pensional dhe invalidor

Ristrukturimi i sistemit pensional në vitin 2006 synonte ofrimin e pensioneve përmes kombinimit të shtyllës së parë dhe të dytë, ndonëse nevojitej një kohë e gjatë për të filluar me ndarjen e tyre (tranzicion i stërgjatur). Sipas parashikimeve aktuale pensionet e para që do të ndahen nga të dy shtyllat priten të realizohen në vitin 2025, kurse fuqia punëtore (si rezultat i përfshirjes së drejtpërdrejtë të punonjësve të rinj në shtyllën e dytë) deri në vitin 2036 do kaloje plotësisht në shtyllën e dytë. Përgjatë periudhës së tranzicionit, qeveria e Republikës së Maqedonisë mori përsipër mbulimin e shpenzimeve të tranzicionit nga buxheti qëndror i saj, ku në vitet e para të tranzicionit barra në Fondin pensional shtetëror ishte jashtëzakonisht e lartë. Kjo barrë pritet dalëngadalë të ulet dhe në vitin 2043 të eliminohen kryesisht shpenzimet e tranzicionit (Актуерски извештај, 2010).

Pra, përgjatë planifikimit të zhvillimit të sistemit pensional të Republikës së Maqedonisë kujdes të veçantë duhet t'i kushtohet lëvizjes së shpenzimeve të tranzicionit, për shkak të presionit financiar në Fondin për sigurim pensional dhe invalidor të Republikës së Maqedonisë. Kjo e fundit, parasegjithash varet nga parashikimet dhe lëvizjet aktuale të parametrave demografik, andaj përmirësimi i tyre do të ndikonte në uljen e vëllimit të shpenzimeve të tranzicionit në përgjithësi.

IV. 2. Struktura e bazës së të dhënave për fondet pensionale

Krijimi i bazës së të dhënave për projektimin e qëndrueshmërisë së sistemit pensional të Republikës së Maqedonisë, mundësohet përmes analizës së trendit të elementeve kyç të sipërmendura (pensionisti dhe i siguruari, llojet e pensioneve, projeksionet e popullsisë, të ardhurat dhe shpenzimet e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor, Fondi për sigurim pensional dhe ndikimi i fondeve private tek ai shtetëror) - elemente këto, që ndikojnë në dizajnimin e strukturës së bazës së të dhënave duke marrë për bazë dy segmente kryesore: segmentin demografik dhe atë financiar (Мршиќ и Тренковски, 2008).

IV.2.1. Segmenti demografik

Demografia si shkencë e studimit të popullsisë përfshinë madhësinë dhe densitetin e saj, natalitetin, mortalitetin, rritjen, shpërndarjen, migrimin dhe statistikën vitale, e njëherit integrimin e të gjitha këtyre parametrave në kushtet shoqërore dhe ekonomike. Po ashtu, demografia mund të analizohet nga aspekti i strukturës dhe dinamizmit të saj. Struktura demografike apo statusi i popullsisë pasqyrohet përmes moshës, gjinisë, nivelit të edukimit, të ardhurave, amviseve, urbanizimit, shërbimeve publike, përkatësisë etnike, etj. Kurse, dinamizmi

demografik pasqyron ndryshimet në popullsi të shprehura përmes statistikave vitale (nataliteti, fertiliteti, mortaliteti, riprodhimi, statusi martesor) dhe migracionit (Cseh and Terebessy, 2013).

Lëvizja e parametrave demografik apo zhvillimi i procesit demografik paraqet bazë për formimin e fuqisë punëtore. Popullsia e aftë për punë përcaktohet nga intensiteti i rimëkëmbjes dhe ndryshimet në strukturën e moshës së popullsisë duke përcaktuar shkallën sasiore të potencialit të punësimit në një vend, që do të thotë se ndryshimet në strukturën e moshës reflektohen në nivelin e produktivitetit social të punës. Plakja e popullsisë në një masë të konsiderueshme ndikon edhe në nivelin e aktivitetit ekonomik, përkatësisht në pjesëmarrjen e punonjësve në prodhimin shoqëror të popullsisë së përgjithshme (Kapov, 2014).

Në Republikën e Maqedonisë ndikimi i faktorëve demografik është shumë i pranishëm, ngase nga numri i popullsisë së aftë për punë varet edhe numri i të siguruarve, gjegjësisht të ardhurat e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor. Po ashtu, rritja e numrit të popullsisë së aftë për punë është e lidhur drejtpërsëdrejti me rritjen ekonomike dhe standardin jetësor. Ky i fundit, në njërën anë çon në rritjen e aktiviteteve të subjekteve dhe krijimin e nevojës për më tepër të punësuar, kurse në anën tjetër mundëson rritjen e të ardhurave të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor. Së fundmi, rritja e standardit jetësor ndikon në rritjen e kohëzgjatjes së jetesës, përkatësisht periudhë më të gjatë të shfrytëzimit të pensioneve dhe ngarkesë më të madhe për buxhetin e Fondit.

Pra, tabloja e favorshme e parametrave demografik në të shumtën e rasteve ka ndikim pozitiv në funksionimin e përgjithshëm të sistemeve pensionale. Mirëpo, në vendin tonë situata aktuale e parametrave demografik është shumë larg nga ajo e dëshiruara, madje nuk ka as edhe sinjale pozitive për ndryshime eventuale në këtë fushë. Për shembull: lëvizja e popullsisë së përgjithshme në Republikën së Maqedonisë paraqet një parametër të rëndësishëm për projektimin e sistemit pensional, posaçërisht nga këndvështrimi i popullsisë së gatshme për punë, prandaj se si ka lëvizur numri i përgjithshëm i popullsisë dhe si janë projeksionet për të ardhshmen sjellim tabelën vijuese:

Tabela 49: Numri i përgjithshëm i popullsisë së Republikës së Maqedonisë

Vitet	Numri i përgjithshëm i popullsisë
1950	1.230.000
2002	2.022.547
2007	2.038.000
2015	2.025.000
2025	1.990.000
2050	1.745.000
2100	1.500.000
Burimi: Enti shtetëror statistikor i Republikës së Maqedonisë	

Pra, lëvizja e numrit të përgjithshëm të popullsisë nga viti 1950 e këndej, e njëkohësisht projeksionet për të ardhmen tregojnë një trend rënës në popullsinë e përgjithshme saqë në vitin e fundit të periudhës së projeksionit Republika e Maqedonisë pritet të humbas $\frac{1}{4}$ e numrit aktual të popullsisë.

Përveç lëvizjes së popullsisë së përgjithshme në tablon e supozimeve demografike një rol të rëndësishëm sa i përket qëndrueshmërisë së sistemit pensional zënë edhe supozimet mbi fertilitetin, mortalitetin dhe jetëgjatësinë. Andaj, se si ka lëvizur trendi i parametrave në fjalë dhe si janë projeksionet e tyre, i prezantojmë më hollësisht në kapitullin e pestë - aspekti demografik.

IV.2.2. Segmenti financiar

Performanca financiare e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor, respektivisht rezultatet e gjenerura nga elementet e bazës së të dhënave luajnë rolin kyç në përgatitjen e raporteve vjetore financiare për Fondin për sigurim pensional dhe invalidor. Baza e të dhënave me saktësi dhe korrektesë mund të raportoj mbi performancën financiare të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor, ngaqë kjo e fundit përfshinë të gjitha flukset financiare në drejtim të të ardhurave, shpenzimeve, kontributeve, humbjes, etj. Andaj, që të arrihet konsolidimi dhe qëndrueshmëria e sistemit pensional duhet fillimisht nënvizuar faktorët që kanë impakt pozitiv në operimin e tij, e më tej marginalizimin e faktorëve që ndikojnë negativisht në funksionimin financiar të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor të Republikës së Maqedonisë.

Mirëpo, nëse i referohemi fillimit të tranzicionit asokohe raporti i punësuar pensioner varionte 30 - 35 pensionist për 100 të punësuar, me ndryshime të vogla nga vëdi në vend. Ndonëse normat e tilla krahasuar me vendet tjera të botës ishin të larta, shpenzimet pensionale të shprehura si përqindje e Prodhimit të Brendshëm Bruto ishin relativisht e ulëta, pra 5.6% për vendet baltike (Letonia, Lituania, Estonia) dhe 7.6% për vendet e CEFTA-s (përfshirë edhe Maqedoninë). Për më tej, asokohe në pjesën më të madhe të shteteve të tranzicionit erdhi deri tek ulja e prodhimitarisë dhe punësimit, përkatësisht niveli i punësimit që zvogëluar për 20 - 50% nën nivelin e vitit 1989 duke çuar në ndryshime të mëdha në treguesit e Prodhimit të Brendshëm Bruto.

Po ashtu, në aspekt të punësimit numri i të punësuarëve dukshëm ishte zvogëluar saqë në vitin 1995 në shtetet e Evropës Qëndrore dhe Juglindore arriti deri në 12.5%, edhe pse nuk mund të merret si tregues relevant pasi që nuk ishte raportuar punësimi me orar të pjesshëm dhe punësimi për të cilin nuk kishte kontratë punë të lidhur (punësimi në të zesë). Ky veprim, nga këndvështrimi ekonomik dhe social shkaktoi vështirësi të mëdha për punonjësit, aktivitetet dhe për sistemin pensional që më së shumti u tangua, ngase pagesat për kontributet pensionale dukshëm u ulën kurse për pensionet u rritën duke shkaktuar në një hendek të madh financiar.

Për rrjedhojë, një numër i madh i kompanive nuk bënin pagesa të rregullta për kontributet për sigurim pensional dhe invalidor në emër të të punësuarëve dhe u deklaruan teprica të ndryshme teknike dhe teknologjike dhe borxhet e akumuluarra financiare u rritën. Duke u nisur nga kjo, punëtorët e pushuar gjetën punë në sektorin informal dhe kështu ishin jashtë kornizave të organeve për pagesën e kontributeve sociale, duke impenjuar uljen e të ardhurave të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor.

Po ashtu, sistemet pensionale rritën shumën e kontributit për sigurim pensional dhe invalidor me liberalizimin e njëkohshëm të kushteve për pension të parakohshëm dhe pension me aftësi të kufizuara, për të kompensuar rritjen e papunësisë në ato vende. Kjo mënyrë e përdorimit të sistemit pensional paraqiste një zëvendësim të pjesshëm për programet e mbrojtjes sociale dhe punësimit - zëvendësim ky, që shkaktoi një rritje të dukshme në numrin e pensionistëve për një periudhë shumë të shkurtër kohore (Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i Republikës së Maqedonisë).

Së fundmi, sa i përket ndryshimeve në bilancin e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor si rezultat i uljes së normës së kontributit, pjesëmarrjes së buxhetit në financimin e hendekut financiar, rritjes së shpenzimeve të tranzicionit dhe të pensioneve me liberalizimin e njëhershme të kushteve për pensione të hershme dhe invalidore, kullimit të një pjesë të kontributit në shtyllën e dytë - si segmente financiare i sjellim më hollësisht në kapitullin vijues - aspekti financiar.

KAPITULLI V: ANALIZË FINANCIARE E FONDIT PËR SIGURIM PENSIONAL DHE INVALIDOR: ANALIZA EMPIRIKE

V. 1. Aspekti demografik

Në tablon e supozimeve demografike përpos lëvizjes së përgjithshme të popullsisë një rol të rëndësishëm në drejtim të qëndrueshmërisë së sistemit pensional zënë edhe supozimet mbi natalitetin, fertilitetin, mortalitetin dhe jetëgjatësinë. Normat e natalitetit janë të rëndësishëm ngase, pasqyrojnë numrin e popullsisë së gatshme për punë nga ku varet edhe numri i të siguruarve. Kurse, jetëgjatësia paraqet një tregues të tablove të mortalitetit që tregon mesatarisht se sa vjeç një person do të jetojë në një moshë të caktuar, apo se njerëzit do të jetojnë më gjatë duke ndikuar kështu në rritjen e të moshuarve, përkatësisht në rritjen e numrit të pensionistëve dhe kohëzgjatjes së daljes në pension. Andaj, për të parë se si kanë lëvizur këto tregues demografik dhe ç'thonë parashikimet aktuale për ta, sjellim në mënyrë të veçantë secilin nga këto tregues përmes një analize të trendit të tyre përgjatë periudhës 1994-2017 dhe parashikimet aktuale të tyre deri në vitin 2050.

V.1.1. Natalitetidhe fertiliteti

Nataliteti paraqet lindjen e përgjithshme të fëmijëve në një zonë të caktuar dhe për një kohë të caktuar dhe që matet përmes raportit të numrit të lindjeve të gjalla dhe numrit mesatar të popullsisë për vitin për të cilin llogaritet, shumëzuar për 1000 banorë (Мицески и Темјановски, 2011). Duke u nisur nga kjo, në Republikë e Maqedonisë të dhënat statistikore tregojnë se norma e natalitetit në tridhjetë vitet e fundit ka shënuar rrënie të vazhdueshme si në zonat rurale ashtu edhe në ato urbane. Nëse i referohemi numrit të lindjeve për periudhën 1980 - 2011 vërejmë se ky numër është zvogëluar për 43%, gjegjësisht nga 39.784 lindje në vitin 1980 në 22.770 në vitin 2011. Mirëpo, nga viti 2006 e këndej paraqitet një periudhë më stabile sa i përket normës së natalitetit që varion në 11% për çdo 1000 banorë të Republikës së Maqedonisë - tabela në vijim (Enti shtetëror statistikor i Republikës së Maqedonisë):

Tabela 50: Trendi zhvëllimor i natalitetit të Republikës së Maqedonisë për periudhën 1994-2017

Vitet	Popullsia mesatare përgjatë viteve	Lindjet e gjalla	Përqindja e natalitetit në 1000 banorë
1980	1.889.000	39.784	21.06
1981	1.916.000	39.488	20.61
1982	1.928.000	39.789	20.64
1983	1.942.000	39.210	20.19
1984	1.956.000	38.861	19.87
1985	1.969.000	38.722	19.67
1986	1.982.000	38.234	19.29
1987	1.995.000	38.572	19.33
1988	2.007.000	37.879	18.87
1989	2.018.000	35.927	17.80
1990	2.028.000	35.401	17.46
1991	2.039.000	34.830	17.08
1992	2.056.000	33.238	16.17
1993	2.066.000	32.374	15.67
1994	1.946.000	31.421	16.15
1995	1.966.000	29.886	15.20
1996	1.983.000	28.946	14.60
1997	1.997.000	26.830	13.43
1998	2.008.000	26.639	13.27
1999	2.017.000	24.964	12.38
2000	2.026.000	26.168	12.92
2001	2.035.000	24.183	11.88
2002	2.020.000	24.154	11.96
2003	2.027.000	23.596	11.64
2004	2.032.000	23.361	11.50
2005	2.037.000	22.482	11.04
2006	2.040.000	22.585	11.07
2007	2.044.000	22.688	11.10
2008	2.047.000	22.945	11.21
2009	2.051.000	23.684	11.55
2010	2.055.000	24.296	11.82
2011	2.059.000	22.770	11.06
2012	2.061.000	23.568	11.43
2013	2.064.000	23.138	11.21
2014	2.067.000	23.596	11.41
2015	2.070.000	23.075	11.15
2016	2.072.000	23.002	11.10
2017	2.075.301	21.754	10.48
Burimi: nga raporti vjetor i Entit shtetëror statistikor i Republikës së Maqedonisë, 2017			

Duke u bazuar në trendin zhvëllimor të natalitetit për vitet 1994 - 2017 konstatohet se:

- në vitin 1980 numri mesatar i popullsisë arrinte në 1.889.000 banorë dhe numri i lindjeve të gjalla deri në 39.784, që do të thotë se në çdo 1000 banorë kanë lindur 21 fëmijë;
- në vitin 1991 numri mesatar i popullsisë arrinte në 2.039.000 dhe numri i lindjeve të gjalla deri në 34.830, pra 17 fëmijë të lindur në çdo 1000 banorë;

- në vitin 2001 numri mesatar i popullsisë arrinte në 2.035.000 dhe numri i lindjeve të gjalla deri në 24.183, që do të thotë se në çdo 1000 banorë kanë lindur 11 fëmijë;
- zvogëlimi i numrit të lindjeve të gjalla në vitin 1991 krahasuar me vitin 1980 arrin deri në 12%, si dhe;
- zvogëlimi i lindjeve të gjalla në vitin 2001 krahasuar me vitin 1980 arrin deri në 39.22%, kurse krahasuar me vitin 2017 deri në 45.22%.

Megjithkëtë, norma e natalitetit në të shumtën e rasteve nuk është se na jep ndonjë vlerë të veçantë analitike sepse tregon raportin mes numrit të fëmijëve të lindur dhe popullsisë së përgjithshme, andaj, për analizë më të thelluar shpesh herë merren edhe indikatorë tjerë, sikurse norma e fertilitetit që merr për bazë vetëm popullsinë në vitet riprodhuese. Fertiliteti si tregues demografik mund të analizohet në aspektin e popullsisë mashkullore dhe asaj femërore (veçmas dhe bashkërisht), ndonëse më së shumti i referohet gjinisë femërore që është në gjendje për të lindur.

Po ashtu, norma e përgjithshme e fertilitetit konsiderohet një fertilitet hipotetik ose i mundshëm dhe paraqet numrin e lindjeve të gjalla që pritet një grua t'i lind gjatë periudhës së saj riprodhuese. Nëse i rikthehemi vitit 1971 konstatojmë se, kjo normë në Republikën e Maqedonisë arrinte në 2.98 fëmijë për grua dhe në vitin 1981 në 2.45, që ishte dukshëm më e lartë në raport me vendet e Evropës krahasuar për të njëjtën periudhë (viti 1971). Trendi i uljes së vazhdueshme të fertilitetit është më së shumti i theksuar në dekadën e fundit të shekullit XX, ku norma e fertilitetit në vitin 1994 ishte akoma në nivelin e riprodhimit të thjeshtë të popullsisë, respektivisht 2.1 fëmijë për një grua, për të vijuar me një rënie deri në 1.5 në vitin 2006 (Ministria për punë dhe politikë sociale e Republikës së Maqedonisë, 2008).

Mirëpo, sipas parashikimeve aktuale të Entit shtetëror statistikor të Republikës së Maqedonisë, pritet që kjo normë të filloje gradualisht të rritet dhe në periudhën 2045-2050 të arrij nivelin e vitit 2000, gjegjësisht 1.7 fëmijë për grua. Andaj, se si ka lëvizur trendi i normës së fertilitetit përgjatë periudhës 1994 - 2015, e njëherit si janë parashikimet aktuale për të njëjtën, sjellim tabelën vijuese:

Tabela 51: Lëvizja e normës së përgjithshme të fertilitetit të Republikës së Maqedonisë për periudhën 1994-2015 dhe parashikimet e saj për të ardhmen deri në vitin 2050

Vitet	Norma e fertilitetit
1994	2.1
1996	1.9
2000	1.7
2006	1.5
2010 - 2015**	1.38
2015 - 2020**	1.43
2020 - 2025**	1.48
2045 - 2050**	1.73

Pra, tabela mësipër pasqyron më qartë trendin e normës së përgjithshëm të fertilitetit ku niveli më i ulët shënohet në vitin 2015 me 1.38 fëmijë për grua, për të vijuar me një trend rritës shumë të ngadalshëm që në vitin 2050 pritet të arrij nivelin e vitit 2000, gjegjësisht 1.7 fëmijë për grua. Nëse normat e fertilitetit lëvizën më këtë dinamikë pritet të ndodh ulja drastike e popullsisë në Republikën e Maqedonisë, andaj parashikimet për lëvizjen e normës së fertilitetit në të ardhmen nuk mund të jenë shumë premtuese, parasegjithash për shkak të gjendjes aktuale të normës së fertilitetit dhe ndikimit të një numri të madh faktorësh ekonomik.

Duke u nisur nga kjo, në vijim prezantojmë tre skenarët e mundshëm rreth normës së fertilitetit bazuar në lëvizjen e normës së fertilitetit në të kaluarën, gjendjen e faktorëve ekonomik aktual dhe parashikimet e ardhshme të treguesëve ekonomik (rritjen reale të pagave, koston së jetesës, rritjen e Prodhimit të Brendshëm Bruto, etj).

Tabela 52: Parashikimi i normës së fertilitetit në tre skenarët e mundshëm (optimist, bazik dhe pesimist), për periudhën 2012-2080

Vitet	Skenari optimist	Skenari Bazik	Skenari pesimist
2012	1.57	1.55	1.53
2020	1.80	1.70	1.60
2030	1.90	1.80	1.70
2040	2.00	1.90	1.80
2050	2.10	2.00	1.90
2060	2.10	2.00	1.90
2070	2.10	2.00	1.90
2080	2.10	2.00	1.90

Burimi: nga raporti i sistemit pensional i Republikës së Maqedonisë me parashikimet aktuale, 2011

Të dhënat statistikore nga e kaluara tregojnë një normë relativisht të ulët të fertilitetit, përkatësisht 1.5 në vitin 2006, e për këtë arsyë norma e fertilitetit prej 2.1 është më se e nevojshme për një popullsi të qëndrueshme afatgjate, në të kundërtën popullsia do të fillojë të zvogëlohet, kurse mbi 2.1 do kemi shtim të popullsisë. Mirëpo, nga parashikimet mësipërm mund të vërehet një rritje e ngadalësuar në normën e fertilitetit në të tre skenarët, rrjedhimisht në skenarin bazik norma e fertilitetit arrin nivelin e 2.0 në vitin 2070 (edhe pse kjo e fundit mund të jetë nën ose mbi këtë nivel), në skenarin optimist deri në 2.10, kurse në skenarin pesimist kjo normë arrin deri në 1.95.

Duke marrë për bazë trendin e natalitetit dhe fertilitetit për periudhën 1994 - 2017, shtrohet pyetja: cilët ishin shkaqet kryesore që sollën Republikën e Maqedonisë në këtë gjendje dhe ç'duhet bërë për të stimuluar këto tregues kryesor demografikë?!

Sipas hulumtimeve të kryera rreth dinamikës së zhvillimit të natalitetit disa nga arsyt kryesore që ndikuan në uljen e vazhdueshme të natalitetit janë: shmangia e përgjegjësisë së krijimit të familjes, braktisja e vlerave tradicionale, zvogëlimi i numrit të martesave, rritja e numrit të divorceve, ndryshimi në strukturën e moshës dhe në strukturën shoqërore të popullsisë, ulja e fertilitetit, lëvizja hapësinore - mekanike e popullsisë, frika nga përkeqësimi i kushteve të përgjithshme të jetesës dhe shumë arsye tjera të cilët mund të identifikohen më së miri gjatë aktivizimit të ekipeve të ekspertëve në këtë fushë (Мицески и Темјановски, 2011).

Pra, popullsia me ekzistencën, njohuritë, aftësitë dhe kreativitetin e saj është një importues i domosdoshëm për suksesin e çdo aktiviteti të ndërmarrë, andaj, duhet t'i kushtohet një vëmendje e veçantë, të zhvillohen disiplina të veçanta për të analizuar, studiuar dhe parashikuar dinamikën dhe menaxhimin e resursit njerëzor. Mirëpo, e gjithë kjo do të ishte e kotë nëse vazhdon trendi i uljes së natalitetit dhe nëse nuk identifikohen me kujdes rrethanat dhe të ndërmerren masa si në nivelin personal, familjar ashtu edhe në atë shtetëror. Sipas strategjisë për zhvillimin demografik 2008 - 2015 të Ministrisë për punë dhe politikë sociale, qëllimi kryesor strategjik mbetet zhvillimi i qëndrueshëm demografik i popullsisë, përmes përmirësimit të cilësisë së kapitalit njerëzor, zvogëlimi të dallimit në baza të ndryshme dhe rritjes së kohezionit social. Kurse, si qëllime specifike strategjike konsiderohen (Strategjia për zhvillimin demografik të Republikës së Maqedonisë, 2008 - 2015):

- ngadalësimi i zvogëlimi të normës së uljes së popullsisë dhe krijimi i kushteve për zhvillim të qëndrueshëm demografik, përmes ndërmarrjes së masave që do të stimulojnë rritjen e popullsisë natyrore dhe të jetëgjatësisë dhe krijimin e kushteve për zvogëlimin e proceseve të migracionit;
- zvogëlimi i pabarazive rajonale demografike dhe krijimi i një shpërndarje të qëndrueshme territoriale dhe përmirësimi i kualitetit të jetesës përmes përmirësimit të nivelit arsimor, punësimit, statusit social, respektivisht krijimit të kushteve që do të ndikojnë në uljen e presionit për migrim të popullsisë;
- zvogëlimi i dallimeve dhe pabarazive ekzistuese në mes të popullsisë me qëllim të rritjes së kohezionit social, përmes uljes së pabarazive të popullsisë në bazë të gjinisë, përkatësisë etnike, sociale dhe territoriale me të cilën do të rritet barazia dhe kohezioni social në vend.

Së fundmi, zhvillimi i qëndrueshëm demografik i popullsisë së Republikës së Maqedonisë kërkon masa dhe metoda për krijimin e mundësive të barabarta për realizimin e statusit të dëshiruar riprodhues dhe qasje të barabartë në informata, kujdes shëndetësor, arsim dhe shërbime tjera që lidhen me zhvillimin demografik të të gjitha grupeve shoqërore. Kjo e fundit, do të mundësojë rritjen graduale të natalitetit, e me këtë edhe të numrit të forcës punëtore që do të kontribuojë në gjenerimin më të madh të të ardhurave të Fondit për sigurim pensional

dhe invalidor, rrjedhimisht realizimin e objektivit kryesor të sistemit pensional - pagesën e pensioneve.

V.1.2. Mortaliteti

Sipas të dhënave statistiore të publikuara në Entin shtetëror statistikor të Republikës së Maqedonisë, vitet e tetëdhjeta të shekullit XX karakterizohen me një rritje të mortalitetit. Nëse analizojmë normën e përgjithshme të mortalitetit për periudhën 1994-2017 vërejmë se, kjo normë nga viti 1994 - 2006 është rritur gradualisht dhe varion nga 8.0 në 9.1 vdekje për një mijë banorë. Andaj, se si ka lëvizur trendi i mortalitetit për periudhën 1994-2017 sjellim tabelën në vijim:

Tabela 53: Trendi zhvëllimor i mortalitetit të Republikës së Maqedonisë për periudhën 1994-2017

Vitet	Popullsia mesatare përgjatë viteve	Nataliteti	Mortaliteti	% e mortaliteti në 1000 banorë	Rritja natyrore
1994	1.946.000	31.421	15.649	8.1	15.772
1995	1.966.000	29.886	16.169	8.3	13.717
1996	1.983.000	28.946	15.882	8.1	13.064
1997	1.997.000	26.830	16.373	8.3	10.457
1998	2.008.000	26.639	16.628	8.4	10.011
1999	2.017.000	24.964	16.622	8.3	8.342
2001	2.026.000	26.168	17.085	8.5	9.083
2001	2.035.000	24.183	16.790	8.3	7.393
2002	2.020.000	24.154	17.866	8.9	6.288
2003	2.027.000	23.596	17.813	8.9	5.783
2004	2.032.000	23.361	17.944	8.8	5.417
2005	2.037.000	22.482	18.406	9.0	4.076
2006	2.040.000	22.585	18.630	9.1	3.955
2007	2.044.000	22.688	19.594	9.6	3.094
2008	2.047.000	22.945	18.982	9.3	3.963
2009	2.051.000	23.684	19.060	9.3	4.624
2010	2.055.000	24.296	19.113	9.3	5.183
2011	2.059.000	22.770	19.465	9.5	3.305
2012	2.061.000	23.568	20.134	9.8	3.434
2013	2.064.000	23.138	19.208	9.3	3.930
2014	2.067.000	23.596	19.718	9.5	3.878
2015	2.070.000	23.075	20.461	9.9	2.614
2016	2.072.000	23.002	20.421	9.9	2.581
2017	2.075.301	21.754	20.318	9.7	1.436

Burimi: nga raporti vjetor i Entit shtetëror statistikor i Republikës së Maqedonisë, 2017

Pra, nga viti 1994 e këndeje si rrjedhojë e pjesëmarrjes së të moshuarve në numrin e përgjithshëm të popullsisë, standardit jetësor dhe gjendjes së sektorit shëndetësor vërejmë një trend rritës në normën e mortalitetit. Sidoqoftë, kjo normë nga viti 2006 - 2017 lëviz me osilime të vogla (rritje apo ulje) prej 0.5 % në numrin e të vdekurve dhe në vitin 2017 arrin në 20.318, përkatësisht ulje prej 0.5% krahasuar me vitin paraprak.

Përveç natalitetit, fertilitetit dhe mortalitetit si tregues i rëndësishëm demografik paraqitet edhe norma e rritjes natyrore që njëkohësisht parashikon lëvizjen e ardhshme të popullsisë. Nëse norma e natalitetit është më e madhe se e mortalitetit, atëherë kemi rritje natyrore pozitive, në të kundërtën rritje natyrore negative. Në Republikën e Maqedonisë si rezultat i uljes së normës së natalitetit dhe rritjes së mortalitetit norma e rritjes natyrore shënon një ulje nga 8.1% në vitin 1994 në 1.8% në vitin 2006, për të arritur në 0.6% në vitin 2017. Pra, reduktimi drastik i normës së rritjes natyrore të popullsisë, na bën me dije edhe njëherë për nevojën e marrjes së masave direkte dhe indirekte të politikës demografike që do të shmangin trendin afatgjatë të uljes së normës së rritjes natyrore të popullsisë.

V.1.3. Jetëgjatësia

Jetëgjatësia si tregues demografik i referohet numrit të viteve që një person pritët të jetojë, bazuar në një vlerësim të moshës mesatare që anëtarët e një grupi të caktuar të popullsisë do të jenë kur do të vdesin. Sipas të dhënave të publikuara në Geoba.se⁴⁰ rreth jetëgjatësisë mund të thuhet se, ky tregues demografik po e fiton betejën si në Evropë ashtu edhe në shtetet ballkanike, respektivisht të gjithë njerëzit në mbarë botën mesatarisht jetojnë deri në 71.5 vjeç, apo 6.2 vjeç më shumë krahasuar me vitin 1990 ku jetëgjatësia mesatare arrinte në 65.3 vjeç. Mirëpo, se cilët janë shtetet që aktualisht dominojnë me jetëgjatësi më të lartë në botë, sjellim tabelën vijuese:

Tabela 54: Top 10-shi i shteteve me jetëgjatësi mesatare më të lartë në botë

Rangimi	Shteti	Jetëgjatësia mesatare
1	Hong Kong SAR	84.3
2	Japonia	83.8
3	Italia	83.5
4	Spanja	83.4
5	Zvicra	83.2
6	Islanda	82.9
7	Franca	82.7
8	Singapuri	82.6
9	Suedia	82.6
10	Australia	82.5

Burimi: nga Viktoria Baranyai, më 20 shkurt 2018 (www.myexpatsworld.com)

Lista e shteteve e prezantuar në tabelën mësipër bazohet kryesisht nga të dhënat e siguruar nga Forumi ekonomik botëror nga 137 shtete të përfshira në studim (Baranyai, 2018). Top 10-shi i shteteve me jetëgjatësi më të lartë janë nga Azia dhe Evropa, kurse me jetëgjatësi më të ulët konsiderohen shtetet Afrikane. Pra, edhe pse me një diferencë shumë të vogël në vend të parë rangohet Hong Kongu, për të vijuar me katër shtetet që kane pothuajse jetëgjatësi

⁴⁰ Geoba.se mbledh dhe normalizon të dhënat nga një numër burimesh, sikurse: Geonames.org, U.S. Census, World Bank, CIA World Factbook, YR.NO, Google, Yahoo, etj.

mesatare të njëjtë (Japonia, Italia, Spanja dhe Zvicra), për ta përmbyllur me pesë shtetet e fundit (Islanda, Franca, Singapuri, Suedia dhe Australia) që karakterizohen me një jetëgjatësi mesatare pothuajse identike si në rastin e Japonisë, Italisë, Spanjës dhe Zvicrës.

Mirëpo, nëse kthehemi dhe analizojmë se sa mesatarisht jeton një njeri i ballkanit, rezultatet tregojnë se edhe në shtetet ballkanike jetëgjatësia rritet vazhdimisht, e në rastin tonë konkret arrin deri në 76.41 vjeç. Ndërsa, se si rangohet Republika e Maqedonisë kundrejt shteteve tjera të ballkanit sjellim tabelën vijuese:

Tabela 55: Jetëgjatësia në disa nga shtetet ballkanike për vitin 2017

Rangimi	Shteti	Jetëgjatësia (mesatarisht vitet)
31	Greqia	80.66
46	Bosnja dhe Hercegovina	79.68
66	Shqipëria	78.47
67	Sllovenia	78.37
86	Sllovakia	77.02
87	Kroacia	76.99
94	Republika e Maqedonisë	76.41
106	Sërbia	75.68
117	Bullgaria	75.02
123	Estonia	74.76
151	Kosova	71.89

Burimi: Geoba.se (<http://www.geoba.se>)

Siç mund të vërejmë, Greqia rangohet në vendin e 31-ë në nivel botëror dhe në vendin e parë në nivel ballkanik me një jetëgjatësi prej 80.66 vjeç përfshirë mbi 100 shtete pjesëmarrëse në nivel botëror (Geoba.se)⁴¹. Po ashtu, me një diferencë jo shume të madhe për nga jetëgjatësia vijon Bosnja dhe Hercegovina, pastaj Shqipëria dhe Sllovenia me një jetëgjatësi pothuajse identike, e që përsëritet edhe tek rasti i Sllovakisë dhe Kroacisë. Kurse, sa i përket Republikës së Maqedonisë në nivel botëror rangohet në vendin e 94 - r, dhe në vendin e shtatë ndaj atyre të ballkanit, e në katër vendet e fundit kemi të radhitura Sërbinë, Bullgarinë, Estoninë dhe Kosovën (nga një selektim personal i rastësishëm i shteteve).

Rritja e jetëgjatësisë i atribuohet kryesisht rritjes së standardit jetësor si rezultat i përmirësimit të vazhdueshëm të një numri faktorësh, sikurse: përmirësimi i sistemit të shëndetit publik, vetëdijesimi rreth mënyrës së të ushqyerit, kujdesi, siguria në vendin e punës, përmirësimi i shëndetësisë, etj. Duke marrë për bazë përmirësimin e faktorëve të fundit, në Republikën e Maqedonisë jetëgjatësia nga viti 1960 - 2017 ka shënuar rritje për 15 vite, andaj se si ka lëvizur ky trend i jetëgjatësisë si për burrat ashtu edhe për gratë, shërbehuni me tabelën vijuese:

⁴¹ Ky rangim bazohet në të dhënat e raportuara nga Geoba.se që mbledh dhe normalizon të dhënat nga një numër burimesh, sikurse: Geonames.org, U.S. Census, World Bank, CIA World Factbook, YR.NO, Google, Yahoo, etj.

Tabela 56: Jetëgjatësia në Republikën e Maqedonisë për periudhën 1960-2017

Vitet	Jetëgjatësia për burrat	Jetëgjatësia për gratë	Jetëgjatësia
1960	60.20	61.07	60.63
1970	65.26	67.37	66.30
1980	66.91	70.48	68.64
1990	69.23	73.16	71.15
1991	69.35	73.40	71.33
1992	69.46	73.63	71.50
1993	69.59	73.86	71.68
1994	69.40	74.10	71.70
1995	69.80	74.00	71.80
1996	70.30	74.80	72.50
1997	70.30	74.70	72.50
1998	70.20	74.50	72.30
1999	70.40	75.30	72.80
2000	70.80	75.20	73.00
2001	70.90	76.10	73.40
2002	70.60	75.60	73.00
2003	70.90	75.70	73.20
2004	71.50	75.80	73.60
2005	71.60	75.90	73.70
2006	71.70	76.20	73.90
2007	71.80	75.90	73.80
2008	72.40	76.50	74.40
2009	72.30	76.70	74.40
2010	72.90	77.20	75.00
2011	73.10	77.20	75.10
2012	73.00	76.90	74.90
2013	73.40	77.50	75.50
2014	73.50	77.50	75.50
2015	73.50	77.40	75.50
2016	73.40	77.50	75.40
2017	73.80	79.20	76.41

Burimi: (<https://countryeconomy.com>)

Siç mund të shihet nga tabela mësipër, jetëgjatësia në Republikën e Maqedonisë nga viti 1960 - 2017 ka shënuar rritje të vazhdueshme duke arritur deri në 76.41 vjeç në vitin 2017. Po ashtu, nënvizojmë se gratë kundrejt burrave jetojnë mesatarisht më gjatë, e që në dekadën e fundit kjo diferencë lëviz deri në 5 vite. Kjo e fundit edhe një herë na bën me dije se pse aspekti demografik është aq i rëndësishëm për qëndrueshmërinë e sistemit pensional dhe pse implementimi i strategjisë për zhvillimin demografik të Republikës së Maqedonisë do të ndikonte së pari në përmirësimin e rritjes së natalitetit, më tej edhe të treguesëve tjerë demografik.

Kur jemi tek ndërmarrja e masave për zhvillimin demografik të Republikës së Maqedonisë, e në veçanti tek parashikimi i dinamikës së jetëgjatësisë gjatë lindjes dhe daljes në pension, në vijim sjellim rezultatet e parashikimeve aktuale të jetëgjatësisë për periudhën 2012 - 2050 në tre skenarë të mundshëm, edhe atë: optimist, bazik dhe pesimist.

Tabela 57: Skenari optimist i parashikimit të jetëgjatësisë së Republikës së Maqedonisë për periudhën 2012-2050

Optimist		Gjatë lindjes		Gjatë daljes në pension	
Vitet	Burra	Gra	Burra	Gra	
2012	71.39	75.64	15.22	19.05	
2020	71.40	75.60	15.23	19.02	
2030	72.00	76.10	15.62	19.39	
2040	72.50	77.00	15.95	20.06	
2050	73.00	78.00	16.28	20.83	
2060	73.00	78.00	16.28	20.83	
2070	73.00	78.00	16.28	20.83	
2080	73.00	78.00	16.28	20.83	

Burimi: nga raporti i sistemit pensional i Republikës së Maqedonisë me parashikimet aktuale, 2011

Në skenarin optimist rritja e jetëgjatësisë së të sigruarit është konstante duke lëvizur brenda kufijve të pranueshëm të rritjes së pritshme ose të parashikueshme (prej 71.39 në 73.00 vjeç për burrat dhe prej 75.64 në 78.00 vjeç për gratë). Duke u nisur nga fakti se me rritjen e jetëgjatësisë rritet edhe periudha e marrjes së pensionit, në anën e djathtë të tabelës kemi paraqitur jetëgjatësinë gjatë daljes në pension, rrjedhimisht sa vite mesatarisht pritët të jetojnë pensionistët nga momenti i daljes në pension. Pra, burrat pritët të jetojnë nga 15.28 deri në 16.28 vite më shumë, kurse gratë prej 19.05 deri në 20.83 vite më shumë, që do të thotë se burrat do të marrin për 16 vite pension dhe gratë për 20 vite radhazi, e sigurisht se për Fondin për sigurim pensional dhe invalidor ky rezultat i parashikimeve aktuale paraqet një barrë të madhe financiare.

Tabela 58: Skenari bazik i parashikimit të jetëgjatësisë së Republikës së Maqedonisë për periudhën 2012-2050

Bazik		Gjatë lindjes		Gjatë daljes në pension	
Vitet	Burra	Gra	Burra	Gra	
2012	71.49	75.82	15.29	19.18	
2020	71.90	76.50	15.55	19.69	
2030	72.40	77.10	15.88	20.14	
2040	74.00	78.80	16.96	21.45	
2050	75.00	80.00	17.65	22.41	
2060	75.00	80.00	17.65	22.41	
2070	75.00	80.00	17.65	22.41	
2080	75.00	80.00	17.65	22.41	

Burimi: nga raporti i sistemit pensional i Republikës së Maqedonisë me parashikimet aktuale, 2011

Në skenarin bazik rritja e jetëgjatësisë së të sigruarit është më e shpejtë, pra nga 71.49 në 75.00 vjeç për burrat dhe prej 75.82 në 80.00 vjeç për gratë. Kurse, sa i përket sa vite pritët të jetojnë pensionistët nga momenti i daljes në pension, rezultatet tregojnë se për burrat kjo jetëgjatësi lëviz nga 15.29 deri në 17.65 vite më shumë, e për gratë prej 19.18 deri në 22.41 vite më shumë, që do të thotë se burrat do të marrin për 17 vite pension dhe gratë për 22 vite radhazi. Kjo gjendje është alarmante për Fondin për sigurim pensional dhe invalidor pasi që këto rezultate të parashikimeve aktuale i përkasin skenarit bazik apo atij aktual.

Tabela 59: Skenari pesimist i parashikimit të jetëgjatësisë së Republikës së Maqedonisë për periudhën 2012-2050

Pesimist		Gjatë lindjes		Gjatë daljes në pension	
Vitet	Burra	Gra	Burra	Gra	
2012	71.61	76.02	15.37	19.33	
2020	72.50	77.50	15.95	20.44	
2030	72.90	78.10	16.21	20.90	
2040	75.50	80.00	18.00	22.41	
2050	77.00	81.00	19.09	23.22	
2060	77.00	81.00	19.09	23.22	
2070	77.00	81.00	19.09	23.22	
2080	77.00	81.00	19.09	23.22	

Burimi: nga raporti i sistemit pensional i Republikës së Maqedonisë me parashikimet aktuale, 2011

Në skenarin pesimist rezultatet janë më të ndjeshme pasi që rritja e jetëgjatësisë së të siguruarit është më e shpejtë se në dy skenarët paraprak, pra, jetëgjatësia gjatë lindjes për burrat do të rritet nga 71.61 në 77.00 vjeç dhe nga 76.02 në 81.00 vjeç për gratë. E sigurisht që kjo rritje do të reflekton automatikisht edhe në kolonën e rritjes së jetëgjatësisë gjatë daljes në pension, përkatësisht burrat pritet të marrin pension për 19 vite dhe gratë për 23 vite rishtazi. Pra, ky skenar na pasqyron rezultatet më pak të dëshirueshme për Fondin për sigurim pensional dhe invalidor, ngase barra financiare që pritet ta ngarkojë Fondin për sigurim pensional dhe invalidor është shumë më e lartë se në skenarin bazik dhe optimist.

Së fundmi, si kanë lëvizur treguesit e përgjithshëm demografik dhe cili është impakti i tyre në qëndrueshmërinë e sistemit pensional të Republikës së Maqedonisë në formë të përmbledhur i sjellim më poshtë:

Tabela 60: Vështrim i përgjithshëm i lëvizjes së popullsisë për periudhën 1994-2017 (në mijë)

Vitet	P.mes atare ⁴²	Lindjet e gjalla ⁴³	Mortaliteti gjithsej	Fosh. e vde kura	Rritja natyrore	Gjithsej martesat	Divor Cet	N. në 1000 banorë	M. në 1000 banorë	Kol 6 (pro milë)	% e kol 7
1994	1.946	33.487	15.771	752	17.716	15.736	612	17.2	8.1	9.1	8.1
1995	1.966	32.154	16.338	729	15.816	15.823	710	16.3	8.3	8.0	8.0
1996	1.983	31.403	16.063	515	15.340	14.089	705	15.8	8.1	7.7	7.1
1997	1.997	29.478	16.596	463	12.882	14.072	1.021	14.8	8.3	6.5	7.0
1998	2.008	29.244	16.870	476	12.374	13.993	1.027	14.6	8.4	6.2	7.0
1999	2.017	27.309	16.789	406	10.520	14.172	1.045	13.5	8.3	5.2	7.0
2000	2.026	29.308	17.253	346	12.055	14.255	1.325	14.5	8.5	6.0	7.0
2001	2.035	27.010	16.919	321	10.091	13.267	1.448	13.3	8.3	5.0	6.5
2002	2.020	27.761	17.962	283	9.799	14.522	1.310	13.7	8.9	4.8	7.2
2003	2.027	27.011	18.006	305	9.005	14.402	1.405	13.3	8.9	4.4	7.1

⁴² Popullsia mesatare në vitin 1994 bazohet nga të dhënat e regjistrimit të vitit 1994, kurse nga viti 1995 - 2001 vlerësimet janë kryer në bazë të popullsisë së përgjithshme sipas regjistrimit të vitit 1994. E vlerësimet nga periudha 2002 - 2017 janë kryer në bazë të popullsisë së përgjithshme sipas regjistrimit të vitit 2002.

⁴³ Të dhënat mbi lindjet e gjalla, vdekjet dhe martesat nga viti 2004 janë në përputhje me metodologjinë e re për paraqitjen e statistikave vitale.

2004	2.032	23.361	17.944	308	5.417	14.073	1.645	11.5	8.8	2.7	6.9
2005	2.037	22.482	18.406	287	4.076	14.500	1.552	11.0	9.0	2.0	7.1
2006	2.040	22.585	18.630	260	3.955	14.908	1.475	11.1	9.1	1.9	7.3
2007	2.044	22.688	19.594	234	3.094	15.490	1.417	11.1	9.6	1.5	7.6
2008	2.047	22.945	18.982	223	3.963	14.695	1.209	11.2	9.3	1.9	7.2
2009	2.051	23.684	19.060	278	4.624	14.923	1.287	11.5	9.3	2.3	7.3
2010	2.055	24.296	19.113	185	5.183	14.155	1.720	11.8	9.3	2.5	6.9
2011	2.059	22.770	19.465	172	3.305	14.736	1.753	11.1	9.5	1.6	7.2
2012	2.061	23.568	20.134	230	3.434	13.991	1.926	11.4	9.8	1.7	6.8
2013	2.064	23.138	19.208	237	3.930	13.982	2.045	11.2	9.3	1.9	6.8
2014	2.067	23.596	19.718	233	3.878	13.813	2.210	11.4	9.5	1.9	6.7
2015	2.070	23.075	20.461	198	2.614	14.186	2.200	11.1	9.9	1.3	6.9
2016	2.072	23.002	20.421	273	2.581	13.199	1.985	11.1	9.9	1.2	6.4
2017	2.075	21.754	20.381	201	1.373	13.781	1.994	10.48	9.8	0.7	6.6

Burimi: nga raporti vjetor statistikor i Republikës së Maqedonisë 2017, fq.73

Duke u bazuar në dinamikën e treguesëve të përgjithshëm demografik të prezantuar në tabelën mësipër, konstatojmë se:

- popullsia mesatare nga viti 1994 - 2017 është rritur për 6.3 %;
- nataliteti nga viti 1994 - 2017 është zvogëluar për 35%, si rezultat i vonesës në lindje dhe shtyrjes së martesave në moshë më të vjeçër;
- mortaliteti në vitin 1994 me gjithsej 15.771 të vdekur, krahasuar me vitin 2017 me 20.381 është rritur për 29%;
- numri i foshnjeve të vdekura krahasuar me periudhë e analizuar 1994 - 2017 është zvogëluar për 73%;
- rritja natyrore për periudhën 1994 - 2017 është ulur për 91.2%, përkatësisht nga 17.716 në vitin 1994 deri në 1.373 në vitin 2017;
- martesat janë zvogëluar për 13%, pra nga 15.736 në vitin 1994 deri në 13.781 në vitin 2017, si rezultat i kushteve të vështira ekonomike dhe sociale në vend dhe rritjes së numrit të grave që u japin përparësi edukimit dhe ndërtimit të karrierës së tyre;
- divorcet gjithashtu shënojnë një rritje të theksuar, pra nga 612 në vitin 1994 deri në 1.994 divorce në vitin 2017 apo një rritje për 69%.

Pra, të gjithë treguesit demografik të elaboruar më sipër kanë një ndikim të theksuar negativ në Fondin për sigurim pensional dhe invalidor të Republikës së Maqedonisë. Ulja e natalitetit dhe fertilitetit, rritja e mortalitetit dhe jetëgjatësisë shkaktojnë një ngarkesë të lartë financiare për Fondin për sigurim pensional dhe invalidor të Republikës së Maqedonisë, ngase në njërin anë duhet të sigurohen fonde shtesë për numrin e pensionistëve që vazhdimisht rriten, kurse në anën tjetër të sigurohen të ardhura shtesë si rrjedhojë e zvogëlimit të numrit të të siguarëve. Andaj, vetëm nëpërmjet ndërmarrjes së masave për rritjen e normës së natalitetit dhe fertilitetit mund të ndikohet në rritjen e popullsisë aktive të ardhëshme dhe uljen e numrit

të pensionistëve, ku edhe ndikimi i faktorëve demografik mbi Fondin për sigurim pensional dhe invalidor do të zvogëlohej.

V. 2. Aspekti ekonomik

Faktorët ekonomik kanë një ndikim të rëndësishëm në funksionimin e gjithëmbarshtëm të sistemit pensional pasi që korrelacionet ndërmjet tyre lehtësojnë ose pengojnë funksionimin e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor të Republikës së Maqedonisë. Si tregues më të rëndësishëm ekonomik që ndikojnë në Fondin për sigurim pensional dhe invalidor janë: rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto, rritja reale e pagave, rritja e kostos së jetesës dhe papunësia.

V.2.1. Rritja reale e pagave

Lëvizja e pagave në ekonomi drejtpërsëdrejti ndikon në të ardhurat dhe shpenzimet e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor. Çdo rritje ose ulje e pagave reflekton në kontributet e derdhura për pagat e realizuara, e me këtë edhe në të ardhurat e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor. Po ashtu, pagat së bashku me koston e jetesës përdoren për harmonizimin e pensioneve, e që sigurisht çdo ndryshim në këto dy tregues ekonomik ndikon në shpenzimet e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor.

Harmonizimi i pensioneve në Republikën e Maqedonisë bëhet konform Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor (neni 37, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë) që merr për bazë 50% të rritjes së pagës mesatare për të gjithë të punësuarit dhe 50% lëvizjen e indeksit të koston së jetesës. Andaj, se si janë harmonizuar pensionet për periudhën 2001 - 2017 sjellim tabelën vijuese.

Tabela 61: Harmonizimi i kryer i pensioneve prej vitit 2001-2017

Viti	Harmonizimi i pensioneve më 1 janar	Harmonizimi i pensioneve më 1 korrik	Gjithsej harmonizimi
2001	1.79%	-	1.79%
2002	0.63%	5.90%	6.56%
2003	2.97%	2.68%	5.72%
2004	0.80%	0.41%	1.21%
2005	-	0.40%	0.40%
2006	0.48%	2.18%	2.67%
2007	0.64%	1.04%	1.69%
2008	13.00%	7.65%	21.66%
2009	3.50%	2.02%	5.59%
2010	0.30%	1.10%	1.40%
2011	2.10%	0.75%	2.87%
2012	0.31%	1.40%	1.71%
2013	1.15%	0.75%	+5% plotë. Gjith 7%
2014	5% nga shtatori	0.00%	0.00%
2015	0.00%	5% nga shtatori	0.00%
2016	0.00%	5% nga nëntori	0.00%

Sipas të dhënave të publikuara në Entin shtetëror statistikor për rritjen e pagave të punëtorëve dhe levizjen e kostos së jetesës për periudhën 2001 - 2017, konstatojmë se:

- Harmonizimi më i lartë i pensionit është bërë në vitin 2008 si rezultat i rregullimit plotësues me vendimin e sjellur nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, prej 13% prej 1 janarit 2008 dhe 7.65% prej 1 korrikut 2008, apo gjithsej 21.66% harmonizim. Ky i fundit kontribuoi në rritjen e vlerës reale të pensionit dhe përmirësimin e sigurisë materiale dhe financiare të pensionistëve;
- Në vitin 2013, po ashtu me vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë u bë harmonizimi plotësues i pensioneve, edhe atë për: 1.15% prej 1 janarit dhe 0.75% prej 1 korrikut, apo gjithsej 7% harmonizim. Ky vendim i aprovuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, edhe një herë e ngarkoi financiarisht Fondin për sigurim pensional dhe invalidor të Republikës së Maqedonisë.

Kurse, sa i përket lëvizjes së pagës mesatare neto dhe lëvizjes së pensioneve mesatare sipas llojeve të tyre, përfshirë edhe raportin pension - pagë për periudhën 1991 - 2017 sjellim tabelën në vijim:

Tabela 62: Lëvizja e pages mesatare neto, pensionet mesatare sipas llojeve të tyre dhe raporti pension-pagë për periudhën 1991-2017

Vitet	Paga neto	Pension pleqërie	Pension invalidor	Pension familjar	Gjithsej pension	R.pension-pagë
1991	119,74	86,53	62,70	59,39	79,31	66.2%
1992	1.339,95	1.200,50	866,83	826,32	1.032,60	77.1%
1993	6.315,00	5.327,00	3.912,00	3.742,00	4.634,00	73.4%
1994	8.424,00	6.140,00	4.500,00	4.374,00	5.350,00	63.5%
1995	8.435,00	6.438,00	4.735,00	4.623,00	5.609,00	66.5%
1996	8.931,00	6.558,00	4.872,50	4.707,00	5.715,00	64.0%
1997	9.096,00	6.634,00	4.969,50	4.733,00	5.773,00	63.5%
1998	9.694,00	6.607,00	5.007,50	4.717,00	5.751,00	59.3%
1999	10.029,00	7.188,00	5.439,00	5.132,00	6.251,00	62.3%
2000	10.526,00	7.394,00	5.563,00	5.281,00	6.431,00	61.1%
2001	10.592,00	7.498,00	5.672,00	5.354,50	6.535,00	61.7%
2002	11.550,00	7.982,00	6.060,00	5.673,00	6.955,00	60.2%
2003	11.955,00	8.421,00	6.425,00	5.971,00	7.346,00	61.4%
2004	12.534,00	8.492,00	6.509,00	6.023,00	7.428,00	59.3%
2005	13.125,00	8.517,00	6.543,00	6.018,00	7.463,00	56.9%
2006	13.854,00	8.765,00	6.746,50	6.150,00	7.683,00	55.5%
2007	15.543,00	8.947,00	6.898,00	6.243,00	7.848,00	50.5%
2008	17.363,00	10.762,00	8.560,00	7.739,00	9.541,00	55.0%
2009	20.483,00	11.347,00	9.079,00	8.126,00	10.057,00	49.1%
2010	21.454,00	11.615,00	9.213,00	8.225,00	10.273,00	47.9%
2011	21.415,00	12.096,00	9.539,00	8.473,00	10.682,00	49.9%
2012	21.469,00	12.437,00	9.934,00	8.634,00	11.016,00	51.3%
2013	21.500,00	13.287,00	10.597,00	9.270,00	11.845,00	54.9%
2014	22.407,00	13.875,00	11.211,00	9.872,00	12.487,00	55.6%

2015	22.715,00	14.449,00	11.798,00	10.439,00	13.068,00	57.5%
2016	23.457,00	15.062,00	12.449,00	11.052,00	13.727,00	58.5%
2017	23.850,00	15.229,00	12.641,00	11.190,00	13.928,00	58.4%

Burimi: nga raporti për punën e Fondit dhe raporti statistikor vjetor për vitin 2017

Nga tabela e prezantuar mësipër vërehet një rritje e vazhdueshme e pagës mesatare neto dhe një rritje e vazhdueshme e pensioneve, ndonëse kjo e fundit me normë më të ulët krahasuar me rritjen e pagës mesatare neto. Kurse, sa i përket pjesëmarrjes së pensioneve në pagat e realizuara (si rezultat i rritjes më të lart të pagave në krahasim me pensionet) mund të vërhet se kjo pjesëmarrje nga viti 1991 deri në vitin 2017 ka shënuar rrënie të vazhdueshme, respektivisht nga 66.2% në vitin 1991 ulet në 58.4% në vitin 2017.

Sidoqoftë, se si qëndron raporti në mes pjesëmarrjes së llojeve të pensioneve në pagën mesatare neto për periudhën 1991 - 2017, e pasqyrojmë në tabelën vijuese:

Tabela 63: Pjesëmarrja e llojeve të pensioneve në neto pagën mesatare për periudhën 1991-2017

Viti	Pension pleqërie në %	Pension invalidor në %	Pension familjar në %	Gjithsej pensioni në %
1991	72.3	52.4	49.6	66.2
1992	89.6	64.7	61.7	77.1
1993	84.4	61.9	59.3	73.4
1994	72.9	53.4	51.9	63.5
1995	76.3	56.1	54.8	66.5
1996	73.4	54.6	52.7	64.0
1997	72.9	54.6	52.0	63.5
1998	68.2	51.7	48.7	59.3
1999	71.7	54.2	51.2	62.3
2000	70.2	52.9	50.2	61.1
2001	70.8	53.5	50.6	61.7
2002	69.1	52.5	49.1	60.2
2003	70.4	53.7	49.9	61.4
2004	67.8	51.9	48.1	59.3
2005	64.9	49.9	45.9	56.9
2006	63.3	48.7	44.4	55.5
2007	57.6	44.4	40.2	50.5
2008	62.0	49.3	44.6	55.0
2009	55.4	44.3	39.7	49.1
2010	54.1	42.9	38.3	47.9
2011	56.5	44.5	39.6	49.9
2012	57.9	46.3	40.2	51.3
2013	61.8	49.2	43.1	54.9
2014	61.9	50.0	44.0	55.6
2015	63.6	51.9	45.9	57.5
2016	64.2	53.0	47.1	58.5
2017	63.8	53.0	46.9	58.4

Burimi: nga raporti për punën e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor për vitin 2017

Duke u bazuar në të dhënat e gjeneruara nga raporti për punën e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor, sa i përket pjesëmarrjes së llojeve të pensioneve në pagën neto konstatojmë se:

- pensioni i pleqërisë shënon pjesëmarrje më të lartë në pagën neto dhe se nga viti 1991 deri në vitin 2000 vërehen osicilime të vogla prej 1-2% (nga 72.3% në 70.2%) tek të gjitha llojet e pensioneve, kurse tek pjesëmarrja e gjithsej pensionit në pagën neto vërehet një rrënie e theksuar prej 5% (nga 66.2 % në 61.1%);
- nga viti 2000 deri në vitin 2010 tek pjesëmarrja e të gjithë llojeve të pensioneve në pagën neto vërehet një rrënie e dukshme, edhe atë për 16.1% tek pensioni i pleqërisë, 10% tek pensioni invalidor dhe për 11.9% tek pensioni familjar, kurse tek pjesëmarrja e gjithsej pensionit kjo rrënie arrin në 13.2%;
- nga viti 2010 - 2013 kemi një rritje të pjesëmarrjes prej 7.7 % të pensionit të pleqërisë, 6.3% të pensionit invalidor, 4.8% të pensionit familjar dhe një rritje prej 7% të gjithsej pjesëmarrjes së pensionit në pagën neto (si rezultat i vendimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për rregullim shtesë të pensionit);
- nga viti 2013 - 2017 kemi osicilime të vogla pre 2-4% si rezultat i rritjes së vazhdueshme të pagës neto, ndonëse jo në mënyrë proporcionale me rritjen e pensioneve, si dhe;
- nga viti 1991 - 2017 pjesëmarrja e gjithsej pensionit në pagën neto ka shënuar rrënie prej 7%, si rezultat i mos rritjes proporcionale të pagës neto me pjesëmarrjen e pensionit dhe si rezultat i ndryshimit të vazhdueshëm të normës së kontributit për pension.

Mirëpo, siç e ekzaminuam edhe më lartë gjatë harmonizimit të pensionit merren në konsideratë dy indikatorët kryesorë: lëvizja e pagës mesatare dhe indeksi i kostos së jetesës. Duke u nisur nga kjo, sjellim lëvizjen e indeksit të pagës neto nominale dhe asaj reale (më poshtë edhe lëvizjen e indeksit të kostos për jetesë).

Tabela 64: Lëvizja e indeksit për pagën neto reale dhe nominale për periudhën 1995-2017

Vitet	Indeksi i pagës neto nominale	Indeksi i pagës neto reale
1995	100.0	100.0
1996	102.8	100.4
1997	105.6	100.6
1998	109.5	104.4
1999	112.6	108.2
2000	118.8	107.8
2001	116.4	105.1
2002	106.9	105.0
2003	112.1	106.8
2004	116.5	113.5
2005	119.4	115.8
2006	128.1	120.4
2007	107.9	105.5
2008	119.1	107.5
2009	147.6	134.3
2010	152.1	136.2
2011	154.2	132.9
2012	154.6	129.0

2013	156.4	127.0
2014	158.3	128.9
2015	162.1	132.3
2016	165.3	135.2
2017	157.2	129.8

Burimi: nga raporti statistikor vjetor për vitet përkatëse

Pra, nga viti 1995 deri në vitin 2017 vërehet një rritje e vazhdueshme në indeksin e pagës neto nominale duke reflektuar më tej tek indeksi i kostos së jetesës (e elaboruar në temën më poshtë). Po ashtu, në tabelën mësipër kemi paraqitur edhe lëvizjen e indeksit të pagës neto reale të përshtatur me inflacionin që tregon rritjen reale të pagës dhe impaktin real në rritjen e të ardhurave të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor të Republikës së Maqedonisë. Duke u nisur nga relevanca e rritjes reale të pagës neto në gjenerimin e të ardhurave dhe harmonizimin e pensioneve, sjellim në vijim parashikimet aktuale të këtij treguesi ekonomik në skenarin optimist dhe pesimist (duke marrë për bazë vitin 2012):

Tabela 65: Parashikimi i rritjes reale të pagave për periudhën 2013-2055

Vitet	Skenari optimist (rritja reale e pagave)	Skenari pesimist (rritja reale e pagave)
2013	4.00%	4.00%
2015	3.70%	3.20%
2020	3.50%	3.00%
2025	3.30%	2.70%
2030	3.00%	2.50%
2035	3.20%	2.30%
2040	3.30%	2.10%
2045	3.50%	2.00%
2050	3.70%	2.20%
2055	3.60%	2.10%

Burimi: nga parashikimet aktuale të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor për rritjen reale të pagave

Nga tabela mësipër mund të vërehet parashikimi i rritjes reale të pagave në të dy skenarët e mundshëm, ku realizimi i skenarit të parë do të ndikonte pozitivisht në bilancin e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor, duke shkaktuar rritjen e të ardhurave nga kontributet pensionale për shkak të bazës më të lartë edhe atë deri në 4%, kurse realizimi i skenarit të dytë do të mundësonte që Fondi për sigurim pensional dhe invalidor të vazhdoj edhe për shumë kohe me financimin e pensioneve nga të ardhurat shtesë (nga buxheti).

Pra, rritja reale e pagave si tregues ekonomik ka ndikim të veçantë në projektimin e qëndrueshmërisë së sistemit pensional të Republikës së Maqedonisë, andaj çdo rritje apo ulje shkakton ndryshime në koston e jetesës - indikatorë këto, që përdoren për harmonizimin e pensionit konform Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor të Republikës së Maqedonisë.

V.2.2. Rritja e kostos së jetesës

Statistikat për standardin jetësor ofrojnë të dhëna për konsumin familjar, të ardhurat dhe kushtet e jetesës mbi bazë të të cilave kryhen të dhënat analitike mbi varfërinë në Republikën e Maqedonisë, si dhe bazë për përlogaritjen e ponderit të indeksit të kostos së jetesës dhe Prodhimit të Brendshëm Bruto (përfshirë edhe faktin që indeksi i kostos së jetesës është indikator për normën e inflacionit). Po ashtu, të dhënat e Entit shtetëror statistikor të Republikës së Maqedonisë tregojnë rritje të vazhdueshme të pagës nominale neto dhe të indeksit të kostos së jetesës, si indikatorë që në çdo gjashtë muaj përdoren për harmonizimin e pensioneve. Ky harmonizim, në njërin anë ndikon në barazimin e standardit të pensionistëve me lëvizjet aktuale ekonomike përmes përfshirjes së kostos së jetesës në përlogaritjen e pensionit, kurse në anën tjetër ndikon në rritjen e mjeteve të nevojshme për pagesën e pensioneve (Програма за статистички истражувања за периодот 2013 - 2017 година, 2013).

Andaj, duke u nisur nga relevanca e kostos së jetesës në projektimin e qëndrueshmërisë financiare afatgjate të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor, në vijim sjellim dinamikën e indeksit të kostos së jetesës për periudhën 1995 - 2017 dhe parashikimet aktuale të kostos së jetesës për periudhën 2013 - 2055, duke marrë për bazë vitin 2012.

Tabela 66: Lëvizja e indeksit të kostos së jetesës për periudhën 1995-2017

Vitet	Indeksi i kostos së jetesës
1995	100.0
1996	102.3
1997	105.0
1998	104.9
1999	104.1
2000	110.2
2001	110.7
2002	101.8
2003	103.0
2004	102.6
2005	103.1
2006	106.4
2007	102.3
2008	110.8
2009	109.9
2010	111.7
2011	116.0
2012	119.9
2013	123.2
2014	122.8
2015	122.5
2016	122.2
2017	121.1
Burimi: nga raporti statistikor vjetor për vitet përkatëse	

Duke marrë për bazë dinamikën e indeksit të kostos së jetesës për periudhën 1995 - 2017, konstatojmë se:

- nga viti 1995 - 2001 indeksi i kostos së jetesës shënon një rritje në permasa jo edhe shumë të larta krahasuar me dekadën e fundit, pra deri në 10% më shumë se viti 1995;
- në vitin 2002 indeksi i kostos së jetesës shënon një ulje deri në 101.1% duke vijuar më tej me osilime të vogla që zgjatën deri në vitin 2007;
- nga viti 2008 - 2017 indeksi i kostos së jetesës shënon rritje të vazhdueshme duke ndikuar në rritjen e pensionit, ndonëse me një normë më të ulët krahasuar me rritjen e pagës neto, si dhe
- nga viti 1995 - 2017 indeksi i kostos së jetesës shënon një rritje prej 21.1% duke e rritur barrën financiare të të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor.

Tabela 67: Parashikimi i rritjes së kostos së jetesës për periudhën 2013-2055

Vitet	Skenari optimist	Skenari pesimist
2013	2.30%	2.30%
2015	2.10%	2.50%
2020	1.90%	2.70%
2025	2.20%	2.90%
2030	2.10%	3.00%
2035	1.80%	2.90%
2040	1.70%	3.20%
2045	2.0%	3.40%
2050	2.10%	3.30%
2055	2.20%	3.00%

Burimi: nga parashikimet aktuale të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor për rritjen reale të pagave

Për rrjedhojë, parashikimet aktuale në lidhje me koston e jetesës për periudhën 2013 - 2015, rezultojnë se:

- në skenarin optimist paraqitet një situatë më e përshtatshme ku rritja e kostës së jetesës pritet të mos kalojë suazat e 2%-shit, kurse;
- në skenarin pesimist shfaqet një situatë më e ndjeshme, ngaqë kjo rritje rezulton deri në 3% që rrjedhimisht do të shkaktojë edhe rritjen e pensionit, e me këtë edhe rritjen e ngarkesës financiare të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor.

Pra, duke u nisur nga fakti që kostoja e jetesës shënon rritje të vazhdueshme Republika e Maqedonisë kategorikisht duhet të mos miratojë vendimet e qeverisë për plotësim shtesë të pensionit dhe të ndjek rekomandimet e Bankës Botërore që harmonizimi i pensionit të bëhet vetëm duke marrë për bazë indikatorin e pagës nominale dhe koston e jetesës, e jo edhe rregullimet shtesë që bëhen vetëm për qëllime politike e aspak për qëllime produktive.

V.2.3. Papunësia

Papunësia si tregues ekonomik mbi bazë të së cilës mbështeten reformat pensionale vazhdon të krijojë një situatë alarmante në Fondin për sigurim pensional dhe invalidor, si rrjedhojë e mos përmbushjes në kohë të projeksioneve të Bankës Botërore dhe njësisë aktuale që rekomandonin se, për reforma të suksesshme papunësia në Republikën e Maqedonisë deri në vitin 2010 duhej të zvogëlohej në 28%, kurse në vitin 2012 të arrijë në nivelin e 26.5%, me qëllim të ngjalljes së parametrave tjerë ekonomik dhe rritjes së Prodhimit të Brendshëm Bruto. Duke u nisur nga kjo, në vijim paraqesim dinamikën e punësimit dhe të papunësisë për periudhën 1998 - 2017, për të argumentuar arsyet e përkeqësimit të gjendjes financiare të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor dhe strategjinë kombëtare të punësimit të Republikës së Maqedonisë deri në vitin 2020.

Tabela 68: Lëvizja e punësimit dhe e papunësisë për periudhën 2004-2017

Vitet	Popullsia aktive	Popullsia aktive			Norma e aktivitetit	Norma e punësimit	Norma e pa punësimit
		Gjithsej	Të punësuar	Të pa punësuar			
2004	1.594.557	832.281	522.995	309.286	52.2%	32.8%	37.2%
2005	1.607.997	869.187	545.253	323.934	54.1%	33.9%	37.3%
2006	1.618.482	891.679	570.404	321.274	55.1%	35.2%	36.0%
2007	1.627.216	907.138	590.234	316.905	55.7%	36.2%	35.0%
2008	1.633.341	919.424	609.015	310.409	56.3%	37.3%	33.8%
2009	1.638.869	928.775	629.961	298.873	56.7%	38.4%	32.2%
2010	1.648.522	938.294	637.855	300.439	56.9%	38.7%	32.0%
2011	1.656.935	940.048	645.085	294.963	56.8%	38.9%	31.4%
2012	1.669.965	943.055	650.554	292.502	56.5%	39.0%	31.0%
2013	1.676.182	956.057	678.838	277.219	57.2%	40.6%	29.0%
2014	1.673.494	958.998	690.188	268.809	57.3%	41.2%	28.0%
2015	1.676.659	954.924	705.991	248.933	57.0%	42.1%	26.1%
2016	1.678.890	948.599	723.550	225.049	56.5%	43.1%	23.7%
2017	1.679.935	954.212	740.648	213.564	56.8%	44.1%	22.4%

Burimi: nga raporti statistikor vjetor për vitet përkatëse

Të dhënat e raportuara në Entin shtetëror statistikor të Republikës së Maqedonisë, sa i përket lëvizjes së punësimit dhe papunësisë për periudhën 2004 - 2017 konstatojnë se:

- papunësia nga viti 2004 - 2012 arrinë normën më të lartë duke u paraqitur si pengesë kryesore për zhvillimin e ekonomisë së vendit dhe për rritjen e Prodhimit të Brendshëm Bruto;
- nga viti 2013 - 2017 norma e papunësisë fillon të ulet nën nivelin e 30 - shit, për të arritur në vitin 2017 në 22.4% ose deri në 213.564 të papunësuar;
- nga viti 2004 - 2017 norma e papunësisë ulet për 15.2% ose për 95.722 të punësuar duke ndikuar në përmirësimin e të ardhurave të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor, përmes kontributeve të derdhura për sigurim pensional dhe invalidor.

Tabela 69: Lëvizja enormës së punësimit krahasuar me prioritete strategjike të BE-s% dhe strategjinë kombëtare të punësimit të RM-së

Objektivat	Maqedonia 2010	Objektivi kombëtar 2015	Objektivi i Bashkimit Evropian për 2020	Parashikimi i objektivit kombëtar i Republikës së Maqedonisë për 2020 ⁴⁴
% e punësimit nga 20 deri në 64 vjeç	48.1%	55%	75%	60%
% e punësimit tek të rinjtë nga 15 - 29 vjeç	26.5%	29%	-	-
% e punësimit tek të rinjtë nga 15 - 24 vjeç	15.4%	17%	-	-
% e punësimit tek gratë nga 15 - 64 vjeç	34%	42%	-	-
% e punësimit tek t'moshuarit nga 55 - 64 vjeç	34.2%	41%	-	-

Burimi: nga Enti shtetëror statistikor dhe anketa për forcën punëtore për vitin 2010

Sipas objektivit kombëtar të Republikës së Maqedonisë dhe të Bashkimit Evropian, përqindja e punësimit në vitin 2015 pritej të arrij në 55% duke ndikuar drejtpërsëdrejti në rritjen e të ardhurave të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor. Mirëpo, si pasojë e gjendjes reale ekonomike Republika e Maqedonisë nuk arriti në kohë t'i përmbush projeksionet e Bankës Botërore për reforma të suksesshme, rrjedhimisht ulje të papunësisë në 28% në vitin 2010 dhe 26.5% në vitin 2012, si dhe projeksionet e strategjisë kombëtare të punësimit të Republikës së Maqedonisë për rritje të punësimit deri në 55% në vitin 2015. Këto projeksione vendi ynë i arriti 3 vite më vonë, ngase ulja e papunësisë në 26.5% që parashikohej në vitin 2012 u arrit në vitin 2015.

Megjithkëtë, nëse bazohemi vetëm në të dhënat e Entit shtetëror statistikor sa i përket lëvizjes së punësimit dhe papunësisë fitojmë një përshtypje se të gjitha masat e ndërmarra nga ana e qeverisë në lidhje me tregun e punës kanë pasur rezultate pozitive, përkatësisht papunësia dukshëm është zvogëluar dhe punësimi është rritur. Por, si gjithnjë këto të dhëna duhet marrë me një dozë rezervë, për dy arsye:

- së pari u bënë ndryshime në listën e evidencës së të papunëve (para disa viteve) ku një pjesë e mirë e qytetarëve u kategorizuan si persona që kërkojnë punë në mënyrë pasive, duke i larguar më vonë edhe nga evidenca e të papunëve përfshirë rastet ku në mënyrë arbitrare dhe për arsye banale i fshinë nga lista e të papunëve;
- së dyti struktura e rritjes së punësimit, respektivisht a janë të punësuar në sektorin publik apo privat (struktura e rritjes së punësimit determinon qëndrueshmërinë fiskale të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor).

Nëse analizojmë punësimet e përgjithshme në vend nënvizojmë se, pjesa dërmuese e punësimeve janë bërë nga vetë institucionet shtetërore që nuk është se kanë ndonjë impakt të theksuar tek buxheti i Fondit për sigurim pensional dhe invalidor, përpos bartjes së mjeteve

⁴⁴ Parashikimi i objektivit kombëtar i Republikës së Maqedonisë, mbetet akoma indikativ dhe si e nevojshme për harmonizim të mëtutjeshëm.

shtetërore nga një institucion në institucionin tjetër shtetëror. Andaj, që rritja e punësimit të ketë efekt të theksuar në qëndrueshmërinë financiare të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor, duhet që numrin më të madh të punësimeve të reja ta bëjë sektori privat dhe jo ai publik-shtetëror. Mbase, vetëm në këtë formë Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i Republikës së Maqedonisë do të siguron mjete financiare që do të ndikojnë pozitivisht në rritjen e të ardhurave burimore të tij.

Kurse, tek punësimet e reja në sektorin privat është me rëndësi të analizohet struktura e pagave prej ku Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i siguron të ardhurat burimore. Nëse bazohemi në të dhënat e Entit shtetëror statistikor paga mesatare mujore në Maqedoni për vitin 2017 ka qenë 23.850,00 denarë apo rreth 388 Euro, që do të thotë se Maqedonia ka pagën mesatare tre herë më të vogël se paga mesatare e Sllovenisë (1062 Euro) dhe dy herë më të vogël se të Kroacisë (835 Euro). Pra, edhe pse numrat janë argumenti më i fortë jo gjithnjë janë në anën e Fondit, pasi që niveli i ulët i pagave gjeneron të ardhura të ulta dhe të pamjaftueshme për financimin e shpenzimeve të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor, edhe pse në rastin tonë konkret duhet analizuar më thellësisht se kush bëri rritjen e pagave në vend (sektori privat apo ai publik). Qeveria e Republikës së Maqedonisë para disa viteve bëri rritjen e pagave të administratës shtetërore, por e njëjta gjë nuk ndodhi në sektorin privat...?!

Përpos dinamikës së normës së punësimit dhe papunësisë për periudhën 2004 - 2017, në vijim sjellim parashikimet aktuale për normën e punësimit dhe të papunësisë deri në vitin 2050, duke marrë për bazë vitin 2012.

Tabela 70: Parashikimet për normën e punësimit dhe papunësisë për periudhën 2013-2055

Skenarët	Skenari optimist		Skenari pesimist	
Vitet	Të punësuar	Të pa punësuar	Të punësuar	Të pa punësuar
2013	39.3	29.8	39.3	29.8
2015	39.9	29.2	39.6	30.0
2020	40.4	28.0	39.8	29.7
2025	41.0	27.4	40.1	29.5
2030	41.7	26.7	40.3	30.4
2035	42.4	26.0	40.7	30.2
2040	43.0	25.0	41.0	29.5
2045	44.5	23.4	41.4	28.9
2050	45.0	22.0	42.0	28.7
2055	46.4	21.6	42.6	28.3

Burimi: nga parashikimet aktuale të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor

Realizimi i parashikimeve të skenarit pesimist do të ishte shumë i pafavorshëm për Fondin për sigurim pensional dhe invalidor, pasi që në njërin anë shpenzimet vazhdimisht do të rriteshin për shkak të lëvizjeve të padëshirueshme demografike, kurse në anën tjetër të ardhurat do të ishin pothuajse në nivelin e njëjtë si rezultat i ndryshimeve të vogla në lëvizjen e përgjithshme të tregut të punës. Megjithatë pas vitit 2030 pagesa e pensioneve do të

kombinohet nga shtylla e parë dhe e dytë, prap se prap presioni i Fondit do të jetë i madh dhe mjetet e nevojshme për pagesën e pensioneve do të duhet të plotësohen përsëri nga buxheti shtetëror i Republikës së Maqedonisë (pasiguri në pagesën e pensioneve).

Mirëpo, nëse realizohen parashikimet e skenarit optimist (rritje e konsiderueshme në numrin e të punësuarëve), performanca financiare e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor do të përmirësohej. Po ashtu, papunësia në të njëjtën kohë nga 29.8% do të zvogëlohej deri në 21.6% në vitin 2055, e nëse kjo rritje i shtohet Prodhimit të Brendshëm Bruto ndjeshëm do të rriste të ardhurat e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor, që do të thotë se rritja e numrit të të siguruarve dhe e zvogëlimit të papunësuarëve do të ndikonte dukshëm në performancën e përgjithshme financiare të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor të Republikës së Maqedonisë.

Për t'u realizuar skenari optimist Agjencioni për punësim duhet në mënyrë permanente ta luftoj fenomenin e papunësisë përmes ndërmarrjes së aktiviteteve dhe masave për nxitjen e punësimit. Kjo e fundit, mund të arrihet përmes promovimit të programeve për rritjen e punësimit, sikurse (Јаќимовски et al. , 2013):

- promovimi i investimeve intensive në infrastrukturën ekonomike dhe sociale;
- inkorporimi i risive teknologjike me potencial stimulim punësimin;
- sigurimi i kushteve për realizimin e programeve për rikualifikim dhe trajnim personal të vendeve të punës;
- mbështetje e politikës së mobilizimit të kursimeve dhe dhënia e kredive për projekte produktive;
- tejkalimi i pengesave me të cilat përballen ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe mbështetje e iniciativës së tyre;
- promovimi i arsimit të mesëm të përgjithshëm dhe krijimi i kushteve për lëvizje profesionale vertikale;
- përforcimi i informimit të tregut të punës me ofrimin e të dhënave për punësimin, papunësinë dhe të ardhurat;
- ofrimi i ndihmës gjatë punësimit dhe këshillim gjatë fazes së kërkimit punë, trajnime, shkëmbime informacionesh, sigurim social dhe të drejta tjera të parashikuara me ligj;
- krijimi i një politike fleksibile për punësim;
- hartimi i strategjisë kombëtare për reduktimin e papunësisë;
- formulimi dhe zbatimi i programeve për rritjen e qasjes së grave në shërbimet financiare, teknike dhe teknologjike me qëllim të rritjes së të ardhurave dhe përmirësimit të standardit jetësor, etj.

Megjithkëtë, duhet domosdoshmërisht të implementohet edhe strategjia kombëtare për punësim konform principeve dhe qëllimeve të: programit kombëtar për reforma ekonomike 2015, strategjisë fiskale 2015-2017, Evropa 2020 dhe strategjia 2020 për Evropën Juglindore. Qëllimi kryesorë i strategjisë në fjalë është: „**Rritja e punësimit, cilësia e rritjes së punësimit, cilësia e punës dhe produktiviteti, me theks të veçantë në grupet e cënueshme të popullsisë**“, që mund të arrihet përmes qëllimeve më të specifikuara, sikurse (Национална Стратегија за Вработување на Република на Македонија 2016 - 2020, 2015):

1. rritjes së efektivitetit dhe efikasitetit të politikave për punësim me mbështetje të veçantë për kategoritë e rrezikuara të popullsisë;
2. përmirësimit të kapacitetit të sektorit privat për krijimin e vendeve të punës;
3. prodhimit të shkathësive dhe njohurive, apo arsimimit të kuadrove sipas nevojave të punëdhënësve.

Pra, papunësia si tregues ekonomik është një indikator mjaft i rëndësishëm për projektimin e qëndrueshmërisë financiare të Fondit për sigurime pensional dhe invalidor, e për këtë arsye gjatë shpalljes së shifrave për numrin e të punësuarëve në Entin statistikor shtetëror është shumë e rëndësishme të verifikohet sa këto punësime janë të vërteta dhe nga kush është bërë punësimi (sektori privat apo publik), sepse nëse kjo e fundit do të ishte e vërtetë atëherë Republika e Maqedonisë që moti do e kishte arritur objektivin kombëtar dhe të Bashkimit Evropian, e me këtë uljen e deficitit fiskal dhe të pjesëmarrjes së buxhetit në të ardhurat e përgjithshme të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor të Republikës së Maqedonisë.

V.2.4. Rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto

Rikonstruimi i sistemit pensional në Republikën e Maqedonisë, përkatësisht inkorporimi i sigurimit pensional të detyrueshëm me financim kapital dhe i sigurimit vullnetar në bazë të kursimit të kapitalizuar individual synonte krijimin e një sistemi pensional me aftësi paguese afatgjate përmes bartjes së detyrimeve të shtyllës së parë në kuriz të shtyllës së dytë, duke zvogëluar në këtë mënyrë shpenzimet publike për pagësën e pensioneve. Kjo e fundit, sipas projeksioneve të Bankës Botërore mund të arihej nëse dhe vetëm nëse:

- rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto arrin në nivelin e 3%-shit, që do të thotë se me këtë rritje të ekonomisë pas 20 viteve deficieti do të ulej me një shpejtësi të madhe dhe bilanci i Fondit për sigurim pensional dhe invalidor do të kalonte në suficit;
- rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto arrin deri në 4.5%, pra Republika e Maqedonisë shumë më lehtë do të arrinte në konsolidimin e sistemit pensional dhe strukturimin e tij financiar për të përmbushur detyrimet ndaj pensionistëve dhe për të ulur pjesëmarrjen e buxhetit shtetëror.

Megjithatë, jo gjithmonë projeksionet pasqyrojnë fotografinë e vërtetë dhe jo çdo herë realizohen, siç ndodhi me rastin e Republikës së Maqedonisë që nuk arriti t'i përmbush projeksionet e Bankës Botërore në drejtim të uljes së deficitit financiar. Ky deficit nuk arriti të ullej si rezultat i mos zhvillimit të mjaftueshëm të ekonomisë pas periudhës së pavarësisë (prej 2% në 3%) dhe si pasojë e privatizimit të kompanive shtetërore që nuk rezultuan me rezultatet e pritura dhe nuk e lëvizën ekonominë drejt zhvillimit të saj, ngase vetëm një pjesë e vogël e kompanive të privatizuara vazhduan të funksionojnë. Duke u nisur nga kjo, në vijim sjellim trendin e Prodhimit të Brendshëm Bruto, përfshirë Prodhimin e Brendshëm Bruto në çmimet korrente, për kokë banori dhe normën reale të rritjes së Prodhimit të Brendshëm Bruto për periudhën 1998 - 2017.

Tabela 71: Lëvizja e Prodhimit të Brendshëm Bruto për periudhën 1998-2017

Vitet	PBB në çmimet korrente (në milion denarë)	PBB për kokë banori (në euro) (sipas kursit aktual)	PBB në milion euro (sipas kursit aktual)	Norma e rritjes reale të PBB-së
1998	194.979	1.590	3.193	3.4%
1999	209.010	1.709	3.448	4.3%
2000	236.389	1.921	3.893	4.5%
2001	233.841	1.887	3.839	-4.5%
2002	243.970	1.981	4.001	0.9%
2003	268.694	2.164	4.386	2.2%
2004	280.786	2.252	4.578	4.7%
2005	308.447	2.470	5.032	4.7%
2006	334.840	2.682	5.472	5.1%
2007	372.889	2.982	6.095	6.5%
2008	414.890	3.308	6.772	5.5%
2009	414.622	3.300	6.767	-0.4%
2010	437.296	3.459	7.109	3.4%
2011	464.186	3.665	7.544	2.3%
2012	466.703	3.680	7.585	-0.5%
2013	501.891	3.948	8.150	2.9%
2014	527.631	4.141	8.562	3.6%
2015	558.954	4.382	9.072	3.9%
2016	594.795	4.659	9.657	2.8%
2017	616.600	4.827	10.014	0,2%

Burimi: nga Enti shtetëror statistikor i Republikës së Maqedonisë

Të dhënat e prezantuara në tabelën mësipër sa i përket dinamikës së rritjes së Prodhimit të Brendshëm Bruto, rezultojnë me atë se:

- kriza e vitit 2001 e dëmtoi strukturën e përgjithshme të rritjes së Prodhimit të Brendshëm Bruto pas periudhës së pavarësisë, ashtu që rritja prej -4.5% në vitin 2001, 0.9% në vitin 2002 dhe 2.2% në vitin 2003 ndikuan negativisht në ekonominë kombëtare, e me këtë edhe në sistemin pensional të Republikës së Maqedonisë;
- rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto nga viti 2004 deri në vitin 2008 kishte për qëllim përmirësimin e ecures ekonomike të ekonomisë kombëtare me implikimin e zhvillimit të ekonomisë;

- kriza globale financiare në vitin 2009 ndikoi edhe një herë negativisht në rritjen dhe zhvillimin e ekonomisë në nivel botëror dhe në nivel kombëtar;
- pas krizës financiare të vitit 2009 Republika e Maqedonisë e humbi vazhdimësinë e rritjes së Prodhimit të Brendshëm Bruto, andaj edhe normat e rritjes u zvogëluan për 2% deri në 3% duke arritur në vitin 2012 deri në -0.5%;
- pas vitit 2012 e këndeje, norma e rritjes së Prodhimit të Brendshëm Bruto fillon të lëviz pozitivisht deri në 2.9% në vitin 2013 për të vijuar me një stabilitet për 3 vite rishtazi dhe për ta përmbyllur vitin 2017 me një ulje prej 2.6%.

Përpos lëvizjes së Prodhimit të Brendshëm Bruto, në vijim sjellim edhe pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto për periudhën 1990 - 2017:

Tabela 72: Pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto për periudhën 1990-2017

Vitet	Gjithsej shpenzimet pensionale (në milion denarë)	PBB në milion denarë	Pjesëmarrja e shpenzimeve pensionale ne PBB
1990	60.87	506	12.0%
1991	104	920	11.3%
1992	1.337	11.794	11.3%
1993	9.412	59.165	15.9%
1994	18.445	146.409	12.6%
1995	18.296	169.521	10.8%
1996	18.925	176.444	10.7%
1997	19.504	186.018	10.5%
1998	20.533	194.979	10.5%
1999	20.681	209.010	9.9%
2000	22.942	236.389	9.7%
2001	24.697	233.841	10.6%
2002	25.889	243.970	10.6%
2003	27.764	253.493	11.0%
2004	29.117	258.751	11.3%
2005	29.029	276.989	10.5%
2006	31.207	298.140	10.5%
2007	32.770	333.845	9.8%
2008	38.733	405.014	9.6%
2009	41.393	396.496	10.4%
2010	42.507	425.628	10.0%
2011	44.306	455.387	9.7%
2012	46.227	476.072	9.7%
2013	50.854	474.196	10.7%
2014	54.017	518.380	10.4%
2015	56.789	552.286	10.3%
2016	61.488	579.646	10.6%
2017	65.149	630.859	10.3%

Burimi: nga raporti për punën e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor i Republikës së Maqedonisë, 2017

Sipas të dhënave të përpunuara nga Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i Republikës së Maqedonisë, konstatohet se:

- pjesëmarrja më e madhe e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto, shënohet nga viti 1990 deri në 1993 prej 12% deri në 15.9%;
- nga viti 1994 pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve fillon të zvogëlohet gradualisht duke arritur deri në 9.7% në vitin 2000;
- nga viti 2001 deri në vitin 2017 pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto lëviz nën margjinat e 10%-shit.

Kurse, sa i përket parashikimeve aktuale në lidhje me rritjen reale të Prodhimit të Brendshëm Bruto për periudhën 2013 - 2055 shërbehuni me tabelën vijuese:

Tabela 73: Parashikimet për lëvizjen e normës reale të Prodhimit të Brendshëm Bruto për periudhën 2013-2055

Vitet	Skenari optimist	Skenari pesimist
2013	3.10%	3.10%
2015	3.40%	2.90%
2020	4.10%	2.70%
2025	4.44%	3.30%
2030	5.20%	2.30%
2035	5.80%	2.10%
2040	6.10%	2.00%
2045	5.40%	2.40%
2050	5.00%	1.80%
2055	5.20%	1.50%

Burimi: nga parashikimet aktuale të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor për rritjen reale të Prodhimit të Brendshëm Bruto

Siç mund të vërejmë nga tabela mësipër, realizimi i skenarit optimist nënkupton zhvillimin e vazhdueshëm të ekonomisë përmes rritjes së Prodhimit të Brendshëm Bruto. Kjo rritje e Prodhimit të Brendshëm Bruto do të ndikojë në rritjen e numrit të të punësuarëve, apo të të siguruarve duke kontribuar në gjenerimin e të ardhurave dhe në përmirësimin e performancës financiare të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor. Kurse, realizimi i skenarit pesimist do të thotë rritje më e vogël e Prodhimit të Brendshëm Bruto, e pamjaftueshme për tejkalimin e vështirësive financiare për shkak të mos gjenerimit të vendeve të reja të punës, respektivisht mos rritjen e numrit të të siguruarve.

Pra, në varësi të lëvizjes së normës së punësimit, pagave, kostës së jetesës dhe Prodhimit të Brendshëm Bruto, varet rritja apo ulja e të ardhurave burimore të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor. Prandaj, çdo rritje në Prodhimin e Brendshëm Bruto nënkupton rritje të punësimit dhe të pagave të punonjësve, rrjedhimisht një bazë më të madhe për llogaritjen e kontributeve për sigurim pensional dhe invalidor, e me këtë edhe të ardhura më të larta për Fondin për sigurim pensional dhe invalidor të Republikës së Maqedonisë.

V. 3. Aspekti Financiar

Konsolidimi dhe qëndrueshmëria financiare e sistemit pensional ka të bëjë me rruajtjen e aftësisë paguese dhe sigurinë e sistemit pensional në një mjedis të karakterizuar nga një raport vazhdimisht rënës të treguesëve demografik dhe ekonomik. Nëse i rikthehemi tranzicionit të hershëm konstatojmë se, numri i pensionistëve arrinte nga 30 deri në 35 në çdo njëqind të punësuar, kurse shpenzimet pensionale të shprehura si përqindje në Prodhimin e Brendshëm Bruto arrinin mesatarisht deri në 5.6% në vendet baltike (Letoni, Lituani, Estoni) dhe 7.6% në vendet e CEFTA-s (Shoqata për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore ku njëkohësisht edhe Maqedonia është anëtare e saj). Mirëpo, zvogëlimi i menjëhershëm i Prodhimit dhe punësimit (20% - 50% nën nivelin e vitit 1989) çoi në ndryshime të mëdha në raport me Prodhimin e Brendshëm Bruto, pra vendet anëtare të CEFTA-s, nivelin e Prodhimit të Brendshëm Bruto të vitit 1989 e arritën pothuajse në vitin 1997, kurse vendet baltike në vitin 2000 (Pensions at a Glance 2013: OECD and G20 Indicators, 2013)

Për rrjedhojë, në vitin 1995 numri i të punësuarëve dukshëm u zvogëlua duke arritur deri në 12.5% në vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore, edhe pse nuk paraqet një tregues relevant përderisa nuk përfshin punësimin e fshehtë apo me orar të pjesshëm dhe për të cilin nuk është lidhur kontratë pune. Ky tregues është mjaft prezent dhe me një relevancë të theksuar në sferën ekonomike dhe sociale, andaj krijon edhe nevojën për parashtrimin e pyetjes, sikurse: cilët do të ishin pasojat ekonomike dhe sociale nga zvogëlimi i punësimit?

Si gjithnjë, nga perspektiva ekonomike dhe sociale zvogëlimi i punësimit shkakton vështirësi për të punësuarit, e që në rastin tonë konkret goditet më së shumti sistemi pensional, ngase në njërën anë pagesat e kontributeve për pensione shënojnë vazhdimisht rënie, kurse në anën tjetër pagesat e pensioneve shënojnë vazhdimisht rritje. Kjo e fundit, mundëson krijimin e hendekut financiar që pritet të rritet edhe më shumë si rezultat i shkarkimit të punëtorëve nga puna dhe angazhimit të tyre në sektorin jo formal, apo jashtë kornizave të organeve për pagesë të kontributeve sociale.

Pra, duke bërë një përshkrim të situatës financiare në kontekst më të gjerë dhe duke marrë për bazë shkaqet e përkeqesimit të gjendjes financiare të sistemeve pensionale të vendeve Baltike dhe atyre të Evropës Qendrore dhe Juglindore, e njëkohësisht duke u mbështetur në praktikën e tyre, në vijim do të përqendrohemi në përshkrimin e gjendjes financiare momentale të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor të Republikës së Maqedonisë.

V.3.1. Shpenzimet e tranzicionit

Transformimi i sistemit pensional në sistem me më shumë shtylla shkaktoi rritjen e shpenzimeve të tranzicionit që shteti mori përsipër financimin e tyre përgjatë 50 viteve të ardhshme. Këto shpenzime u rritën në përmasa të mëdha, përkatësisht në vitin 2006 arritën deri në 21 milion euro, në vitin 2007 në 30 milion euro, në vitin 2008 në 40 milion euro, në vitin 2009 në 47 milion euro, në vitin 2010 në 52 milion euro dhe në vitin 2012 në 58 milion euro. Kurse, sa i përket vijueshmërisë së shpenzimeve të tranzicionit nga viti 2012 e këndej, përfshirë edhe parashikimet aktuale të tyre deri në vitin 2075, sjellim tabelën vijuese (FYR Macedonia Public Expenditure Review Fiscal Policy for Growth, 2015):

Tabela 74: Parashikimet e shpenzimeve të tranzicionit për periudhën 2013-2075

Skenarët	Në raport me PBB			Në milion denarë (vlera aktuale)			Në milion euro (vlera aktuale)		
Vitet	Optimiste	Bazike	Pesimiste	Optimiste	Bazike	Pesimiste	Optimiste	Bazike	Pesimiste
2013	0,835%	0,835	0,835	4.300	4.325	4.349	69,918	70,325	70,715
2014	0,898%	0,898%	0,898%	4.753	4.818	4.872	77,283	78,339	79,218
2015	0,960%	0,961%	0,961%	5.443	5.549	5.621	88,503	90,221	91,393
2016	1,023%	1,024%	1,024%	6.126	6.286	6.357	99,609	102,213	103,371
2017	1,085%	1,086%	1,086%	6.837	7.083	7.155	111,163	115,178	116,344
2018	1,145%	1,146%	1,147%	7.588	7.938	8.012	123,389	129,066	130,273
2019	1,203%	1,204%	1,207%	8.381	8.849	8.929	136,277	143,885	145,184
2020	1,259%	1,261%	1,262%	9.216	9.745	9.864	149,859	158,456	160,390
2025	1,396%	1,398%	1,400%	11.371	11.952	12.239	184,897	194,334	199,015
2030	1,530%	1,533%	1,537%	14.026	14.897	15.546	228,064	242,223	252,784
2035	1,473%	1,445%	1,454%	14.491	15.802	16.929	235,633	256,938	275,275
2040	1,093%	1,116%	1,143%	12.093	13.737	15.538	196,635	223,363	249,718
2045	0,505%	0,563%	0,629%	5.998	7.640	9.358	97,959	124,230	155,829
2050	0,072%	0,113%	0,159%	920	1.676	2.687	14,959	27,245	43,691
2055	0,000%	0,000%	0,000%	0	0	0	0,000	0,000	0,000
2060	0,000%	0,000%	0,000%	0	0	0	0,000	0,000	0,000
2065	0,000%	0,000%	0,000%	0	0	0	0,000	0,000	0,000
2070	0,000%	0,000%	0,000%	0	0	0	0,000	0,000	0,000
2075	0,000%	0,000%	0,000%	0	0	0	0,000	0,000	0,000

Burimi: nga raporti aktuar, 2013

Siç mund të vërehet nga tabela mësipër, shpenzimet e tranzicionit janë të karakterit të përkohshëm dhe që me kalimin e kohës do të përfundojnë. Ato filluan në vitin e parë të reformës pensionale dhe gradualisht vazhdojnë të rriten saqë në vitin 2020 pritet të arrijnë nivelin e 1.29% të Prodhimit të Brendshëm Bruto, maksimumin prej 1.56% të Prodhimit të Brendshëm Bruto do e arrijnë në vitin 2030 dhe do të përfundojnë në vitin 2045 me forcimin e shtyllës së dytë duke zvogëluar në këtë mënyrë barrën financiare të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor.

Sidoqoftë, shpenzimet e tranzicionit ndikohen më shumë nga parametrat demografik sesa nga ato ekonomik, prandaj në skenarin optimist kanë vlerë më të lartë sesa në skenarin pesimist. E gjithë kjo, për shkak se parametrat ekonomik janë me rezultate më të mira në skenarin optimist, përkatësisht Prodhimi i Brendshëm Bruto dhe rritja e pagave janë në nivel më të lartë, që nënkupton se kapaciteti i financimit të shpenzimeve të tranzicionit është më i lartë se në skenarin pesimist. Andaj, duke u mbështetur në vijueshmërinë e shpenzimeve të tranzicionit dhe njëkohësisht në rritjen marramendëse të tyre prej 5 deri në 10 milion euro për çdo vit, shtrohet pyetja tjetër e radhës që përkon me situatën në fjalë, sikurse: si arrinë Fondi për sigurim pensional dhe invalidor ta përballon këtë ngarkesë shpenzimesh pensionale?!

Financiarisht, kjo ngarkesë paraqet një gjendje kritike për Fondin për sigurim pensional dhe invalidor, sepse për mbulimin e këtyre shpenzimeve duhen të ardhura shtesë që Fondi nuk mundet t'i siguroj, ngase parametrat mbi të cilat mbështeten reformat pensionale janë të goditura nga disa shkaqe, sikurse: ulja e kontributeve, kullimi i tyre në shtyllën e dytë, pensionistët e rinj, etj. Andaj, se si kanë ndikuar këto parametra në përkeqësimin e gjendjes financiare dhe krijimin e nevojës për konsolidimin e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor, e sjellim në mënyrë të veçantë secilin parametër në pjesët vijuese të kapitullit në fjalë.

V.3.2. Ndryshimi i normës së kontributeve (ulja e saj)

Ulja e kontributeve paraqet një ngarkesë financiare të lartë dhe një situatë të palakmueshme më të cilën Fondi për sigurim pensional dhe invalidor ballafaqohet për çdo vit. Me sjelljen e vendimit të qeverisë më 01.01.2009 kontributet u zvogëluan nga 21.2% në 19%, më saktë 10% reduktim në kontributet për sigurim pensional. Po ashtu, në vitin 2010 pasoi reduktimi për 1% për kontributet shtesë, apo ulje në 18% që sipas bazës 21.2% përfaqëson zvogëlim për 15% të kontributeve për sigurim pensional, ose reduktim të të ardhurave për 15% në kushte ku faktorët tjerë mbeten të pandryshuar (Ligji për sigurim pensional dhe invalidor i Republikës së Maqedonisë).

Andaj, duke marrë për bazë vendimin e qeverisë së Republikës së Maqedonisë për ndryshimin e normës së kontributeve, në vijim sjellim dëmtimin financiar që iu shkaktua Fondit për sigurim pensional dhe invalidor si rezultati i uljes së normës së kontributeve nga 21.2% në 18%, apo ulje të të ardhurave burimore për 15%.

Tabela 75: Humbjet financiare si rezultat i ndryshimit të normës së kontributeve për periudhën 2008-2017

Vitet	% e kontributeve	% e uljes se kontributeve	Të ardhurat burimore	Të ardhurat nga mos ndryshimi i normës	Humbjet si rezultat i ndryshimit të normës (në milion denarë)	Humbjet si rezultat i ndryshimit të normës (në euro)
2008	21.2	-	26.355,49	26.355,49	-	-
2009	19	10.37	26.536,02	29.287,80	2.751,78	44.744,39
2010	18	15.09	26.301,39	30.270,26	3.968,87	64.534,47
2011	18	15.09	27.012,55	31.088,74	4.076,19	66.279,51
2012	18	15.09	27.744,05	31.930,62	4.186,57	68.074,31
2013	18	15.09	28.706,74	33.038,58	4.331,84	70.436,42
2014	18	15.09	29.907,64	34.420,70	4.513,06	73.383,09
2015	18	15.09	32.236,20	37.100,64	4.864,44	79.096,59
2016	18	15.09	32.488,86	37.391,42	4.902,56	79.716,42
2017	18	15.09	34.251,87	39.420,47	5.168,60	84.042,27
Total					28.692,75	630.307,47
<i>Burimi: kalkulim personal i bazuar në të dhënat e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor</i>						

Tabela mësipërm na ndihmon të krijojmë një ide mbi gjendjen financiare aktuale të sistemit pensional të Republikës së Maqedonisë, respektivisht na ofron një pasqyrë më të qartë në lidhje me humbjen financiare që ju shkaktua Fondit për sigurim pensional dhe invalidor nga reduktimi për 3.2% në vlerë absolute, rrjedhimisht 630.307,47 milion euro më pak - mjete këto, që duhej të hynin në Fond nëse kontributet do të ishin në kufirin 21.2%. Ndonëse për Fondin për sigurim pensional dhe invalidor këto mjete konsiderohen si humbje, megjithatë për subjektet ekonomike konsiderohen si ndihmesë apo lehtësim, nëse dhe vetëm nëse këto mjete janë të orientuara për qëllime produktive (qëllimet produktive më tej ndikojnë në rritjen ekonomike - përfitim dy anësorë).

Pra, nga këndvështrimi i sistemit pensional kjo situatë konsiderohet si shok, ngase mbulimi i këtyre mjeteve të humbura u bë nga burimet tjera - anësore, parasegjithash nga buxheti i Republikës së Maqedonisë. E nëse do merreshin në konsideratë projeksionet e Bankës Botërore që parashikojnë një rritje të vazhdueshme të ekonomisë (mesatarisht deri në 5% në vit) atëherë Fondi për sigurim pensional dhe invalidor nuk do të ballafaqohej me vështirësi financiare, gjegjësisht periudha e reformave pensionale do të përfundonte me saldo financiare pozitive. Mirëpo, në njërin anë rezultatet e ulëta nga rritja ekonomike dhe në anën tjetër kriza financiare pas pavarësimit dhe kriza e vitit 2008, sollën sistemin pensional të Republikës së Maqedonisë në gjendjen aktuale - në varësi të plotë nga buxheti shtetërorë.

Pra, qeveria e Republikës së Maqedonisë reduktoi normat e kontributit disa herë vetëm e vetëm që të shkurtoj kostot e punës dhe të përmirësoj konkurrencën e punës. Kjo e fundit rezultoi me uljen e të ardhurave nga kontributet deri në 1.15 % të Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe kontribuoi në zgjerimin e deficitit të përgjithshëm deri në 3.7 % të Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe njëkohësisht nuk ndikoi përpjestimisht në rritjen e investimeve dhe

punësueshmërisë, siç ishte projektuar. (Raporti aktuar për vitin 2011)⁴⁵. Po ashtu, Maqedonia së bashku me Kosovën dhe Kazakistanin karakterizohen me normën më të ulët, sa i përket kontributit për sigurim pensional dhe invalidor (Report on the Publicly Funded Pension Scheme in Macedonia, 2011)

V.3.3. Kullimi (përfundimi) i kontributeve në shtyllën e dytë

Kullimi i kontributeve apo përfundimi i tyre në shtyllën për sigurim pensional të detyrueshëm me financim kapital, paraqet parametrin e dytë mbi bazë të së cilës është krijuar situata aktuale financiare e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor. Pra, pas konvertimit në 6.3% të normës së përgjithshme të kontributeve për sigurim pensional dhe invalidor në shtyllën e parë mbeten vetëm 11.7% e të ardhurave nga kontributet, që njëherit përfaqësojnë të ardhurat e përgjithshme të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor, e që së bashku me shtyllën e dytë duhet të shërbejnë për mbulimin e shpenzimeve për pagesën e pensioneve.

V.3.4. Pensionistët e rinj

Penzionistët e rinj paraqesin segmentin e fundit që ndikojnë në përkeqësimin e gjendjes financiare të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor. Pra, penzionistët e rinj apo personat që dalin parakohe në pension përfaqësojnë njerëzit të cilët mund të punojnë, por pa marrë parasysh arsyen dhe mënyrën arrijnë të marrin pension, e më këtë ta ngarkojnë financiarisht edhe më tepër Fondin për sigurim pensional dhe invalidor të Republikës së Maqedonisë.

V.3.5. Lëvizja e përgjithshme e të ardhurave të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor në Republikën Maqedonisë

Gjatë përshkrimit financiar të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor një rol të rëndësishëm zënë edhe lëvizja e të ardhurave dhe shpenzimeve të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor. Andaj, se si kanë lëvizur të ardhurat e përgjithshme pensionale për periudhën 1994 - 2017, shërbehuni me tabelën vijuese:

Tabela 76: Lëvizja e përgjithshme e të ardhurave për periudhën 1994-2017 (në milion denarë)

Vitet	Burimet e te ardhurave ⁴⁶	Agjen. për punësim	Buxheti	Akczat	Të ardhura tjera	Dividenta	Shitja e aksioneve	Gjithsej	% e buxh. tek t'ardhurat e përgjithshme
1994	13.634,70	-	2.944,61	835,15	79,82	-	-	17.494,28	16.83%
1995	14.286,81	-	2.830,00	857,50	36,56	-	-	18.010,87	15.71%
1996	14.180,21	-	3.289,00	778,87	31,46	47,18	-	18.326,72	17.94%
1997	14.551,83	-	3.516,00	731,02	32,02	48,38	-	18.879,25	18.62%

⁴⁵ Norma e kontributit për shtyllën e dytë gjatë periudhës 2009 - 2010 u reduktua nga 6.7% në 6%.

⁴⁶ Deri në vitin 2005 në grupin e burimeve të të ardhurave janë përfshirë edhe të ardhurat nga Agjencioni për punësim.

1998	15.468,00	-	3.618,57	693,86	120,87	49,94	569,84	20.520,72	17.63%
1999	16.843,09	-	3.266,07	633,24	43,05	68,68	177,52	21.031,65	15.52%
2000	17.762,43	-	4.174,42	802,07	88,22	53,86	15,55	22.896,55	18.23%
2001	17.546,45	-	5.744,48	716,09	75,58	39,44	167,54	24.289,58	23.64%
2002	17.939,26	-	6.960,91	687,83	29,20	19,68	172,51	25.809,39	26.97%
2003	19.187,97	-	7.740,95	677,04	80,13	20,98	20,63	27.727,70	27.91%
2004	19.752,87	-	8.486,44	660,97	56,09	20,60	50,91	29.027,88	29.23%
2005	19.888,97	-	8.255,08	659,14	62,74	18,13	27,65	28.911,71	28.55%
2006	19.948,52	1.219,77	9.370,85	661	223,75	22,75	962,6	32.409,24	28.91%
2007	21.914,23	864,98	10.378,52	681,04	151,89	5,88	56,71	34.053,25	30.47%
2008	25.581,91	773,58	10.181,99	717,4	247,71	21,48	97,63	37.621,70	27.06%
2009	26.279,53	256,49	14.020,85	744,49	194,11	19,41	74,64	41.589,52	33.71%
2010	26.137,49	163,9	14.218,12	787,57	112,17	10	40,78	41.470,03	34.28%
2011	26.890,36	122,19	15.704,97	813,77	122,23	7,22	276,35	43.937,09	35.74%
2012	27.659,80	84,25	17.503,34	851,03	149,65	3,44	119,12	46.370,63	37.74%
2013	28.655,98	50,76	21.060,83	870,16	142,69	2,25	287,56	51.070,23	41.23%
2014	29.876,77	30,87	22.677,71	892,39	290,74	0,66	11,54	53.780,68	42.16%
2015	32.214,89	21,22	23.860,89	1.016,11	125,70	0,09	15,52	57.254,51	41.67%
2016	33.819,77	14,22	26.599,48	1.120,71	109,79	0,21	20,78	61.684,96	43.12%
2017	35.606,13	7,77	28.457,04	1.154,21	91,79	3,04	0,00	65.319,98	43.56%

Burimi: nga raporti për punën e Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor i Republikës së Maqedonisë për vitin 2017

Sipas raportit për punën e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor të Republikës së Maqedonisë në lidhje me lëvizjen e të ardhurave të përgjithshme për periudhën 1994 - 2017, konstatojmë se:

- nga viti 1994 - 2017 të ardhurat burimore (nga pagat, stazhi i sigurimit me kohëzgjatje të shtuar, nga bujqit individual, personat fizik të cilët në mënyrë të pavarur kryejnë veprimtari dhe nga Agjencionii punësimit) janë rritur për 61.8% si rrjedhojë e rritjes së numrit të të siguruarve;
- nga viti 2006 e kënde, mjetet nga Agjencioni për punësim reduktohen për çdo vit, si rezultat i zvogëlimit të numrit të personave për të cilët paguhet kontribut, gjegjësisht ndryshimit të dispozitave ligjore që të paguhet kontribut vetëm për personat të cilët nuk posedojnë 15 vite përvojë pune;
- nga viti 1994 - 2017 të ardhurat nga buxheti janë rritur për 89.7% dedikuar për obligimet ligjore (përfituesit e pensioneve bujqësore, ushtarake, pagesën e dallimeve si rezultat i harmonizimit prej 8% nga periudha e kaluar), shpenzimet transitive, mbulimin e deficitit rrjedhës, financimin e shpenzimeve të rrugës për në banjë, etj;
- nga viti 1994 deri në vitin 2017 të ardhurat nga akcizat janë rritur për 27.7%;
- nga viti 1994 - 2017 të ardhurat tjera janë rritur për 13.2%, edhe atë pjesërisht nga qiratë, nga kompensimet e dëmeve dhe fondeve pensionale duke mos anashkaluar edhe të ardhurat nga interesi për pagesën e vonuar të kontributeve për sigurim pensional dhe invalidor, etj;
- të ardhurat nga dividenda janë zvogëluar për 93.7%;

- të ardhurat nga shitja e aksioneve në vitin 2017 arrijnë në nivelin zero, si rrjedhojë e jo-atraktivitetit të aksioneve dhe pjesëve tjera të mbetura për shitje;
- gjithsej të ardhurat e përgjithshme janë rritur për 73.3%, si dhe;
- pjesëmarrja e buxhetit në të ardhurat e përgjithshme nga viti 1994 prej 16.38% është rritur deri në 43.56% në vitin 2017, apo rritje për 27.18%.

Pra, me mjetet e realizuara nga kontributet, buxheti shtetëror, shitja e aksioneve, akcizat, dividendat dhe nga të ardhurat tjera jotatimore, Fondi për sigurim pensional dhe invalidor për vitin 2017 realizoi gjithsej të ardhura prej 65.319,98 milion denarë. Këto të fundit në raport me mjetet e planifikuara me buxhetin e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor, arrijnë 100.22%, ndërsa në krahasim me vitin 2016 janë rritur për 5.89% si rezultat i shumës së rritur të mjeteve të transferuara për mbulimin e deficitit rrjedhës.

V.3.6. Lëvizja e përgjithshme e shpenzimeve të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor në Republikën Maqedonisë

Përpos lëvizjes së të ardhurave të përgjithshme të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor, në përshkrimin e situatës financiare një rol të rëndësishëm shënojnë edhe shpenzimet e përgjithshme pensionale. Sipas buxhtit të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor për vitin 2017 në pjesën e shpenzimeve pensionale në mbështetjen e indikatorëve makroekonomik, ishte paraparë pagesë e rregullt e pensioneve së bashku me harmonizimin e realizuar më 1 janar dhe 1 korrik të vitit 2017, si dhe rritjen e përfituesit pensional për 1.81% në nivel vjetor. Po ashtu, kur jemi tek pjesa e shpenzimeve pensionale sipas raportit për punën e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor, si rezultat i rritjes së numrit të përfituesve të pensionit dhe harmonizimit të zbatuar të pensioneve edhe shpenzimet pensionale të përgjithshme për vitin 2017 shënuan rritje. Andaj, se si kanë lëvizur shpenzimet e përgjithshme pensionale për periudhën 1994-2017, sjellim tabelën vijuese:

Tabela 77: Lëvizja e përgjithshme e shpenzimeve pensionale për periudhën 1994-2015 (në milion denarë)

Vitet	Pensionet	Kompensimet nga sigurimi invalidor	Kontributet nga shëndetësia	Shërbimi profesional ⁴⁷	Shpenzime tjera kapitale	Shpenzime të tranzicionit ⁴⁸	Gjithsej
1994	15.404,40	391,66	2.102,03	-	427,72	-	18.444,58
1995	15.684,34	204,11	2.082,07	-	198,97	-	18.295,69
1996	16.223,17	185,26	2.217,54	-	170,61	-	18.925,01
1997	16.694,20	179,22	2.292,43	-	209,89	-	19.504,07
1998	17.730,56	177,48	2.320,67	-	174,52	-	20.533,40
1999	17.757,99	177,80	2.450,13	-	163,53	-	20.681,29

⁴⁷ Si rezultat i kalimit të sistemit nga një shtyllë në tre shtylla u krijua nevoja për shpenzime profesionale.

⁴⁸ Shpenzimet e tranzicionit i mori përsipër qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe u krijuan si rrjedhojë e përmirësimit të sistemit pensional dhe krijimit të sistemit të shtyllash.

2000	19.745,20	173,44	2.674,37	-	206,53	-	22.941,57
2001	21.282,34	170,19	2.800,73	-	290,23	-	24.696,86
2002	21.282,34	179,85	2.927,64	-	352,59	-	25.880,42
2003	22.252,52	182,89	3.183,98	-	197,74	-	27.764,35
2004	24.028,33	189,07	3.349,18	-	301,62	-	29.116,81
2005	25.108,05	199,61	3.416,82	-	272,67	-	29.028,91
2006	25.410,57	224,98	3.582,45	177,17	486,40	1.325,14	31.206,70
2007	26.305,27	247,79	3.714,03	240,33	385,13	1.877,00	32.769,55
2008	30.953,74	115,58	4.367,89	256,16	549,24	2.490,53	38.733,14
2009	33.537,64	107,53	4.290,57	264,64	260,39	2.932,20	41.392,97
2010	34.437,32	103,52	4.338,25	251,55	203,89	3.172,93	42.507,46
2011	35.751,31	101,65	4.524,32	273,81	172,07	3.482,61	44.305,77
2012	37.292,59	100,65	4.798,82	257,28	177,93	3.599,49	46.226,76
2013	40.812,95	100,57	5.359,18	247,34	193,43	4.141,29	50.854,76
2014	43.931,60	97,45	5.421,47	241,31	187,30	4.138,32	54.017,45
2015	45.569,34	94,71	5.954,22	248,63	202,47	4.719,99	56.789,36
2016	48.248,22	91,83	6.335,80	249,17	189,49	6.373,96	61.488,47
2017	51.820,97	90,22	6.571,29	241,88	171,45	6.253,13	65.148,94
Burimi: nga raporti për punën e Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor i Republikës së Maqedonisë për vitin 2017							

Sa i përket lëvizjes së përgjithshme të shpenzimeve pensionale të raportuara nga Fondi për sigurim pensional dhe invalidor konstatojmë se, këto shpenzime gjatë periudhës 1994-2017 si rezultat i rritjes së numrit të shfrytëzuesve të pensioneve dhe rregullimit të tyre janë rritur në mënyrë marramendëse, përfshirë edhe plotësimet shtesë në vitin 2018 dhe 2013. Për rrjedhojë, lëvizja e përgjithshme e shpenzimeve pensionale për periudhën e analizuar rezulton sikurse:

- nga viti 1994 deri në vitin 2017 shpenzimet për pagesën e pensioneve janë rritur për 70.3%, përfshirë pensionet e rregullta, ushtarake dhe bujqësore;
- nga viti 1994 deri në vitin 2017 kompenzimet nga sigurimi invalidor janë ulur për 77%, që përfshijnë shpenzimet për vendosjen e fëmijëve invalid në konvikte dhe për demtimet fizike;
- nga viti 1994 - 2017 shpenzimet për kontribute shëndetësore shënojnë rritje prej 68.1%, kurse pjesëmarrja e tyre në shpenzimet e përgjithshme në vitin 2017 arrinë deri në 10%;
- nga viti 2006 deri në vitin 2017 shpenzimet për shërbime profesionale janë rritur për 26.6%, e që janë në nivel të mjeteve të planifikuara (98.05%), por krahasuar me vitin 2016 janë më të larta për 2.93% si rrjedhojë e plotësimit të obligimit për transferimin e të punësuarëve me kontratë në vepër në marrëdhënie të rregullt të punës;
- nga viti 1994 - 2017 shpenzimet tjera kapitale janë zvogëluar për 60%, kurse pjesëmarrja e tyre në shpenzimet e përgjithshme arrinë deri në 0.2%, të shpenzuara kryesisht për blerjen e pajisjeve elektronike dhe të zyrave;
- nga viti 2006 deri në vitin 2017 shpenzimet e tranzicionit janë rritur për 78.9% si rezultat i transformimit të sistemit pensional në më shumë shtylla, kurse pjesëmarrja e tyre në shpenzimet e përgjithshme në vitin 2017 arrinë deri në 9.5%, si dhe

- nga viti 1994 deri në vitin 2017 gjithsej shpenzimet pensionale janë rritur për 71.7%.

Pra, të gjithë treguesit demografik, ekonomik dhe financiar të elaboruar mësipër kontribuojnë në krijimin e imazhit të situatës aktuale financiare të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor, që sipas parashikimeve aktuale pritet të përkeqësohet edhe më shumë, parasegjithash për shkak të rritjes së shpenzimeve të tranzicionit dhe uljes së vazhdueshme të treguesëve demografik (në vitin 2030 ky deficit pritet të arrijë maksimumin e tij). Po ashtu, nëse edhe më tej vazhdohet me këtë krizë financiare dhe gjendje ekonomike, e nëse kjo e fundit nuk shënon rritje të theksuar gjatë viteve të ardhshme, atëherë do e mos të implementohet projeksioni i rritjes së kufirit të moshës së daljes në pension. Ky projeksion drejtpërsëdrejti do të ndikoj në uljen e presionit mbi ngarkesën e përgjithshme financiare, por sa ky opsion për uljen e deficitit financiar mund të jetë zgjidhje e përhershme, mbetet akoma çështje e hapur dhe mjaft problematike si për vendet e zhvilluara ashtu edhe për vendet në tranzicion...!

V.4. Ndikimi i ekonomisë informale në Fondin për sigurim pensional dhe invalidor të Republikës së Maqedonisë

Ekonomia “informale” apo e hasur ndryshe si ekonomia “gri”, sipas doracakti të OECD-së (Measuring the Non-Observed Economy, 2002) për matjen e ekonomisë së pa-observuar (vëzhguar), përkufizohet si *“grup aktivitetesh që kanë të ngjarë të mos vëzhgohen, përfshirë aktivitetet nëntokësore, ilegale dhe informale, ose aktivitetet që ndërmerren nga familjet për përdorimin e tyre final “së bashku me mangësitë e grumbullimit të të dhënave”, thuhet se kolektivisht e përbëjnë ekonominë e pa observuar (vëzhguar)”*. Sipas burimit të njëjtë, përhapja e vazhdueshme e ekonomisë informale u referohet shtatë arsyeve të kategorizuara në tri fusha kryesore, sikurse: prodhimi nëntokësor⁴⁹, joformal⁵⁰ dhe ilegal⁵¹.

Po ashtu, sipas (Startienë and Trimonis, 2010) ekonomia informale i referohet *“tregut sekondar me marrëveshjet tregtare që do të ishin të mundura në ekonominë formale, por, që sigurisht do të tatimoheshin ose nuk do të mund të ishin të mundura për shkakqe ligjore”*. Duke u nisur nga kjo, shtrohet pyetja se cilët janë shkaqet dhe pasojat nga ekonomia informale nëse tregu sekondar është i pranishëm...?!

⁴⁹ Prodhimi nëntokësor ka të bëjë me aktivitetet që nuk regjistrohen për arsye ekonomike (shmangia e taksave, e kontributeve shoqërore, pagat, orët e punës, etj) dhe statistikore (mungesë e përgjegjshmërisë, të dhënave jo të azhuruara dhe për shkak të vështirësive të sistemit statistikor për të kuptuar ndryshimet, sidomos në aktivitetet e vogla të prodhimit).

⁵⁰ Prodhimi joformal ka të bëjë me të dhënat që mungojnë për shkak të mungesës së regjistrimit dhe që ligjërisht nuk kërkohet të regjistrohen: zejtarët, fermerët, punëtorët shtëpiakë, etj.

⁵¹ Prodhimi ilegal që ka të bëjë me aktivitetet që përfshijnë prodhimin, shitjen dhe shpërndarjen e produkteve apo shërbimeve që janë të ndaluara ligjërisht).

Edhe pse për shumë autorë shkaqet e ekonomisë informale mbeten të paqarta, sipas autorit (Tanzi, 2002) ekzistojnë katër shkaqe kryesore të ekonomisë informale, sikurse: taksat⁵², rregulloret⁵³, ndalesat⁵⁴ dhe korrupsioni⁵⁵. Duke marrë për bazë këto të fundit shtrohet pyetja: si qëndron Republika e Maqedonisë kundrejt këtij fenomeni?

Sipas një hulumtimi të kryer nga Qendra për analiza ekonomike në vitin 2008 konstatohet se, arsyet kryesore për evazion fiskal nga ana e kompanive të Republikës së Maqedonisë dhe që drejtpërsëdrejti ndikojnë në ekonominë informale, konsiderohen: ngarkesa e lartë tatimore, cilësia e dobët e shërbimeve publike dhe kapaciteti i dobët i Drejtorisë së të ardhurave publike, diferencimi i kompanive nga ana e partive politike dhe kostot e larta të punës (Stojkov et al., 2008). Po ashtu, në vitin 2010 përsëri nga Qendra për analiza ekonomike u realizua një hulumtim tjetër në lidhje me ekonominë informale të Republikës së Maqedonisë (Garvanlieva et al., 2012).

Ky hulumtim u realizua përmes përdorimit të Electricity Consumption Method, si metodë indirekte për vlerësimin e ekonomisë informale dhe përmes Multiple Causes Multiple Indicators (MIMIC), ku rezultatet treguan se: gjatë aplikimit të metodës ECM (Electricity Consumption Method), ekonomia informale nga 34% në vitin 2000 u zvogëlua deri në 24% në vitin 2010, kurse gjatë aplikimit të MIMIC (Multiple Causes Multiple Indicators) ekonomia informale tregoi rritje deri në 52% në vitin 2007 dhe pastaj ulje deri në 47% në vitin 2011. Pra, si shkaqe kryesore të prezencës së ekonomisë informale sipas hulumtimit në fjalë, ishin: tatimet, papunësia, intensiteti i lartë i rregulloreve, burokracia, transferet sociale të paguara nga ana e qeverisë, etj.

Duke ju referuar shkaqeve të fundit që impenjuan rritjen e nivelit të ekonomisë informale, shumë lehtë mund të bëjm ndërlidhjen e tyre me funksionimin e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor të Republikës së Maqedonisë. Si tregues më i rëndësishëm që rëndon ekonominë informale është luhatja, përkatësisht shkalla e lartë e papunësisë (posaçërisht gjatë periudhës 2004-2012), që drejtpërsëdrejti rrit ose ulë të ardhurat burimore të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor. Shkalla e lartë afatgjate e papunësisë sugjeron se një pjesë e madhe e të papunëve kanë qenë të angazhuar në aktivitete të fshehura, që të arrijnë të paktën një nivel bazë të jetesës (punonjësit e padeklaruar kanë më shumë të ngjarë të jenë të angazhuar në

⁵² Nëse nuk do të ekzistonin taksat nuk do të kishte ekonomi informale. Pra ashtu sikurse normat tatimore dhe nivelet e taksave rriten, ashtu edhe përpjekjtet e tatimpaguesve për t'ju shmangur tatimimit rriten (kryesisht përmes angazhimit të tyre në aktivitetet informale - të paregjistruara).

⁵³ Niveli i lartë i zbatimit të rregulloreve nënkupton rritje proporcionale të aktiviteteve të ekonomisë informale, pra shtetet me nivel të lartë të zbatimit të rregulloreve konsiderohen si nxitës kryesorë dhe presion për kompanitë për t'u angazhuar në aktivitetet e ekonomisë informale.

⁵⁴ Niveli i ndalesave për aktivitetet të caktuara në vende të ndryshme është i ndryshëm, andaj edhe përfshirja e këtyre aktiviteteve në ekonominë informale është mjaft prezente.

⁵⁵ Niveli i korrupsionit është një aspekt tjetër kontravers, nëse do të duhet të konsiderohet si pjesë e ekonomisë informale pasi në fund të fundit i referohet shtrembërimit të çmimeve të tregut.

zejtari, bujqësi, angazhime shtëpiake dhe që nuk janë të obliguar të regjistrohen në mënyrë ligjore).

Për rrjedhojë, pjesa shumë e lartë e këtij sektori që i përket ekonomisë informale e bën akoma më të vështirë që qeveria të synoj identifikimin e formave tjera të punësimit të padeklaruar. Për këtë të fundit, flasin edhe shumë studime të kryera në këtë drejtim duke nënvizuar se, niveli i padeklaruar i punësimit në Republikën e Maqedonisë arrin mbi 30% të PBB-së (Williams et al., 2013). Andaj, duke marrë parasysh punësimin informal si tregues kryesor që rrit nivelin e ekonomisë informale dhe njekohesisht dëmton Fondin për sigurim pensional dhe invalidor të Republikës së Maqedonisë në aspekt financiar, në vijim sjellim dinamikën e punësimit informal për periudhën 2007 - 2017.

Tabela 78: Trendi i punësimit informal në Republikën e Maqedonisë për periudhën 2007-2017

Vitet	Burra	Gra	Gjithsej
2007	107.284	55.659	162.943
2008	112.247	61.778	174.025
2009	111.832	58.084	169.916
2010	105.958	60.856	166.814
2011	103.024	57.933	160.957
2012	91.575	54.721	146.295
2013	93.993	58.811	152.805
2014	102.791	53.202	155.993
2015	89.314	51.328	140.642
2016	90.071	43.706	133.777
2017	88.749	45.536	134.285

Burimi: nga të dhënat e publikuara në Entin shtetëror statistikor

Sipas të dhënave të prezantuara në tabelën mësipër konstatojmë se:

- punësimi informal për periudhën 2007 - 2010 është rritur për 2.4%, ose për 3.871 të punësuar informal;
- punësimi informal nga viti 2010 - 2017 është ulur për 19.6%, ose për 32.529 të punësuar informal;
- punësimi informal për periudhën 2007 - 2017 është zvogëluar për 17.6% ose për 28.658 të punësuar informal.

Duke marrë për bazë dinamikën e punësimit informal për periudhën 2007 - 2017, sjellim dy skenarët e krijuar bazuar në pagën minimale dhe mesatare të Republikës së Maqedonisë për të vlerësuar dëmtimin financiar në drejtim të derdhjes së kontributeve për sigurim pensional dhe invalidor, kur kihet parasysh se të ardhurat burimore Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i siguron kryesisht nga kontributet për sigurim pensional dhe invalidor.

Tabela 79: Punësimi joformal, paga minimale dhe mesatare në Republikën e Maqedonisë (2007-2017)

Vitet	Punësimi joformal			Skenari sipas rrogës minimale (1)		Skenari sipas rrogës mesatare (2)	
	Burra	Gra	Gjithsej	Rroga minimale	Kontributet Pensionale	Rroga mesatare	Kontributet pensionale
2007	107.284	55.659	162.943	6.027,00	3.071,00	15.543,00	4.052,00
2008	112.247	61.778	174.025	10.412,00	3.688,00	17.363,00	4.551,00
2009	111.832	58.084	169.916	9.563,00	2.613,00	20.483,00	5.405,00
2010	105.958	60.856	166.814	10.503,00	2.685,00	21.454,00	5.671,00
2011	103.024	57.933	160.957	10.702,00	2.732,00	21.415,00	5.661,00
2012	91.575	54.721	146.295	10.796,00	2.753,00	21.469,00	5.676,00
2013	93.993	58.811	152.805	10.778,00	2.754,00	21.500,00	5.684,00
2014	102.791	53.202	155.993	10.879,00	2.781,00	22.407,00	5.932,00
2015	89.314	51.328	140.642	11.128,00	2.850,00	22.715,00	6.017,00
2016	90.071	43.706	133.777	11.336,00	2.904,00	23.457,00	6.220,00
2017	88.749	45.536	134.285	12.000,00	3.083,00	23.850,00	6.328,00

Burimi: kalkulim personal i bazuar nga të dhënat e publikuara në Entin shtetëror statistikor

Tabela 80: Humbjet financiare nga punësimi informal sipas pagës minimale dhe mesatare (2007-2017)

Vitet	Humbja nga skenari (1) (në denarë)	Humbja nga skenari (1) (në Euro)	Humbja nga skenari (2) (në denarë)	Humbja nga skenari (2) (në Euro)
2007	500.397.953,00	8.136.552,00	660.245.036,00	10.735.691,00
2008	641.804.200,00	10.435.840,00	791.987.775,00	12.877.850,00
2009	443.990.508,00	7.219.357,00	918.395.980,00	14.933.267,00
2010	447.895.590,00	7.282.855,00	946.002.194,00	15.382.149,00
2011	439.734.524,00	7.150.154,00	911.177.577,00	14.815.895,00
2012	402.750.135,00	6.548.782,00	830.370.420,00	13.501.958,00
2013	420.824.970,00	6.842.682,00	868.543.620,00	14.122.660,00
2014	433.816.533,00	7.053.927,00	925.350.476,00	15.046.349,00
2015	400.829.700,00	6.517.556,00	846.242.914,00	13.760.047,00
2016	388.488.408,00	6.316.884,00	832.092.940,00	13.529.966,00
2017	414.000.655,00	6.731.717,00	849.755.480,00	13.817.162,00
Gjithsej	4.934.533.176,00	80.236.311,00	9.380.164.412,00	152.522.994,00

Burimi: kalkulim personal i bazuar nga të dhënat e publikuara në Entin shtetëror statistikor

Sipas skenarëve të krijuar për vlerësimin e dëmtimit financiar konstatojmë se:

- në skenarin e parë ku si bazë merret paga minimale vërejmë se, Fondi për sigurim pensional dhe invalidor për periudhën 2007 - 2017 është dëmtuar për 80.236.311,00 Euro nga punësimi informal, e që nëse do të hynin në Fond për sigurim pensional dhe invalidor do të shlyenin shpenzimet e tranzicionit të vitit 2014;
- në skenarin e dytë ku si bazë merret paga mesatare vërejmë se Fondi për sigurim pensional dhe invalidor është dëmtuar për 152.522.994,00 Euro nga punësimi informal, e që nëse këto të fundit do të hynin në Fondin për sigurim pensional dhe invalidor do të shlyenin shpenzimet e tranzicionit të vitit 2015 dhe 2016.

Humbja financiare nga pjesëmarrja e ekonomisë informale mbetet si shqetësim kryesor për Republikën e Maqedonisë. Duke u nisur nga kjo shtrohet pyetja e radhës, rrjedhimisht cilët masa ndikojnë në uljen e këtij fenomeni po aq sa sfidues, aq edhe i vështirë për t'u trajtuar nga ana e organeve shtetërore...?!

Sipas hulumtimit të kryer nga Qendra për analiza ekonomike, rekomandimi i përgjithshëm për uljen e ekonomisë informale mbetet aplikimi i politikave të orientuara nga stimujt e qeverisë, duke e transformuar ekonominë informale në një formë më pak tërheqëse, përkatësisht uljen e saj. Kjo e fundit veçse është aplikuar në Republikën e Maqedonisë, mirëpo akoma nuk janë ndërmarrë aktivitete në drejtim të ngritjes së vetëdijes dhe edukimit të bizneseve dhe familjeve - aktivitete këto, që mbeten për t'u zbatuar në të ardhmen e afërt.

Kurse, duke ju referuar shkaqeve të përcaktuara nga Tinzi (të ekzaminuar më sipër) që njëkohësisht konsistojnë edhe me rastin e Republikës së Maqedonisë, disa nga masat që do kontribuojnë në uljen e ekonomisë informale janë:

1. **Ulja e ngarkesës tatimore** ndikon më uljen e ekonomisë informale. Për këtë të fundit (Nenovski, 2012) thekson se me mbingarkesën tatimore dhe kontributet, sidomos deri në vitin 2007 kur ishte në fuqi llogaritja progresive e tatimit mbi të ardhurat personale, pjesëmarrja e ekonomisë informale ishte shumë më e lartë. Për këtë arsye, qeveria e Republikës së Maqedonisë aplikoi tatimin e sheshtë dhe në vitin 2008 uli normat e tyre deri në 10% (pas kësaj periudhe rritja vjetore e ekonomisë informale vijoi me minus 9.3% në vitin 2006-2007 dhe minus 10.6% për periudhën 2007-2008). Aplikimi i kësaj mase sipas Nenovskit rezultoi me përmirësimin e etikës tatimore të tatimpaguesëve, rritjen e buxhetit shtetëror dhe reduktimin e ekonomisë informale. Po ashtu, grupi i autorëve (Garvanlieva et al., 2012) pajtohen se ulja e ngarkesës tatimore ulë stimujt për shmangien e tatimeve, e me këtë edhe zvogëlimin e ekonomisë informale.
2. **Ulja e ngarkesave administrative për komunitetin e bizneset** ndikon në uljen e ekonomisë informale, që sipas autorit (Nenovski, 2012) ngarkesat e tepërta administrative për bizneset rezultojnë në dekurajimin e tyre për t'i regjistruar bizneset apo të transferohen në ekonominë formale. Për këtë arsye, aplikimi i sistemit me një ndalesë (the one-stop-shop system) zvogëlon kohën për regjistrimin e bizneseve dhe projekti "regulatory guillotine" konsiderohen si masa efektive për transferimin e bizneseve joformale në formale. Po ashtu, autorët (Stankovic and Stankovic, 2012) vënë re se, sipas raportit World Bank's Doing Business të vitit 2012, në Republikën e Maqedonisë nevojiten tre procedura dhe tre ditë kohë që kushton 2.24% të të ardhurave kombëtare bruto për kokë banori për të filluar një biznes - fakte këto, që pritet të ndikojnë në uljen e ekonomisë informale.

3. **Zvogëlimi i transfereve sociale të paguara nga qeveria ndikon në uljen e ekonomisë informale.** Pra, sipas autorëve (Stankovic and Stankovic, 2012) rritja e numrit të transfereve sociale të paguara nga qeveria e Republikës së Maqedonisë, rezulton me efekte të padëshiruara në ekonominë informale, ngase transferet sociale për të papunët krijojnë dekurajime për të operuar ata në ekonominë formale, e me këtë nxisin edhe më tepër ekonominë informale (ndërkohë që edhe marrin ndihma sociale).
4. **Përmirësimi i rregullativës për bërjen e biznesit ndikon në uljen e ekonomisë informale.** Autori (Nenovski, 2012) bashkë me grupin e autorëve (Garvanlieva et al., 2012), vlerësojnë se politikat e rregullimit fiskal dhe të biznesit motivojnë bizneset për të operuar në ekonominë formale, gjegjësisht të transferohen më lehtë nga ekonomia informale në atë formale (që vjen në shprehje pas reduktimit të ngarkesës tatimore).
5. **Uja e nivelit të korrupsionit ndihmon uljen e ekonomisë informale** që po ashtu sipas grupit të autorëve paraprak aplikimi i një sistemi tatimor të suksesshëm dhe pa ndikime politike, përfshirë stafin adekuat profesional me përvojë dhe ekspertizë thelbësore ulin stimujt për korrupsion dhe motivojnë bizneset të lëvizin në ekonominë formale.
6. **Përmirësimi i ulët dhe efikasiteti i sundimit të ligjit ngadalëson zvogëlimin e ekonomisë informale,** respektivisht ngadalësimi i vazhdueshëm i operimit të sistemit gjyqësor dhe përmirësimi i veprimeve ndaj atyre që shmangin tatimet, kërkon ndërmarrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e efikasitetit të sundimit të ligjit.

Pra, aplikimi i masave për uljen e ekonomisë informale, rrjedhimisht transferimi i bizneseve informale në ato formale do të ndikoj në uljen e numrit të punësuarëve informal, e me këtë edhe në rritjen e të ardhurave burimore të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor.

V. 5. Analiza empirike

V.5.1. Qëllimi i analizës empirike dhe arsyeshmëria e përcaktimit të variablave varëse

Qëllimi kryesor i zbatimit të analizës empirike mbetet kryesisht elaborimi i faktorëve tjerë (përveç atyre demografik) që njëkohësisht afektojnë shpenzimet e pensioneve të pleqërisë. Faktorët demografik konsiderohen si përkeqësuesit kryesor të gjendjes financiare të sistemit pensional, e njëherit edhe iniciuesit kryesorë për sforcimin e reformave në sistemin pensional, respektivisht transformimin e sistemit pensional nga modeli jofinancues në atë hibrid (financues dhe jo financues) ose plotësisht në model financues. Mirëpo, ky transformim i sistemit pensional nuk ka arritur akoma të zgjedh problemin e aftësisë pagueuse ngase burimet e kësaj pa aftësie janë të llojeve të ndryshme, edhe atë: të faktorëvetë tregut të punës, produktit kombëtar, edukimit, mjaftueshmësisë së të ardhurave të pensioneve, etj.

Pra, përveç treguesëve demografik shpenzimet pensionale afektohen edhe nga treguesit ekonomik që në korrelacion me treguesit tjerë anojnë ose lehtësojnë funksionimin e sistemit pensional të Republikës së Maqedonisë. Andaj, duke u mbështetur në qëllimin e analizës empirike sjellim analizën e marrëdhënieve të pesë grupeve të faktorëve që pritej të ndikojnë në variablat e varura, përkatësisht në pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto dhe pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto, në raport me normën e varësisë së pleqërisë.

Përcaktimi për dy variablat e varura konsiston në faktin se, këto të fundit në një mënyrë apo tjetër determinojnë qëndrueshmërinë financiare të sistemit pensional, rrjedhimisht nevojën për konsolidim të mëtejshëm kur kihet parasysh se kjo e fundit varet kryesisht nga dinamika e treguesëve demografik dhe atyre ekonomik. Andaj, pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto si variabël e parë e varur, fillimisht shërben për të determinuar se cilët janë treguesit kryesorë që më së shumti afektojnë uljen apo rritjen e pjesëmarrjes së shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto, për të vijuar më tej si bazë për përcaktimin e variablës së dytë varëse. Pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto në raport me normën e varësisë së pleqërisë si variabël e dytë varëse, shërben për të përcaktuar shpenzimet pensionale për pensionist dhe për të parë se cilët nga variablat shpjeguese afektojnë më së shumti rritjen apo uljen e tyre.

V.5.2. Përcaktimi i modelit dhe arsyeshmëria e përcaktimit të variablave të pavarura (shpjeguese)

Duke marrë parasysh kredibilitetin e gjetjeve mbi shpenzimet dhe disponueshmërinë e të dhënave statistikore mbi variablat shpjeguese, në vijim këto të fundit i kemi klasifikuar në pesë grupe të veçanta të faktorëve, edhe atë:

Tabela 81: Variablat e pavarura dhe arsyeshmëria e përfshirjes së tyre në analizën empirike

Grupi i faktorëve	Variablat shpjeguese	Arsyeshmëria e përcaktimit të variablave shpjeguese
1. Demografikë	1. Raporti i varësisë së pleqërisë; 2. Jetëgjatësia deri në moshën 65 vjeç.	1. Raporti i varësisë së pleqërisë paraqet numrin e pensionistëve dhe pritet të ndikoj pozitivisht në testimin e variables së pare varëse; 2. Jetëgjatësia deri në moshën 65 vjeç ndikon në rritjen e pjesëmarrjes së shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto.
2. Të tregut të punës	1. Kohëzgjatja e marëdhënies së punës; 2. Norma e punësimit për grup-moshën mbi 65 vjeç; 3. Norma e punësimit për grup moshën 15-64.	1. Kohëzgjatja e marëdhënies së punës pritet të ul pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto; 2. Norma e punësimit për grup-moshën mbi 65 vjeç, po ashtu pritet të ulë pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto; 3. Norma e punësimit për grup moshën 15-64 pritet të ketë ndikim negativ në pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto, ngase sa më gjatë që njerëzit punojnë aq më e vogël është mundësia për shfrytëzimin e pensionit.
3. Të produktit kombëtar	1. Prodhimi i Brendshëm Bruto; 2. Prodhimi i Brendshëm Bruto për kokë banori; 3. Produktiviteti i punës.	Përveç faktorëve të tregut të punës edhe faktorët e produktit kombëtar pritet të ulin pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto, respektivisht lidhja e tyre është negative.
4. Sipas mjaftueshmërisë së të ardhurave të pensioneve	1. Norma e zëvendësimit.	1. Norma e zëvendësimit paraqet raportin mes pages mesatare dhe pensionit mesatar, andaj çdo rritje e normës së zëvendësimit pritet të ndikojë pozitivisht në variablat varëse.
5. Sipas nivelit arsimor	1. Përqindja e popullsisë së përgjithshme që kanë përfunduar së paku arsimin e mesëm në grup moshën 55-64 vjeç.	1. Përqindja e popullsisë së përgjithshme që kanë përfunduar së paku arsimin e mesëm në grup moshën 55-64 vjeç, nënkupton së kjo grup moshë do të jetojë më gjatë për shkak të standardit më të mirë jetësor, e në këtë mënyrë do të rezultojë me rritjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto.

Pra, duke u mbështetur në arsyeshmërinë e përcaktimit të variablave shpjeguese, rrjedhimisht dalin edhe hipotezat për lidhshmërinë e drejtë apo të zhdrejtë me variablat varrëse, sikurse në rastin e pesë hipotezave ndihmëse të përcaktuara në fillim të studimit:

1. Faktorët (për dallim nga ato demografik), që ulin pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto janë faktorët që lidhen me tregun e punës dhe me prodhimin vendor;
2. Me rritjen e kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës ulet pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto;
3. Me rritjen e normës së varësisë së pleqërisë dhe jetëgjatësisë rritet pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto;
4. Përqindja më e lartë e personave të edukuar (nga mosha 55-64 vjeç) rrit edhe pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto;
5. Pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto në raport me normën e varësisë së pleqërisë (pensionistët), është negativisht e lidhur me indikatorët demografik dhe tregut të punës.

Pas grumbullimit të të dhënave rreth variablave që konsistojnë me grupet e faktorëve të lartpërmendur, vëmë në përdorim metodën statistikore Panel Data. Kjo e fundit, si metodë statistikore gjen përdorim të gjerë në shkencat shoqërore dhe ka për qëllim observimin e të dhënave gjatë dy dimensioneve, sikurse: “Cross Sectional dhe Times Series”. Të dhënat në fjalë, zakonisht grumbullohen përgjatë viteve dhe mbi të njëjtin individ (në rastin tonë konkret mbi 10 shtete) e më pas drejtohet një regresion mbi këto dy dimensioneve.

Tabela 82: Shtetet pjesëmarrëse në analizën empirike, periudha dhe burimi i të dhënave

Shtetet pjesëmarrëse në analizën empirike	Periudha	Burimi i të dhënave
1. Bullgaria 2. Kroacia 3. Greqia 4. Hungaria 5. Portugalia 6. Republika e Maqedonisë 7. Rumania 8. Sllovakia 9. Sllovenia 10. Republika Çeke	2000-2015	Të dhënat janë grmbulluar nga: 1. Zyra statistikore e Bashkimit Evropian (Eurostat); 2. Banka Botërore; 3. Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO); 4. Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN); 5. Enti statistikor shtetëror i Republikës së Maqedonisë .

Po ashtu, Panel Data mundëson edhe kontrollimin e disa llojeve të variablave të cilat nuk janë të inkuadruara në model (nuk observohen) dhe variablat e panjohura që dallojnë në mes rasteve, por nga ana tjetër janë konstante përgjatë kohës, si dhe e kundërta, të ndryshme përgjatë kohës dhe konstante në mes rasteve (Davies and Lahiri, 1995).

V.5.3. Teknikat e përdorura gjatë analizës empirike

Analiza jonë empirike konsiston në ndjekjen e dy fazave:

- **Faza e parë:** përfshin vlerësimin e trendit të pjesëmarrjes së shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto dhe pjesëmarrjes së shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto, në raport me normën e varësisë së pleqërisë;
- **Faza e dytë:** përfshin vlerësimin e modeleve të regresionit panel për të dy variablat e varura duke lënë anash normën e varësisë së pleqërisë nga seti i variablave shpjeguese gjatë vlerësimit të modelit që i referohet pjesëmarrjes së shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto, në raport me normën e varësisë së pleqërisë.

Si rrjedhojë, modelet në fjalë janë përlogaritur si më poshtë:

$$\frac{SHP}{PBB_{it}} = \alpha_0 + \alpha_1 NVP_{it} + \alpha_2 J_{it} + \alpha_3 KMP_{it} + \alpha_4 NPG_{(>65)it} + \alpha_5 NPG_{(15-64)it} + \alpha_6 PBB_{git} + \alpha_7 PBB_{pcit} + \alpha_8 PP_{git} + \alpha_9 NZ_{it} + \alpha_{10} AM_{(55-)it} + v_{it} (1)$$

$$\frac{SHP}{PBB} NVP_{it} = \alpha_0 + \alpha_1 J_{it} + \alpha_2 KMP_{it} + \alpha_3 NPG_{(>65)it} + \alpha_4 NPG_{(15-)it} + \alpha_5 PBB_{git} + \alpha_6 PBB_{pcit} + \alpha_7 PP_{git} + \alpha_8 NZ_{it} + \alpha_9 AM_{(55-64)it} + v_{it} (2)$$

ku v_{it} është një komponent i përgjithshëm i rastit bazuar në të dhënat e panelit që mbulojnë gabimet e rastit, efektet fikse (duke ju referuar me l shteteve) dhe efektet e rastit. Pra, fillojmë me Pooled Ols Regression Model si model më i thjeshtë, për të vijuar me efektet fikse ose efektet e rastit dhe në fund me GMM.

POOLED OLS Regression Model

Ekuacioni i regresionit të thjeshtë linear shërben për të definuar raportet mes variablës së varur dhe asaj të pavarur dhe për të vlerësuar variablën e varur Y, që në rastin tonë konkret shprehet përmes: pjesëmarrjes së shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto dhe pjesëmarrjes së shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto, në raport me normën e varësisë së pleqërisë të bazuara në variablën e pavarur X. Duke u nisur nga regresioni i thjeshtë linear dhe aplikimi i metodës së katrorëve të vegjël (OLS), në këtë studim kemi testuar efektet e variablave të pavarura (raportin e varësisë së pleqërisë, jetëgjatësinë deri në moshën 65 vjeç, kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës, normën e punësimit të grup moshës mbi 65 vjeç dhe të asaj 15-64 vjeç, produktivitetin e punës, normën e zëvendësimit, nivelin arsimor respektivisht përqindjen e popullsisë së përgjithshme që kanë përfunduar së

paku arsimin e mesëm në grup moshën 55-64 vjeç) në variablat e varura, përkatësisht ndikimin e tyre në pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto dhe në pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto, në raport me normën e varësisë së pleqërisë (Kutner et al., 2005).

Modeli i efekteve fikse (Fixed Effects)

Modeli i efekteve fikse si një model statistikor që gjen zbatim në statistikë dhe ekonometri paraqet sasitë e vrojtura në drejtim të variablave shpjeguese që janë të trajtuara sikur sasitë të ishin jo të rastit - trajtim ky, i cili nuk haset tek “Random Effects” dhe “Mixed Effects” ku të gjitha ose disa nga variablat shpjeguese trajtohen si rrjedhojë e rastit. Po ashtu, efektet fikse shqyrtojnë marrëdhëniet në mes parashikuesve dhe rezultateve të variablave brenda një njësie ekonomike (vendi, personi, kompani, etj) me karakteristika të veçanta individuale, që edhe mund por edhe mund mos të ndikojnë në variablat parashikuese (për shembull: duke qenë një mashkull apo femër mund të ndikojë në opinionin rreth një çështje të caktuar; sistemi politik i një vendi të caktuar mund të ketë ndonjë efekt në tregti ose Prodhimin e Brendshëm Bruto; praktikatat e biznesit të një kompanie mund të ndikojnë në çmimin e aksioneve) (Nwakuya and Ijomah, 2017)

Modeli i efekteve të rastit mund të shprehet përmes ekuacionit:

$$Y_{it} = X_{it} \beta + \alpha_i + \mu_{it} \text{ për } t=1, \dots, T \text{ dhe } i=1, \dots, N$$

Ku me ç'rast:

- Y_{it} - është variabla e varur e vrojtuar për individin (shtetin) i në kohën t ;
- X_{it} - paraqet variablen e pavarur;
- β - është koeficienti
- α_i - paraqet ndërprerësin e panjohur për secilin shtet
- μ_{it} - është termi gabim

Për dallim nga X_{it} , α_i nuk mund të observohet drejtpërsëdrejti.

Pra, përdorimi i efekteve fikse bëhet sa herë që jemi të interesuar të bëjmë një analizë të impaktit të variablave që ndryshojnë me kalimin e kohës. Megjithatë, *“nëse një variabël e pa observuar nuk ndryshon me kalimin e kohës, atëherë çdo ndryshim në variablën e varur duhet të jetë si rrjedhojë e ndikimeve të ndryshme, e jo si rrjedhojë e karakteristikave fikse”* (Stock and Watson, 2003).

Modeli i efekteve të rastit (Random Effects)

Për dallim nga modeli i efekteve fikse arsyeja e përdorimit të modelit të efekteve të rastit konsiston në atë se, varacioni i të gjitha subjekteve (shteteve) supozohet të jetë i rastësishëm dhe i pa ndërlidhur me parashikuesit dhe variablat tjera të pavarura, të përfshira në modelin ekonometrik. Për rrjedhojë, nëse kemi arsye për të besuar mbi atë se ndryshimet mes subjekteve (shteteve) kanë ndonjë ndikim në variablën e varur, atëherë duhet përdorur modeli i efekteve të rastit. Një arsye edhe më shumë për përdorimin e modelit në fjalë, ka të bëjë fakti se mund të përfshihen në kohë variablat e pandryshueshme (p.sh.gjinore) që në rastin e modelit të efekteve fikse absorbohen nga vetë modeli.

Modeli i efekteve të rastit mund të shprehet përmes ekuacionit:

$$Y_{it} = \beta X_{it} + \alpha + \mu_{it} + \varepsilon_{it} \text{ ku } \varepsilon_{it} = \alpha_{it} + n_{it}$$

- μ_{it} - paraqet gabimin mes entiteteve (shteteve)
- ε_{it} - paraqet gabimin brenda entiteteve (shteteve)

Modeli i efekteve të rastit vlerëson se gabimi i njësisë ekonomike (entiteteve) nuk është i ndërlidhur me parashikuesit, lejon për një kohë variablat e pandryshueshme të luajnë rolin e variablave shpjeguese - rol ky, i cili nuk haset tek modeli i efekteve fikse, ngase te ky i fundit është e nevojshme specifikimi i karaktertikave individuale që edhe mund, por edhe mund mos të ndikojnë në variablat e parashikuara. Pra, modeli i efekteve të rastit lejon gjeneralisimin e konkluzioneve përtej mostrës së përdorur brenda modelit (Nwakuya and Ijomah, 2017).

Modeli i efekteve fikse apo i efekteve të rastit (Fixed or Random)?

Për të vlerësuar se cili nga modelet është më i përshtatshëm për rastin tonë, shërbehemi me Hausman testin i cili krahason diferencën mes dy vlerësuesve ($\hat{q}_1$), në raport me variancën e kësaj difference, edhe atë (Baltagi, 2005):

- Nëse diferenca e vlerësuesve në raport me variancën është e madhe atëherë kemi signifikançë që sugjeron se, diferenca është sistematike. Së këndejmi, diferenca sistematike mes dy vlerësuesve $\hat{\beta}_{GLS}$ dhe $\tilde{\beta}_{WITHIN}$ sugjeron se, ekziston një korelacion mes u_{it} (error terms) dhe variablave të pavarura X_{it} . Si rrjedhojë, vlerësuesi (Random Effects) është i njëanshëm dhe në kundërshtim. Andaj, në këtë rast preferohet të zgjidhet vlerësuesi tjetër, përkatësisht Fixed Effects.
- Nëse diferenca e vlerësuesve në raport me variancën është e vogël, atëherë kemi josignifikancë. Kjo e fundit na bën me dije se, diferenca mes dy vlerësuesve $\hat{\beta}_{GLS}$ dhe

$\tilde{\beta}_{WITHIN}$ është josistematike, që do të thotë se vlerësuesi (Random Effect) është i njëanshëm dhe konsistent (i përputhshëm). Në këtë rast preferohet Random Effect - i, (ose te paktën është i pranueshëm).

Po ashtu, testi statistikor Hausman posedon edhe shpërndarrjen *Chi-square (K)* ku në këtë rast (*K*) paraqet shkallën e lirisë që jepet si e dhënë nga numri i koeficientëve të vlerësuar. Rezultatet e testit mund të interpretohen si në formën vijuese:

- **TT > CV $\Rightarrow$ vlerëso FE**
 - Nëse testi statistikor është më i lartë se vlera kritike, nënkupton se diferenca mes dy vlerësuesve është më e madhe në raport me variancën e saj, andaj në këtë rast vlerëso Fixed Effects;
- **TT < CV $\Rightarrow$ vlerëso RE**
 - Nëse testi statistikor është më i ulët se vlera kritike, nënkupton se diferenca mes dy vlerësuesve është më e vogël në raport me variancën e saj, andaj në këtë rast vlerëso Random Effects;

Megjithatë, gjatë interpretimit të rezultateve të gjeneruara nga analiza empirike duhet të kihet parasysh se: hipoteza zero sugjeron se modeli i efekteve të rastit është më i përafërt, kurse hipoteza alternative sugjeron se modeli i efekteve fikse është më i përafërt.

GMM

GMM si një metodë që gjen zbatim në ekonometri dhe statistikë përdoret për vlerësimin e parametrave në modelet statistikore. Kjo metodë zakonisht zbatohet në kontekstin e modeleve semiparametrike ku parametri i interesit është dimension i fundit, kurse forma e plotë e funksionit të shpërndarjes së të dhënave mund të mos njihet, e për këtë arsye vlerësimi maksimal i gjasave nuk është i zbatueshëm. Po ashtu, metoda në fjalë kërkon që një numër i caktuar i kushteve momentale të jenë të specifikuara për modelin. Këto kushte momentale janë funksionet e parametrave të modelit dhe të dhënat, ashtu që pritshmëria e tyre në vlerat e vërteta të parametrave të mbetet zero. Për më tej, metoda GMM minimizon një normë të caktuar të mesatareve të mostrës së kushteve momentale. Vlerësuesit e GMM-it njihen të jenë konsistent, asimptotikisht normale dhe efikase në klasën e të gjithë vlerësuesve që nuk përdorin ndonjë informacion shtesë, përpos informacionit që gjendet në kushtet momentale.

Pra, GMM i referohet një klase vlerësuesish të cilët janë të sendërtuar duke shfrytëzuar momentet e mostrës së kushteve momentale të popullsisë të modelit të gjenerimit të të dhënave. GMM vlerësuesit përdoren gjerësisht për arsyet e mëposhtme, sikurse (Hansen, 2007):

- GMM vlerësuesit kanë veti të mëdha të modelit që janë lehtë për t'u karakterizuar, përfshirë mënyrat që lehtësojnë krahasimin. Një familje e vlerësuesve të tillë mund të studiohet a priori duke e lehtësuar në këtë mënyrë krahasimin e efikasitetit asimptotik. Kjo metodë gjithashtu siguron një mënyrë të natyrshme të krijimit të testeve që marrin parasysh të dy gabimet: të mostrës dhe vlerësimit.
- Në praktikë studiuesit e konsiderojnë si të dobishme që vlerësuesit e GMM-it, të mund të krijohen pa e specifikuar procesin e plotë të gjenerimit të të dhënave. Kjo karakteristikë është përdorur në analizimin e modeleve ekonomike pjesërisht të specifikuara, modele dinamike pothuajse të paqarta, të dizajnuara për përshtatjen e momenteve të targetuara.

Së fundmi, metoda e GMM-it konsiderohet si e përshtatshme për një sërë problemesh në ekonomi, parasegjithash për shkak se vetitë e tyre të mëdha të mostrës janë lehtë për t'u karakterizuar, përkatësisht mundësojnë zbatimin e testeve që marrin në konsideratë gabimet e mostrës dhe vlerësimit.

V.5.4. Diagnotifikimi i modelit në rastin e testimit të variables së parë varëse (Pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto)

Diagnotifikimi i një regresioni përfshinë një set të procedurave të disponueshme që shërbejnë për analizë të regresionit që vlerëson validitetin e modelit duke vënë në përdorim metoda të ndryshme. Ky vlerësim mund të jetë një eksplorim i supozimeve themelore statistikore rreth modelit, ekzaminim i strukturës së modelit duke marrë në konsideratë formulimet që përmbajnë disa ose më shumë variabla të ndryshme sqaruese, përfshirje e testeve të ndryshme që ndihmojnë në diagnotifikimin e modelit, etj. Këto të fundit kanë për qëllim të gjejnë variablat që janë më pak të përfaqësuar nga modeli, ose që kanë një efekt relativisht të lartë në parashikimin e regresionit. Andaj, për diagnotifikimin e POOLED OLS Regression Model-it jemi shërbyer me testin e homogjenitetit dhe me testin e heteroscedasticitetit (Hayashi, 2001).

Testi i homogjenitetit

Meqë P-value (0.0000) rezulton me vlerë më të ulët se niveli i signifkancës (0.05), konstatojmë se, hipoteza zero është e papranueshme ngase observimet nga mostra rezultojnë të jenë kryesisht të rastësishme. Po ashtu, duke u bazuar në P-value (0.0000) konstatojmë se nuk kemi homogjenitet (shih *appendix*).

Testi i heteroskedasticitetit

Duke u bazuar në vlerën e probabilitetit $\text{Prob} > \chi^2 = 0.6350$ që në rastin tonë është më e lartë se niveli i signifikançës (0.05), konstatohet se hipoteza zero është e papranueshme. Pra, vlerësojmë se kemi evidencë të heteroskedasticitetit në modelin tonë, respektivisht ndryshmëria e një variabli është e pabarabartë me gamën e vlerave të variablës së dytë (tjetrës) që e parashikon atë (shih *appendix*).

Për rrjedhojë, thjeshtësia e regresionit të thjeshtë linear rrjedh kryesisht nga supozimi për termin error (që supozohet se $\epsilon \sim N(0, \sigma^2)$) i cili në model nuk sqaron diçka më shumë rreth variablave tjera (distribucioni i termit error është i pavarur nga variablat tjera), përveç se observimet e termit error janë të pakorreluara me njëra tjetrën. Si rrjedhojë e pa aftësisë së termit error për të ofruar informacion shtesë rreth variablave në fjalë, konstatohet se vlerësimi efikas mund të arrihet me anë të katrorëve të vegjël (OLS) dhe përmes disa metodave tjera të regresionit sikurse: Fixed Effects dhe Random Effects .

Diagnostifikimi i efekteve fikse (Fixed Effects)

Meqë, F test that all $u_i = 0$, $F(9, 67) = 16.08$ dhe $\text{Prob} > F = 0.0000$, vlerësojmë efektet fikse që trajtojnë marrëdhëniet në mes parashikimeve dhe rezultateve të variablave brenda një njësie ekonomike, respektivisht brenda shteteve. Këto të fundit (shtetet) kanë karakteristikat e tyre individuale që mund, por edhe mund të mos ndikojnë në variablat parashikuese (shih *appendix*).

Diagnostifikimi i efekteve të rastit (Random Effects)

Duke u mbështetur në $\text{Prob} > \chi^2 = 0.0000$ konstatohet se, modeli ynë është i përshtatshëm si rezultat i vlerës së probabilitetit që duhet të jetë më e vogël se 0.05, në të kundërtën modeli është i pa përshtatshëm (shih *appendix*).

Diagnostifikimi nëse duhet të zgjedhim efektet fikse apo të rastit

Për të vlerësuar nëse duhet të zgjedhim efektet fikse apo të rastit shërbehem me Hausman testin. Ky test posedon edhe shpërndarjen Chi-square (K) ku në këtë rast (K) paraqet shkallën e lirisë si e dhënë nga numri i koeficientëve të vlerësuar. Andaj, duke marrë për bazë $\text{Prob} > \chi^2 = 0.0079$ ($0.0079 < 0.05$) vlerësojmë se modeli i efekteve të rastit është i papërshtatshëm për rastin tonë konkret, andaj përcaktohem për modelin e efekteve fikse (shih *appendix*).

Diagnostifikimi i GMM-it

Pas përcaktimit për teknikën e efekteve fikse analizën tonë empirike për variablën e parë të varur e përmbylлим me GMM-in, që eliminon problemin e endogjenitetit pasi që e dërgon rrezidualin në zero, respektivisht lufton heteroskedacitetin dhe autokorelacionin. Pra, shërbehemi me testet vijuese: Arellano - Bond test për AR (1), Arellano - Bond test për AR (2) dhe Sargan test (shih *appendix*).

Arellano - Bond test për AR (1) mbështetet në hipotezën zero se “nuk ka autokorelacion” dhe aplikohet për rrezidualet e diferencuara. Në rastin tonë kjo vlerë rezulton me 0.246.

Arellano - Bond test për AR (2), si test është më i rëndësishëm në diferencat e para ngase detekton autokorelacionin në nivele dhe synojnë të jenë me vlera sa më të larta. Në rastin tonë, ky test rezulton me 0.028.

Sargan testi mbështetet në hipotezën zero se “instrumentet si grup janë ekzogjene” prandaj sa më e lartë vlera e p-value sargan statistics aq më mirë. Në rastin tonë konkret kjo vlerë është 0.985.

Pra, me diagnostifikimin e GMM-it përmbylлим analizën empirike për testimin e variablës së parë varëse, përkatësisht pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto.

V.5.5. Diagnostifikimi i modelit në rastin e testimit të variables së dytë varëse (Pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto, në raport me normën e varësisë së pleqërisë)

Analiza empirike përfshinë edhe variablën e dytë të varur, respektivisht pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto, në raport me normën e varësisë së pleqërisë. Pra, përmes regresionit të thjeshtë linear dhe aplikimit të metodës së katrorëve të vegjël (OLS) testojmë efektet e variablave të pavarura në variablën e dytë të varur. Po ashtu, për diagnostifikimin e POOLED OLS Regression Model-it kemi vënë në përdorim testin e homogjenitetit dhe të heteroscedasticitetit.

Testi i homogjenitetit

Duke u nisur nga fakti se P-value (0.0540) është e njëjtë me nivelin e significancës (0.05), konstatojmë se hipoteza zero është e papranueshme (observimet nga mostra rezultojnë t’jenë kryesisht të rastësishme) respektivisht nuk kemi homogjenitet (shih *appendix*).

Testi i heteroskedasticitetit

Duke u bazuar në vlerën e probabilitetit $\text{Prob} > \chi^2 = 0.6876$ që është më e lartë se niveli i signifikançës (0.05), konstatohet se hipoteza zero është e papranueshme. Pra, vlerësojmë se kemi evidencë të heteroskedasticitetit në modelin tonë (shih *appendix*).

Diagnostifikimi i efekteve fikse

Meqë, F test that all $u_i = 0$, $F(9, 68) = 14.46$ dhe $\text{Prob} > F = 0.0000$ edhe në testimin e variablës së dytë varrëse vlerësojmë efektet fikse që trajtojnë marrëdhëniet mes shteteve të marra si mostër (shih *appendix*).

Diagnostifikimi i efekteve të rastit

Meqë $\text{Prob} > \chi^2 = 0.0000$ (më e vogël se 0.05) konstatohet se edhe në testimin e variablës së dytë varrëse modeli ynë është i përshtatshëm (shih *appendix*).

Diagnostifikimi nëse duhet të zgjedhim efektet fikse apo të rastit

Duke marrë për bazë $\text{Prob} > \chi^2 = 0.0014$ ($0.0014 < 0.05$), vlerësojmë se modeli i efekteve fikse është më i përshtatshëm (shih *appendix*).

Diagnostifikimi i GMM-it

Edhe gjatë testimit të variablës së dytë të varur vëmë në përdorim: Arellano - Bond test për AR (1), Arellano - Bond test për AR (2) dhe Sargan test (shih *appendix*).

Arellano - Bond test për AR (1), gjatë testimit të variablës së dytë varëse rezulton me vlerë prej 0.321.

Arellano - Bond test për AR (2), gjatë testimit të variablës së dytë varëse rezulton me vlerë prej 0.050.

Sargan testi që mbështet hipotezen zero në rastin e testimit të variablës së dytë varëse rezulton me vlerë prej 0.994.


Pra, me aplikimin e testeve paraprake përmbylлим analizën empirike dhe sjellim rezultatet për të njëjtat, përkatësisht për pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto dhe për pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto, në raport me normën e varësisë së pleqërisë.

V.6. Gjetjet nga analiza empirike

V.6.1. Gjetjet nga analiza empirike (faza e parë)

Siç e ekzaminuam më lartë, analiza jonë empirike konsiston në ndjekjen e dy fazave. Në vijim paraqesim interpretimin e rezultateve nga faza e parë, përkatësisht trendin e pjesëmarrjes së shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto dhe trendin e pjesëmarrjes së shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto në raport me normën e varësisë së pleqërisë për periudhën 2000 - 2015.


Grafik 1: Trendi i pjesëmarrjes së shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto, për periudhën 2000-2015



Burimi: Llogaritjet e autorit

Siç mund të vërehet edhe nga vetë grafiku i prezantuar më sipër, tek të gjitha shtetet pjesëmarrëse ekziston një trend rritës sa i përket pjesëmarrjes së shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto. Pra, krahasuar me shtetet pjesëmarrëse Greqia rangohet si shtet me pjesëmarrje më të lartë prej 17%, për të vijuar me Portugalinë me 15%, Slloveninë dhe Kroacinë me 11%, Republikën e Maqedonisë me 10%, Republikën Çeke dhe Hungarinë me 9%, për ta përmbyllur rangimin me Rumaninë dhe Bullgarinë me 8%. Ky trend rritës është kryesisht rrjedhojë e ndryshimit të faktorëve të ekzaminuar më lartë.

Grafik 2: Trendi i pjesëmarrjes së shpenzimeve pensionale në Prodhimin e Brendshëm Bruto, në raport me normën e varësisë së pleqërisë, për periudhën 2000-2015



Burimi: Llogaritjet e autorit

Sa i përket pjesëmarrjes së shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto në raport me normën e varësisë së pleqërisë vërehet se, në të gjitha shtetet pjesëmarrëse luhatjet kanë qenë shumë të vogla apo lëvizje deri në 1% rritje ose ulje.

V.6.2. Gjetjet nga analiza empirike (faza e dytë)

Gjetjet e analizës empirike nga faza e dytë konsistojnë në vlerësimin e modeleve të ekzaminuar më lartë, respektivisht vlerësimin e modeleve të regresionit panel për variablat e varura duke marrë për bazë koeficientin P- value që potencon se, vlerat e gjeneruara përgjatë analizës empirike duhet të jenë më të vogla se 0.05 që të tregojnë rezultate të besueshme.

Gjatë aplikimit të teknikës së GMM-it (që eliminon problemin e endogjenitetit), ne transformojmë variablën e varur në variabël të pavarur, respektivisht shfrytëzojmë dimensionin e serive kohore për të gjeneruar instrumente nga diferencat lagged të variablave duke zgjedhur problemin e lagged të variablës së varur si një variabël e pavarur (sqaruese) që po ashtu mund të ndërlidhet dhe të ndikojë në variablën e varur, përkatësisht në pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto. Rezultatet tregojnë se modelet janë të modeluar mirë, pasi që koeficienti lagged i pjesëmarrjes së shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto është statistikisht i rëndësishëm, respektivisht me nivel të besueshmërisë prej 99%. Duke u nisur nga kjo, në tabelën vijuese prezantojmë rezultatin e gjeneruar nga vlerësimi i ekuacionit të parë, përkatësisht pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto.

Tabela 83: Testmi i variablave shpjeguese dhe ndikimi i tyre në pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensione në Prodhimin e Brendshëm Bruto, për periudhën 2000-2015

Variablat/teknikat	OLS	Fixed Effects	Random Effects	GMM
	(SHP/PBB)	(SHP/PBB)	(SHP/PBB)	(SHP/PBB)
Pjesëmarrja e shpenzimeve të pensione në Prodhimin e Brendshëm Bruto (SHP/PBB) (epgdplagl - si variabël e pavarur e përdorur në GMM)	-	-	-	0.4088*** (0.002)
Norma e varësisë së pleqërisë (NVP) Odr (old-age dependency ratio)	0.0979*** (0.005)	0.3783*** (0.000)	0.0979** (0.014)	0.3790*** (0.001)
Jetëgjatësia deri në moshën 65 vjeç (J) Leat65 (life expectancy at age 65)	0.4214*** (0.000)	-0.0088 (0.939)	0.4214*** (0.000)	0.0702 (0.566)
Kohëzgjatja e marëdhënies së punës (KMP) Dwl (duration of working life)	0.1989** (0.045)	-0.1497 (0.403)	0.1989** (0.019)	-0.2089 (0.234)
Norma e punësimit për grup moshën 15-64 (NPG) Erateage1564 (employment rate in the age group 15-64)	-0.0974*** (0.003)	-0.1498*** (0.000)	-0.0974*** (0.002)	-0.1191*** (0.002)
Norma e punësimit për grup-moshën mbi 65 vjeç (NPG) Erover65 (employment rate in the age group over 65)	-0.2122*** (0.000)	-0.1612** (0.012)	-0.2122*** (0.000)	-0.1572** (0.012)
Rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) Gdpgrowth	-1.2721 (0.599)	-0.3048 (0.815)	-1.2721 (0.592)	-0.3020 (0.774)
Rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto për kokë banori Gdppercapita	1.0591 (0.660)	0.1422 (0.913)	1.0591 (0.655)	0.1623 (0.877)
Norma e zëvendësimit (NZ) Rrate (replacement rate)	1.5608 (0.237)	-2.8265** (0.022)	1.5608 (0.177)	-2.6121** (0.017)
Përqindja e popullsisë së përgjithshme që kanë përfunduar së paku arsimin e mesëm në grup moshën 55-64 vjeç (AM) Educa5564 (percentage of total population having completed at least upper secondary education in the age group 55-64 years)	0.0554*** (0.000)	-0.0465 (0.137)	0.0554*** (0.000)	-0.0559 (0.122)
Produktiviteti i punës Labprod (labour productivity)	0.1193* (0.072)	0.0936** (0.023)	0.1193* (0.074)	0.0827** (0.013)
Observimet Observations	83	83	83	70
R-Squared	0.9068	0.0262	0.9068	-
F	110.68	44.53	-	58.65
chi2	-	-	700.93	-
Arellano - Bond test for AR (1)	-	-	-	(0.246)
Arellano - Bond test for AR (2)	-	-	-	(0.028)
Sargan test	-	-	-	(0.000)
Model	OLS	Fixed Effects	Random Effects	GMM

Burimi: Llogaritjet e autorit

Shënim: (SH/PBB) ose (EP/GDP) është variabla e varur. Në kllapa ekzistojnë gabime të vlerësimit të parametrave dhe nivelet përkatëse të signifkancës: *sigifikancë të nivelit .10 ; ** të nivelit .05; *** të nivelit .01.

Në modelin e parë ekonometrik testojmë variablën e varur, pra pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto, kundrejt variablave tjera të pavarura (norma e varësisë së pleqërisë, jetëgjatësia deri në moshën 65 vjeç, kohëzgjatja e marrëdhënies së punës, norma e punësimit e grup moshës 15 - 64 vjeç, norma e punësimit e grup moshës mbi 65 vjeç, norma e zëvendësimit, përqindja e popullsisë së përgjithshme që kanë përfunduar së paku arsimin e mesëm në grup moshën 55-64 vjeç, rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe Prodhimit të Brendshëm Bruto për kokë banori). Rezultatet e gjeneruara tregojnë se:

- norma e varësisë së pleqërisë ka signifikançë dhe ndikim pozitiv tek të gjithë teknikat e zbatuara për vlerësimin e pjesëmarrjes së shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto, që njëkohësisht konfirmon se me rritjen e normës së varësisë së pleqërisë (pensionistët) rritet edhe pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto;
- jetëgjatësia deri në moshën 65 vjeç tregon signifikançë gjatë zbatimit të teknikës OLS dhe teknikës së efekteve të rastit, por jo edhe në rastin e efekteve fikse dhe GMM-it;
- kohëzgjatja e marrëdhënies së punës tregon signifikançë të nivelit .05 vetëm në teknikën e OLS-së dhe efekteve të rastit;
- norma e punësimit për grup moshën 15 - 64 vjeç tregon signifikançë dhe ndikim negativ tek të gjitha teknikat e vlerësimit, që do të thotë se çdo rritje prej 1% e normës së punësimit të grup moshës 15-64 vjeç do të ndikoj negativisht në pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto (do të ulë pjesëmarrjen e tyre në Prodhimin e Brendshëm Bruto);
- norma e punësimit për grup moshën mbi 65 vjeç ka ndikim negativ në pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto, pra tregon signifikançë të nivelit .01 në teknikën e OLS-së dhe efekteve të rastit dhe .05 në rastin e teknikës së efekteve fikse dhe të GMM-it (do të ulë pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto);
- norma e zëvendësimit sipas teknikave të vlerësimit tregon signifikançë të nivelit .05 vetëm në rastin e efekteve fikse dhe GMM-it, edhe pse ndikimi i tyre është negativ, pra çdo rritje prej 1% e normës së zëvendësimit do të rezultojë me -2.8265% dhe -2.6121% ulje të pjesëmarrjes së shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto;
- përqindja e popullsisë së përgjithshme që kanë përfunduar së paku arsimin e mesëm në grup moshën 55-64 vjeç, tregon signifikançë dhe ndikim pozitiv gjatë testimit në OLS dhe efekteve të rastit, por koeficientët nuk kanë vlerë të lartë;
- produktiviteti i punës tregon signifikançë të nivelit .05 gjatë testimit me teknikën e efekteve fikse dhe të GMM-it, dhe signifikançë të nivelit .10 në testimin e OLS-së dhe efekteve të rastit;

- rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe Prodhimit të Brendshëm Bruto për kokë banori nuk tregon signifikancë në asnjë lloj niveli apo teknikë të zbatuar në këtë model.

Kurse, në modelin e dytë ekonometrik bëjmë testimin e variablës së dytë të varur, respektivisht pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto në raport me normën e varësisë së pleqërisë, kundrejt variabla të tjera shpjeguese, por paraprakisht duke larguar nga seti i variabla të normës së varësisë së pleqërisë. Edhe në rastin e dytë shfrytëzojmë dimensionin e serive kohore për të gjeneruar instrumente nga diferencat lagged të variabla duke zgjedhur problemin e lagged të variablës së dytë të varur si një variabël e pavarur (squares). Rezultatet tregojnë se koeficienti lagged i pjesëmarrjes së shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto në raport me normën e varësisë së pleqërisë është statistiki i rëndësishëm me një nivel të besueshmërisë prej 95%. Në vijim prezantojmë rezultatet e gjeneruara nga vlerësimi i ekuacionit të dytë, përkatësisht pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto në raport me normën e varësisë së pleqërisë.

Tabela 84: Testimi i variabla shpjeguese dhe ndikimi i tyre në pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto në raport me normën e varësisë së pleqërisë, për periudhën (2000-2015)

Variablat/teknikat	OLS	Fixed Effects	Random Effects	GMM
	(SHP/PBB)/ NVP	(SHP/PBB)/ NVP	(SHP/PBB)/ NVP	(SHP/PBB)/ NVP
Pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto në raport me normën e varësisë së pleqërisë (SHP/PBB)/NVP (epgdpodr LL - si variabël e pavarur e përdorur në GMM)	-	-	-	0.2278** (0.089)
Norma e varësisë së pleqërisë (NVP) Odr (old-age dependency ratio)	-	-	-	-
Jetëgjatësia deri në moshën 65 vjeç (J) Leat65 (life expectancy at age 65)	0.0019 (0.597)	-0.0068 (0.287)	0.0019 (0.542)	-0.0046 (0.530)
Kohëzgjatja e marëdhënies së punës (KMP) Dwl (duration of working life)	0.0211*** (0.001)	-0.0020 (0.868)	0.0211*** (0.000)	-0.0029 (0.802)
Norma e punësimit për grup moshën 15-64 vjeç (NPG) Erateage1564 (employment rate in the age group 15-64)	-0.0036 (0.177)	-0.0009 (0.722)	-0.0036* (0.088)	0.0020 (0.426)
Norma e punësimit për grup-moshën mbi 65 vjeç (NPG) Erover65 (employment rate in the age group over 65)	-0.0079*** (0.000)	0.0013 (0.759)	-0.0079*** (0.001)	0.0009 (0.833)
Rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) Gdpgrowth	-0.1387 (0.260)	-0.0900 (0.331)	-0.1387 (0.378)	-0.0324 (0.650)
Rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto për kokë banori Gdpper capita	0.1308 (0.286)	0.0799 (0.387)	0.1308 (0.405)	0.0230 (0.746)
Norma e zëvendësimit (NZ) Rate (replacement rate)	0.1886** (0.016)	0.0284 (0.728)	0.1886*** (0.008)	0.1145 (0.113)
Përqindja e popullsisë së përgjithshme që kanë përfunduar së paku arsimin e mesëm në grup moshën 55-64 vjeç (AM) Educa5564 (percentage of total population having	0.0011** (0.013)	-0.0026 (0.225)	0.0011** (0.041)	-0.0032 (0.185)

completed at least upper secondary education in the age group 55-64 years)				
Produktiviteti i punës (PP) Labprod (labour productivity)	0.0028 (0.521)	0.0051 (0.075)	0.0028 (0.521)	0.0061*** (0.007)
Observimet Observations	83	83	83	70
R-Squared	0.5121	0.0542	0.5121	-
F	11.17	7.29	-	9.51
chi2	-	-	76.63	-
Arellano - Bond test for AR (1)	-	-	-	(0.321)
Arellano - Bond test for AR (2)	-	-	-	(0.050)
Sargan test	-	-	-	(0.000)
Model	OLS	Fixed Effects	Random Effects	GMM

Burimi: Llogaritjet e autorit

Shënim: (SH/PBB)/NVP ose (EP/GDP)/ODR është variabla e varur. Në kllapa ekzistojnë gabime të vlerësimit të parametrave dhe nivelet përkatëse të signifikançës: *sigifikancë të nivelit .10; ** të nivelit .05; *** të nivelit .01.

Rezultatet e gjeneruara nga testimi i variablës së dytë të varur rezultojnë me rezultate të ndryshme, skurse:

- kohëzgjatja e marrëdhënies së punës tregon signifikançë gjatë testimit me teknikën OLS-ë dhe teknikën e efekteve të rastit, që do të thotë se me rritjen e kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës për 1 %, rritet pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto në raport me normën e varësisë së pleqërisë për 0.0211 si në OLS-ë ashtu edhe në teknikën e efekteve të rastit;
- norma e punësimit për grup moshën mbi 65 vjeç rezulton me signifikançë negative gjatë testimit me OLS-ë dhe teknikën e efekteve të rastit, që do të thotë se me rritjen prej 1 % të normës së punësimit për grup moshën mbi 65 vjeç, ulet pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto në raport me normën e varësisë së pleqërisë për 0.0079%, si në OLS-ë ashtu edhe tek teknika e efekteve të rastit;
- norma e punësimit për grup moshën 15-64 vjeç, tregon signifikançë të nivelit .10 gjatë testimit me teknikën e efekteve të rastit, pra me rritjen prej 1 % të normës së punësimit për grup moshën 15-64 vjeç ulet pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve për -0.0036;
- norma e zëvendësimit tregon signifikançë dhe ndikon pozitivisht gjatë testimit në OLS-ë dhe gjatë efekteve të rastit, por jo signifikançë në GMM dhe gjatë efekteve fikse;
- përqindja e popullsisë së përgjithshme që kanë përfunduar së paku arsimin e mesëm në grup moshën 55-64 vjeç, tregon signifikançë të nivelit .05 dhe ndikim pozitiv gjatë testimit në OLS-ë dhe efekteve të rastit;
- produktiviteti i punës tregon signifikançë të nivelit .01 gjatë testimit në GMM edhe pse ky koeficient është pozitiv dhe shumë i ulët;

- së fundmi, edhe në modelin e parë edhe tek i dyti konstatohet se rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto për kokë banori nuk tregojnë ndonjë signifikancë pozitive ose negative në ndonjërin nga teknikat e zbatuara.

Pra, qëllimi kryesor i këtij studimi konsiston në analizimin e faktorëve tjerë që afektojnë shpenzimet e pensioneve, duke vënë në zbatim gjithsej katër teknika për testimin e të dy variablave të varura kundrejt gjithsej dhjetë variablave shpjeguese. Po ashtu, fakti që marrim për bazë dy variabla të varura dhe zbatohet më shumë teknika gjatë testimit të tyre, rezultojnë me rezultate të ndryshme, përkatësisht gjatë testimit të variablës së parë të varur treguesit që më së shumti afektojnë rritjen apo uljen e pjesëmarrjes së shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto janë: norma e varësisë së pleqërisë, jetëgjatësia deri në moshën 65 vjeç, kohëzgjatja e marrëdhënies së punës, norma e punësimit për grup moshën 15 - 64 vjeç, norma e punësimit për grup moshën mbi 65 vjeç, norma e zëvendësimit, përqindja e popullsisë së përgjithshme që kanë përfunduar së paku arsimin e mesëm në grup moshën 55-64 vjeç dhe produktiviteti i punës.

Sa i përket treguesëve në fjalë vlen të theksohet fakti se rezultatet dhe signifikanca e tyre nuk janë të gjeneruara nga një teknikë e vetme, por nga më shumë teknika që na bëjnë me dije edhe një herë se, përveç faktorëve demografik shpenzimet e pensioneve i afektojnë edhe faktorët tjerë të ekzaminuar më lartë. Kurse, gjatë testimit të variablës së dytë të varur edhe pse u aplikuan teknikat e njëjta të vlerësimit rezultatet ishin të ndryshme, gjegjësisht variablat që treguan një nivel signifikance ishin: kohëzgjatja e marrëdhënies së punës, norma e punësimit për grup moshën mbi 65 vjeç, norma e zëvendësimit, përqindja e popullsisë së përgjithshme që kanë përfunduar së paku arsimin e mesëm në grup moshën 55-64 vjeç dhe produktiviteti i punës.

V.7. Testimi i hipotezave

Siç e ekzaminuam më lartë, reformat e aprovuara pensionale në Republikën e Maqedonisë përgjatë periudhës transitorie vijuan kryesisht nga lëvizjet demografike dhe treguesit ekonomik. Reformat e aprovuara gjegjëse, kishin për qëllim konsolidimin e Fondit për sigurim pensional dhe rruajtjen e aftësisë paguese afatgjate, përkatësisht sigurimin e mjeteve për pagesat e pensioneve. Pra, duke marrë për bazë faktin se lëvizjet demografike dhe treguesit ekonomik shkaktuan nevojën për konsolidim të sistemit pensional të Republikës së Maqedonisë, e njëkohësisht për të argumentuar të njëjtën, ngritëm edhe hipotezën kryesore dhe ato ndihmëse për ta mbështetur studimin në fjalë. Mirëpo, se sa këto hipoteza mbështesin studimin tonë, në tabelat vijuese sjellim edhe testimin e tyre:

Tabela 85: Testimi i hipotezës kryesore

Testimi i hipotezës kryesore	Pranojmë ose hedhim poshtë (për testimin e hipotezës kryesore shërbehemi me rezultatet nga ekzaminimi i secilit tregues demografik dhe ekonomik)
1. Indikatorët ekonomik dhe trendi i parametrave demografik bëjnë që sistemi pensional i Republikës së Maqedonisë, të jetë jo i qëndrueshëm.	Gjatë ekzaminimit të treguesëve ekonomik konstatuam se: ▪ raporti në vlerë pagë - pension nga viti 1994 - 2017 është ulur për 7.8% (nga 66.2% në 58.4%); ▪ Indeksi i kostos së jetesës nga viti 1994 - 2017 është rritur për 21.1%; ▪ paga neto është rritur deri në 23.850 denarë në vitin 2017, mirëpo harmonizimi plotësues i pensioneve në vitin 2008 dhe 2013 (me vendimin e qeverisë) ngarkoi financiarisht më shumë Fondin për sigurim pensional dhe invalidor; ▪ norma e rritjes reale e Prodhimit të Brendshëm Bruto nga viti 1994 prej 3.4% është ulur në 0.2%; ▪ raporti i punësuar - pensioner nga 2.2 në vitin 1994 është ulur në 1.9 në vitin 2017. Kurse, gjatë ekzaminimit të treguesëve demografik konstatuam se: ▪ projeksionet e popullsisë tregojnë se në vitin e fundit të periudhës së projeksionit, gjegjësisht në vitin 2100 Republika e Maqedonisë pritet të humbas ¼ e numrit aktual të popullsisë; ▪ nataliteti (lindjet e gjalla) nga viti 1980 - 2017 është ulur për 45.22% (nga 39.784 në 21.754 lindje të gjalla); ▪ norma e fertilitetit nga 2.1 fëmijë për grua në vitin 1994 arrin në 1.38 fëmijë për grua në vitin 2015 dhe pritet të arrijë deri në 1.73 në vitin 2055; ▪ mortaliteti shënon rritje për 29% për periudhën 1994 - 2017 (nga 15.771 në 20.318 të vdekur); ▪ rritja natyrore për periudhën 1994 - 2017, nga 17.716 në vitin 1994 është ulur deri në 1.373 në vitin 2017); ▪ jetëgjatësia në Republikën e Maqedonisë nga viti 1960 prej 60.63 arrin në 76.41 vjeç në vitin

	2017 dhe pritet të arrijë deri në 78.00 në vitin 2080 (mesatarisht deri në 5 vite gratë për dallim nga burrat jetojnë më gjatë); ▪ jetëgjatësia prej momentit të daljes në pension për periudhën 2012-2050 në tre skenarët e mundshëm lëvizën, sikurse: në skenarin optimist jetëgjatësia prej daljes në pension rritet nga 15.22 - 16.28 për burrat dhe nga 19.05 - 20.83 për gratë; në skenarin bazik nga 15.29 - 17.65 për burrat dhe 19.18 - 22.41 për gratë; dhe në skenarin pesimist nga 15.37- 19.09 për burrat dhe 19.33-23.22 për gratë; ▪ martesat nga viti 1994 - 2017 janë zvogëluar për 13% (nga 15.736 në 13.781), kurse divorcet janë rritur për 69% (nga 612 në 1.994). Sa i përket testimit të hipotezës kryesore, duke marrë për bazë lëvizjen e treguesëve ekonomik dhe atyre demografik, konstatojmë se: <i>Indikatorët ekonomik dhe trendi i parametrave demografik, bëjnë që sistemi pensional i Republikës së Maqedonisë, të jetë jo i qëndrueshëm, dhe rrjedhimisht hipoteza kryesore është e pranueshme.</i>
--	---

Për mbështetjen e hipotezës kryesore kemi ngritur gjithsej 8 hipoteza ndihmëse të cilat i testojmë përmes teknikave të aplikuara në fazën e dytë të analizës empirike.

Tabela 86: Testimi i hipotezave ndihmëse

Testimi i hipotezave ndihmëse	Pranojmë ose hedhim poshtë (për testimin e hipotezave ndihmëse shërbehe mi teknikat e aplikuara në studim, sikurse: OLS, efektet fikse, efektet e rastit dhe GMM)
1. Rritja ekonomike dhe trendi i punësimit bëjnë që sistemi pensional i Republikës së Maqedonisë deri në vitin 2055, të jetë plotësisht i varur nga burimet shtesë të financimit, respektivisht nga buxheti.	Gjatë ekzaminimit të Prodhimit të Brendshëm Bruto që nënkupton rritjen ekonomike dhe ndikimin në sistemin pensional, posaçërisht gjatë transformimit në sistem pensional me më shumë shtylla, konstatuam se, kjo e fundit mund të arrihej vetëm nëse: ▪ rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto arrin në nivelin e 3%-shit, e me këtë rritje të ekonomisë pas 20 viteve deficitit do të ullej dhe bilanci i Fondit për sigurim pensional dhe invalidor do të kalonte në suficit; ▪ rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto arrin deri në 4.5%, e me këtë Republika e Maqedonisë shumë më lehtë do të arrinte në konsolidimin e sistemit pensional dhe uljen e pjesëmarrjes së buxhetit. Mirëpo, Republika e Maqedonisë nuk arriti t'i përmbush

	projeksionet e Bankës Botërore në drejtim të uljes së deficitit financiar si rezultat i mos zhvillimit të mjaftueshëm të ekonomisë pas periudhës së pavarësisë (prej 2% në 3%) dhe si rezultat i privatizimit të kompanive shtetërore (vetëm një pjesë e vogël e kompanive të privatizuara vazhduan të funksionojnë). Kurse, gjatë ekzaminimit të trendit të punësimit konstatuam se, për reforma të suksesshme pensionale papunësia në Republikën e Maqedonisë, duhej që: ▪ deri në vitin 2010 të zvogëlohej në 28%; ▪ deri në vitin 2012 të arrijë në nivelin e 26.5%; ▪ punësimi deri në vitin 2015 të arrijë në 55% (sipas objektivit kombëtar të Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian). Mirëpo, si rezultat i gjendjes reale ekonomike Republika e Maqedonisë dy projeksionet e para arrit t'i përmbush 3 vite më vonë, pra në vitin 2015 e jo në vitin 2012 (sa këto punësime kanë qenë reale shërbehuni me temën V.2.3)! Andaj, si rrjedhojë e mos realizimit të projeksioneve të parapara ishte e nevojshme sigurimi i burimeve shtesë - nga buxheti qëndrorë. Sa i përket testimit të hipotezës së parë ndihmëse, bazuar në projeksionet e rritjes ekonomike sipas Bankës Botërore dhe gjendjen reale të tyre, konstatojmë se: <i>Rritja ekonomike dhe trendi i punësimit bëjnë që sistemi pensional i Republikës së Maqedonisë, të jetë plotësisht i varur nga burimet shtesë të financimit, respektivisht nga buxheti, e me këtë hipoteza në fjalë është e pranueshme.</i>
2. Rritja reale e pagave, rritja e kostos së jetesës, papunësia dhe rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto, rezonojnë të jenë me rezultate negative në gjendjen aktuale të sistemit pensional të Republikës së Maqedonisë.	Gjatë ekzaminimit të rritjes reale të pagave, konstatuam se: ▪ sipas skenarit optimist rritja reale e pagave duke marrë për bazë vitin 2013 nga 4% pritet të arrijë në 3.60% në vitin 2055; ▪ sipas skenarit pesimist nga 4% në vitin 2013 pritet të ulet deri në 2.10% në vitin 2055. Gjatë ekzaminimit të rritjes së kostos së jetesës, konstatuam se: ▪ nga viti 1995 - 2001 indeksi i kostos së jetesës shënon rritje deri në 10.7% (nga 100% në vitin 1995 në 110.7% në vitin 2001); ▪ në vitin 2002 indeksi i kostos së jetesës shënon një ulje deri në 101.1%, që vijoi deri në vitin 2007; ▪ nga viti 2008 - 2017 shënon rritje të vazhdueshme duke ndikuar në rritjen e pensionit (pavarësisht se me një normë më të ulët krahasuar me rritjen e pagës neto);

	▪ nga viti 1995 - 2017 indeksi i kostos së jetesës shënon një rritje prej 21.1%, duke e rritur në këtë mënyrë barrën financiare të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor. Gjatë ekzaminimit të papunësisë, konstatuam se: ▪ nga viti 2004 - 2012 papunësia arrin normën më të lartë; ▪ nga viti 2013 - 2017 norma e papunësisë fillon të ulet në nivelin e 30 - shit; ▪ nga viti 2004 - 2017, norma e papunësisë është ulur për 15.2%, ose për 95.722 të punësuar. Mirëpo, nëse kihet parasysh ndryshimet që u bënë në listën e evidencës së të papunëve vetëm para disa viteve dhe strukturën e punësimit (sektori privat apo publik), bën të kuptojmë se këto shifra duhet marrë me një dozë rezervë (shifra të fryra)! Gjatë ekzaminimit të Prodhimit të Brendshëm Bruto, konstatuam se: ▪ kriza e vitit 2001 e dëmtoi strukturën e përgjithshme të rritjes së Prodhimit të Brendshëm Bruto pas periudhës së pavarësisë, ashtu që rritja prej -4.5% në vitin 2001, 0.9% në vitin 2002 dhe 2.2% në vitin 2003, ndikuan negativisht në ekonominë kombëtare, e me këtë edhe në sistemin pensional të Republikës së Maqedonisë; ▪ rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto nga viti 2004 - 2008 kishte për qëllim zhvillimin e ekonomisë kombëtare; ▪ kriza globale financiare në vitin 2009 ndikoi edhe një herë negativisht në rritjen dhe zhvillimin e ekonomisë në nivel botëror dhe në nivel kombëtar; ▪ pas krizës financiare të vitit 2009 Republika e Maqedonisë e humbi vazhdimësinë e rritjes së Prodhimit të Brendshëm Bruto (zvogëlim prej 2% - 3%); ▪ norma e Prodhimit të Brendshëm Bruto në vitin 2012 arriti deri në -0.5%; ▪ pas vitit 2012 e këndej, norma e rritjes së Prodhimit të Brendshëm Bruto filloi të lëviz pozitivisht deri në 2.9% në vitin 2013; ▪ nga vitit 2014 - 2016 norma e rritjes së Prodhimit të Brendshëm Bruto lëviz në margjinat e 2%-shit; ▪ në vitin 2017 norma e rritjes së Prodhimit të Brendshëm Bruto shënon një ulje duke arritur në nivelin e 2.6%. Sa i përket testimit të hipotezës së dytë ndihmëse përmes ekzaminimit të treguesëve ekonomik, konstatojmë se: <i>rritja reale e pagave, rritja e kostos së jetesës, papunësia dhe rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto, rezonojnë të jenë me rezultate negative në gjendjen aktuale të sistemit pensional të vendit tonë, ngase</i>
--	--

	<i>intensiteti i rritjes është i pamjaftueshëm për të përballuar dinamikën dhe trendin e parametrave pensionale, prandaj hipoteza në fjalë është e pranueshme.</i>
3. Faktorët (për dallim nga ato demografik) që ulin pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto janë faktorët që lidhen me tregun e punës dhe faktorët që lidhen me prodhimin vendor.	Gjatë testimit të faktorëve të tregut të punës, konstatuam se: ▪ kohëzgjatja e marrëdhënies së punës tregon signifikançë të nivelit .05 vetëm në teknikën e OLS-së dhe efekteve të rastit; ▪ norma e punësimit e grup moshës mbi 65 vjeç ka ndikim negativ në pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto, pra tregon signifikançë të nivelit .01 në teknikën e OLS-së dhe efekteve të rastit (me rritjen e 1% të normës së punësimit për grup moshën mbi 65 vjeç, ulët pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto për -0.0974 në teknikën e OLS-së dhe efekteve të rastit) dhe signifikançë të nivelit .05 në rastin e teknikës së efekteve fikse dhe të GMM-it (me rritjen e 1% të normës së punësimit për grup moshën mbi 65 vjeç, ulët pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto për -0.1498 në teknikën e efekteve fikse dhe për -0.1191 në rastin e GMM-it); ▪ norma e punësimit për grup moshën 15 - 64 vjeç tregon signifikançë dhe ndikim negativ tek të gjitha teknikat e vlerësimit, pra me rritjen e normës së punësimit për grup moshën 15-64 vjeç për 1%, ulët pjesëmarrja e shpenzimeve të pensionit për -0.0974 në teknikën e OLS-së dhe efekteve të rastit, për -0.1498 në teknikën e efekteve fikse dhe për -0.1191 në rastin e GMM-it. Gjatë testimit të faktorëve të produktit kombëtar, konstatuam se: ▪ Rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto për kokë banori si në modelin e parë ashtu edhe në modelin e dytë nuk treguan ndonjë ndikim. Kjo e fundit është si rezultat i mospërputhjes së projeksioneve të parapara për rritjen e Prodhimit të Brendshëm Bruto për 3% dhe për 4.5%; ▪ norma e zëvendësimit sipas teknikave të vlerësimit tregon signifikançë të nivelit .05 në rastin e efekteve fikse dhe GMM-it, pra çdo rritje prej 1% e normës së zëvendësimit do të rezultojë me uljen e pjesëmarrjes së shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto për - 2.8265% në rastin e efekteve fikse dhe për -2.6121% në rastin e GMM-it.

	Sa i përket testimit të hipotesës së tretë ndihmëse, bazuar në teknikën e OLS-së, efekteve fikse, efekteve të rastit dhe në GMM, konstatojmë se: faktorët (për dallim nga ato demografik), që ulin pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto janë faktorët që lidhen me tregun e punës dhe me prodhimin vendor, andaj hipoteza në fjalë është e pranueshme.
4. Me rritjen e kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës ulet edhe pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto.	Gjatë testimit të kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës në Panel Data konstatuam se, variabla në fjalë tregon signifikançë të nivelit .05 vetëm në teknikën e OLS-së dhe efekteve të rastit (asnjë signifikançë në teknikën e efekteve fikse dhe të GMM-it) pra, me rritjen e kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës për një 1%, do të rritet pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto për 0.1989. Sipas rezultatit të gjeneruar nga Panel Data konstatojmë se, hipoteza : me rritjen e kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës, ulet pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto nuk është e pranueshme.
5. Me rritjen e normës së varësisë së pleqërisë dhe jetëgjatësisë rritet edhe pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto.	Gjatë testimit të faktorëve demografik, konstatuam se: ▪ norma e varësisë së pleqërisë ka signifikançë dhe ndikim pozitiv tek të gjithë teknikat e aplikuara, gjegjësisht me rritjen e normës së varësisë së pleqërisë për 1%, do të rritet pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto për 0.0979 (në rastin e OLS-së dhe efekteve të rastit), për 0.3783 në rastin e efekteve fikse dhe për 0.3790 në rastin e GMM-it. ▪ jetëgjatësia deri në moshën 65 vjeç tregon signifikançë të nivelit .01 gjatë aplikimit të teknikës së OLS-ë dhe efekteve të rastit, pra me rritjen e jetëgjatësisë deri në moshën 65 vjeç për 1%, do të rritet pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto për 0.4214. Sa i përket testimit të hipotezës së pestë ndihmëse, bazuar në teknikat e ekzaminuara më lartë konstatojmë se, hipoteza: me rritjen e normës së varësisë së pleqërisë dhe jetëgjatësisë, rritet edhe pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto është e pranueshme.
6. Përqindja më e lartë e personave të edukuar (nga moshë 55-64 vjeç) rrit edhe pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve	Gjatë testimit të hipotezës ndihmëse në fjalë, konstatuam se: ▪ përqindja e popullsisë së përgjithshme që kanë përfunduar së paku arsimin e mesëm në grup moshën 55-

në Prodhimin e Brendshëm Bruto;	64 vjeç, tregon signifikançë të nivelit .01 në teknikën e OLS-së dhe efeteve të rastit, gjegjësisht me rritjen e përqindjes së personave të edukuar nga moshë 55-64 për 1% rritet edhe pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto për 0.0554. Sa i përket testimit të hipotezës së gjashtë ndihmëse konstatojmë se, hipoteza: <i>përqindja më e lartë e personave të edukuar (nga moshë 55-64 vjeç) rrit edhe pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto, është e pranueshme.</i>
7. Pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto në raport me normën e varësisë së pleqërisë (pensionistët) është negativisht e lidhur me indikatorët demografik dhe tregut të punës;	Gjatë testimit të faktorëve demografik dhe të tregut të punës në rastin e modelit të dytë, konstatuam se: ▪ jetëgjatësia si variabël e pavarur në modelin e dytë nuk tregon asnjë lloj signifikançe në asnjërin nga teknikat e aplikuara; ▪ norma e punësimit e grup moshës mbi 65 vjeç rezulton me signifikançë negative të nivelit .01, pra me rritjen prej 1 % të normës së punësimit për grup moshën mbi 65 vjeç, ulet pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto në raport me normën e varësisë së pleqërisë për -0.0079% si në OLS-ë ashtu edhe tek teknika e efekteve të rastit; ▪ norma e punësimit për grup moshën 15-64 vjeç, tregon signifikançë të nivelit .10 gjatë testimit me teknikën e efekteve të rastit, gjegjësisht me rritjen prej 1 % të normës së punësimit për grup moshën 15-64 ulet pjesëmarrja e shpenzimeve të pensionit për -0.0036; Sa i përket testimit të hipotezës së shtatë ndihmëse duke marrë parasysh largimin e varësisë së pleqërisë nga seti i variablave shpjeguese vërejmë se: jetëgjatësia deri në moshën 65 vjeç nuk tregon asnjë lloj signifikançe, kurse faktorët e tregut të punës (me përjashtim vetëm të kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës), janë të lidhur negativisht me pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto, në raport me normën e varësisë së pleqërisë. Andaj edhe në këtë rast konstatojmë se hipoteza në fjalë: <i>pjesëmarrja e shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto në raport me normën e varësisë së pleqërisë (pensionistët) është negativisht e lidhur me indikatorët demografik dhe të tregut të punës, është e pranueshme.</i>
8. Masat e uljes së informalitetit në ekonomi	Gjatë ekzaminimit të ekonomisë informale dhe ndikimin e saj në

në përgjithësi kanë ndikim në të ardhurat e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor.	Fondin për sigurim pensional dhe invalidor, konstatuam se: ▪ Ulja e ngarkesës tatimore ndikon në uljen e ekonomisë informale; ▪ Ulja e ngarkesave administrative për komunitetin e bizneset ndikon në uljen e ekonomisë informale; ▪ Zvogëlimi i transfereve sociale të paguara nga qeveria ndikon në uljen e ekonomisë informale; ▪ Përmirësimi i rregullativës për bërjen e biznesit ndikon në uljen e ekonomisë informale; ▪ Uja e nivelit të korrupsionit ndihmon uljen e ekonomisë informale; ▪ Përmirësimi i ulët dhe efikasiteti i sundimit të ligjit ngadalëson zvogëlimin e ekonomisë informale. Sa i përket testimit të hipotezës së fundit ndihmëse duke marrë në konsideratë dëmtimin financiar që ju shkaktua Fondit për sigurim pensional dhe invalidor nga rritja e vazhdueshme e punësimit informal, konstatojmë se hipoteza e fundit ndihmëse: <i>masat e uljes së informalitetit në ekonomi në përgjithësi kanë ndikim në të ardhurat e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor është e pranueshme.</i>
--	--

Pra, gjatë testimit të hipotezave të ngritura në fillim të studimit bazuar në rezultatet e gjeneruara nga aplikimi i teknikave të ekzaminuara më lartë, edhe një herë konstatojmë se faktorët demografik dhe të tregut të punës si në modelin e parë ashtu edhe në të dytin paraqesin faktorët që më së shumti afektojnë shpenzimet e pensioneve, dhe rrjedhimisht qëndrueshmërinë financiare të sistemit pensional të Republikës së Maqedonisë.

V.8. Krijimi i skenarëve

Pas testimit të hipotezave të ngritura në fillim të studimit dhe njëkohësisht konfirmimin e gjendjes aktuale të sistemit pensional të Republikës së Maqedonisë, ky studim mori përsipër që përmes përdorimit të modelit bazë *ARIMA* të sigurojë në veçanti parashikimet e të gjithë treguesëve të përfshirë në studim, të vlerësoj tendencat e këtyre treguesëve, respektivisht ndikimin e tyre në sistemin pensional të Republikës së Maqedonisë. Kjo e fundit nënkupton implikimin e një analize të të dhënave serike kohore përmes modelit të servie autoregresive të rendit të parë *AR(1)*, me koeficientë 1 të variablës autoregresive të pavarur me mbetje kohore 1, që ndryshe këto seri kohore quhen Random Wals Series (Chatfield, 2000).

Pë rrjedhojë, një seri kohore paraqet një sërë matjesh të bëra për të njëjtit tregues përgjatë kalimit të viteve, e për këtë arsye edhe vlerësimet e të dhënave të përdorura në këtë studim janë vjetore. Pra, një model autoregresiv shërben për të gjetur vlerën e serive kohore përmes regresionit të vlerave të mëparshme nga seria e njëjtë kohore, duke rregulluar vlerat e mëparshme nga seria e njëjtë.

$$y_t = \beta_0 + \beta_{1yt-1} + \varepsilon_t$$

Në këtë model regresioni variabla e pavarur në periudhën e mëparshme bëhet parashikues, kurse gabimet kanë parashikimet e zakonshme, përfshirë dhe gabimet që hasen në një model të thjeshtë regresioni linear. Sekuenca e një autoregresioni është numri i drejtpërdrejt i vlerave të mëparshme në seri që shfrytëzohen për të parashikuar vlerën në kohën e tashme (aktuale), sikurse (Gujarati, 2003):

Vlera e tashme = vlera e kaluar + pjesa që nuk mund të parashikohet

Pra, ana e majtë e barazisë paraqet variablat e varura (regresantët), kurse ana e djathtë e barazisë paraqet variablat e pavarura (regresorët).


Për më tej, të dhënat që shfrytëzohen për vlerësimin e AR (1) janë të dhëna historike me seri kohore vjetore mbi karakteristikat financiare dhe demografike të popullsisë së Republikës së Maqedonisë për periudhën 1994 - 2017. Po ashtu, të dhënat janë të disponueshme në burimet zyrtare, sikurse: Fondi për sigurime pensional dhe invalidor, Enti shtetëror statistikor dhe Ministria e financave e Republikës së Maqedonisë. Andaj, duke shfrytëzuar softuer-in STATA, tabela vijuese pasqyron në veçanti parashikimet për të gjithë treguesit individualë. Shfrytëzimi i modelit *ARIMA* dhe regresioni na mundëson të gjenerojmë një parashikim për të gjithë treguesit e përshkruar në pjesën e metodologjisë. Duke marrë për bazë këtë të fundit, shifrat e mëposhtme prezantojnë rezultatet e vlerave aktuale dhe pasqyrojnë vlerat e tyre të parashikuara deri në vitin 2057.

Tabela 87: Rezultatet e parashikimeve të treguesëve demografik dhe financiar (ARIMA model), për periudhën 2017-2057 (në denarë)

ARIMA model	Situata aktuale	Situata e parashikuar (pa reforma)		
Vitet/treguesit	2017	2027	2037	2057
Tëardhurat nga kontributet	33.454.250.000	43.020.380.000	52.285.720.000	71.021.690.000
Të ardhurat nga buxheti	27.607.140.000	38.408.390.000	48.971.980.000	70.791.160.000
Te ardhurat e përgjithshme	63.691.110.000	84.836.830.000	104.913.300.000	145.851.000.000
Shpenzimet e pensioneve	49.809.980.000	66.483.660.000	81.730.770.000	112.945.700.000
Shpenzimet e përgjithshme	63.382.280.000	83.566.900.000	103.062.900.000	143.186.400.000
Numri i të punësuarëve	573.427	611.684	653.728	746.470
Numri i pensionistëve	309.645	349.500	389.606	470.061
Nataliteti	22.430	17.422	13.465	5.791
Mortaliteti	20.727	22.880	25.024	26.313
I punësuar/ penzioner	1.88	1.72	1.57	1.31
	Situata aktuale	Situata e parashikuar (me reformën e të ardhurave nga kontributet duke e rritur normën e kontributit deri në 22% dhe uljen e të ardhurave nga buxheti për atë ndryshim)		
Vitet/treguesit	2017	2027	2037	2057
Të ardhurat nga kontributet	34.835.850.000	45.412.137.000	55.215.190.000	75.298.700.000

Përpos të dhënave të analizuara me anë të modelit Random Wals Series, për një pasqyrim më të qartë të vlerave të parashikuara në formën e grafikoneve (veçmas për treguesit demografik dhe veçmas ato financiar) sjellim edhe parashikimin e tyre.

Grafik 3: Parashikimet për treguesit demografik të popullsisë së Republikës së Maqedonisë për periudhën 2017-2057




Vija e kaltërt që përfundon në vitin 2017 shënon vlerën e vërtetë, kurse vija e kuqe dhe e ndërprerë shënon vlerat e parashikuara

Sipas vlerës së p-value më e vogël se niveli i significances prej 0.05 mund të konkludohet se, koeficientët për *termin* auto-regresiv janë statistikisht të rëndësishme dhe ruhen në model. Po ashtu, qasja e përdorur në rastin tone është modeli AR (1) i përshtatur për vlerësimin e parashikimit të të gjithë treguesëve individualë duke filluar nga treguesit demografik e më pas për treguesit financiar. Me shfrytëzimin e të dhënave historike për periudhën 1994 - 2017, koeficienti *ARIMA L1*, tregon vlerësime statistikore të rëndësishme në nivel të significancës prej 1%, për të gjithë treguesit e përdorur në këtë analizë. Duke u nisur nga kjo, gjetjet për treguesit demografik tregojnë se:

- numri i të punësuarëve deri në vitin 2057 do të rritet për 30.1%;
- numri i pensionistëve krahasuar me vitin 2017 do të rritet për 51.8%;
- nataliteti deri në vitin 2057 do të zvogelohet për 74.1%;
- mortaliteti si tregues demografik deri në vitin 2057 do të rritet për 26.9% .

Grafik 4: Parashikimet për treguesit financiarë të sistemit pensional të Republikës së Maqedonisë për periudhën 2017 - 2057



Vija e kaltërt që përfundon në vitin 2017 shënon vlerën e vërtetë, kurse vija e kuqe dhe e ndërprerë shënon vlerat e parashikuara

Kurse, gjetjet për treguesit financiar rezultojnë me atë se:

- të ardhurat nga buxheti deri në vitin 2057 do të rriten për 156.4% ;
- shpenzimet e pensioneve krahasuar me vitin 2017 do të rriten për 126.7%;
- shpenzimet e përgjithshme deri në vitin 2057 do të rriten për 125.9%;

- të ardhurat e përgjithshme deri në vitin 2057 do të rriten për 128.9%;
- të ardhurat nga kontributet deri në vitin 2057 do të rriten për 112.2%;
- raporti i punësuar - pensioner deri në vitin 2057 do të arrijë në 1.31.

Megjithkëtë, duke marrë parasysh pamundësinë tonë për të ndikuar në përmirësimin e treguesëve demografik të cilët njëkohësisht do të ndikojnë në përmirësimin e treguesëve financiar, erdhëm në konstatimin që të analizojmë vetëm ndikimin e treguesëve të ndryshëm financiar në saldo bilansin e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor, rrjedhimisht të dizajnohet një model i qëndrueshëm i financimit të sistemit pensional pavarësisht rritjes apo uljes së demografisë. Fillimisht, shprehëm interesim për vlerësimin e të ardhurave nga kontributet për sigurim pensional dhe invalidor, por, për shkak të korelacionit të madh mes numrit të të punësuarëve dhe të ardhurave të gjeneruara nga këto kontribute, rezultuam me rezultate joshnifikante. Andaj, bazuar në të dhënat e disponueshme dhe njëkohësisht duke marrë në konsideratë pengesat e mësipërme, konsideruam si të nevojshme vlerësimin e modelit vijues:

$$\text{Saldo-Bilanci} = \beta_0 + \beta_1 \text{shpenzimet e përgjithshme} + \beta_2 \text{të ardhurat nga buxheti} + \beta_3 \text{shpenzimet e pensioneve} + \beta_4 \text{numri i të punësuarëve} + \beta_5 \text{nurmi i pensionistëve}$$

Tabela 88: Rezultatet nga analiza e regresionit (OLS) për sistemin aktual pensional të Republikës së Maqedonisë

Metoda e katrorëve të vegjël (OLS)		
Variablat e pavarura	Variabla e varur: saldoja neto e bilancit të FSPI-së	
	Koeficienti	Gabimi standard
Shpenzimet e përgjithshme	-0,616***	0,199
Të ardhurat nga buxheti	0,367***	0,077
Shpenzimet e pensioneve	0,263	0,241
Numri i të punësuarëve	0,011**	0,004
Numri i pensionistëve	0,092***	0,017
Konstanta	-19495,87	4240,61
Numri i viteve	24	
F (5, 18)	9,62	
Prob> F	0.0001	
R-squared	0.7011	

Burimi: Kalkulim i autorit me STATA 13

Rezultatet e modelit mund të interpretohen si në formën vijuese:

$$\text{Saldo-Bilanci} = -19495 - 0,616 \text{shpenzimet e përgjithshme} + 0,367 \text{të ardhurat nga buxheti} + 0,263 \text{shpenzimet e pensioneve} + 0,011 \text{numri i të punësuarëve} + 0,092 \text{nurmi i pensionistëve}$$

Përparësia e këtij modeli është thjeshtësia dhe fakti se parametrat janë lehtë të interpretueshme dhe me shenjat sipas pritjeve (hipotezave), përveç numrit të pensionistëve që pritej të jetë me shenjë negative, kurse rezultati është me koeficientë pozitiv. Duke u nisur nga rezultatet e gjeneruara, ndikimi i tyre në bilancin neto të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor mund të interpretohet, sikurse:

- konstanta prej -19.945 milion denarë paraqet gjendjen fillestare me deficit të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor;
- me rritjen e shpenzimeve të përgjithshme për një njësi, saldoja e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor zvogëlohet ose deficitin rritet për 0.616 denarë;
- me rritjen e pjesëmarrjes së të ardhurave buxhetore për një njësi, saldoja e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor rritet ose deficitin zvogëlohet për 0.367 denarë;
- me rritjen e numrit të të punësuarëve për një njësi, saldoja rritet ose deficitin zvogëlohet për 0.011 të punësuar;
- me rritjen e numrit të pensionistëve për një njësi, saldoja e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor rritet ose deficitin zvogëlohet për 0.092, sa i përket numrit të pensionistëve.

Pra, sipas analizës së regresionit si parametra statistikisht të rëndësishëm shfaqen shpenzimet e përgjithshme, të ardhurat buxhetore, numri i të punësuarëve dhe numrii pensionistëve - parametra këto, që anojnë funksionimin normal të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor të Republikës së Maqedonisë, duke e bërë akoma më të vështirë rrualtjen e aftësisë paguese afatgjate.

KAPITULLI VI: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Konkluzionet që dalin nga ky studim do t'i sistemoj si në vijim:

1. Sistemi pensional përfaqëson një sfidë të vazhdueshme si për ligjvënësit, rregullatorët, ashtu edhe për pensionistët. Andaj, dilema kyçe e shumë shteteve të zhvilluara dhe atyre në tranzicion mbetet pikërisht drejtimi i zhvillimit të sistemit pensional, struktura dhe performanca e tij.

2. Sistemi pensional që nga themelimi e deri më sot funksionon në bazë të parimit të solidaritetit mes brezave dhe ka për qëllim krijimin e fondeve për pensionistët dhe rruajtjen e nivelit pothuajse të njëjtë të jetesës.

3. Ndryshimet në strukturën demografike sollën vështirësi në drejtim të zbatimit të parimit të solidaritetit mes brezave, përkeqësime në sistemet pensionale, përfshirë krijimin e borxheve në fondet pensionale, përkatësisht ndërmarrjen e reformave pensionale në mbarë botën.

4. Reformat pensionale paraqesin një kategori dinamike dhe të vazhdueshme që haset si në shtetet e zhvilluara, në zhvillim ashtu edhe në shtetet në tranzicion. Reformat pensionale synonin realizimin e së drejtës për sigurimin pensional dhe invalidor për të gjithë gjeneratat, realizimin afatshkurtër dhe afatgjatë të aftësisë paguese, përforcimin e besueshmërisë së publikut dhe stimulimin e zhvillimit të tregjeve të kapitalit, gjegjësisht inkurajimin e rritjes ekonomike.

5. Objektivat e sistemit pensional shpesh herë ngatërohen me mbrojtjen sociale e cila po ashtu trajton sfidat e varfërisë, cënueshmërisë dhe përjashtimeve sociale, ndonëse ekzistojnë dallime thelbësore mes pensionit dhe mbrojtjes sociale në aspekt të administrimit dhe financimit.

6. Në aspekt të administrimit edhe pse disa programe të mbrojtjes sociale mund të ngjasojnë me pensionet, prap se prap nuk administrohen si skemë pensionale. Pensionet paraqesin përfitime të cilat sigurohen nga individit duke paguar në një skemë pensionale apo që paguhet nga punëdhënësi.

7. Në aspekt të financimit pensionet financohen në mënyra të ndryshme përmes kontributit në një skemë pensionale ose hapjes së një llogarie bankare si formë kursimi, që do luajë rolin e pensionit në moshën e pleqërisë.

8. Nevoja e transformimit të sistemit PAYG në skemë pensionale plotësisht të financuar, gjegjësisht lidhja e kursim - investimeve rezultoi me krijimin e modelit klasik, neoklasik dhe alternativën e tretë “Klasik - Keynesian”.

9. Modeli klasik favorizoi reformën e skemës pensionale plotësisht të financuar që mori në konsideratë investimin e kursimeve të akumuluar, kurse modeli neoklasik konsideroi pay-as-you-go si të dëmshëm për kapitalin e akumuluar.

10. Modeli i tretë “Klasik - Keynesian” u bazuan në kohëzgjatjen e postulave Keynesiane të investimeve të pavaruara nga kursimi, përkrahës të sistemit PAYG ose të paktën neutral në lidhje me akumulimin dhe me çfarëdo qoftë reforme që synonte nxitjen e kursimit si të dëmshëm për rritjen e kërkesës agregate.

11. Duke iu referuar modelit të tretë “Klasik - Keynesian”, ekonomistët dalluan dy pozita “Klasike-Keynesiane” edhe atë: grupi i parë që i atribuohen teorisë kritike të kapitalit të teorisë së Keynes’it, rrjedhimisht kufizojnë rolin e kërkesës efektive në rastet e periudhës afatshkurtër, dhe grupi i dytë që i atribuohet identifikimit të mekanizmave që janë prapa rregullimit të kursimeve për investime afatgjate.

12. Sipas grupit të parë, ngurtësia e normës së interesit ose reagimi i ngadaltë i investimeve në rast të rënies së normave të interesit parandalon rënien e pagave nominale ose zgjerimin e ofertës së parasë duke dërguar ekonominë përsëri në punësim të plotë.

13. Sipas grupit të dytë (teorisë së kërkesës efektive afatgjate), motori i rritjes ekonomike përfaqësohet nga komponenti autonom ose final i kërkesës agregate, rrjedhimisht nuk varet nga niveli aktual ose i pritjes së të ardhurave reale të krijuara nga vendimet e firmave për të prodhuar dhe që përbëhen nga konsumi autonom, shpenzimet qeveritare dhe eksportet.

14. Shpenzimet sociale përfaqësojnë një motor të rritjes ekonomike duke shkaktuar implikime mikroekonomike dhe makroekonomike, të elaboruara përmes modelit të ciklit jetësor dhe modelit të mbivendosjes së gjeneartave.

15. Modeli i ciklit jetësor mbështetet në idenë e një individi racional dhe mirë i informuar, që planifikon konsumin e tij gjatë ciklit jetësor bazuar kryesisht në parashikimet e tij për të ardhurat jetësore dhe në vëzhgimin empirik se konsumi agregat për kokë banori është më pak i qëndrueshëm në krahasim me të ardhurat agregate për kokë banori.

16. Studimet e hershme empirike rreth modelit të ciklit jetësor konstatuan se: pensionet shtetërore pakësojnë nevojën për të kursyer privatisht për dalje në pension; pensionet private profesionale rrisin kursimet dhe inkurajojnë pensionimin e parakohshëm; si dhe pensionet private personale gjithashtu rritin kursimet, por nukurajojnë pensionimin e mëvonshëm.

17. Modeli i mbivendosjes së gjeneratave Diamond - Samuelson, fillon me një individ përfaqësues nga secili brez, e më pas grumbullohet tek të gjithë individët që njëkohësisht jetojnë. Sjellja e individëve, kompanive dhe qeverive në modelin OLG-ë, supozohet që me kalimin e kohës të ndikoj në sjelljen dinamike të ekonomisë.

18. Modeli më i thjeshtë i mbivendosjes së gjeneratave konsiderohet modeli i dy periudhave, respektivisht të rinjve dhe pleqërisë. Pra, në çdo moment ekzistonte brezi i ri dhe brezi i vjetër, që rezultoi me vështirësi gjatë transformimit të skemës PAYG në skemë pensionale plotësisht të financuar.

19. Vështirësitë e transformimit nga skema PAYG në skemën pensionale plotësisht të financuar i barti gjenerata e tranzicionit në dy raste, edhe atë: kur oferta e punës dhe dalja në pension u konsideruan ekzogjene dhe në rastin kur oferta e punës dhe dalja në pension u konsideruan endogjene.

20. Kur oferta e punës dhe dalja në pension u konsideruan ekzogjene ishte e pamundur të realizohet zhvendosja nga skema PAYG në një skemë pensionale të financuar, pa mos e përkeqësuar gjeneratën e tranzicionit që duhet të paguajë si për pensionin e vet të financuar plotësisht, ashtu edhe për pensionin PAYG të gjeneratës së mëparshme.

21. Kur oferta e punës dhe dalja në pension u konsideruan endogjene dhe u përgjigjen taksave, kalimi gradual nga skema PAYG në një skemë të financuar ishte e mundur dhe madje duke e përmirësuar mirëqenien, për aq kohë sa taksat e pashtrembëruara gjetën përdorim në fazën e tranzicionit.

22. Transformimet paraprake, mundësuan sendërtimin e një sistemi pensional me shumë shtylla, andaj për njerëzit që jetonin në vendet e zhvilluara ishte konvencionale të flitej për sistem pensional shumë shtyllësh dhe për sistem pensional të strukturuar në plane pensionale, fonde pensionale dhe ente pensioni.

23. Shtylla e parë si pjesë e sistemit të sigurimeve sociale sigurohet nga shteti dhe në këtë drejtim njihen dy lloje të sistemeve të sigurimeve sociale: Beveridge dhe Bizmarck. Sistemi Bizmarck siguron një standard jetësor të balancuar përgjatë jetës së të sigurvearit, kurse sistemi Beveridge fokusohet në ofrimin e nivelit ekzistencial për të sigurvearit.

24. Pavarësisht dallimeve në funksionim sistemet Beveridge dhe Bizmarck synonin reduktimin e varfërisë dhe pabarazinë e të ardhurave, rrjedhimisht nxitjen e kohezionit social dhe përmirësimin e efikasitetit të ekonomisë, sigurisë individuale dhe lehtësimin e rreziqeve sociale.

25. Pjesa më e madhe e skemave pensionale të shtyllës së parë janë jofinanciare, të definuara për nga natyra apo skema me kontribute të përcaktuara imagjinare, të njohura ndryshe si pay-as-you-go.

26. Skemat pensionale të shtyllës së parë janë skema të pafinancuara ku anëtarët kanë llogari individuale të kontributeve të përcaktuara, kurse skemat me kontribute të përcaktuara - të financuara, kontributet e anëtarëve të vendosura në llogaritë individuale nuk janë të “financuara”, pra, mjetet e akumuluar në llogaritë individuale të anëtarëve nuk investohen në instrumentet e tregjeve financiare, por janë të lidhura me normën e rritjes së Prodhimit të Brendshëm Bruto, ose me normën e rritjes së të ardhurave mesatare kombëtare (me variabla jofinanciare).

27. Skema me kontribute të përcaktuara imagjinare dallon nga skema me kontribute të përcaktuara të financuara në dy aspekte: së pari në lidhje me kontributin e tyre potencial në kursimet kombëtare, dhe së dyti ndryshojnë në raport me normën e sistemit të kthimit.

28. Shtylla e dytë sigurohet nga kompanitë në formën e skemave ose planeve pensionale profesionale, pra, fondet e pensioneve profesionale financohen nga fondi i mjeteve pensionale të grumbulluara nga kontributet ose shpërblimet e paguara nga punëdhënësi dhe punonjësi, si dhe nga kthimi i investimeve nga kontributet e investuara.

29. Ndonëse pjesa më e madhe e skemave pensionale profesionale janë të financuara, prap se prap, llogaritja e përfitimeve të pensionit ndryshon shumë mes llojeve të ndryshme të skemave pensionale profesionale. Duke u nisur nga kjo, skemat në fjalë i klasifikojmë në skema pensionale me përfitime të përcaktuara, me kontribute të përcaktuara dhe skema pensionale hibrid apo me origjinë të përzier.

30. Skema pensionale me përfitime të përcaktuara siguron një pension të paracaktuar, qoftë në monedhë absolute ose si një pjesë e një mase të pagës - përqindje e përcaktuar e pagës përfundimtare ose një mesatare e pagës së viteve të fundit.

31. Në skemat pensionale me kontribute të përcaktuara, kontributet mund të jenë shuma fikse vjetore ose përqindje fikse e pagës, e se pensioni varet nga vlera e fondit të akumuluar deri në kohën e daljes në pension.

32. Dallimi kryesor mes skemës pensionale me përfitime të përcaktuara dhe me kontribute të përcaktuara qëndron në atë se, në skemën e parë rezultati përfundimtar është i definuar, kurse tek skema e dytë rezultati përfundimtar është i ndryshueshëm.

33. Përpos përparësisë së zgjedhjes mes skemave pensionale me përfitime të përcaktuara dhe kontribute të përcaktuara, ekzistojnë edhe dallime në mënyrën e financimit. Tek skema pensionale PAYG pjesëmarrësit e tanishëm janë të obliguar të derdhin kontribute për të paguar përfitimet e pensionistëve të tanishëm, kurse tek skema pensionale me kontribute të përcaktuara fondet e akumuluar në shtyllën e dytë investohen më tej në asete të tregtueshme ose jo të tregtueshme.

34. Skemat pensionale përpos që dallojnë në aspekt të mënyrës së financimit, po ashtu hasin në përparësi dhe mangësi kundrejt njëra tjetrës. Pra, skemat pensionale me përfitime të përcaktuara ofrojnë përfitime të qëndrueshme, sponsorizuesi i skemës bartën rrezikun, shpërndanë rrezikun e investimit dhe ofron sigurim kundrejt jetëgjatësisë.

35. Skemat pensionale me përfitime të përcaktuara kërkojnë të mbështeten nga struktura të fuqishme të qeverisjes, për t'u siguruar se fonde të mjaftueshme janë investuar për të përmbushur detyrimet e ardhshme.

36. Skema pensionale me kontribute të përcaktuara lejon përputhjen e flukseve të parasë së gatshme me nevojat eventuale, individit bart rrezikun dhe ka të drejtë zgjedhje në investime, si dhe lejon që pasuria të trashëgohet. Po ashtu, kërkojnë një grup të arsimuar për të siguruar normat e përshatshme të zëvendësimit në pension.

37. Skemat paraprake edhe pse ofrojnë përparësi kundrejt njëra tjetrës, prap se prap gjatë dizajnit optimal të një skeme pensionale paraqiten edhe një mori pengesash reale, sikurse: zgjedhja dhe performanca e investimit, modelet përkatëse, përfundimi dhe lehtësia në bartje (transferimi), stimujt, ekonomitë informative në hartimin dhe zbatimin e skemës pensionale, rreziku nga vijueshmëria e pagave, rreziku i normës së interesit, etj.

38. Infrastrukturat e ndryshme të sistemeve pensionale gjeneruan stimuj të ndryshëm për politik-bërësit dhe politikat e ndryshme pensionale, duke i klasifikuar më tej shtetet në: shtete të sigurimeve sociale, Bismarckian Lite, shtete me sistem pensional me shumë shtylla dhe shtete me sisteme pensionale jo të plota.

39. Tek shtetet e sigurimeve sociale sistemet pensionale u konsideruan si një kontratë sociale mes shtetit dhe qytetarëve, duke ua deleguar menaxhimin e pensioneve partnerëve social. Po ashtu, politika e reformës pensionale karakterizohej nga zbatimi i politikave të politik - bërësve dhe shmangia e fajit.

40. Tek shtetet “Bismarckian Lite” madhësia e vogël e pensionit shtetëror siguroi qëndrueshmëri financiare gjatë gjithë tranzicionit demografik, shkurtimet e pensioneve dhe rritjes së fondeve ishin rezultat i vendimeve politike dhe u realizuan lehtë pasi që shteti nuk mbante përgjegjësi, duke përfshirë edhe sigurimin vullnetar profesional që ndikohej nga plakja e popullsisë.

41. Tek shtetet me sistem pensional me shumë shtylla transferimi mes brezave kryhet përmes kombinimit të skemave PAYG dhe instrumenteve të financuara, kurse pensioni bazë financohet nga skema PAYG që ekspozohet ndaj të njëjtave probleme të lidhura me plakjen e popullsisë.

42. Tek pensionet e financuara nga sistemet pensionale me shumë shtylla qeveritë nuk janë drejtpërdrejt përgjegjëse për përcaktimin e nivelit të përfitimeve të pensionit, gjegjësisht përfitimi pensional varet nga rregullat që janë në fuqi, performanca e tregut të aksioneve, aftësitë menaxheriale të menaxherit të fondeve dhe nga fati.

43. Bazuar në politikën e reformës pensionale, kombinimin e shteteve që u përkasin grupit të “sigurimeve sociale”, “Bismarckian Lite” dhe atyre me shumë shtylla, konstatojmë se evolucionin i reformave pensionale në krijimin e sistemeve pensionale në shtetet e zhvilluara, në zhvillim dhe atyre në tranzicion, u shkaktua nga faktorët po thuajse të njëjtë, por me një dallim paraqitje për një dekadë më vonë.

44. Reformat pensionale në shtetet e zhvilluara u nxitën kryesisht nga ndikimi i presioneve të ndryshme, sikurse: plakja e popullsisë, rritja e ulët e të ardhurave, jetëgjatësia, fertiliteti, shfrytëzimi i programeve të mirëqenies në mënyrë joproporcionale nga ana e të moshuarve, për të mos anashkaluar edhe presionet e faktorëve ekonomik.

45. Reformat pensionale në shtetet në zhvillim ndodhën gjatë viteve 90 - ta e këndej, kishin të bëjnë me inkorporimin e shtyllës së dytë si rrjedhojë e presioneve të shumta nga: plakja e popullsisë, reduktimi aktiv i forcës punëtore, inkuadrimi i vonshëm i të rinjve në tregun e punës, efektiviteti i ulët i pensioneve vullnetare private, rritja graduale e moshës së daljes në pension, vendosja e një lidhje mes kontributeve dhe pagesave të përfitimeve, shfrytëzimi i privilegjeve të pensioneve të hershme, dalja e parakohshme në pension, etj.

46. Reformat pensionale në shtetet në tranzicion kishin për qëllim konsolidimin e shtyllës së parë dhe përgatitjen e sistemeve me komponentin e financimit kapitl. Të gjitha reformat parametrike në shtetet në tranzicion synonin racionalizimin e sistemeve ekzistuese dhe diversifikimin e rreziqeve demografike dhe atyre ekonomike.

47. Reformat pensionale parametrike në shtetet në tranzicion ishin të orientura në: krijimin e një sistemi pensional që do t'ju përshtatej ndryshimeve radikale të ndodhura në rendin politik, ekonomik e social; ruajtjen e të drejtave sociale dhe ekonomike në fushën e sigurimeve sociale; unifikimin gradual të moshës së pensionit dhe të periudhës së kontribuimit në skemë gjatë një periudhe të caktuar kohore; garantimin e fondeve për të siguruar pagesat e pensioneve; reduktimin e pjesëmarrjes së buxhetit në drejtim të financimit të sigurimeve sociale, përmirësimin dhe përforcimin e sistemit të financimit publik; krijimin e një fondi të fortë pensional që do të plotësojë nevojat e klientëve; ofrimin e mundësive për zbatimin e skemave të reja të sigurimeve sociale të bazuara në kushtet e tregut, etj.

48. Republika e Maqedonisë (si shtete në tranzicion) përgjatë periudhës transitore pësoi në reforma pensionale dhe të sistemit pensional. Këto reforma kishin për qëllim konsolidimin e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor dhe sigurimin e mjeteve për pagesat e pensioneve, për personat që plotësojnë kushtet ligjore për dalje në pension.

49. Reformat pensionale parametrike në Republikën e Maqedonisë kishin për qëllim përgatitjen e sistemit pensional me tre shtylla, edhe atë: shtylla e parë që përfshinë sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor në bazë të solidaritetit të gjeneratave, shtylla e dytë sigurimin pensional të detyrueshëm me financim kapital dhe shtylla e tretë sigurimin pensional vullnetar në bazë të kursimit të kapitalizuar individual.

50. Reformat e aprovuara pensionale në Republikën e Maqedonisë mundësuan që nga 1 janar i vitit 2006, të filloj implementimi i sistemit të reformuar pensional ku rolin kryesor vazhdon ta luaj Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i Republikës së Maqedonisë.

51. Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i Republikës së Maqedonisë bën transferimin e kontributeve për sigurim pensional dhe invalidor në llogaritë personale të siguruesve, realizimin e së drejtës për sigurim pensional dhe invalidor dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare për sigurim social konform ligjit për sigurim pensional dhe invalidor.

52. Në shtyllën e parë dhe të dytë të sistemit të detyrueshëm pensional të Republikës së Maqedonisë përfshihen të gjithë të punësuarit në bazë të marrëdhënies së punës dhe kryerjes së veprimtarisë, kurse në shtyllën e tretë përfshihen të gjithë personat që ndajnë mjete sipas dëshirës (vullnetarët).

53. Me menaxhimin e mjeteve që grumbullohen në shtyllën e parë qeverisën Fondi për sigurim pensional dhe invalidor, kurse me mjetet që grumbullohen në dy shtyllat tjera menaxhojnë kompanitë private pensionale, sikurse: KB Shoqëria e parë pensionale dhe NLB Fondi i ri pensional që në mars të vitit 2018 u riemërtua në Shoqëria e pensioneve Sava sh. a Shkup.

54. Riemërtimi i NLB Fondit të ri pensional vijoi si rrjedhojë e shitjes së 100% të aksioneve kompanisë slovene Sava Re DD., Ljubljana, që konsiderohet si një grup i fuqishëm dhe me një reputacion të gjerë ndërkombëtar.

55. Anëtarët e Fondit pensional të detyrueshëm në Republikën e Maqedonisë e fitojnë të drejtën e pensionit nga shtylla e dytë në momentin që e fitojnë të drejtën për pension pleqërie sipas ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, pra një pension marrin nga Fondi për sigurim pensional dhe invalidor dhe tjetrin nga institucioni i autorizuar për pagesën e pensionit nga shtylla e dytë.

56. Në Republikën e Maqedonisë të gjithë anëtarët marrin pjesërisht pension pleqërie, familjar dhe pension invalidor nga shtylla e parë, sipas formulës së përcaktuar që përfshinë përqindjen e përcaktuar në varësi të viteve të shërbimit (përvoja), shumëzuar me bazën e pensionit e përcaktuar nga pagat e valorizuara gjatë gjithë kohës që i siguruari ka qenë në marrëdhënie pune.

57. Pjesa tjetër e pensionit për anëtarët e Republikës së Maqedonisë, realizohet nga shtylla e dytë sipas një zgjedhje të anëtarit në njërin nga format e ofruara, edhe atë: përmes anuitetit pensional, tërheqjes së programuar apo përmes një kombinimi mes anuitetit pensional dhe tërheqjes së programuar.

58. Përpos Shoqërisë së pensioneve Sava sh.a Shkup me shtyllën e dytë menaxhon edhe KB Shoqëria e parë pensionale. KB Fondi i parë i hapur dhe i detyrueshëm pensional Shkup është themeluar dhe menaxhohet nga ana e KB Shoqërisë së parë pensionale SHA Shkup. Po ashtu, përbehet nga mjetet e gjeneruara prej kontributeve të anëtarëve të kësaj Shoqërie.

59. Mjetet e KB Fondit të parë të detyrueshëm pensional janë të ndara nga mjetet e KB Shoqërisë së parë pensionale SHA Shkup, nën rrualtjen e Bankës kujdestar me qëllim që të arrihet një nivel sa më i lartë i siguri së këtyre mjeteve.

60. Investimi i mjeteve të grumbulluara nga anëtarët e Shoqërisë së pensioneve Sava sh.a Shkup dhe KB Shoqërisë së parë pensionale, realizohet konform rregullave të rrepta ligjore për sigurim pensional të detyrueshëm me financim kapital dhe në harmoni me strategjitë dhe taktikat investuese të tyre.

61. Karakteristikë kryesore e Shoqërisë së pensioneve Sava sh.a Shkup dhe KB Shoqërisë e parë pensionale mbetet menaxhimi privat dhe konkurrues që mundëson menaxhimin e fondeve pensionale, investimin e kontributeve të paguara dhe diversifikimin e rreziqeve nga investimet e bëra (përfshirë edhe diversifikimin ndërkombëtar).

62. Shtylla e tretë e sistemit pensional e Republikës së Maqedonisë paraqet mënyrën e re të sigurimit pensional me financim kapital në bazë të kontributeve të përcaktuara vullnetarisht. Kjo shtyllë, për dallim nga siguri i detyrueshëm pensional me financim kapital përfshinë personat të cilët dëshirojnë të sigurojnë një volum të lartë të sigurisë materiale.

63. Me mjetet e grumbulluara në shtyllën me financim kapital në bazë të kontributeve të përcaktuara vullnetarisht, menaxhojnë të njëjtat kompani që menaxhojnë me mjetet e grumbulluara në shtyllën e dytë.

64. Shtylla e tretë mundëson sigurimin pensional vullnetar kolektiv, përkatësisht punëdhënësit paguajnë mjete shtesë për sigurim pensional për një grup të caktuar, ose për të gjithë të punësuarit e tyre.

65. Në bazë të shumës dhe periudhës së pagimit të mjeteve shtesë për sigurim pensional, kontributeve të derdhura dhe kthimit të investimit, përcaktohet edhe shuma e mjeteve të akumuluar që përdoren më tej për pagimin e kontributeve pensionale nga ana e Shoqërisë së pensioneve Sava Sh.a Shkup dhe KB fondit të parë të hapur vullnetar pensional.

66. Anëtarët e shtyllës së tretë për dallim nga shtylla e dytë e fitojnë të drejtën e kontributeve pensionale 10 vite përpara moshës së daljes në pension (konform Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor), si dhe janë të obliguar të bëjnë zgjedhjen jo më vonë se moshë 70 vjeç (kompanitë i informojnë për obligimet e zgjedhjes).

67. Për mbikëqyrjen e mjeteve të investuara nga ana Shoqërisë së pensioneve Sava Sh.a Shkup dhe KB Shoqërisë së parë pensionale, kujdeset Agjencioni për mbikëqyrjen e sigurimit pensional me financim kapital.

68. Agjencioni për mbikëqyrjen e sigurimit pensional me financim kapital u themelua në korrik të viti 2002, dhe kontrollon punën e Shoqërisë së pensioneve Sava Sh.a Shkup dhe KB Shoqërisë së parë pensionale, për t'i mbrojtur interesat e anëtarëve të fondeve pensionale.

69. Po ashtu, Agjencioni për mbikëqyrjen e sigurimit pensional me financim kapital është person juridik dhe përgjegjës për lëshimin, revokimin dhe heqjen e licencave për themelimin e shoqërive pensionale, menaxhimin me fondet pensionale dhe nxjerrjen, revokimin dhe anulimin e lejeve për menaxhimin me fonde pensionale të detyrueshme dhe vullnetare.

70. Me formimin e shtyllës së tretë kompletohet sistemi pensional i Republikës së Maqedonisë që parasegjithash synoi minimizimin e problemeve afatgjate të sistemit pensional aktual, uljen e pasigurisë financiare dhe tejkalimin e vështirësive demografike të shprehura përmes zvogëlimit të numrit të punësuarëve dhe rritjes së numrit të pensionerëve.

71. Projektimi i qëndrueshmërisë së sistemit pensional të Republikës së Maqedonisë arrihet përmes krijimit të një bazë të dhënash të përshtatshme dhe të besueshme që përfshin disa elemente, edhe atë: pensionistin dhe të siguruan, pensionet dhe llojet e tyre, projeksionet e popullsisë, të ardhurat dhe shpenzimet e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor, Fondin për sigurim pensional dhe invalidor, si dhe ndikimin e fondeve private tek ai shtetëror.

72. Pensionisti si objektiv kryesor i Fondit për sigurim pensional dhe invalidor luan rolin e njëjtë me të siguruan, ngase nga numri i përgjithshëm i pensionistëve varet situata financiare e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor. Kurse, i siguruari përfaqëson elementin e dytë sa i përket rëndësisë prej ku varet trendi i elementeve tjerë dhe korrelacioni mes tyre.

73. Pensionet po ashtu luajnë një rol të rëndësishëm gjatë projektimit të qëndrueshmërisë së sistemit pensional të Republikës së Maqedonisë. Rregullimi i pensioneve në Republikën e Maqedonisë bëhet konform nenit 37 të ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, duke marrë për bazë lëvizjen e kostos së jetesës deri në 50%, dhe rritjen e pagës mesatare deri në lartësi prej 50%.

74. Rregullimi plotësues i pensioneve me vendimin e qeverisë së Republikës së Maqedonisë është bërë në vitin 2008 (prej 5% - 8%) dhe në vitin 2013, kurse sa i përket pjesëmarrjes më të madhe në gjithsej pensionet e ndara shënojnë pensionet e pleqërisë. Pjesa tjetër u përket pensioneve familjare dhe atyre invalidor.

75. Projeksionet e popullsisë si element i bazës së të dhënave vazhdon të nxisë shqetësim jo vetëm në shtetet në tranzicion, por edhe në vendet e Bashkimit Evropian. Ky shqetësim më së miri theksohet në fjalimin e deputetit Laszlo Andor në vitin 2012 përpara parlamentit Evropian, i cili këmbënguli për ndërmarrjen e reformave pensionale.

76. Sipas Laszlo Andor reformat pensionale duhet të orientohen në tre drejtime, edhe atë: në rritjen e moshës së daljes në pension, rritjen e mundësive për të moshuarit që të mos e braktisin tregun e punës dhe në stimulimin e pensionistëve të ardhshëm për të investuar sa më shumë tek fondet pensionale vullnetare.

77. Të ardhurat e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor si element i bazës së të dhënave janë mjaft të rëndësishëm ngase nga të ardhurat varet kryesisht qëndrueshmëria dhe funksionimi i Fondit për sigurim pensional dhe invalidor i Republikës së Maqedonisë. Të

ardhurat e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor mund të rriten përmes rritjes së numrit të të siguruarve, rritjes së kontributeve për sigurim pensional dhe rritjes së pagave.

78. Shpenzimet e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor po ashtu zënë një rol të rëndësishëm në bazën e të dhënave. Nga viti 2006 e këndej, Fondi për sigurim pensional dhe invalidor filloi realizimin e shpenzimeve mbi bazë të transferimit të mjeteve në fondet pensionale private për kontributin për sigurim pensional dhe invalidor për anëtarët që kishin qasje në fondet pensionale private.

79. Rritja e shpenzimeve pensionale në dekadën e fundit rezultoi parasegjithash nga ndërmarrja e reformave pensionale në drejtim të: rrjedhjes apo kullimit të kontributeve në shtyllën e dytë, deficitit strukturor si rezultat i mos ekuilibrit të të ardhurave dhe shpenzimeve, zvogëlimit të kontributeve dhe bazës më të ulët për llogaritjen dhe pagesën e kontributeve.

80. Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i Republikës së Maqedonisë, si element i bazës së të dhënave është në korrelacion me të gjitha elementet tjera të sistemit pensional, sikurse: të siguruarit, pensionistët, pensionet dhe llojet e tyre, të ardhurat dhe shpenzimet e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor, etj.

81. Ndikimi i fondeve private tek ai shtetëror si element i fundit i bazës së të dhënave ka të bëjë me ristrukturimin e sistemit pensional, rrjedhimisht ofrimin e pensioneve përmes kombinimit të shtyllës së parë dhe të dytë, ndonëse nevojitet kohë e gjatë për ndarjen e tyre. Sipas parashikimeve aktuale pensionet e para që do të ndahen nga të dy shtyllat priten të realizohen në vitin 2025, kurse fuqia punëtore deri në vitin 2036 do të kalojë në shtyllën e dytë.

82. Krijimi i bazës së të dhënave për projektimin e qëndrueshmërisë së sistemit pensional të Republikës së Maqedonisë mundësohet përmes analizës së trendit të elementeve të bazës së të dhënave, e që njëkohësisht ndikojnë në dizajnimin e strukturës së bazës së të dhënave duke marrë për bazë segmentin demografik, ekonomik dhe financiar.

83. Në tablon e supozimeve demografike përpos lëvizjes së përgjithshme të popullsisë në drejtim të qëndrueshmërisë së sistemit pensional një rol të rëndësishëm zënë edhe supozimet mbi natalitetin, fertilitetin, mortalitetin, jetëgjatësinë, etj.

84. Bazuar në dinamikën e treguesëve të përgjithshëm demografik për periudhën 1994 - 2017, konstatohet se: popullsia mesatare është rritur për 6.3 %, nataliteti është zvogëluar për 35%, norma e fertiliteti është zvogëluar deri në 1.38 fëmijë për grua, jetëgjatësia mesatare është rritur deri në 76.41 vjeç, mortaliteti është rritur për 29%, numri i foshnjeve të vdekura

është zvogëluar për 73%, rritja natyrore është ulur për 92%, martesat janë zvogëluar për 13% dhe divorcet janë rritur për 69%.

85. Disa nga arsyet që ndikuan në përkeqësimin e treguesëve demografik janë: ndryshimi në strukturën e moshës dhe në strukturën shoqërore të popullsisë, braktisja e vlerave tradicionale, shmangia e përgjegjësisë së krijimit të familjes, ndryshimi në strukturën e moshës dhe në strukturën shoqërore të popullsisë, pasiguria rreth kushteve të përgjithshme të jetesës, etj.

86. Përpos faktorëve demografik një ndikim të rëndësishëm në funksionimin e gjithëmbarshtëm të sistemit pensional të Republikës së Maqedonisë zënë edhe faktorët ekonomik, sikurse: Prodhimi i Brendshëm Bruto, rritja reale e pagave dhe e kostos së jetesës, papunësia, etj.

87. Gjatë ekzaminimit të Prodhimit të Brendshëm Bruto për periudhën 1998-2017, konstatojmë se: kriza e vitit 2001 dhe kriza globale financiare e vitit 2009 dëmtuan strukturën e përgjithshme të rritjes së Prodhimit të Brendshëm Bruto (prej -4.5% në vitin 2001, 0.9% në vitin 2002, 2.2% në vitin 2003 dhe nga vitit 2004-2011 shënohet ulje prej 2%-3% në normat e Prodhimit të Brendshëm Bruto). Në vitin 2012 norma e Prodhimit të Brendshëm Bruto shënoi nivelin më të ulët (-0.5%), kurse nga vitit 2012 e këndeje kjo normë filloi të lëviz pozitivisht duke arritur në vitin 2017 deri më 2.6%.

88. Gjatë ekzaminimit të rritjes reale të pagave konstatojmë se: sipas skenarit optimist rritja reale e pagave duke marrë për bazë vitin 2013 nga 4% pritet të arrijë në 3.60% në vitin 2055, kurse sipas skenarit pesimist nga 4% në vitin 2013 pritet të ulet deri në 2.10% në vitin 2055.

89. Gjatë ekzaminimit të rritjes së kostos së jetesës për periudhën 1995-2017, konstatojmë se: nga viti 1995 - 2001 indeksi i kostos së jetesës është rritur për 10.7% (nga 100% në vitin 1995 në 110.7% në vitin 2001), kurse nga vitit 2002-2007 indeksi i kostos së jetesës shënoi ulje deri në 101.1%, për të vijuar me një rritje permanente deri në vitin 2017. Pra, nga viti 1995-2017 indeksi i kostos së jetesës është rritur për 21.1%.

90. Gjatë ekzaminimit të papunësisë për periudhën 2004 - 2017, konstatojmë se: nga viti 2004 - 2012 papunësia arrin normën më të lartë, kurse nga viti 2013 - 2017 norma e papunësisë fillon të ulet nën nivelin e 30 %-shit. Pra, nga vitit 2004 - 2017 norma e papunësisë është ulur për 15.2% ose për 95.722 të punësuar (edhe pse këto shifra konsiderohen si të fryra dhe duhet marrë me një dozë rezervë).

91. Në varësi të lëvizjes së treguesëve ekonomik varet rritja apo ulja e të ardhurave burimore të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor. Pra, çdo rritje e Prodhimit të brendshëm Bruto nënkupton rritje të punësimit dhe të pagave të punonjësve, rrjedhimisht një

bazë më e madhe për llogaritjen e kontributeve për sigurim pensional dhe invalidor (të ardhura më të larta për Fondin për sigurim pensional dhe invalidor).

92. Çdo ndryshim në treguesit demografik dhe ekonomik shkakton ndryshime në segmentin financiar duke krijuar nevojën për krijimin e sistemit pensional me më shumë shtylla, e me këtë edhe rritjen e shpenzimeve të tranzicionit që shteti mori përsipër t'i mbulojë.

93. Pamundësia e mbulimit të shpenzimeve të tranzicionit nga ana e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor ishte si rezultat i goditjes së parametrave mbi të cilat u mbështeten reformat pensionale, sikurse: ulja e kontributeve, kullimi i tyre në shtyllën e dytë, pensionistët e rinj, etj.

94. Shpenzimet e tranzicionit janë të karakterit të përkohshëm që filluan në vitin e parë të reformës pensionale dhe vazhdojnë të rriten. Në vitin 2020 pritet të arrijnë nivelin e 1.29% të PBB-së, maksimumin prej 1.56% të Prodhimi të Brendshëm Bruto do e arrijnë në vitin 2030, kurse në vitin 2045 do të përfundojnë së bashku me forcimin e shtyllës së dytë duke zvogëluar barrën financiare të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor.

95. Ulja e kontributeve nga 21.2% në 19% përfaqëson reduktim për 10% të të ardhurave nga kontributet, kurse në 18% zvogëlim për 15% të kontributeve për sigurim pensional, ose reduktim të të ardhurave për 15% në kushte ku faktorët tjerë mbeten të pandryshuar.

96. Kullimi i kontributeve apo përfundimi i tyre në shtyllën e dytë nënkupton konvertimin e normës së përgjithshme të kontributeve për sigurim pensional (11.7% në shtyllën e parë dhe 6.3% në shtyllën e dytë), kurse pensionistët e rinj përfaqësojnë njerëzit të cilët mund të punojnë, por për arsye të ndryshme arrijnë të marrin pension dhe ta ngarkojnë financiarisht edhe më tepër Fondin për sigurim pensional dhe invalidor të Republikës së Maqedonisë.

97. Përpos parametrave mbi bazë të së cilëve mbështeten reformat pensionale, gjatë përshkrimit financiar të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor të Republikës së Maqedonisë një rol të rëndësishëm zënë edhe të ardhurat dhe shpenzimet e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor.

98. Gjatë ekzaminimit të të ardhurave të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor për periudhën 1994 - 2017 konstatojmë se, të ardhurat e përgjithshme janë rritur për 73.3% (të ardhurat nga kontributet janë rritur për 61.8%, nga buxheti për 89.7%, nga akcizat për 27.7%, të ardhurat tjera për 13.2%, kurse të ardhurat nga Agjencioni për punësim kanë shënuar rënie të vazhdueshme, nga dividenda janë ulur për 93.7%, përfshirë edhe të ardhurat nga shitja e aksioneve që në vitin 2017 shënuan nivelin zero).

99. Gjatë ekzaminimit të shpenzimeve të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor për periudhën 1994 - 2017 konstatojmë se, gjithsej shpenzimet janë rritur për 71.1% (shpenzimet për pagesën e pensioneve janë rritur për 70.3%, për kontribute shëndetësore për 68.1%, shërbimet profesionale për 26.6%, të tranzicionit për 78.9%, kurse kompensimet nga siguri invalidor janë ulur për 77% dhe shpenzimet kapitale për 60%).

100. Përpos metodës krahasimore dhe statistikore në ekzaminimin e treguesëve demografik dhe atyre ekonomik, kemi vënë në funksion edhe analizën empirike (përmes modelit “Panel Data”) dhe krijimin e skenarëve (përmes modelit “ARIMA”).

101. Analiza empirike konsiston në ndjekjen e dy fazave, edhe atë: faza e parë që përfshinë vlerësimin e trendit të pjesëmarrjes së shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto dhe pjesëmarrjes së shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto në raport me normën e varësisë së pleqërisë.

102. Faza e dytë e analizës empirike përfshinë vlerësimin e modeleve të regresionit panel për të dy variablat e varura (pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Bruto Prodhimin e Brendshëm dhe pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Bruto Prodhimin e Brendshëm, në raport me normën e varësisë së pleqërisë), duke larguar normën e varësisë së pleqërisë nga variablat shpjeguese gjatë vlerësimit të modelit që i referohet variablës së dytë varëse.

103. Rezultatet e gjeneruara nga faza e parë e analizës empirike tregojnë se, Greqia rangohet e para me 17% sa i përket pjesëmarrjes së pjesëmarrjes së shpenzimeve të pensioneve në Bruto Prodhimin e Brendshëm, pastaj vijon Portugalia me 15%, Sllovenia dhe Kroacia me 11%, Republika e Maqedonisë me 10%, Republika Çeke dhe Hungaria me 9% dhe Rumania dhe Bullgaria me 8%, kurse sa i përket pjesëmarrjes së pjesëmarrjes së shpenzimeve të pensioneve në Bruto Prodhimin e Brendshëm, në raport me normën e varësisë së pleqërisë oscilimet kanë qenë jashtëzakonisht të ulëta, respektivisht lëvizje deri në 1% rritje ose ulje.

104. Rezultatet e gjeneruara nga faza e dytë e analizës empirike rezultojnë të ndryshme gjatë testimit të variablave të varura, përjashtuar Prodhimin e Brendshëm Bruto dhe Prodhimin e Brendshëm Bruto për kokë banori që nuk tregojnë signifikancë në asnjë lloj niveli apo teknikë të zbatuar në këtë studim.

105. Gjatë testimit të variablës së parë të varur, përkatësisht pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Bruto Prodhimin e Brendshëm konstatojmë se: norma e varësisë së pleqërisë, jetëgjatësia deri në moshën 65 vjeç, kohëzgjatja e marrëdhënies së punës, norma e punësimit për grup moshën 15 - 64 vjeç, norma e punësimit për grup moshën mbi 65 vjeç, norma e zëvendësimit, përqindja e popullsisë së përgjithshme që kanë përfunduar së paku arsimin e

mesëm në grup moshën 55-64 vjeç dhe produktiviteti i punës, afektojnë më së shumti rritjen apo uljen e pjesëmarrjes së shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto.

106. Gjatë testimit të variablës së dytë të varur, përkatësisht pjesëmarrjen e shpenzimeve të pensioneve në Bruto Prodhimin e Brendshëm, në raport me normën e varësisë së pleqërisë konstatojmë se: kohëzgjatja e marrëdhënies së punës, norma e punësimit për grup moshën mbi 65 vjeç, norma e zëvendësimit, përqindja e popullsisë së përgjithshme që kanë përfunduar së paku arsimin e mesëm në grup moshën 55-64 vjeç dhe produktiviteti i punës, afektojnë më së shumti rritjen apo uljen e pjesëmarrjes së shpenzimeve të pensioneve në Prodhimin e Brendshëm Bruto, në raport me normën e varësisë së pleqërisë.

107. Pas gjenerimit të rezultateve nga analiza empirike vijuar me krijimin e skenarëve, rrjedhimisht parashikimin e treguesëve demografik deri në vitin 2057, ku konstatojmë se: numri i të punësuarëve deri në vitin 2057 do të rritet për 30.1%; numri i pensionistëve do të rritet për 51.8%; nataliteti do të zvogëlohet për 74.1%; dhe mortaliteti do të rritet për 26.9%.

108. Parashikimet për treguesit financiar nga krijimi i skenarëve tregojnë se: të ardhurat nga buxheti deri në vitin 2057 do të rriten për 156.4%; shpenzimet e pensioneve do të rriten për 126.7%; shpenzimet e përgjithshme për 125.9%; të ardhurat e përgjithshme do të rriten për 128.9%; të ardhurat nga kontributet për 112.2%; dhe raporti i punësuar - pensioner deri në vitin 2057 do të arrijë në 1.31.

109. Së fundmi, gjatë analizës së regresionit (OLS) për sistemin aktual pensional të Republikës së Maqedonisë konstatojmë se: me rritjen e shpenzimeve të përgjithshme për një njësi, deficitin rritet për 0.616 denarë dhe me rritjen e pjesëmarrjes së të hyrave buxhetore për një njësi, deficitin zvogëlohet për 0.367 denarë. Kurse, me rritjen e numrit të të punësuarëve për një njësi, deficitin zvogëlohet për 0.011 të punësuar dhe me rritjen e numrit të pensionistëve për një njësi, deficitin zvogëlohet për 0.092 - sa i përket numrit të pensionistëve.

Rekomandimet kryesore që rezultojnë nga ky studim janë:

1. Përqendrimin në përpilimin e një programi konzistent për reforma ekonomike që siguron ambient të volitshëm institucional dhe ekonomiko-social për reforma të reja pensionale (rritja e moshës së daljes në pension dhe kthimi i normës së kontributit në gjendjen e mëparshme) do të mundësonte krijimin e kushteve për aftësi paguese afatgjate të sistemit pensional, rritjen e kursimeve kombëtare dhe forcimin e pushtetit të investimeve. Zhvillimi i tregut të kapitalit si domosdoshmëri për integrimin teknologjik-infrastrukturorë në rajon e më gjerë, eliminimi i të gjitha barrierave të biznesit në rajon, marrëveshja mbi tregtinë e lirë, investimet e huaja, punësimi i lirë, konsiderohen si parakushte kryesore që reformat e reja pensionale të japin efektin e tyre në rritjen ekonomike.

2. Rritja e moshës së daljes në pension dhe sfida për të ekuilibruar punën dhe pensionin kundrejt ndryshimit të ciklit jetësor dhe rolit social ekonomik cilësohet si një nga rekomandimet e pashmangshme. Mirëpo, në rastin e Republikës së Maqedonisë fillimisht duhet analizuar trendi i punësimit dhe parashikimet për të njëjtën, respektivisht nëse ky trend është në harmoni me ndryshimet demografike, përfshirë edhe strukturën e punësimit për të vlerësuar gatishmërinë ekonomike për aprovimin e kësaj reforme pensionale po aq të nevojshme. Nëse kjo e fundit e aprovon rritjen e moshës së daljes në pension, atëherë implementimi duhet vijuar në dy mënyra, edhe atë: përmes zgjerimit gradual të kufirit të moshës së daljes në pension, përkatësisht indeksimin e moshës me muaj të caktuar për çdo vit; dhe rritjes së kufirit të moshës së daljes në pension përshtatur me jetëgjatësinë, pra në çdo 5-6 vite të rritet kufiri i pensionimit për një vit dhe kështu të arrihet pragu 70 vjeç deri në vitin 2030 (kur do fillon edhe ndarja e pensioneve nga shtylla e dytë). Aplikimi i kësaj reforme do të shkaktojë efektin e dualitetit, ngase në njërin anë do të mundësojë rritjen e numrit të të punësuarëve dhe uljen e shpenzimeve pensionale, kurse në anën tjetër zvogëlimin e varshmërisë së Fondit për sigurim pensional dhe invalidor nga buxheti shtetëror.

3. Rritja e kontributeve apo kthimi i tyre në gjendjen e mëparshme konsiderohet si e pashmangshme për tejkalimin e krizës financiare, ngase në njërin anë do të mundësojë rritjen e të të ardhurave të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor, kurse në anën tjetër do të ndikojë në uljen e hendekut financiar. Kjo e fundit shkakton edhe pasoja sociale që justifikohen vetëm në rastin kur, ekonomia e Republikës së Maqedonisë në të ardhmen shënon rezultate pozitive përmes rritjes së Prodhimit të Brendshëm Bruto. Andaj, duke marrë parasysh përplasjet mes punëdhënësve dhe punëmarrësve për shkak të rritjes së kostos së punës, një nga alternativat e mundshme është një kompromis mes dy palëve, respektivisht 17% të paguan punëdhënësi dhe 5% punëmarrësi!

4. Mbrojta e pensioneve publike si një shtyllë e mbrojtjes së të të ardhurave për të moshuarit dhe invalidët në kushtet e rritjes së vazhdueshme të deficitit në shtyllën e parë, rekomandohet “ngrirja” e transferimit të 6%-shit për një periudhë të 5 viteve, që do të ndikonte në uljen e deficitit në shtyllën e parë. Ose, rekomandohet aplikimi i përvojave të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, të cilët për një periudhë të caktuar zvogëluan normat e transferimit deri nga 2% në 3%, që po ashtu mund të konsiderohet si një zgjidhje e përkohshme për Republikën e Maqedonisë. Kurse, vendimi i “ngrirjes” së transfereve në shtyllën e dytë duhet të pasohet nga një vendim për mos rritjen e pensioneve mbi normën e inflacionit dhe në funksion të parandalimit të transferimeve ekonomikisht të paqëndrueshme.

5. Definimi i kontributeve dhe përfitimeve (si parametra të pensioneve) të bazohet në metoda bashkëkohore aktuale dhe jo në skenarë të thjeshtë optimist dhe pesimist, si dhe harmonizimi i pensionit të bëhet vetëm duke ndjekur rekomandimet e Bankës Botërore, duke marrë për bazë indikatorin e pagës nominale dhe koston e jetesës. Po ashtu, shmangiet negative për kontributet dhe përfitimet e pritura dhe në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet e pritura, duhet të bazohen në shpërndarjet përkatëse probabilitare të pranuarra gjerësisht nga aktuarë dhe drejtues risku të mirëkualifikuar në fushën e fondeve pensionale.

6. Krijimi i mekanizmave dhe stimuljeve nga ana e institucioneve për inkurajimin e individëve për të kursyer më shumë dhe ndërmarrjen e masave për promovimin e shtyllës së dytë dhe tretë, respektivisht ngritja e vetëdijes së qytetarëve, konsiderohet si parakusht kryesor reformues, por edhe rrjedhojë e reformave pensionale. Reformat pensionale u konsideruan të vështira për t’u adoptuar, por si të nevojshme për zhvillimin e ekonomisë vendore, sepse sistemi PAYG paraqitej si një kërcënim potencial për qëndrueshmërinë fiskale dhe stabilitetin ekonomik të Republikës së Maqedonisë.

7. Ndërmarrja e masave për përmirësimin e dispozitave ligjore në drejtim të rritjes së kompetencave dhe lirisë së fondeve private pensionale sa i përket menaxhimit të kapitalit të fondeve pensionale. Sistemi pensional i përket industrisë financiare, andaj kjo pjesë duhet të rregullohet. Mekanizmi i rregullimit duhet t’i përfshijë të gjitha planet private dhe publike, që do të thotë se plani shtetëror pensional duhet t’i nënshtrohet politikave të rregullimit financiar, qeverisjes dhe drejtimit në bazë të parimeve dhe drejtimit të qeverisjes financiare.

8. Inkurajimi i aktiviteteve të fondeve private pensionale (orientimi kryesisht në shtyllën e tretë), gjegjësisht përforcimi i shoqërive pensionale (KB Shoqëria e parë pensionale dhe Shoqërisë së pensioneve Sava sh.a Shkup) për menaxhimin e fondeve pensionale në drejtim të kapitalit potencial, kadrovik dhe teknik për tejkalimin e sfidave aktuale dhe atyre të ardhshme. Skemat private pensionale zmadhojnë lirinë individuale, për dallim nga sistemi PAYG që zvogëlon liritë individuale në kontekst të organizimit dhe planifikimi të ardhmërisë së tyre, skemat private pensionale zmadhojnë lirinë individuale. Po ashtu, e drejta e pronësisë apo kapitalizmi i sistemit pensional krijon të drejta pronësore, rrjedhimisht paratë që derdhen nga ana e anëtarëve në shtyllën e tretë konsiderohen pronë private e tyre dhe e trashëgimtarëve të tyre.

9. Përqendrimi në zbatimin e strategjisë për zhvillimin demografik 2008-2015 të Ministrisë për punë dhe politikë sociale, përmes përmirësimit të kapitalit njerëzor, zvogëlimit të pabarazive rajonale demografike dhe rritjes së kohezionit social. Për më tepër, zbatimi i strategjisë në fjalë do të mundësojë rritjen graduale të natalitetit, respektivisht rritjen e forcës punëtore dhe gjenerimin më të madh të të hyrave nga kontributet për sigurim pensional dhe invalidor, e me këtë përmbushjen e objektivit kryesor të sistemit pensional - pagesën e pensioneve.

10. Ulja e fenomenit të papunësisë përmes përqendrimit në promovimin e programeve për rritjen e punësimit dhe përqendrimi në implementimin e strategjisë kombëtare për punësim konform principeve dhe qëllimeve të: programit kombëtar për reforma ekonomike 2015, strategjisë fiskale 2015-2017, Evropa 2020 dhe strategjia 2020 për Evropën Juglindore, që synon rritjen e cilësisë së punësimit dhe produktivitetit me theks të veçantë në grupet e cenueshme të popullsisë. Pra, promovimi i programeve për rritjen e punësimit (investimet intensive në infrastrukturën ekonomike dhe sociale, përfshirja e risive teknologjike me potencial stimulimi punësimin, promovimi i arsimit të mesëm të përgjithshëm, fleksibilitet në punësim) dhe implementimi i Strategjisë Kombëtare për punësim do të rezultojë me rritjen e numrit të të punësuarëve, e me këtë edhe në përmirësimin e situatës financiare të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor të Republikës së Maqedonisë.

11. Përqendrimi në riformulimin e politikave për nxitjen e punësimit në sektorin privat dhe përqendrimi në koordinimin efektiv të politikës pensionale dhe punësimi, respektivisht përfshirja e një sistemi në të cilin kontributet për sigurim pensional dhe invalidor për personat që kyçen në programe të ndryshme punësimi dhe për të cilët ofrohen lehtësime tatimore, t'i kompensohen Fondit për sigurim pensional dhe invalidor nga ana e buxhetit të Republikës së Maqedonisë. Ky sistem i vecantë, të përfshijë periudhën që parashikohet mospagimi i kontributeve, në të kundërtën Fondi për sigurim pensional dhe invalidor vetëm ngarkohet me detyrim dhe nuk gjeneron të ardhura si të nevojshme për krijimin e tregjeve të punës dhe

sistemet e pensioneve, dhe për t'i inkurajuar njerëzit të qëndrojnë sa më gjatë aktiv dhe t'ju mundësojnë një kalim fleksibël nga puna në pension. Po ashtu, lirimi nga kontributet për sigurim social rrit kërkesat e sektorit privat duke ndikuar në njërën anë në stimulimin e punësimit, kurse në anën tjetër në dëmtimin e fondeve sociale në veçanti Fondin për sigurim pensional dhe invalidor.

12. Përmirësimi i disiplinës financiare, pagesa e rregullt e pensioneve (ulja e pensionistëve fiktiv) dhe përqendrimi në uljen e ekonomisë informale do të arrihet përmes uljes së ngarkesës tatimore dhe administrative për komunitetin e biznesit, zvogëlimit të transfereve sociale, përmirësimit të rregullativës për bërjen e biznesit, ujen e nivelit të korrupsionit dhe rritjen e besimit në institucionet shtetërore, konsiderohen si mundësi për qëndrueshmëri financiare afatgjate të sistemit pensional, me parakushtin e përmirësimit të normës së zëvendësimit (të njohura ndryshe si reforma parametrike). Kurse, sa i përket pensionistëve fiktiv, përqendrimi në përditësimin e vazhdueshëm të bazës së të dhënave për të siguruarit dhe plotësimin e tyre me të dhëna të reja (krijimin e një baze më të mirë statistikore për Fondin për sigurim pensional dhe invalidor) do të shërben për hulumtime shkencore në këtë fushë.

13. Forcimi i kapacitetit të politikbërjes si domosdoshmëri për udhëheqjen dhe drejtimin efektiv të procesit të reformës, respektivisht ndërmarrja e një analize të hollësishme të efekteve të zbatimit të arkitekturës së re të pensioneve më së voni deri në vitin 2020, përmes një tryeze të rrumbullakët me përfaqësues nga: Banka Botërore, organet e legjislativit, Fondi për sigurim pensional dhe invalidor, kompanitë që menaxhojnë më shtyllën e dytë dhe të tretë, kompanitë e sigurimit, rregullatorët dhe mbikëqyrësit, etj. Me këtë takim pritet të hidhen themelet për rikonfigurimin e parashikuar të sistemit pensional të Republikës së Maqedonisë, në përputhje me defektet e hasura dhe dinamikën e treguesëve demografik dhe ekonomik.

Bibliografia

1. (n.d.). Retrieved from KB Shoqëria e parë pensionale SHA Shkup:
<https://www.kbprvo.com.mk/Al/%D0%B7%D0%B0%D0%B4%D0%BE%D0%BB%D0%B6%D0%B8%D1%82%D0%B5%D0%BB%D0%B5%D0%BD%D0%BF%D0%B5%D0%BD%D0%B7%D0%B8%D1%81%D0%BA%D0%B8-%D1%84%D0%BE%D0%BD%D0%B4/>
2. (n.d.). Retrieved from Central European Free Trade Agreement - CEFTA: <http://cefta.int/>
3. (n.d.). Retrieved from Investopedia: <https://www.investopedia.com/corp/about.aspx>
4. (n.d.). Retrieved from Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i Sërbisë:
<http://www.pio.rs/eng/about/scope-of-activity.html>
5. (n.d.). Retrieved February Monday, 2018, from Ministria për punë dhe politikë sociale:
<http://www.mtsp.gov.mk/sloboden-pristap-do-informacii.nspix>
6. (n.d.). Retrieved from Shoqëria e pensioneve Sava Sh.a Shkup: <http://www.sava-penzisko.mk/sq-AL/Home/About>
7. (n.d.). Retrieved from Enti shtetëror statistikor i Republikës së Maqedonisë:
<http://www.stat.gov.mk/OblastOpsto.aspx?id=2>
8. (n.d.). Retrieved from Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i Republikës së Maqedonisë:
http://www.piom.com.mk/sq/per_ne/47.html
9. Ruiz-Tagle and Castro. (1998). *THE CHILEAN PENSION SYSTEM*. OECD.
10. "Wilmington plc". (1978). Retrieved November 2017, from Pension Funds Online:
<http://www.pensionfundsonline.co.uk/content/country-profiles/japan/103>
11. "Official Gazette of the Republic of Montenegro" No. 54/03. (n.d.). Pension and Disability Insurance Law. Montenegro.
12. (1919, April). Retrieved from International Labour Organization: <http://www.ilo.org/global/about-the-ilo/history/lang--en/index.htm>
13. 1994-96 Advisory Council Report. (1997). Report of the 1994-1996 Advisory Council on Social Security. USA.
14. Agnieszka. (2009). The Pension System and Employment of Older Workers: How to Change the Incentive Structure-The Polish Experience. In L. M. Robert Holzmann, *Pension Reform in Southeastern Europe: Linking to Labor and Financial Market Reforms* (pp. p. 163-194, ch.11). Washington: The International Bank for Reconstruction and Development / The World Bank.

15. Andersen and Sarasa. (2002). The generational conflict reconsidered. *Journal of European Social Policy* , 5-21.
16. Andersen. (1990). *The Three Worlds of Welfare Capitalism*. Great Britain: Princeton University Press, 41 William Street, Princeton New Jersey 08540.
17. Angel de La Fuente, Rafael Domenech. (2013). The financial impact of Spanish pension reform: A quick estimate. *Journal of Pension Economics and Finance* , 111-137.
18. Asher, M. G. (2000). *Social Security Reform Imperatives: The Southeast Asian Case*.
19. B. Fredrich & S. Martin. (1991). Welfare effects of unfunded pension systems when labor supply is endogenous. *Department of Economics University of Konstanz* .
20. Baltagi, B. H. (2005). *Econometric Analysis of Panel Data*. England: John Wiley & Sons Ltd, The Atrium, Southern Gate, Chichester, West Sussex PO19 8SQ, England.
21. Baranyai. (2018). Countries with the Highest Life Expectancy in 2018.
22. Barr, N. (2001). The Truth About Pension Reform. *Finance and Development: A quarterly magazine of the IMF* , Volume 38, Number 3.
23. Bexheti and Mjaku. (2017). "Konsolidimi dhe Ndërtimi i Qëndrueshmërisë Financiare nga Sistemi Pensional i Kosovës".
24. Blake D. (2006). *Pension Economics*. England: John Wiley & Sons Ltd, The Atrium, Southern Gate, Chichester, West Sussex PO19 8SQ.
25. Blake. (2006). *Pension Economics*. John Wiley & Sons Ltd, The Atrium, Southern Gate, Chichester, p.25.
26. Blake. (2006). *Pension Finance*. England: John Wiley & Sons Ltd, The Atrium, Southern Gate, Chichester,.
27. Blake, D. (2006, pp. 90-135). *Pension Economics*. England: John Wiley & Sons Ltd, The Atrium, Southern Gate, Chichester, West Sussex PO19 8SQ.
28. Blinder et al. (1983). Social Security Bequests and the Life Cycle Theory of Saving: Cross - Sectional Tests. in F. Modigliani et al. (eds.), *The Determinants of National Saving and Wealth, International Economic Association* , 89-122.
29. Bodie et al. (1988). *Defined Benefit versus Defined Contribution Pension Plans: What are the Real Trade-offs? Selection from volume: Pensions in the U.S. Economy*. University of Chicago Press, pp.139 - 162.
30. Bodie, Z. (1989). *PENSIONS AS RETIREMENT INCOME INSURANCE*. Cambridge: NATIONAL BUREAU OF ECONOMIC RESEARCH.

31. Bonoli and Shinkawa. (2005). *Ageing and Pension Reform Around the World*. UK: Edward Elgar Cheltenham, UK • Northampton, MA, USA, p. 235-238.
32. Bonoli and Shinkawa. (2005). *Ageing and Pension Reform Around the World: Evidence from Eleven Countries*. Edward Elgar Publishing Limited.
33. Bonoli, G. (2003). *Two Worlds of Pension Reform in Western Europe*. Ph.D. Program in Political Science of the City University of New York, pp. 399-416.
34. C. Vidal-Meliá, M. Boado-Penas, O. Settergren. (2009, pp. 287-317). *Automatic Balance Mechanisms in Pay-As-You-Go Pension Systems*. The Geneva Papers on Risk and Insurance - Issues and Practice.
35. CamilaArza. (2008). *The Limits of Pension Privatization: Lessons from Argentine Experience*.
36. Cesaratto. (2005). *Pension Reform and Economic Theory*. UK: Edward Elgar Publishing Limited.
37. Cesaratto. (2003). The Classical 'Surplus' Approach and the Theory of the Welfare State and Public Pensions. In E. S. Tortia, *Democrazia economica tra stato e mercato*. Napoli: La Citta del Sole.
38. Chatfield, C. (2000). *Time-series forecasting*. New York: Chapman & Hall/CRC.
39. Croitoru, E. L. (2012). *ANALYSIS OF PENSION REFORMS IN EU MEMBER*. Annals of the University of Petroșani, Economics.
40. Cseh and Terebessy. (2013). *Introduction to demography. Presentation and calculation of basic demographic indicators*. p.4.
41. Danziger et al. (1982). *The Life - Cycle Hypothesis and the Consumption Behavior of the Elderly*. Institute for Research on Poverty.
42. Darby. (1977). *The Effects of Social Security on Income and the Capital Stock*. Washington, DC.: American Enterprise Institute.
43. Darby, M. R. (1977). *The Effects of Social Security on Income and the Capital Stock*. Washington, DC.: American Enterprise Institute.
44. David and Menchik. (1987). The Effect of Social Security on Lifetime Wealth Accumulation and Bequests. *Economica* , 421-434.
45. David B. (2006). *Pension Economics*. England: John Wiley & Sons Ltd, The Atrium, Southern Gate, Chichester, West Sussex PO19 8SQ.
46. Davies and Lahiri. (1995). "A New Framework for Testing Rationality and Measuring Aggregate Shocks Using Panel Data". *Journal of Econometrics* , p. 205-227.

47. Devereux and Sabates-Wheeler. (2004). *Transformative social protection*. ENGLAND: INSTITUTE OF DEVELOPMENT STUDIES, Brighton, Sussex BN1 9RE.
48. European Commission et. al. (2008). *Social Protection and Social Inclusion in Bosnia and Herzegovina - Executive Summary*„. Manuscript completed in 2008 by European Commission, p.6.
49. Fabris, N. (2009). Statement of the Central Bank. In L. M. Robert Holzmann, *Pension Reform in Southeastern Europe: Linking to Labor and Financial Market Reform* (pp. 341 -347, ch.28). Washington: The International Bank for Reconstruction and Development / The World Bank.
50. Fondi Pensional i Kosovës. (2006, Shtator). Retrieved from http://fondipensional.com/per_ne_main.html
51. Fredrich and Martin. (1991). Welfare effects of unfunded pension systems when labor supply is endogenous. *Departmet of Economics University of Konstanz* .
52. (2015). *FYR Macedonia Public Expenditure Review Fiscal Policy for Growth*. World Bank Group, p.109-120.
53. G. Bonoli & T. Shinkawa. (2005, p. 8-18). *Ageing and Pension Reform Around the World: Evidence from Eleven Countries*. USA: Edward Elgar Publishing Limited.
54. Garegnani, P. (1970). Heterogeneous Capital, the Production Function and the Theory of Distribution. In *The Review of Economic Studies* (pp. 407 - 436, vol. 37).
55. Garvanlieva et al. (2012). *SHadow Economy in Macedonia*. Skopje: Center for Economic Analyses (CEA).
56. *Geoba.se*. (n.d.). Retrieved from <http://www.geoba.se/population.php?pc=world&page=2&type=015&st=country&asde=&year=2017>
57. Gjini. (2013). *Reformat e pensioneve në Shqipëri*. Tiranë, Shqipëri.
58. Gjini, V. (2013). *Reformat e pensioneve në Shqipëri*. Tiranë, Shqipëri.
59. Gora, M. (2008). *Retirement Decisions, Benefits and the Neutrality of Pension Systems*. European Network of Economic Policy Research Institutes .
60. Grech, A. G. (2010). *Assessing the sustainability of pension reforms in Europe*. London: Centre for Analysis of Social Exclusion London School of Economics London WC2A 2AE.
61. Green, F. (1981). The Effect of Occupational Pension Schemes on Saving in the United Kingdom: A Test of the Life Cycle Hypothesis. *The Economica Journal* , 136-144.
62. Groome et al. (2006). Aging and Financial Markets. *Finance and Development: A quartely magazine of the IMF* , Vol. 43.

63. Gujarati, D. N. (2003). *Basic Econometrics*. USA: The McGraw-Hill Companies, Inc. for manufacture and export.
64. H. Stefan. (1990, Vol. 164). *The Efficiency of Unfunded Pension System*.
65. Hansen, L. P. (2007). *Generalized Method of Moments Estimation*. Chicago: University of Chicago.
66. Hayashi. (2001). *Ecnometrics: Finite-Sample Properties of OLS (chapter 1)*. USA: Princeton University Press.
67. Hinrichs. (2000). "Elephants on the move. Patterns of public pension reform in OECD Countries",. p. 353-378.
68. Hinrichs. (2005). New century, new paradigm: Pension reforms in Germany. In G. B. Shinkawa, *Ageing and Pension Reform Around the World: Evidence from Eleven Countries* (pp. 46-70). USA: Edward Elgar Publishing Limited.
69. Holzmann and Palmer. (2006). *Pension Reform: Issues and Prospects for Non-Financial Defined Contribution (NDC) Schemes*. Washington, DC 20433, USA: The International Bank for Reconstruction and Development / The World Bank.
70. Holzmann and Palmer. (2006). *What is NDC? in Pension Reform: Issues and Prospect for Non-Financial Defined Contribution Schemes*. Washington, DC 20433, USA: The International Bank for Reconstruction and Development / The World Bank, pp 17-23.
71. Homburg, S. (1990). The Efficiency of Unfunded Pension Systems. *Journal of Institutional and Theoretical Economics*, Vol. 164 .
72. Horioka et al. (1996). Do the Aged Dissave in Japan? Evidence from Micro Data. *Journal of the Japanese and International Economies* , 295-311, Vol.10.
73. Hutsebaut, M. (2011). *PENSION REFORMS IN THE COUNTRIES OF THE WESTERN BALKANS FROM A EUROPEAN PERSPECTIVE*. Belgium.
74. Indicators for Sustainable Development Goals. (2014). *Indicators for Sustainable Development Goals: A report by the Leadership Council of the Sustainable Development Solutions Network*. Sustainable Development Solutions Network.
75. Instituti i sigurimeve shoqërore . (n.d.). Përfitimet dhe llojet e pensioneve:
http://www.iss.sh.gov.al/wp-content/uploads/2014/02/Tabela_moshes_daljes_pension.pdf.
Tiranë, Shqipëri.
76. Internatinoal Labour Office. (2009). *Report on the pension reform in Bosnia and Herzegovina* .
Budapest: International Labour Organization 2009.
77. International Monetary Fund. (2012). The Financial Impact of Longevity Risk.

78. Ivan. (2006). *"Pension reform in Slovakia: the context of economic globalization"*. Brussels: European Trade Union Institute for Research, Education and Health and Safety (ETUI-REHS), p.16.
79. Jappelli and Modigliani. (2003). The Age-Saving Profile and the Life-Cycle Hypothesis. *The Collected papers of Franco Modigliani, Vol.6, MIT Press*.
80. Jovanović et al. (2015). Pension and Disability Insurance Reform in Serbia. *34th International Conference on Organizational Science Development INTERNATIONALIZATION AND COOPERATION*. Slovenia.
81. Kotlikoff and Summers. (1981). *The Role of Intergenerational Transfers in Aggregate Capital Accumulation*. Chicago: Journal of Political Economy, the University of Chicago.
82. Kotlikoff, L. J. (1979). Testing a Theory of Social Security and Life Cycle Accumulation. In Kotlikoff, *Social Security* (pp. 396-410, Vol. 69, No.3). American Economic Review.
83. Kutner et al. (2005). *Applied Linear Statistical Models, Fifth Edition*. The McGraw-Hill Compan Inc.
84. Laitner and Juster. (1996). New Evidence on Altruism: A study of TIAA-CREF Retirees. *The American Economic Review*, 893-908, Vol 86. No.4.
85. Laszlo, A. (2012). *White Paper*.
86. Leimer and Richardson. (1992). Social Security, Uncertainty Adjustments and the Consumption Decision. *Economica*, 311-335, Vol. 59.
87. Ligji për sigurim pensional dhe invalidor i Republikës së Maqedonisë . (n.d.). Republika e Maqedonisë.
88. Lillelaid et al. (2009). Pension Reform in Southeastern Europe Linking to Labor and Financial Market Reforms. In L. M. Robert Holzmann, *Designing a Regulatory Framework for Pension Reform and Development of Financial Markets: The Estonian Experience* (pp. 227-246, ch.15). The International Bank for Reconstruction and Development / The World Bank.
89. Logue and Rader. (1997). *Managing Pension Plans: A Comprehensive Guide to Improving Plan Performance (Financial Management Association Survey and Synthesis Series)*. Cambridge: Harvard Business School Press.
90. Loredana, T. (2008). *ANALYSIS OF THE PENSION EXPENDITURES IN ROMANIA*. Str. Gradinarilor, Bl. R2, Sc. A, Ap. 13, Mioveni, Arges: University of Pitesti, Faculty of Economic Sciences.
91. Lynch, J. (2001). The Age-Oriented of Social Policy Regimes in OECD Countries. *Journal of Social Policy*, 411-436.
92. Mandin and Palier. (2005). The politics of pension reform in France: The end of exceptionalism? In G. B. Shinkawa, *Ageing and Pension Reform Around the World: Evidence from Eleven Countries* (pp. 74-94). USA: Edward Elgar Publishing Limited.

93. (2002). *Measuring the Non-Observed Economy*. OECD.
94. *Ministria e punës, familjes, çështjeve sociale dhe mundësive të barabarta*. (n.d.). Retrieved from <http://www.mddsz.gov.si>.
95. *Ministria e Punës, familjes, çështjeve sociale dhe mundësive të barabarta*. (n.d.). Retrieved from <http://www.mddsz.gov.si>.
96. Ministria për punë dhe politikë sociale e Republikës së Maqedonisë. (2008). *Strategjia për zhvillimin demografik të RM-së, 2008 - 2015*.
97. Ministry for National Economy. (2010). *The reform of the Hungarian pension system (A reformed reform)*. Budapest: Ministry for National Economy.
98. Miroslav Verbič, Rok Spruk. (2014). *Aging Population and Public Pensions: Theory and Macroeconometric Evidence*.
99. Mitkov, N. (2018, July 5). Retrieved from Osiguraj se: <http://osigurajse.mk/novosti/penziskiot-sistem-pred-kolaps/>
100. Modigliani and Muralidhar. (2005). *Rethinking Pension Reform*. England: Cambridge, New York, Melbourne, Madrid, Cape Town, Singapore, São Paulo, pp. 25-28.
101. Modigliani, F. (1986). Life Cycle, Individual Thrift, and the Wealth of Nations. *American Economic Review* , 297-313.
102. Mrksic, D. (2003). *Upravljanje organizacijama za osiguranje i reosiguranje*. Beograd.
103. Munnell and Chen. (2017). *401(K)/IRA HOLDINGS IN 2016: AN UPDATE*. Centre for Retirement Research at Boston College.
104. Muralidhar et al. (1998b). *Welfare Cost of Defined Contribution Plans - The Case for an Alternative Pension Scheme*. Investment Management Department, World Bank.
105. Muralidhar, A. S. (2001). *Innovations in Pension Fund Management*. California: The Board of Trustees of the Leland Stanford Jr. University.
106. Myles and Pierson. (2001). The Comparative Political Economy Of Pension Reform. In P. Pierson, *The New Politics of the Welfare State* (pp. 305-333). Oxford: Oxford University Press.
107. N. Barr & P. Diamond. (2006). *The economics of pensions*. Oxford Review of Economics Policy, Vol. 22. No. 1, Pensions, forthcoming.
108. Nenovski, T. (2012). *Macroeconomic aspects of the grey economy - the case of Macedonia*. Munich Personal RePEc Archive.

109. Nikač, M. (2015). *Present Situation and Future Steps: Reform of Pension Scheme in Serbia*. Institute for Social Insurance.
110. Nr.7703, L. (ndryshuar me nenin 1, të Ligjit nr. 104/2014, datë 31.07.2014, 07). Ligji: “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”. Tiranë, Shqipëri.
111. Nwakuya and Ijomah. (2017). Fixed Effect Versus Random Effects Modeling in a Panel Data Analysis; A Consideration of Economic and Political Indicators in Six African Countries. *International Journal of Statistics and Applications* , 275-279.
112. OECD Private Pensions Outlook. (2009). *Pension Country Profile: Poland - Extract from the OECD Private Pensions Outlook 2008*. OECD 2009.
113. Omanovic. (2009). Statement of the Ministry of Labor and Social Welfare, Federation of Bosnia and Herzegovina. In P. R. Reforms, *Robert Holzmann, Landis MacKellar, and Jana Repansek* (pp. 319-322, ch.23). Washington: The International Bank for Reconstruction and Development / The World Bank.
114. Orszag and Stiglitz. (1999). *"Rethinking Pension Reform: Ten Myths About Social Security Systems"*. Presented at the World Bank Conference, "New Ideas About Old Age Security".
115. Orszag and Stiglitz. (1999). *"Rethinking Pension Reform: Ten Myths About Social Security Systems"*, Presented at the conference on "New Ideas About Old Age Security". Washington, D.C.: The World Bank.
116. *Pension and Disability Insurance Fund of Serbia*. (n.d.). Retrieved from <http://www.pio.rs/eng/>
117. (2013). *Pensions at a Glance 2013: OECD and G20 Indicators*. OECD.
118. Penzes, P. (2012). *Recent developments in the Slovak pension system*. National Bank of Slovakia.
119. Pierson. (1996). *The New Politics of the Welfare State*. The Johns Hopkins University Press, p. 143-179.
120. Pierson. (1997). The politics of pension reform. In K. G. Boadway, *Reform of Retirement Income Policy*. International and Canadian Perspectives, Kingston (Ontario): Queen’s University, School of Policy Studies, p. 273 - 294.
121. Poterba, J. M. (1994). *International Comparisons of Household Saving*. Chicago: University of Chicago Press.
122. *Raporti aktuar për vitin 2011*. Fondi për sigurim pensional dhe invalidor.
123. (2011). *Report on the Publicly Funded Pension Scheme in Macedonia*. Center for Economic Analyses (CEA).

124. Rudic, S. (2009, ch.23). Statement of the Ministry of Finance, Republic of Srpska. In L. M. Robert Holzmann, *Pension Reform in Southeastern Europe: Linking to Labor and Financial Market Reform* (pp. 323-326). Washington: The International Bank for Reconstruction and Development / The World Bank.
125. Sack, K. (2000). THE 2000 CAMPAIGN: THE VICE PRESIDENT; Gore and Bush Trade Jobs On Pensions and Spending. *The New York Times* .
126. Samson and Taylor. (2015). *Supporting Social Protection Systems*. Luxemburg: No 4, European Communities.
127. Schneider, O. (2009). *Reforming pensions in Europe: Economic fundamentals and political factors*. Charles University, Institute of Economic Studies (IES).
128. Schwarz, A. M. (2006). *Pension System Reforms*.
129. Shinkawa, T. (2005). The politics of pension reform in Japan: Institutional legacies, credit-claiming and blame avoidance. In G. B. Shinkawa, *Ageing and pension reform around the world: Evidence from Eleven Countries* (pp. 157-180). USA: Edward Elgar Publishing Limited .
130. Sinfo. (2010, October). Pension system reform: Secure old age for all generations. Slovenia.
131. Sircelj, A. (2009, ch.32). Statement of the Ministry of Finance, Slovenia. In L. M. Robert Holzmann, *Pension Reform in Southeastern Europe: Linking to Labor and Financial Market Reforms* (pp. 359-365). Washington: The International Bank for Reconstruction and Development / The World Bank.
132. Solow, R. M. (1970). *Growth Theory: An Exposition* . Oxford: Clarendon Press.
133. Sraffa, P. (1960). *Production of Commodities by Means of Commodities*. Vora & Co, Publishers PVT. LTD. 3, Round Building. Bombay 2.
134. Stankovic and Stankovic. (2012). *Bratislav, Social and Economic Aspects of the Shadow Economy in the Republic of Macedonia: a study*. SSRN Electronic Journal.
135. Startienė and Trimonis. (2010). *Causes and Consequences of Non-Observed Economy*. EKONOMIKA IR VADYBA (Economics and Management).
136. Stock and Watson. (2003). *Introduction to Econometrics*. New York: Prentice Hall, p. 289-290.
137. Stojkov et al. (2008). *Flat Tax Policy Assessment in Macedonia*. Skopje: CENTER FOR ECONOMIC ANALYSES (CEA).
138. Strategjia për zhvillimin demografik të Republikës së Maqedonisë, 2008 - 2015. *Ministria për punë dhe politika sociale*. <http://www.mtsp.gov.mk/>.
139. T. Lillelaid, V. Tali, and Th. Auväärt. (2009, ch.15). Pension Reform in Southeastern Europe Linking to Labor and Financial Market Reforms. In L. M. Robert Holzmann, *Designing a Regulatory*

Framework for Pension Reform and Development of Financial Markets: The Estonian Experience (pp. 227-246). The International Bank for Reconstruction and Development / The World Bank.

140. Takayama, N. (1990). How much do public pensions discourage personal savings. *Hitotsubashi Journal of Economics* , 87-103, Vol. 31, No. 2.
141. Tanzi, V. (2002). *The Shadow Economy, Its Causes and Its Consequences*. Rio de Janeiro: Brazilian Institute of Ethics in Competition.
142. Telegrafi.com. (22 shkurt, 2018). *Kosova me pagën mesatare më të ulët në rajon, Sllovenia më të lartën*. Retrieved from <https://telegrafi.com/kosova-pagen-mesatare-te-ulet-ne-rajon-sillovenia-te-larten/>
143. Thillainathan. (2003). *THE EMPLOYEES PROVIDENT FUND OF MALAYSIA: Asset Allocation, Investment Strategy and Governance Issues Revisited*. Presented at the “ Pension Fund Management” Workshop organized by the Employees Provident Fund.
144. Thillainathan, R. (2003). *THE EMPLOYEES PROVIDENT FUND OF MALAYSIA: Asset Allocation, Investment Strategy and Governance Issues Revisited*. ” presented at the “ Pension Fund Management” Workshop organized by the Employees Provident Fund .
145. Todorovic, M. (2009). Statement of the Ministry of Labor, Montenegro. In L. M. Robert Holzmann, *Pension Reform in Southeastern Europe: Linking to Labor and Financial Market Reforms* (pp. 345, ch.29). Washington: The International Bank for Reconstruction and Development / The World Bank.
146. Weaver. (2005). Public pension reform in the United States. In G. B. Shinkawa, *Ageing and Pension Reform Around the World: Evidence from Eleven Countries* (pp. 230-251). USA: Edward Elgar Publishing Limited.
147. Weaver. (1986). The Politics of Blame Avoidance. *Journal of Public Policy* , 371-398.
148. Wesbroom and Reay. (2005). *Pension Plans: UK and International Experience*. Research Report 271, Department for Work and Pensions, Leeds.
149. Williams et al. (2013). *Tackling undeclared work in the former Yugoslav Republic of Macedonia*. Eurofound.
150. World Bank. (1994). *World Development Report 1994 Infrastructure for Development*. Oxford University Press, Inc.
151. А1он. (2013, октомври 28). Ќе има липари за пензии? Република на Македонија.
152. (2010). *Актуерски извештај*.
153. Атанасовска, С. (2011). *Реформите во пензискиот систем на РМ и пензиските фондови како инвестициони фондови*.

154. Бар и Дајмонд. (2003). *Реформи на пензиите*. Скопје.
155. Јаќимовски et al. . (2013). *Невработеност - ризици и предизвици*. Скопје: Институт за социолошки и политичко - правни истражувања.
156. Каров. (2014). *Проектирање на одржливоста на државниот пензиски фонд*.
157. Мицески и Темјановски. (2011). *ДИНАМИЧКА АНАЛИЗА НА РАЗВОЈНИТЕ ТРЕНДОВИ НА НАТАЛИТЕТОТ ВО РУРАЛНИТЕ РИДСКО-ПЛАНИНСКИ СРЕДИНИ ВО Р.МАКЕДОНИЈА*. стр. 2-3.
158. Мицески и Темјановски. (2011). *ДИНАМИЧКА АНАЛИЗА НА РАЗВОЈНИТЕ ТРЕНДОВИ НА НАТАЛИТЕТОТ ВО РУРАЛНИТЕ РИДСКО-ПЛАНИНСКИ СРЕДИНИ ВО Р.МАКЕДОНИЈА*. стр. 11-12.
159. Мршиќ и Тренковски. (2008). *Задолжителни и доброволни пензиски осигурувања (искуство и иднина) и пензиски шеми*. стр.248.
160. (2015). *Национална Стратегија за Вработување на Република на Македонија 2016 - 2020*. Скопје, Република на Македонија, ст.73: Министерство за труд и социјална политика.
161. (2013). *Програма за статистички истражувања за периодот 2013 - 2017 година*. Скопје, Република на Македонија: Државен завод за статистика.
162. Утрински весник. (2008, јули 30). Владата ги чести пензионерите со уште поголеми пензии. Скопје, Република на Македонија.

Appendix

```

Random-effects GLS regression              Number of obs   =      83
Group variable: code                      Number of groups  =     10

R-sq:  within = 0.7649                    Obs per group: min =      2
        between = 0.9324                      avg =      8.3
        overall = 0.9068                      max =     11

corr(u_i, X)  = 0 (assumed)                Wald chi2(10)    =    700.93
                                                Prob > chi2      =    0.0000

```

epgdp	Coef.	Std. Err.	z	P> z	[95% Conf. Interval]	
odr	.0979342	.0398118	2.46	0.014	.0199046	.1759639
leat65	.4214761	.053849	7.83	0.000	.315934	.5270182
dwl	.1989386	.0848009	2.35	0.019	.0327318	.3651453
erateage1564	-.097496	.0321553	-3.03	0.002	-.1605192	-.0344728
erover65	-.2122456	.0366821	-5.79	0.000	-.2841412	-.14035
gdpgrowth	-1.272157	2.370629	-0.54	0.592	-5.918505	3.374191
gdppercapita	1.059139	2.367361	0.45	0.655	-3.580803	5.699081
rrate	1.560857	1.156223	1.35	0.177	-.705299	3.827013
educa5564	.0554829	.0085562	6.48	0.000	.0387131	.0722527
labprod	.1193064	.0667881	1.79	0.074	-.0115958	.2502087
_cons	-8.812172	2.287454	-3.85	0.000	-13.2955	-4.328844
sigma_u	0					
sigma_e	.45790946					
rho	0	(fraction of variance due to u_i)				

```

Fixed-effects (within) regression      Number of obs   =      83
Group variable: code                  Number of groups =      10

R-sq:  within = 0.5182                Obs per group: min =      2
      between = 0.0062                  avg =      8.3
      overall  = 0.0134                  max =     11

                                     F(10,63)          =      6.77
corr(u_i, Xb) = -0.8029                Prob > F          =     0.0000

```

epgdpodr	Coef.	Std. Err.	t	P> t	[95% Conf. Interval]	
odr	-.0083456	.0066906	-1.25	0.217	-.0217156	.0050245
leat65	-.0006157	.0081348	-0.08	0.940	-.0168718	.0156404
dwl	-.0007731	.0125394	-0.06	0.951	-.0258311	.0242849
erateage1564	-.0011076	.002609	-0.42	0.673	-.0063214	.0041061
erover65	.0015367	.0044222	0.35	0.729	-.0073004	.0103738
gdpgrowth	-.0814956	.0917317	-0.89	0.378	-.2648068	.1018156
gdppercapita	.0716247	.091587	0.78	0.437	-.1113973	.2546466
rrate	.0603325	.0850449	0.71	0.481	-.1096161	.2302812
educa5564	-.0031371	.0021783	-1.44	0.155	-.0074901	.0012158
labprod	.0049904	.0028258	1.77	0.082	-.0006566	.0106374
_cons	.8331482	.4190597	1.99	0.051	-.0042759	1.670572
sigma_u	.11816861					
sigma_e	.03229495					
rho	.93050051	(fraction of variance due to u_i)				

```

F test that all u_i=0:      F(9, 63) =      7.68      Prob > F = 0.0000

```

.

```

Fixed-effects (within) regression      Number of obs   =      83
Group variable: code                  Number of groups =     10

R-sq:  within = 0.5063                Obs per group: min =      2
      between = 0.1164                      avg =     8.3
      overall  = 0.0542                      max =     11

                                     F(9,64)          =      7.29
corr(u_i, Xb)  = -0.7844                Prob > F         =     0.0000

```

epgdpodr	Coef.	Std. Err.	t	P> t	[95% Conf. Interval]	
leat65	-.0068928	.0064192	-1.07	0.287	-.0197166	.005931
dwl	-.0020944	.0125488	-0.17	0.868	-.0271634	.0229747
erateage1564	-.0009366	.0026167	-0.36	0.722	-.0061641	.0042909
erover65	.0013653	.0044392	0.31	0.759	-.0075031	.0102337
gdpgrowth	-.0900085	.0918739	-0.98	0.331	-.2735477	.0935308
gdpper capita	.0799366	.0917401	0.87	0.387	-.1033353	.2632085
rrate	.0284376	.0814614	0.35	0.728	-.1343002	.1911753
educa5564	-.0026347	.00215	-1.23	0.225	-.0069299	.0016604
labprod	.0051257	.002836	1.81	0.075	-.0005398	.0107913
_cons	.881276	.4190881	2.10	0.039	.0440513	1.718501
sigma_u	.11809325					
sigma_e	.03243491					
rho	.92985596	(fraction of variance due to u_i)				

```

F test that all u_i=0:      F(9, 64) =    17.73      Prob > F = 0.0000

```

Random-effects GLS regression Number of obs = 83
Group variable: code Number of groups = 10

R-sq: within = 0.3094 Obs per group: min = 2
 between = 0.7150 avg = 8.3
 overall = 0.5121 max = 11

Wald chi2(9) = 76.63
corr(u_i, X) = 0 (assumed) Prob > chi2 = 0.0000

epgdpodr	Coef.	Std. Err.	z	P> z	[95% Conf. Interval]	
leat65	.001919	.0031489	0.61	0.542	-.0042528	.0080908
dwl	.0211913	.0054112	3.92	0.000	.0105856	.031797
erateage1564	-.0036318	.0021303	-1.70	0.088	-.0078071	.0005435
erover65	-.0079554	.0024333	-3.27	0.001	-.0127246	-.0031862
gdpgrowth	-.1387358	.1572285	-0.88	0.378	-.4468981	.1694264
gdppercapita	.130849	.1570003	0.83	0.405	-.1768659	.4385639
rrate	.1886791	.0716587	2.63	0.008	.0482306	.3291275
educa5564	.0011024	.000539	2.05	0.041	.0000459	.0021589
labprod	.0028408	.0044306	0.64	0.521	-.0058429	.0115245
_cons	-.193768	.1407096	-1.38	0.168	-.4695536	.0820177
sigma_u	0					
sigma_e	.03243491					
rho	0	(fraction of variance due to u_i)				

Dynamic panel-data estimation, one-step difference GMM

Group variable: code	Number of obs	=	70
Time variable : year	Number of groups	=	10
Number of instruments = 48	Obs per group: min	=	1
F(10, 60)	=	58.65	avg = 7.00
Prob > F	=	0.000	max = 10

epgdp	Coef.	Std. Err.	t	P> t	[95% Conf. Interval]
labprod	.0827348	.0323968	2.55	0.013	.0179316 .1475381
educa5564	-.0559978	.0356728	-1.57	0.122	-.127354 .0153584
rrate	-2.612104	1.065575	-2.45	0.017	-4.743571 -.4806358
gdppercapita	.1623515	1.044126	0.16	0.877	-1.926212 2.250915
gdpgrowth	-.3020091	1.044707	-0.29	0.774	-2.391734 1.787715
erover65	-.157296	.0609522	-2.58	0.012	-.2792185 -.0353735
erateage1564	-.1191099	.0362164	-3.29	0.002	-.1915535 -.0466663
dwl	-.2089694	.1736959	-1.20	0.234	-.5564129 .138474
leat65	.0702326	.1216188	0.58	0.566	-.1730412 .3135064
odr	.379077	.1078829	3.51	0.001	.163279 .594875

Instruments for first differences equation

Standard

D.(epgdp labprod educa5564 rrate gdppercapita gdpgrowth erover65
erateage1564 dwl leat65 odr)

GMM-type (missing=0, separate instruments for each period unless collapsed)

L2.(gdpgrowth gdppercapita educa5564 labprod)

Arellano-Bond test for AR(1) in first differences: z = -1.16 Pr > z = 0.246

Arellano-Bond test for AR(2) in first differences: z = -2.20 Pr > z = 0.028

Sargan test of overid. restrictions: chi2(38) = 80.02 Prob > chi2 = 0.000

(Not robust, but not weakened by many instruments.)

Difference-in-Sargan tests of exogeneity of instrument subsets:

gmm(gdpgrowth gdppercapita educa5564 labprod, lag(2 2))

Sargan test excluding group: chi2(1) = 59.22 Prob > chi2 = 0.000

Difference (null H = exogenous): chi2(37) = 20.80 Prob > chi2 = 0.985

iv(epgdp labprod educa5564 rrate gdppercapita gdpgrowth erover65 erateage1564 dwl leat65 odr)

Sargan test excluding group: chi2(27) = 32.86 Prob > chi2 = 0.202

Difference (null H = exogenous): chi2(11) = 47.16 Prob > chi2 = 0.000

.
.
.

Dynamic panel-data estimation, one-step difference GMM

Group variable: code	Number of obs	=	70
Time variable : year	Number of groups	=	10
Number of instruments = 47	Obs per group: min	=	1
F(9, 61) = 9.51	avg	=	7.00
Prob > F = 0.000	max	=	10

epgdpodr	Coef.	Std. Err.	t	P> t	[95% Conf. Interval]	
labprod	.0061286	.0022044	2.78	0.007	.0017207	.0105365
educa5564	-.0032368	.0024149	-1.34	0.185	-.0080656	.001592
rrate	.1145232	.0712171	1.61	0.113	-.0278843	.2569306
gdppercapita	.0230977	.0710022	0.33	0.746	-.1188799	.1650753
gdpgrowth	-.0324157	.0710384	-0.46	0.650	-.1744658	.1096344
erover65	.0009444	.0044575	0.21	0.833	-.0079689	.0098577
erateage1564	.0020178	.0025178	0.80	0.426	-.0030168	.0070525
dwl	-.0029097	.0115685	-0.25	0.802	-.0260424	.020223
leat65	-.0046151	.0073097	-0.63	0.530	-.0192318	.0100016

Instruments for first differences equation

Standard

D.(epgdpodr labprod educa5564 rrate gdppercapita gdpgrowth erover65
erateage1564 dwl leat65)

GMM-type (missing=0, separate instruments for each period unless collapsed)

L2.(gdpgrowth gdppercapita educa5564 labprod)

Arellano-Bond test for AR(1) in first differences: z = -0.99 Pr > z = 0.321

Arellano-Bond test for AR(2) in first differences: z = -1.96 Pr > z = 0.050

Sargan test of overid. restrictions: chi2(38) = 81.45 Prob > chi2 = 0.000

(Not robust, but not weakened by many instruments.)

Difference-in-Sargan tests of exogeneity of instrument subsets:

gmm(gdpgrowth gdppercapita educa5564 labprod, lag(2 2))

Sargan test excluding group: chi2(1) = 62.47 Prob > chi2 = 0.000

Difference (null H = exogenous): chi2(37) = 18.98 Prob > chi2 = 0.994

iv(epgdpodr labprod educa5564 rrate gdppercapita gdpgrowth erover65 erateage1564 dwl leat65)

Sargan test excluding group: chi2(28) = 33.65 Prob > chi2 = 0.213

Difference (null H = exogenous): chi2(10) = 47.79 Prob > chi2 = 0.000

Random-coefficients regression
Group variable: code

Number of obs = 52
Number of groups = 5

Obs per group: min = 10
avg = 10.4
max = 11

Wald chi2(8) = 180.46
Prob > chi2 = 0.0000

epgdp	Coef.	Std. Err.	z	P> z	[95% Conf. Interval]	
odr	-1.414185	3.134857	-0.45	0.652	-7.558391	4.730021
leat65	.5228561	1.54893	0.34	0.736	-2.51299	3.558702
dwl	.7988283	2.044724	0.39	0.696	-3.208757	4.806414
erateage1564	-.448788	.2971848	-1.51	0.131	-1.031259	.1336835
erover65	-.1806105	1.199983	-0.15	0.880	-2.532535	2.171314
rrate	6.901597	9.088834	0.76	0.448	-10.91219	24.71538
educa5564	-.2408956	.112409	-2.14	0.032	-.4612132	-.0205781
labprod	-.0781854	.0740596	-1.06	0.291	-.2233396	.0669688
_cons	45.78728	19.9643	2.29	0.022	6.657976	84.91659

Test of parameter constancy: chi2(36) = 100.77 Prob > chi2 = 0.0000

. estat hettest

Breusch-Pagan / Cook-Weisberg test for heteroskedasticity

Ho: Constant variance

Variables: fitted values of epgdp

chi2(1) = 0.23
Prob > chi2 = 0.6350

```

Fixed-effects (within) regression               Number of obs   =        85
Group variable: code                           Number of groups =        10

R-sq:  within = 0.8056                        Obs per group: min =         2
        between = 0.0634                                avg =        8.5
        overall = 0.0095                                max =        11

                                         F(8,67)         =       34.71
corr(u_i, Xb) = -0.7588                     Prob > F         =       0.0000

```

epgdp	Coef.	Std. Err.	t	P> t	[95% Conf. Interval]	
odr	.3073079	.1143004	2.69	0.009	.0791635	.5354524
leat65	.0921523	.1388274	0.66	0.509	-.1849485	.369253
dwl	-.3790897	.2073482	-1.83	0.072	-.7929584	.0347789
erateage1564	-.1832167	.0443285	-4.13	0.000	-.2716968	-.0947367
erover65	-.080315	.0736949	-1.09	0.280	-.2274107	.0667807
rrate	-2.192353	1.461102	-1.50	0.138	-5.108724	.7240181
educa5564	-.079356	.0359247	-2.21	0.031	-.151062	-.00765
labprod	-.0801031	.0251892	-3.18	0.002	-.130381	-.0298253
_cons	28.01615	6.759235	4.14	0.000	14.52466	41.50764
sigma_u	3.7476537					
sigma_e	.55892618					
rho	.97824115	(fraction of variance due to u_i)				

```

.F test that all u_i=0:      F(9, 67) =      16.08          Prob > F = 0.0000

```

```
. xtreg epgdp odr leat65 dwl erateage1564 erover65 rrate educa5564 labprod, re
```

```
Random-effects GLS regression              Number of obs   =       85
Group variable: code                      Number of groups  =       10

R-sq:  within = 0.7710                    Obs per group: min =        2
      between = 0.7287                      avg =       8.5
      overall  = 0.7743                      max =       11

                                           Wald chi2(8)      =    250.07
corr(u_i, X)  = 0 (assumed)                Prob > chi2       =    0.0000
```

epgdp	Coef.	Std. Err.	z	P> z	[95% Conf. Interval]	
odr	.2024104	.0821495	2.46	0.014	.0414004	.3634204
leat65	.3915911	.1120212	3.50	0.000	.1720337	.6111486
dwl	.0409575	.1662164	0.25	0.805	-.2848207	.3667356
erateage1564	-.2460757	.0351739	-7.00	0.000	-.3150153	-.1771361
erover65	-.0303041	.0654408	-0.46	0.643	-.1585657	.0979575
rrate	-1.603363	1.394592	-1.15	0.250	-4.336713	1.129987
educa5564	.0170923	.0164559	1.04	0.299	-.0151608	.0493453
labprod	-.0815627	.0264552	-3.08	0.002	-.1334141	-.0297114
_cons	5.69575	4.123721	1.38	0.167	-2.386594	13.77809
sigma_u	1.0946617					
sigma_e	.55892618					
rho	.79320709	(fraction of variance due to u_i)				

```
. hausman Fixed Random
```

	Coefficients			
	(b) Fixed	(B) Random	(b-B) Difference	sqrt(diag(V_b-V_B)) S.E.
odr	.3073079	.2024104	.1048976	.0794735
leat65	.0921523	.3915911	-.2994388	.0820019
dwl	-.3790897	.0409575	-.4200472	.1239571
erateage1564	-.1832167	-.2460757	.062859	.026978
erover65	-.080315	-.0303041	-.0500109	.0338887
rrate	-2.192353	-1.603363	-.5889898	.4358112
educa5564	-.079356	.0170923	-.0964483	.0319341
labprod	-.0801031	-.0815627	.0014596	.

b = consistent under Ho and Ha; obtained from xtreg
 B = inconsistent under Ha, efficient under Ho; obtained from xtreg

Test: Ho: difference in coefficients not systematic

```
chi2(8) = (b-B)'[(V_b-V_B)^(-1)](b-B)
        =      20.73
Prob>chi2 =      0.0079
(V_b-V_B is not positive definite)
```

```
. xtrc epgdpodr leat65 dwl erateage1564 erover65 rrate educa5564 labprod
Note: 15 obs. dropped (panels too small)
```

```
Random-coefficients regression      Number of obs   =       70
Group variable: code                Number of groups =        7

                                   Obs per group: min =        9
                                   avg =       10.0
                                   max =       11

                                   Wald chi2(7)      =        5.10
                                   Prob > chi2       =       0.6476
```

epgdpodr	Coef.	Std. Err.	z	P> z	[95% Conf. Interval]	
leat65	-.0294678	.0643011	-0.46	0.647	-.1554956	.09656
dwl	.0141546	.0590831	0.24	0.811	-.1016463	.1299554
erateage1564	.0080605	.0108848	0.74	0.459	-.0132733	.0293943
erover65	-.0026525	.0108483	-0.24	0.807	-.0239148	.0186098
rrate	.5737691	.474236	1.21	0.226	-.3557163	1.503255
educa5564	-.0164475	.0181389	-0.91	0.365	-.0519991	.0191042
labprod	-.0010238	.0081347	-0.13	0.900	-.0169675	.0149198
_cons	1.08292	1.516056	0.71	0.475	-1.888494	4.054334

```
Test of parameter constancy:      chi2(48) =    64.72      Prob > chi2 = 0.0540
```

```
. estat hettest
```

```
Breusch-Pagan / Cook-Weisberg test for heteroskedasticity
Ho: Constant variance
Variables: fitted values of epgdpodr
```

```
chi2(1)      =    0.16
Prob > chi2   =    0.6876
```

```
. xtreg epgdpodr leat65 dwl erateage1564 erover65 rrate educa5564 labprod, fe
```

```
Fixed-effects (within) regression           Number of obs   =       85
Group variable: code                       Number of groups =       10

R-sq:  within = 0.3317                     Obs per group:  min =        2
        between = 0.0949                             avg =       8.5
        overall = 0.1285                             max =       11

                                           F(7,68)         =       4.82
corr(u_i, Xb) = -0.9063                     Prob > F         =       0.0002
```

epgdpodr	Coef.	Std. Err.	t	P> t	[95% Conf. Interval]	
leat65	-.0046192	.0071799	-0.64	0.522	-.0189466	.0097081
dwl	-.0174035	.013503	-1.29	0.202	-.0443483	.0095413
erateage1564	-.0028131	.0029005	-0.97	0.336	-.0086009	.0029747
erover65	.0059056	.0048255	1.22	0.225	-.0037234	.0155347
rrate	.0475169	.091606	0.52	0.606	-.1352801	.2303139
educa5564	-.0044689	.0023119	-1.93	0.057	-.0090822	.0001444
labprod	-.0056568	.0016496	-3.43	0.001	-.0089485	-.0023651
_cons	1.449462	.4398454	3.30	0.002	.571764	2.32716
sigma_u	.15256242					
sigma_e	.03660732					
rho	.94555861	(fraction of variance due to u_i)				

```
F test that all u_i=0:      F(9, 68) =      14.46      Prob > F = 0.0000
```

```
. xtreg epgdpodr leat65 dwl erateage1564 erover65 rrate educa5564 labprod, re
```

Random-effects GLS regression Number of obs = 85
Group variable: code Number of groups = 10

R-sq: within = 0.2848 Obs per group: min = 2
 between = 0.4148 avg = 8.5
 overall = 0.2483 max = 11

corr(u_i, X) = 0 (assumed) Wald chi2(7) = 32.44
 Prob > chi2 = 0.0000

epgdpodr	Coef.	Std. Err.	z	P> z	[95% Conf. Interval]	
leat65	.0004484	.004916	0.09	0.927	-.0091868	.0100837
dwl	.0055514	.0098268	0.56	0.572	-.0137088	.0248117
erateage1564	-.0067808	.0021071	-3.22	0.001	-.0109107	-.0026509
erover65	.0036538	.0038996	0.94	0.349	-.0039893	.0112968
rrate	.0306819	.0847953	0.36	0.717	-.135514	.1968777
educa5564	.0001005	.0009276	0.11	0.914	-.0017176	.0019185
labprod	-.0062015	.0016519	-3.75	0.000	-.0094391	-.0029639
_cons	.6099801	.2371279	2.57	0.010	.145218	1.074742
sigma_u	.05988134					
sigma_e	.03660732					
rho	.72794738	(fraction of variance due to u_i)				

```
. hausman Fixed Random
```

	Coefficients			
	(b) Fixed	(B) Random	(b-B) Difference	sqrt(diag(V_b-V_B)) S.E.
leat65	-.0046192	.0004484	-.0050677	.005233
dwl	-.0174035	.0055514	-.022955	.0092609
erateage1564	-.0028131	-.0067808	.0039677	.0019931
erover65	.0059056	.0036538	.0022519	.0028422
rrate	.0475169	.0306819	.016835	.0346614
educa5564	-.0044689	.0001005	-.0045694	.0021176
labprod	-.0056568	-.0062015	.0005447	.

b = consistent under Ho and Ha; obtained from xtreg
B = inconsistent under Ha, efficient under Ho; obtained from xtreg

Test: Ho: difference in coefficients not systematic

chi2(7) = (b-B)'[(V_b-V_B)^(-1)](b-B)
= 23.42
Prob>chi2 = 0.0014
(V_b-V_B is not positive definite)

Dynamic panel-data estimation, one-step difference GMM

Group variable: code	Number of obs	=	70
Time variable : year	Number of groups	=	10
Number of instruments = 47	Obs per group: min	=	1
F(11, 59)	=	34.81	avg = 7.00
Prob > F	=	0.000	max = 10

epgdp	Coef.	Std. Err.	t	P> t	[80% Conf. Interval]	
epgdplag1	.408849	.1253042	3.26	0.002	.2464465	.5712514
labprod	.0497185	.034595	1.44	0.156	.0048811	.0945559
erateage1564	-.0825326	.0464481	-1.78	0.081	-.1427324	-.0223327
educa5564	-.0262512	.0363901	-0.72	0.474	-.0734152	.0209128
rrate	-2.629974	1.249812	-2.10	0.040	-4.249812	-1.010136
gdppercapita	.688949	1.08885	0.63	0.529	-.722272	2.10017
gdpgrowth	-.8092452	1.089215	-0.74	0.460	-2.22094	.6024491
erover65	-.0534421	.0631863	-0.85	0.401	-.1353357	.0284515
dwl	-.1756521	.1756719	-1.00	0.321	-.4033344	.0520302
leat65	.0560534	.1240427	0.45	0.653	-.1047141	.216821
odr	.2391642	.1207138	1.98	0.052	.0827112	.3956172

Instruments for first differences equation

Standard

D.(epgdp labprod educa5564 rrate gdppercapita gdpgrowth erover65 dwl
leat65 odr)

GMM-type (missing=0, separate instruments for each period unless collapsed)

L2.(gdpgrowth gdppercapita erover65 labprod)

Arellano-Bond test for AR(1) in first differences: z = -3.20 Pr > z = 0.001

Arellano-Bond test for AR(2) in first differences: z = -0.99 Pr > z = 0.322

Sargan test of overid. restrictions: chi2(36) = 60.61 Prob > chi2 = 0.006
(Not robust, but not weakened by many instruments.)

Difference-in-Sargan tests of exogeneity of instrument subsets:

iv(epgdp labprod educa5564 rrate gdppercapita gdpgrowth erover65 dwl leat65 odr)

Sargan test excluding group: chi2(26) = 31.39 Prob > chi2 = 0.214

Difference (null H = exogenous): chi2(10) = 29.23 Prob > chi2 = 0.001

.

Dynamic panel-data estimation, one-step difference GMM

Group variable: code	Number of obs	=	70
Time variable : year	Number of groups	=	10
Number of instruments = 39	Obs per group: min	=	1
F(10, 60) = 7.56	avg	=	7.00
Prob > F = 0.000	max	=	10

epgdpodr	Coef.	Std. Err.	t	P> t	[95% Conf. Interval]	
epgdpodr						
L1.	.2278411	.1316249	1.73	0.089	-.0354479	.4911301
leat65	-.0029231	.007645	-0.38	0.704	-.0182153	.012369
dwl	-.0065705	.0126773	-0.52	0.606	-.031929	.018788
erateage1564	.0034104	.0026767	1.27	0.208	-.0019437	.0087646
erover65	-.0034183	.0043575	-0.78	0.436	-.0121346	.0052979
gdpgrowth	-.0418737	.0750713	-0.56	0.579	-.1920386	.1082911
gdppercapita	.0327327	.0750054	0.44	0.664	-.1173005	.1827659
rrate	.0897793	.0780023	1.15	0.254	-.0662485	.2458072
educa5564	-.0010471	.0027084	-0.39	0.700	-.0064647	.0043705
labprod	.00583	.0025443	2.29	0.025	.0007405	.0109194

Instruments for first differences equation

Standard

D.(epgdpodr labprod educa5564 rrate gdppercapita gdpgrowth erover65
erateage1564 dwl leat65)

GMM-type (missing=0, separate instruments for each period unless collapsed)

L2.(epgdpodr gdpgrowth educa5564)

Arellano-Bond test for AR(1) in first differences: z = -2.01 Pr > z = 0.045
Arellano-Bond test for AR(2) in first differences: z = -1.77 Pr > z = 0.076

Sargan test of overid. restrictions: chi2(29) = 67.71 Prob > chi2 = 0.000
(Not robust, but not weakened by many instruments.)

Difference-in-Sargan tests of exogeneity of instrument subsets:

gmm(epgdpodr gdpgrowth educa5564, lag(2 2))

Sargan test excluding group: chi2(0) = 0.00 Prob > chi2 = .

Difference (null H = exogenous): chi2(29) = 67.71 Prob > chi2 = 0.000

iv(epgdpodr labprod educa5564 rrate gdppercapita gdpgrowth erover65 erateage1564 dwl leat65)

Sargan test excluding group: chi2(19) = 13.54 Prob > chi2 = 0.810

Difference (null H = exogenous): chi2(10) = 54.18 Prob > chi2 = 0.000

.

